



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 23, 26 DHE 30 KORRIK 2018**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 23, 26. I 30. JULA 2018. GODINE**

**KORRIK - JUL
2018**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-066 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për patentë shoferë,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-067 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-069 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-070 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për transportin rrugor,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-071 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme,
9. Debat parlamentar për dialogun me Serbinë,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-065 për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës,
13. Propozimi i grupeve parlamentare të AAK-së dhe Nismës Socialdemokrate për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare,
14. Shqyrtimi i raportit vjetor i Autoritetit Rregullator për Ujëra për vitin 2017,
15. Shqyrtimi i raportit vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017,
16. Shqyrtimi i raportit vjetor për vitin 2017 i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanje van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-066 o izmeni i dopuni Zakona br. 05/L-064 o vozačkoj dozvoli,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-067 o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-063 o železnicama Kosova,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-068 o izmeni i dopuni Zakona br. 2003/11 o putevima, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 03/L-120,
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-069 o izmeni i dopuni Zakona br. 05/L-088 o pravilima drumskog saobraćaja,
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-070 o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-179 o drumskom saobraćaju,
8. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-071 o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-183 o drumskom transportu opasnih materija,
9. Parlamentarna rasprava o dijalogu sa Srbijom,
10. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-082 o zaštiti ličnih podataka,
11. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-065 o razmatranju i potvrđivanju neopravdane imovine,
12. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-084 o zaštiti deteta,
13. Predlog parlamentarnih grupa AAK i Nisma za zamenu članova pri parlamentarnim komisijama,
14. Razmatranje Godišnjeg izveštaja regulativnog autoriteta za vode za 2017,
15. Razmatranje Godišnjeg izveštaja o performansi Nacionalne kancelarije za reviziju za 2017,
16. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Regulatornog autoriteta elektronskih i poštanskih komunikacija za 2017. god.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Po e vazhdojmë seancën e re plenare.

Urdhëro, zonja Blerta Deliu-Kodra, edhe zonja Ganimete Musliu e ka kërkuar fjalën. Urdhëro!

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqë ende nuk jemi futur në rendin e ditës, kam një propozim që të plotësohet rendi i ditës i mbledhjes së sotme plenare me dy pika. Do të thotë është: Ratifikimi i Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin “Evropa për qytetarët” dhe po ashtu ratifikimi i marrëveshjes financiare për RIPA 2017 pjesa e parë ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Komisioni për Integritet i ka trajtuar të ky këto marrëveshje në njërin prej mbledhjeve të fundit që i kemi mbajtur dhe ka vendosur që me procedurë të përshpejtuar t’i sjellë në seancë.

Shpresoj që do të kemi mundësi t’i futim në rendin e ditës, për shkak se na duhen që ta mbërrimë muajin shtator që qytetarët të arrijnë të përfitojnë sidomos nga marrëveshja “Evropa për qytetarët”.

Ndonëse sot u pa që është e vështirë të votohet ratifikimi i marrëveshjeve, propozoj që të futen në rend të ditës për seancën e sotme.

KRYETARI: Faleminderit! E nderuar deputete, vetëm të futemi në seancë. Kisha pasur dëshirë që regjia ta mbajë këtë pjesë të propozimit pastaj kur të futemi në seancë. Është vendimmarrje e seancës për futjen e pikave të rendit të ditës, 2/3 e pjesëmarrësve.

Të nderuar deputetë, jemi në seancë të re plenare,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës.

Para se të futemi, pra në seancë plenare e kemi këtë propozimin e zonjës deputete Blerta Deliu-Kodra. Do të thotë është futja pikë e rendit të ditës, Shqyrtimin e Projektligjit nr. 06/L-090 për ratifikimin e marrëveshjes financiare për IPA 2017, pjesa e parë ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Kërkohet shmangie nga afatet procedurale të parapara në nenin 15, paragrafi 7 të Rregullores së Kuvendit dhe për Shqyrtimin e Projektligjit nr. 06/L-094 për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin “Evropa për qytetarët” kërkohet shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 15, paragrafi 7 dhe neni 56 paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit. Do të thotë, duhen 2/3 e deputetëve. A ka mundësi t’i vë të dyja bashkarish edhe votojmë prezencën një herë. 92 deputetë janë në sallë, votojmë në mënyrë elektronike për shmangien nga Rregullorja e Kuvendit futjen e pikave në rend të ditës këto dy projektligje, të cilat i thashë më lart dhe janë të propozuara nga zonja deputete Blerta Deliu Kodra. Votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar. 61 për. Futen në pika të rendit të ditës, do të vazhdojmë menjëherë në pikat e rendit të ditës, kërkohet falje, a dëshironi t’i vini më projektligjet, të cilat janë edhe këto bashkërisht në votim pasi janë me shmangie menjëherë? Do t’i fusim me projektligje. Ilir, urdhëro!

ILIR DEDA: Faleminderit!

Vetëm po dua të sqaroj këtu dy marrëveshjet me Bashkimin Evropian janë 48 milionë euro e gjysmë për sivjet, të cilat ndahen për qytetarët e Kosovës. Përfitojnë niveli komunal të rinjtë, bizneset e reja, e gjëra tjera. Të gjitha partitë politike sot kanë qenë prezentë në Komision për Integritet dhe unanimisht të gjithë e kanë ngritur dorën që kanë votuar pro, që ta kalojmë sot në këtë seancë me 2/3 se kjo ka të bëjë me asistencën direkte, e cila nuk i shkon Qeverisë, por i shkon qytetarëve të Kosovës, 48.5 milionë euro deri në dhjetor të këtij viti. Domethënë, nëse nuk e aprovojmë tash ne i humbim 48 milionë euro prej BE-së, grante për Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, njoftimi i deputetit është sqarim i mjaftueshëm, futen në pika të rendit të ditës 3 dhe 4, vetëm është votim formal. Vazhdojmë me pikën e parë, zonja Musliu po e shoh po futem në pika të rendit të ditës,

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit zgjat deri në tre minuta. Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarojnë se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën. Zonja Ganimete Musliu, urdhëroni, fjala për ju!

GANIMETE MUSLIU: I nderuari kryetar i Kuvendit!

I nderuari kryeministër,

Ministra,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Më lejoni që sot t'i uroj qytetarët e Runikut dhe ta përgëzoj ministrin e Kulturës, zotin Kujtim Gashi, që ka marrë vendim që nga sot shtëpia e kulturës në Runik të jetë pjesë e listës së trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme.

Pushteti lokal i Skenderaj në të kaluarën ka bërë vazhdimisht kërkesa, të cilat mund të gjenden të protokolluara diku në arkivat e ministrisë që Shtëpia e Kulturës në Runik të jetë në listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme. Fatkeqësisht ato kërkesa kanë rënë në vesh të shurdhër dhe ai institucion i cili ka një histori të veçantë për kulturën dhe atdhedashësit e asaj ane deri më tani ka mbetur si në një gërmadhë që thërret në ndërgjegjen e institucioneve përgjegjëse të vendit.

I nderuari ministër, Drenica e në veçanti qytetarët e Runikut sot e mirëpresin lajmin për vendimin që e keni marrë në raport me Shtëpinë e Kulturës në Runik dhe ju inkurajojnë që të merrni sa më shumë vendime të tilla, ku aktivitetet kulturore do të rrisin interesimin e të rinjve për pjesëmarrje aktive në jetën kulturore dhe të rinjtë e Kosovës do t'i heqin nga rruga. Brezat e rinj duhet ta dinë për të kaluarën e pasur kulturore e historike të paraardhësve të tyre dhe të kultivojnë me krenari traditën dhe kulturën tonë të begatshme për brezat e ardhshëm. Edhe një herë, i nderuari ministër, uroj qytetarët e Skenderaj dhe Runikut dhe gjithashtu ju falënderoj juve për gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe përfundimisht Shtëpinë e Kulturës në Runik ta fusni në mbrojtje të trashëgimisë kulturore, kjo shtëpi e cila dëshmon vlera në kulturën e Kosovës në përgjithësi, e të Drenicës në veçanti.

Gjithashtu, më lejoni të ju përgëzoj edhe për vendimin që e keni marrë për selinë e Shtabit të Brigadës 121 Komandant Kumanova në Lipjan. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Valentina Bunjaku-Rexhepi. Ju kisha lutur deputetëve që të paraqiten a e marrin fjalën në emër të tyre si deputetë apo në emër të grupit parlamentar.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuari kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Unë do të flas në emër timin personal. Të nderuar deputetë, Ligji për rendin dhe qetësinë publike duhet të ndryshojë për periudhat e qëndrimit të bashkatdhetarëve dhe mërgimtarëve tanë, përkatësisht gjatë pushimit veror dhe atij të shkurtër dimëror.

Neni 8, bezdisje publike dhe shkeljet që kanë të bëjnë me zhurmën në paragrafin 1 parasheh: “kushdo që shkakton zhurmë të panevojshme dhe të padurueshme që dëgjohen nga banorët përreth apo në rrugë dhe që shqetëson personat e tjerë është deri në orën 22:00 e deri në orën 07:00 të mëngjesit, gjatë ditëve të javës dhe prej 23:00 deri në orën 07:00 të mëngjesit të

shtunave dhe të dielave”. Dënohet për kundërvajtje. Ne propozojmë që ky orar të ndryshojë gjatë pushimit të gjatë veror e sidomos në praninë e mërgimtarëve tanë në vendlindje duke e shtyrë deri në ora 24:00 e jo në ora 23:00. Mandej, kjo shtyrje jo vetëm gjatë të shtunave dhe të dielave, por edhe gjatë ditëve të javës. Po ashtu, kjo duhet të vlejë edhe në pushimin dimëror, përkatësisht në festat e dhjetorit dhe ditëve të para të janarit, ku kemi po ashtu shumë mërgimtarë në Kosovë. Kufizimi i argëtimit të rinisë së mërgatës dhe qytetarëve lokal është kufizim edhe i lirisë së plotë të mërgimtarëve dhe nevojës për relaksim të tyre. Ne duhet t’i joshim dhe t’i nxisim të rinjtë e mërgatës të vijnë në Kosovë dhe të mbajnë lidhje të fuqishme me vendlindjen duke ua mundësuar atyre jetën, argëtimin qoftë edhe duke pasur shumë zhurmë... sepse ata janë një shtresë e bashkëqytetarëve tanë, të cilët japin frymë dhe energji Kosovës.

Kosova nuk është vendi i tërheqjes masive të turistëve të huaj dhe mërgata jonë janë bashkëkombësit dhe turistët më të mirë. Prandaj, mërgata duhet të jetë pjesë e agjendës kombëtare, pjesë e politikave turistike, pjesë e politikanëve të dhënies të sa më shumë mundësive për argëtim e kalim të mirë të kohës në vendlindje dhe unë si deputete kërkoj që të ndryshohet Ligji për rendin dhe qetësinë publike dhe kërkoj që ta iniciojë ndryshimin e këtij projektligji dhe normalisht që kërkoj edhe ndihmën e gjithë deputetëve tjerë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Salih Salihu e ka fjalën.

SALIH SALIHU: Në emër të grupit. Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot dua të flas për gjendjen e rëndë të bujqësisë e shkaktuar si pasojë e reshjeve dhe motit shumë të keq që po mbizotëron muajve të fundit. Në këtë drejtim gjendja më e rëndë është në sektorin e drithërave, veçanërisht në kulturën e grurit e cila është në fazën e korrjes.

Shiu që ka ra thujse çdo ditë ka dëmtuar shumë sipërfaqet bujqësore të mbjella me grurë, të cilat rrezikonin të mbesin pa u korrur. Për fat të mirë dje edhe pardje ishte ditë pak më e mirë dhe është vërejtur se bujqit janë duke bërë përpjekje për t’i kryer korrjet e tyre. Reshjet përveç që kanë shkaktuar dëme në rendiment, si pasojë e peshës absolute dhe peshës ... të ulët ka dëmtuar rëndë edhe cilësinë e grurit duke hidrolizuar komponentët kimike në produktet që prishin vetit e miellit për bërjen e bukës cilësore. Rendimenti mesatar në disa regjione sipas informatave nga prodhuesit e grurit sillet rreth 2 ton për hektar, e që kjo është një humbje e madhe për bujqit e Kosovës, si dhe do të rritë nevojën e importit të grurit për plotësimin e nevojave të popullatës për ushqim. Dëmet janë evidente edhe te kulturat tjera bujqësore, si vreshta, në regjionin e Rahovecit, pastaj ushqimi i kafshëve nga bari i thatë këtë vit është dëmtuar rëndë, thujse gjithkund në Kosovë, si dhe dëmtimi i misrit nga breshëri në disa pjesë të Kosovës e veçanërisht në Anamoravë.

Dëme kanë pësuar edhe perimet në fusha të hapura, por edhe në sera për shkak të lagështisë së madhe relative të ajrit, por edhe për shkak të ngritjes së nivelit të ujërave nëntoksore. Pra, në përgjithësi ky vit ishte një vit i vështirë për bujqit e Kosovës që do të ketë influencë edhe në ekonominë e vendit tonë. Dëmet janë shumë të mëdha, bujqit janë në gjendje shumë të rëndë, Qeveria nuk ka fond për t'i kompensuar ata. Kosova nuk ka sigurim të produkteve bujqësor e as sistem mbrojtës kundër breshrit, prandaj në këtë me këtë rast dua të kërkoj nga Qeveria që sa më parë të bëjë evidentimin dëmeve në terren dhe të ju dal në ndihmë bujqve të Kosovës. Tashmë u bënë gati dy muaj që u dëmtuan qindra hektarë të vreshtave në Rahovec, ndërkohë që nuk kemi asnjë veprim konkret në drejtim të kompensimit të tyre. Gjithashtu, ky vit duhet të na shërbejë si mësim dhe në projektimet buxhetore për bujqësi të ndahet një linjë e veçantë buxhetore për dëmet eventuale nga fatkeqësitë natyrore, sepse vitet e tilla të vështira mund të kemi përsëri në të ardhmen.

Fermerët tanë kanë mjaft telashe me imputet jo cilësore dhe shumë të shtrenjta, fara, plehu artificial, pesticidet dhe të gjitha këto importohen me çmime të larta duke ngritur koston e prodhimit për njësi të sipërfaqes në raport me vendet fqinjë, e tash nëse edhe nga moti i keq dëmtohen dhe si shtet nuk mund t'u dalim në ndihmë këtyre njerëzve, atëherë fermerët e Kosovës do të detyrohen të heqin dorë nga kjo veprimtari. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Javën e kaluar kemi qenë dëshmitarë të një deklaratë të papranueshme nga ana e Presidentit të Kosovës, i cili u shpreh pak a shumë kështu që Kosovën e presin kompromise të dhimbshme me Serbinë. Tashmë jam i bindur që këta dy presidentë, Thaçi dhe Vuçiqi, lëre më që nuk janë konfrontim i interesave, por madje nuk janë as palë.

Ata, e kanë arritur statusin e Tandemit, si njëfarë binomi që sapo e përmend njërin të asocion tjetrin. Vuçiqi për Thaçin mendon që ai paraqet shansin e përkryer për një kompromis të majmë, me Thaçin ai synon të arrijë edhe Bashkimin Evropian, edhe autonominë serbe në Kosovë. Kurse, Thaçi për Vuçiqin mendon që ai paraqet shans të përkryer për ta shpëtuar nga të gjithë ata faktorë të fuqishëm që mendojnë se i ka ardhur koha të largohet nga skena politike. Presidenti jonë mendon që nëse dikush prej fuqive të mëdha dëshiron ta heq qafe, ai e ka në dorë së bashku me Vuçiqin skenarin e stabilitetit rajonal, i cili edhe mund të rrezikohet nëse këta dy dëshirojnë. Në këtë mënyrë ata janë bërë qift i ndërvarur dhe Mogerinit po i pëlqen ky vallëzim, sepse po dëshiron me çdo kush që brenda mandatit të saj të arrijë një marrëveshje Kosovë-Serbi. Natyrisht, ngutja e saj nuk është e thënë të përputhet me realizimin e interesave tona, ky proces padyshim që është i rëndësishëm ama jam i bindur që ngutja më shumë i përket CV-së, se sa vetë procesit. Shikuar nga ky pozicion, e ne besojmë që ky është një pozicion i vërtetë puna më e shëndetshme politikisht është që ta shpërfaqim motivin e këtij trekëndëshi dhe të mos i shkojmë Thaçit prapa në këtë aventurë të rrezikshme.

Pra, në gjendjen aktuale nuk ka qëndrim më shtetëror dhe më kombëtar se ky. Së pari duhet të refuzohet absolutizmi i Thaçit, së dyti duhet të kundërshtohet uzurpimi që po ia bën ai këtij procesi, ai po sillet në stilin “unë jam Kosova”. Së treti, të mos tolerohet vetë shpallja e tij dhe vetë mandatimi i tij që të shkojë në bisedime dhe të vendosë çka dëshiron ai. Shpesh e kam dëgjuar këto ditë një kërkesë absurde nga pushteti, e kjo është thirrja që ta krijojmë një unitet me Presidentin Thaçi.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, në emër të grupit? Kryetari i Grupit Parlamentar, Glauk Konjufca e ka pasur fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Shpresoj të jenë të rastësishme këto të gjitha që po na ndodhin. Shpesh e kam dëgjuar kërkesën që të krijohet unitet me Hashim Thaçin, kjo kërkesë është ironike, sepse Thaçi në shoqërinë tonë është vetë simboli i përçarjes. Kush i ka fajet, a thua pse ky njeri është i tillë? A i ka fajet vetë ai me veprimet e deritashme politike? Apo i ka fajet opozita?

20 vite karrierë politike të këtij personi kanë treguar rregullën kryesore të pushtetit që ai e ka, bashkëpunëtorët i trajton sikur çorapet. Nëse i bëhesh servil, nëse je patericë e jetëgjatësisë së tij të mban afër, të lavdëron, të ngrit, pak me dashtë bile të bën edhe kryeministër apo drejtor të Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës. Ama, kur e sheh që nëpërmjet teje po rrezikohet nuk të njeh, të shkel, të sakrifikon dhe të hedh si leckë. Këtë përvojë e kanë të gjithë bashkëpunëtorët e tij të kaluar, nëse të ka kundërshtar të vendosur së pari të joshë, pastaj ta tërheq vërejtjen, pastaj të kërcënon, ta lëshon policinë, nëse nuk ndalesh t’i hedh në qafë prokurorët dhe gjyqtarët e korruptuar.

Këtë përvojë e ka Lëvizja Vetëvendosje me Presidentin Thaçi, kurse ata të cilët e zgjedhin i rrëzon prapa shpine, siç bëri për shembull me Lidhjen Demokratike të Kosovës. Si mund të quhet atëherë ky njeri person i cili e arrin unitetin në Kosovë. Unë mendoj që është dëm i madh t’ia lëmë fatin e brezave të ardhshëm një njeriu si ky.

KRYETARI: Faleminderit! Glauk, më vjen keq po as s’kam qenë duke e vëzhguar kohën, por sido që të jetë regjia kisha pas dëshirë nuk e di a e pate deklarin në fillim që je në emër të Grupit. As nuk bëj ndërhyrje, as, për aq sa mundesh t’i me bë ndërhyrje nga ajo pjesa ku je ti. Asnjë ndërhyrje, ta jap fjalën, kjo është për korrektësi për mua po flas tash si kryetar, se më erdh keq nuk desha të ndërhyjë, por fare as s’kam bërë ndërhyrje, as nuk kam qenë i koncentruar te pjesa e kohës.

Bilalli e pati një vërejtje shumë të mirë, deklarohuni, është mirë me e sjellë paraprakisht kur je në emër të grupeve parlamentare mund t’ju dalloj, e pastaj ju jap fjalën vetëm në emër të grupeve

dhe nga pesë minuta, mjafton një letër me shkrim grupet parlamentare përcaktojnë njeriun i cili dëshiron të flasë në emër të grupit parlamentar edhe ka pesë minuta, dhe unë së pari u jap atyre fjalën. Jo, pastaj deputetëve. Tani është situata në mes të Ahmet Isufit dhe Teuta Haxhiut. Cili e merr fjalën në emër të Grupit Parlamentar? Ahmet Isufi, të lutem!

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministra, kolegë deputetë,

Derisa ne po flasim për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, kemi veç lëvizje, të cilat shqetësojnë qytetarët e Kosovës e sidomos ata të brezit kufitar në Karaqevë, me të cilin rast është vendosur edhe një tabelë, e cila pamundëson lëvizjen e qytetarëve në pronat e tyre dhe kjo duhet të alarmojë edhe Qeverinë, edhe të gjitha institucionet e vendit në mënyrë që të dilet në mbrojtje të territorit të Kosovës dhe të mos lejohet që të shkelet kufiri dhe të cenohet integriteti territorial i vendit.

E di që ka pas probleme edhe në të kaluarën, por tani kur po flitet për dialogun normalisht edhe stacionimi i forcave serbe në pjesën jugore është me bazë që në të vërtetë i shqetëson qytetarët e kësaj ane. Prandaj, duhet të merren hapa të domosdoshëm në mënyrë që të ketë siguri më të madhe në pjesën kufitare, sidomos në pjesën që e përmenda. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi, sigurisht në emër të Grupit Parlamentar.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Po, në emër të grupit, unë kësaj radhe do të bëj një dallim mes le të quaj idenë që ka kjo pikë e rendit të ditës, unë sot nuk do të ankojem, as nuk do të kritikoj, por thjeshtë do të shfrytëzoj këtë pikë të rendit të ditës që të shpreh mirënjohjen për një kategori të njerëzve të kësaj shoqërie që në këto ditë të fluksit të madh të njerëzve nga diaspora, të fluksit të madh të turistëve në Republikën e Shqipërisë, apo të Malit të Zi, të cilët po kujdesen në mënyrë të jashtëzakonshme dhe me sukses të madh të mbajnë rendin dhe të kontribuojnë për mbarëvajtjen në komunikacion dhe në pikat kufitare. Pra, bëhet fjalë për policët e Kosovës.

Unë thjeshtë po e shfrytëzoj këtë rast për të ju shpreh mirënjohje për tërë angazhimin që janë duke e bërë në këtë drejtim. Thjesht, dje më ka rastisë të kthehem nga Republika e Shqipërisë dhe gjatë tërë rrugës, qoftë në territorin e Republikës së Shqipërisë, apo në territorin e Kosovës në pikën kufitare angazhimi i tyre, organizimi i tyre, mënyra e trajtimit krejt të kësaj situatë ka qenë e jashtëzakonshme për një periudhë 5 deri 10 minuta nuk i ka rënë asnjë veturë të pres më shumë. Pra, i përgëzoj dhe ju shpreh mirënjohje edhe në emër të Nismës, edhe në emër të gjithë atyre që përfaqësoj për kontributin e tyre të palodhshëm me orë të tëra duke u angazhuar që

mbarëvajtja edhe në pikat kufitare, edhe gjatë rrugës e komunikacionit, sidomos me fëmijë të vegjël, veturat të cilat kanë familje besoj që e vlerësojnë edhe më shumë se sa kushdo tjetër.

Unë, thashë nuk do të ankojem, sepse zakonisht në këtë pikë të rendit të ditës e shfrytëzojmë për gjuajtje nga llogoret të njëri-tjetrit, apo të ndonjë institucioni tjetër unë kësaj radhe po e shfrytëzoj këtë për atë që e thashë, natyrisht që kjo shkon edhe për ministrinë e ri, i cili jam i sigurt që e ka pjesën e kontributit që krejt ky mekanizëm të funksionojë siç është më së miri, sidomos siç thashë në këtë kohë kur kemi fluks të madh të njerëzve në Kosovë, hyrje-dalje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fidan Rekaliu e ka fjalën.

FIDAN REKALIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar bashkëqytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dua të shpreh një shqetësim të fermerëve llapjan nëpërmjet pikës për deklaram jashtë rendit të ditës. Siç është njoftuar tashmë për opinionin, Komuna e Podujevës sidomos në katër vitet e fundit është shndërruar në një zonë të kultivimit të shumë kulturave bujqësore e veçanërisht asaj të mjedrës. Kushtet e mira klimatike dhe cilësia e tokës së punueshme në njërën anë dhe ndjenja e ndërmarrësisë e punëtorëve të zellshëm që i karakterizon fermerët e ndërmarrësit nga Podujeva, por jo vetëm ka ndikuar që viteve të fundit të kemi një shtim impresiv të numrit të fermerëve në këtë komunë.

Komuna e Podujevës si përkrahëse dhe iniciuese e shumë iniciativave mbështetëse kishte arritur që të sensibilizojë edhe donatorë të jashtëm, ku mbështetja më e madhe erdhi nga USAID-i Amerikan me projekte zhvillimore të qëndrueshme, që e mbështetin zhvillimin ekonomik, rritjen e prodhimit dhe të punësimit.

Si rezultat i gjithë këtyre faktorëve që përmenda më lartë brenda një periudhe të shkurtër komuna e Podujevës u shndërrua në një qytet që identifikohet me kulturën e mjedrës dhe kjo jo për shkak sepse për më pak se dy vite u mbollën mbi njëmijë hektarë mjedër. Cilido shtet e qeveri serioze, jo vetëm do t'i gëzohej një fakti të tillë, por edhe do të hartonte politika mbështetëse për të rritur e inkurajuar këtë lloj ndërmarrësie që ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e prodhimit dhe punësimit në vend. Sot fermerët dhe kultivuesit e mjedrës në komunën e Podujevës, por edhe më gjerë, gjenden në një pozitë të vështirë të afarizmit për shkak të rënies së çmimeve.

Çfarë do të mund të bënte kjo Qeveri dhe që varet vetëm nga vullneti politik është që nëpërmjet të Ministrisë së Bujqësisë dhe programeve mbështetëse të rishikojë dhe të ridizajnojë politikat mbështetëse, duke trajtuar me prioritet të veçantë kulturat bujqësore dominonte në vendin tonë, në rastet ku ndodhin kriza që rrezikojnë qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e kultivimit të këtyre

kulturave bujqësore (rrushi në Rahovec, molla në Istog, mjedra në Podujevë apo kultura tjera bujqësore në komunat tjera).

Duhet të subvencionohen në mënyrë të veçantë në raste të tilla, kur çmimet kanë rënë dhe rrezikohet qëndrueshmëria e kultivimit të një kulture që mbështet sektorin prodhues në vend.

Dua të apeloj tek Qeveria, Ministria e Bujqësisë dhe sidomos te kolegët deputetë, që të angazhohen në këtë drejtim pasi që këto programe të mbështetjes dhe subvencionimit në raste të tilla, siç i përmenda më lartë, janë drejtpërdrejtë investim në prodhim, punësim dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për vendin dhe qytetarët.

Investimi i mëtejshëm duhet të bëhet edhe në ngritjen e kapaciteteve humane në trajnimin e këtyre produkteve, të cilat mund të kenë impakt në zhvillim ekonomik të vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Memli Krasniqi, urdhëro!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Po ndihem jashtëzakonisht mirë në këtë pikë, që sot ka diskutime veçanërisht për fermerët dhe diskutimi im do të jetë për këtë çështje dhe mirëpres edhe diskutimet e kolegëve Salihu dhe Rekalju, ndoshta Fidanin e kisha përmirësuar pak. Është e vërtetë që ka pasur ndihmë shumë prej donatorëve, por është pakrahasimisht ndihma e Ministrisë së Bujqësisë më e madhe se krejt donatorët bashkë, edhe si investim nëpërmjet grandeve, edhe si investim nëpërmjet subvencioneve, edhe në komunën e Podujevës, po kudo tjetër në Kosovë.

Unë do të flas për një çështje tjetër, vendimi për masën e përkohshme mbrojtëse në importin e pemëve dhe perimeve, marrë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë më datë 13 korrik dhe në zbatim nga data 18 korrik, që është marrë duke u bazuar në Ligjin për masat mbrojtëse në importe. Pas hetimeve dhe vlerësimeve të nevojshme, siç parashihen me legjislacionin në fuqi ka krijuar një situatë të re në tregun vendor, që potencialisht u krijon mundësi prodhuesve vendorë, para së gjithash fermerëve tanë, për t'i vendosur në treg dhe për t'i shitur prodhimet e tyre.

Aneksi i vendimit në fjalë liston 21 produkte bujqësore (pemë dhe perime), të cilat kultivohen në vendin tonë. Unë mirëpres në parim këtë vendim. Meqë, jemi në sezonin kur shumica e këtyre produkteve e kanë fazën e vjeljes dhe në mungesë të kapaciteteve të mjaftueshme për ruajtje afatgjate, masat mbrojtëse në fjalë do t'i ndihmojë fermerët tanë që të jenë shumë më konkurrues në treg. Sidoqoftë, unë jam i befasuar me mospërfshirjen e rrushit në vendimin dhe listën e produkteve që do t'i nënshtrohen masës së përkohshme mbrojtëse. Për këtë çështje gjatë javës së kaluar kam biseduar me vreshtarë të ndryshëm të komunës së Rahovecit, por edhe të komunës së

Suharekës dhe kërkesa e tyre pa përjashtim është që listës së produkteve të mbrojtura në këtë fazë t'i shtohet edhe rrushi.

Janë mbi 3 500 hektarë me vreshta në Kosovë dhe me qindra familje që merren me kultivimin e rrushit dhe ata e meritojnë që të kenë kujdesin e institucioneve shtetërore, njëjtë si kultivuesit e kulturave tjera bujqësore që favorizohen nga vendimi i përmendur më herët. Andaj, kërkoj me këtë rast nga ministri i Tregtisë dhe Industrisë, që sa më parë të bëjë plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për masë të përkohshme mbrojtëse për të përfshirë edhe rrushin në listën e kulturave bujqësore, të cilat adresohen nga ky vendim dhe në këtë mënyrë për të ndihmuar edhe fermerët, konkretisht vreshtarët e Kosovës, të cilët padyshim se e meritojnë mbështetjen e njëjtë, sikur edhe kultivuesit tjerë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Liburn Aliu, urdhëro!

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Unë desha të ngre çështjen e cila prej shumë vitesh çdo vit diskutohet dhe është temë diskutimi e do të jetë prapë edhe këtë vit temë diskutimi e që nuk ka përmirësim aspak e bëhet fjalë për çështjen e prerjes së pyjeve, shkatërrimit të pyjeve, që është duke ndodhur kudo në Kosovë, në vazhdimësi, prej shumë vitesh.

Si në zonat që janë, si në pyjet që janë brenda parqeve nacionale e po ashtu, edhe në pyjet që janë jashtë parqeve nacionale është duke ndodhur e njëjta gjë. Pra, qofshin ato pyje nën kompetencën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe konkretisht të ministres Albena Reshitaj, qofshin ato nën kompetencën e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, konkretisht të ministrit Rikallo, në cilëndo kompetencë e kemi situatën e njëjtë, pra pyjet janë duke u prerë kudo nëpër Kosovë në mënyrë totalisht të pakontrolluar dhe është duke ndodhur një shkatërrim jashtëzakonisht i madh, sidomos në krahasim me vitet paraprake.

Këto dy vjetët e fundit janë vite kur ma kemi sipërfaqe të tëra të shkatërruara të pyjeve, të cilat përpos që prehen në mënyrë të pakontrolluara, ato prehen në mënyrë jo të duhur dhe lënë pas mbeturina kudo, të cilat do të jenë shkaktar i mundshëm i zjarreve në vitet që vijnë, për shkak se ato mbeturina thahen, kalben dhe pastaj janë shumë lehtë të ndezshme e po ashtu edhe përhapin sëmundje brenda pyjeve. Duke e ditur edhe këtë me këtë rast, besoj se edhe Agjencia e Pyjeve shpeshherë e ka alarmuar këtë situatë që kemi sëmundje brenda pyjeve e në anën tjetër nuk kemi asnjë masë konkrete që merret nga institucionet tona.

Unë nuk mendoj se është e pamundur të ndalet. Është plotësisht e mundur të ndalet, vetëm se duhet thjesht të vendosin ministrat tanë, të vendos kryeministri, që pyjet në këtë vend të mos priten më në mënyrë të pakontrolluar, ashtu siç po ndodh deri tash. Ajo është shumë e lehtë për t'u ndalur. Individët që e bëjnë këtë punë, në secilën komunë dihen qartë se cilët janë ata. Nëse e

shohin në territorin e parkut nacional të Sharrit, ose edhe atë të Bjeshkëve të Nemuna, mund ta shihet qartë kushdo që del andej, që është duke ndodhur një shkatërrim masiv. Andaj, një hap i vetëm, një vendim dhe një vendosmëri mund ta ndalë këtë proces dhe kjo nuk do të thotë që të mos presin pyje, por të presin në mënyrë të kontrolluar.

KRYETARI: Shqipe Pantina, urdhëro!

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryetar!

Para dy javësh ky Kuvend me vota unanime, pra asnjë votë kundër, miratoi rezolutën e cila kërkonte që të krijoheshin lehtësira për bashkatdhetarët tanë me rastin e hyrjes në pikat kufitare, rezolutë e cila do të duhej të fillonte të zbatohet më 15 korrik.

Megjithatë, tashmë kanë ardhur ankesat e para nga qytetarët, gjegjësisht bashkatdhetarët tanë që vijnë e sidomos në pikat kufitare ne Merdare dhe në Han të Elezit, pritjet nëpër të cilat janë jashtëzakonisht të gjata. Ne i kërkojmë Ministrisë së Punëve të Brendshme, është mirë që edhe ministri është këtu, që t'u dërgojë policëve kufitarë udhëzimet e nevojshme për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, sepse gjatë vizitave që ua kemi bërë pikave kufitare Policia nuk ka qenë e njoftuar me rezolutën dhe nuk i ka pasur udhëzimet e nevojshme për zbatimin e saj.

Përveç kësaj, pasi që edhe ministrin e Punëve të Brendshme e kemi këtu, unë dua të ngre edhe një shqetësim tjetër. Pajtohem me zotin Sherifi, se Policia po bën një punë të mirë në komunikacion. Megjithatë, për fatin e keq, këto kohët e fundit kemi një numër të madh të aksidenteve që kanë përfunduar me fatalitet.

Unë u shpreh ngushëllime të gjitha familjeve që kanë humbur të dashurit e tyre në këto aksidente, por po ashtu dua t'u bëj thirrje të gjithë ngasësve të veturave që të kenë kujdes të shtuar në këto ditë, kur fluksi në trafik është rritur. Një thirrje të veçantë po ashtu dua t'ua bëj të gjithë bashkëqytetarëve tanë që vijnë nga vendet e BE-së, sepse rrugët tona, për fat të keq, nuk e kanë cilësinë e njëjtë të rrugëve të shteteve prej nga vini, prandaj duhet dështohet kujdesi gjatë ngasjes së veturave nëpër rrugët tona dhe të njëjtën kohë i kërkoj Ministrisë së Punëve të Brendshme që të rrisë masat e sigurisë, gjegjësisht të rrisë numrin e patrullave të Policisë, jo vetëm në Rrugën e Kombit, por në të gjitha rrugët magjistrale e në rrugët tjera, ku trafiku është më i rënduar e ku, siç thamë, numri i aksidenteve është rritur e shumë prej tyre, për fat të keq, kanë përfunduar edhe me fatalitet.

Dua ta mbyll me një lutje, me një thirrje, - Më mirë të humbim një minutë në jetë, sesa të humbim një jetë në minutë!

Faleminderit!

KRYETARI: Teuta Haxhiu, urdhëro!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të gjitha çështjet që unë do t'i ngre, normalisht se i ngritën edhe kolegët e mi, por nuk është aspak tepër. Pra, e para që dua të ngre është edhe një herë tendenca për të rrënuar objektin shkollor, që është i vetmi institucion në Pejë për personat e verbër. Për mua është e pakuptimtë. Andaj, duke e ruajtur jo vetëm këtë kategori, por secilën nga kategoritë që janë shumë të çmueshme për shoqërinë kosovare, ky objekt do të duhej të ruhej dhe njëkohësisht me marrëveshje bashkë me shoqatat, duhet nëse vërtet vlerësohet që do të duhej të ndërrohej lokacioni, atëherë paraprakisht duhet të ndërtohet objekti tjetër, pastaj të vijë në shprehje bashkë me miratimin e tyre ndoshta, një rrënim i objektit, ngase unë nuk kam informata pse.

Pra, do të duhej të kemi informata shumë më shumë rreth kësaj që po ndodh. Pra, pajtohem plotësisht me shoqatën që ky objekt, jo që duhet të rrënohet, por në fakt këta persona duhet shumë më shumë të punojmë, nga se edhe vetë Ligji për persona të verbër nuk po zbatohet dhe ata kanë probleme kudo, në objekte po edhe në rrugë.

Çështja tjetër që dua të ngre është, ftoj Qeverinë e Republikës së Kosovës që të rregullojë njëherë e përgjithmonë pagesat e policëve për orët shtesë dhe të ndërrimit të natës. Me dokumente të rregullohet kjo çështje, nga se vërtet në bisedë me disa policë kufitarë personalisht i kam pyetur dhe më kanë thënë që një kohë ka qenë, por aktualisht jo. Prandaj, ftoj Qeverinë që ky problem të rregullohet njëherë e përgjithmonë.

Dhe e treta, ftoj kryetarët e komunave, që në këtë kohë kur kemi fluks të madh të bashkatdhetarëve që e mbajnë gjallë frymën kudo në vend, që punimet nëpër rrugët kryesore në komuna të mundohen t'i lënë më vonë, ngase vërtet komunikacioni është shumë i dendur dhe këto janë shqetësimet e tyre, ngase po ballafaqohen edhe me punime në rrugë, por njëkohësisht edhe me probleme që u përmendën më herët, me aksidente që fatkeqësisht për secilin prej nesh po janë dhembje.

Pra, edhe një herë, jo vetëm t'i ftojme që të vijnë e të investojnë në Kosovë, por t'u krijojmë kushte dhe njëkohësisht të japim maksimumin, që këtë kategori të shoqërisë sonë, jo vetëm pse është vlerë, por njëkohësisht të krijojmë edhe hapësirë që ata të ndjehen mirë për një kohë sa rrinë në Kosovë. Edhe një herë, Kosova ka nevojë, rrugët tona kanë nevojë, për ndërtime, por mbi të gjitha ta lëmë këtë kohën e verës, sidomos kur është fluksi më i madh i tyre, pra t'i lëmë për më vonë ato punime apo t'i sanojmë më herët, para se ata të jenë në Kosovë. faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Luljeta Veselaj-Gutaj, urdhëro!

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Çështja për të cilën do të diskutoj sot vjen drejtpërdrejtë nga shqetësimet e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe ka të bëjë me shtimin e numrit të rasteve të vjedhjeve, të cilat po ndodhin në pronë publike dhe në pronë private.

Mungesa e sigurisë së mirëfilltë dhe dinamike është shqetësim i madh për qytetarët tanë, si element parësor i zhvillimit të një jete normale. Ky shqetësim kohëve të fundit është në rritje e sipër, për çka sipas statistikave dhe informacioneve të rasteve të paraqitura nga vetë qytetarët, po ashtu edhe raportet zyrtare, të cilat i kemi parë në ditët e fundit.

E theksova “kohët e fundit”, sepse mu në kohën sezonale të pushimeve që mërgimtarët e presin me padurim ardhjen e tyre, për t’u bashkuar me anëtarët e familjes dhe për t’u gëzuar e për të kaluar ditë të mira me ta, ata ballafaqohen me probleme të kësaj natyre bashkë me ne. Gjatë kësaj kohe po krijohet ndjenja e pasurisë së qytetarëve për jetën dhe pronën e tyre, ku në oborret tona dhe në ambientet publike vidhen vetura, vidhen shtëpi, lokale, pra drejtpërdrejtë po dëmtohet pasuria e çdo qytetari në Republikën e Kosovës.

Kërkoj nga Qeveria e Republikës së Kosovës që t’i shtojë kapacitetet, në mënyrë që organeve të rendit t’u mundësohet të jenë sa më aktive dhe të pranishme në komunitet, për rritjen e sigurisë publike dhe parandalimin e të gjitha rreziqeve për qytetarët në vend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Hajdar Beqa është deputeti i fundit dhe futemi në pjesën e seancës.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli!

I nderuar nënkryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë dua ta ngre një çështje për të cilën u zotova dhe më obliguan qytetarët që i hasa rastësisht në një takim, në një protestë, në fshatin Zllakuqan të Istogut.

Çështja që kanë banorët e Zllakuqanit të Klinës realisht në përballje me reduktimin e energjisë elektrike tash e dy javë. Reduktimet janë çdo ditë mbi nëntë orë në ditë dhe edhe pse janë pages të rregullt të energjisë elektrike. Qytetarët kanë organizuar edhe protesta duke bllokuar magjistralen Istog - Klinë - Prishtinë, ku ka pasur edhe ndërhyrje nga Policia me qëllim të lirimit të rrugës. Qytetarët pohojnë se kanë informuar me kohë kompaninë KEDS, e cila ka thënë se janë disa prishje, por nuk kanë marrë ndonjë masë konkrete.

Ata zotohen se nëse KEDS nuk intervenon në lëshimin e energjisë elektrike, do të vazhdojnë me protesta edhe më të mëdha. Unë si deputet i Republikës së Kosovës kërkoj nga KEDS që t’i

marrë seriozisht shqetësimet e qytetarëve, sepse kemi shqetësime të tilla në tërë Republikën e Kosovës. Kemi shqetësime të tilla edhe në regjionet, në këtë rast edhe kah vij unë, sidomos në Rekë të Keqe, një frymë apo vetëm një reshje e vogël e shiut po të ndodh, kemi një ditë a dy që ndalet energjia elektrike, pavarësisht a është festë, ditë pune apo çfarëdo kohe (acar, dimër apo...).

Kërkoj edhe nga ministri i Zhvillimit Ekonomik që ta marrë këtë çështje shumë seriozisht në interes të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe të kërkojë nëpërmjet Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike, që t'i marrin të gjitha masat ndaj kompanisë KEDS që ta implementojë në përpikëri kontratën që e ka me Qeverinë e Kosovës, sepse në bazë të kontratës që e ka është dashur që tri vjetët e para të përmirësohet rrjeti i energjisë elektrike në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe pse jemi në përfundim të kohës, po tash mbasi po e shoh nga një deputet, Gani Dreshaj, ju kisha lutur... Faleminderit!

GANI DRESHAJ: Unë desha t'i them parafolësit faleminderit! Është e vërtetë, që në Istog kemi probleme me rrymë dhe desha t'i lutem ministrit të Punëve të Brendshme pasi që rastësisht i kemi, Istogu dhe Klina e kanë edhe një problem edhe më të zorshëm, që çdo ditë gjatë verës, i kisha lutur të ketë një patrullë të Policisë së Komunikacionit. Në udhëkryqin që hyn prej Kline kemi një orë pritje, ministër.

Mendoj që është e arsyeshme, pasi që s'kemi semaforë, të dalë një patrullë, sepse po vonohemi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kisha lutur deputetët të mos qëndrojnë larg, sepse për t'u futur në seancë pas pyetjeve parlamentare duhet t'i kemi 61 deputetë. Vetëm ta keni parasysh! S'mund të futemi në seancë fare, në qoftë se s'janë 61 deputetë.

2. Koha për pyetjet parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjatë 60 minuta. Për këtë seancë janë parashtruar 31 pyetje parlamentare.

Deputeti Daut Haradinaj, pyetje për ministrin Bejtush Gashi. Ndërkohë, unë kaloj në bazë të radhitjes kur të vij në deputetët, kisha pasur dëshirë kur janë prezentë në sallë, pastaj ta ngrenë dorën që kanë pasur pyetje e ripërsëris pyetjen, në qoftë se jemi brenda kësaj pike.

Po ashtu, deputeti Daut Haradinaj, pyetje për ministrin Shyqiri Gashi.

Deputeti Driton Çausi, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Derisa nuk është njëra palë, unë vetëm po i lexoj. Prapë po e shoh, as deputetët nuk janë, as Kabineti qeveritar.

Deputeti Avdullah Hoti, pyetje për ministrin Kujtim Gashi. Nuk është.

Deputetja Mirjeta Kalludra, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Urdhëroni!

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, kryetar!

Pyetja ime ka të bëjë me çështjen e ballafaqimit të mungesës së shërbimeve. Pyetja është dorëzuar diku me datën 12 qershor dhe është lexuar në seancën e kaluar. Ministri ka munguar në dy seanca, por unë po e lexoj pyetjen, besoj të ma japë edhe përgjigjen.

Pyetja ka të bëjë me ballafaqimin e mungesës së shërbimeve, që ka të bëjë edhe me mungesën e aparaturave mjekësore, të cilat janë jashtë funksionit, siç është rasti edhe me rezonancën magnetike, e cila shpeshherë po mbetet jashtë funksionit dhe me këtë rast lista e pritjes së pacientëve është shumë e gjatë dhe shumë qytetarë detyrohen të presin për një periudhë të gjatë që t'i kryejnë këto vizita.

Pyetja ime për ministrin është: A ka ndonjë plan për blerjen e pajisjeve të reja, pasi që shumica e këtyre pajisjeve mjekësore janë shumë të vjetruara dhe a ka kërkesë apo ndonjë planifikim konkret për blerjen e aparaturës së rezonancës magnetike?

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit, deputete!

Realisht, pyetjen unë nuk e kam pasur, por në rregull është.

E nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Sistemi shëndetësor është trashëguar me lista të gjata të pritjeve, jo vetëm për rezonancë magnetike, por ka pasur lista të gjata në shumë shërbime të ndryshme.

Natyrisht që nga marrja e detyrës, e para ka qenë që të identifikohen se cilat, ku, janë listat e pritjes dhe realisht, cilat rezultojnë me një ngarkesë financiare dhe ngarkesë shëndetësore për të gjithë pacientët tanë. Ju e dini vetë, keni qenë besoj edhe vetë dëshmi, që tanimë veç e kemi larguar një listë pritjeje që ka qenë për stentim dhe është fokus yni po ashtu, që ta largojmë listën e pritjes edhe për rezonancë magnetike, e cila tanimë është funksionale dhe punon. Punon gjatë tërë kohës. Pra, nuk është jashtë funksionit dhe e kemi në buxhetim për ta blerë pajisjen e re për rezonancë magnetike, e cila është në përfundim të specifikacioneve.

Këtë javë kemi kërkuar nga Shërbimi Spitalor që të na japë përfundimisht specifikacionet, në mënyrë që ne ta hapim për oferta, prandaj besoj se edhe ky është një lajm shumë i mirë. Pra, do të kemi dy rezonanca magnetike dhe në këtë mënyrë do të mënjanojmë listën e krijuar, e cila

është bërë për vite me radhë e që shpeshherë pacientët tanë i dërgon nëpër klinika të ndryshme private, në pamundësi për ta marrë këtë në spital. Është një projekt që e kam marrë shumë seriozisht, e kam filluar, në mënyrë që ta shohim si të përfunduar këtë, ashtu siç i kemi parë përfundimet edhe në disa klinika të tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ka pyetje shtesë? Deputetja ka pyetje shtesë, ministër.

MIRJETA KALLUDRA: Nëse ka mundësi ministri, të na japë një periudhë më të saktë, se kur do të kryhet ky realizim i blerjes së rezonancës magnetike, se kjo listë është jashtëzakonisht e madhe e pacientëve që po detyrohen në shumë raste të shkojnë nëpër spitale private, ku dihet se çmimet janë jashtëzakonisht shumë të shtrenjta dhe nuk mund të përballohen nga qytetarët dhe pagat e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, të lutem!

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit!

Deputete, realisht ajo listë, siç thashë edhe më herët, ne në QKUK, në SHSKUK kemi trashëguar lista të shumta. Për shembull, për stentim ka qenë një listë shumë më serioze, për vetë faktin që njerëzit kanë pasur probleme me zemër dhe nuk kanë mundur të bëjnë zgjidhje të menjëhershme e, në anën tjetër, shpenzimet për to kanë qenë me mijëra euro.

Prandaj, kur thashë për rezonancë, tregova që rezonanca magnetike do të blihet këtë vit, datën e saktë nuk mund ta jap, për arsye se është proces i prokurimit. Pra, në qoftë se nuk ka ankesë fare për një proces të prokurimit, kryhet më herët, në qoftë se ka ankesë, mund të shtyhet për 30-40 ditë.

Mirëpo, me rëndësi është që ne blerjen do ta bëjmë këtë vit dhe do ta heqim edhe atë listë të pritjes, natyrisht ashtu siç janë hequr edhe listat e tjera të pritjes. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Naser Rugova, pyetje për ministrin Nenad Rikallo, nuk është as deputeti, as ministri.

Deputetja Dorentina Maloku-Kastrati, pyetje për ministrin Pal Lekaj, ministri nuk është këtu, deputete, a do ta lexosh pyetjen?

DORENTINA MALOKU-KASTRATI: Faleminderit!

Nuk është aspak e drejtë, sepse është hera e dytë që po më vjen radha ta lexoj të njëjtën pyetje për ministrin Lekaj dhe është hera e dytë që ai nuk ndodhet në seancë për t'u përgjigjur pyetjeve të deputetëve.

Sido që të jetë, unë do ta lexoj edhe një herë çështjen, të cilën e kam ngritur nëpërmjet pyetjes parlamentare.

Në muajin shtator të vitit 2016 ka filluar zgjerimi i rrugës nacionale Podujevë-Prishtinë, respektivisht deri te rreth rrotullimi në Besi, pesë segmentet e kësaj rruge, e cila ka qarkullim më së shumti në Kosovë, është paraparë të përfundojë brenda tri ose katër vjetësh, mirëpo buxheti i ndarë për të është i pamjaftueshëm për t'i përmbushur afatet e parapara.

Pyetja për ministrin Lekaj ishte se a mund të na tregonte se kur banorët e Llapit dhe të Gollakut do të udhëtonin në rrugën e premtuar?

Unë pres që në seancën e radhës ministri Lekaj t'i përgjigjet pyetjes sime parlamentare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministri nuk është prezent.

Deputeti Driton Çausi, pyetje për kryeministrin, a po e pret kryeministrin se ishte këtu. Urdhëro, fjala për ju!

DRITON ÇAUSHI: Vetëm një sqarim, duhet të jetë një gabim i administratës. Për shkak se unë kam marrë përgjigje në këtë pyetje në seancën e kaluar.

KRYETARI: Faleminderit! Është rasti i dytë që po ngrihet si shqetësim, qoftë i ministrave, qoftë i deputetëve, administrata, ju kisha lutur, edhe pse rrallë bën gabime të tilla.

Deputeti Nezir Çoçaj, pyetje për ministrin Pal Lekja, nuk është ministri, a dëshiron të presësh deri në fund të kësaj seance, në qoftë se vjen.

Deputeti Korab Sejdiu, pyetje për ministrin Bajram Hasani, nuk është ministri.

KORAB SEJDIU: Nuk po e shoh ministrin, kështu që nuk po di sa ia vlen të bëj pyetjen deri të kthehet.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Frashër Krasniqi, pyetje për ministrin Abelard Tahairi, nuk është po ashtu ministri, as Frashëri nuk qenka, po më duket.

Deputetja Ganimete Musliu nuk është këtu, ka pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi, veç ministër, nëse përgjigjesh vetë, se e di pyetjen, nuk është deputetja.

Deputeti Xhelal Sfeçla po ashtu ka pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj, po presim në momentin kur do të jenë këtu, unë edhe një herë do t'i riaktivizoj pyetjet, në qoftë se rastësisht është ndonjë prej ministrave, e unë harroj, mundësisht me dorë e kërkoni fjalën.

Deputeti Salih Zyba, pyetje po ashtu për ministrin Pal Lekaj, nuk është ministri, as deputeti.

Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin Bedri Hazma, të dytë janë këtu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Pyetja është parashtruar më 2 korrik, ministri është i pranishëm, unë po e bëj pyetjen parlamentare.

Më 29 qershor, Ministria e Financave e ka ekzekutuar vendimin e paligjshëm Qeverisë që parashihte rritje arbitrare të pagave për një grup të caktuar të zyrtarëve të lartë qeveritarë.

Dhe, pyetja parlamentare është se cila linjë buxhetore u përdor për këtë ekzekutim? Cila ka qenë rritja e faturës mujore për paga, si rezultat i ekzekutimit të këtij vendimi dhe a do të nënkuptojë kjo mosrespektim të limitit të paraparë për paga në Ligjin për buxhetin për vitin 2018?

KRYETARI: Po, ministër, fjala për ju.

Në ndërkohë ministrat kur dalin në foltore, në qoftë se ka pyetje shtesë, pritni në foltore, në qoftë se kanë, se zakonisht kanë pyetje shtesë deputetët.

MINISTRI BEDRI HAZMA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete Haxhiu,

Ministria e Financave ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Këto dispozita ligjore e obligojnë Ministrinë e Financave për ekzekutimin e vendimeve të plotfuqishme, duke përfshirë këtu edhe vendimin e Qeverisë, të cilit ju i referoheni.

Rritja nga vendimi i Qeverisë deri në datën sot kur po flasim ka kosto 750 mijë euro më shumë në baza mujore, po do të kemi parasysh që në këtë shumë është përfshirë edhe sistemi i drejtësisë, duke e përfshirë edhe Këshillin Prokurorial, edhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Kur e themi deri më sot, kemi parasysh që kemi edhe disa organizata buxhetore, ministri, që nuk e kanë dorëzuar dokumentacionin me ndryshime në Thesar.

Mjetet janë paguar nga linja e pagave dhe mëditjeve, sipas Ligjit për buxhetin për vitin 2018 dhe, sipas trendëve siç është duke shkuar shpenzimi nga kategoria e pagave dhe mëditjeve, nuk presim që do të tejkalojmë shumën e planifikuar të parapara në kategorinë e pagave dhe

mëditjeve në buxhetin e shtetit për vitin 2018, kur them nuk do të kemi tejkalim, i referohem shumës totale.

Ndërsa, në strukturë brenda organizatave buxhetore, disa organizata buxhetore mund të kenë në fund të vitit minus te masa e pagave, po disa organizata buxhetore mund të kenë tepriçë, kur them tepriçë si rezultat i mospunësimeve, si rezultat i fluktimit të punësuarve apo çështjeve të tjera dhe ka mundësi që trendët aktualë sigurojnë që masa e pagave do të jetë sipas buxhetit të planifikuar për vitin 2018. Po do të jemi të obliguar që të lëvizim brenda përbrenda organizatave buxhetore, kryesisht minuset do të reflektohen te Këshilli Gjyqësor dhe te Këshilli Prokurorial.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputetja ka pyetje shtesë, urdhëro!

ALBULENA HAXHIU: Sa i përket pyetjes shtesë, i kam dy çështje:

E para, nuk e kuptova cila është fatura vjetore, sa milionë euro i ka kushtuar buxhetit të Republikës së Kosovës vendimi i paligjshëm për rritjen e pagave? Domethënë, sa milionë, a mund të na tregoni, a është 8 milionë euro? Që kanë mundur të shkojnë në shkolla, në çerdhe, në spitale, a është më shumë se 8 milionë euro, pra sa është kjo shifër?

Dhe, e dyta, unë kam parë edhe kundërshtimin tuaj në mbledhjen e Qeverisë lidhur me këtë vendim dhe e kam konsideruar si të drejtë kundërshtimin ndaj një vendimi të paligjshëm. Me sa kemi kuptuar, ju nuk e keni përkrahur si të tillë. Prandaj, edhe ndaj teje s'kemi bërë kallëzim penal, për shkak se nuk keni votuar për.

Por, pse në Gjykatën Kushtetuese kur jeni pyetur...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Urdhëro, vazhdojani regjia, të lutem.

ALBULENA HAXHIU: Por, ajo çfarë neve na ka shqetësuar si Vetëvendosje ka të bëjë me hipokrizinë e ministrit të Financave, për shkak se Gjykata Kushtetuese e ka pyetur ministrin e Financave, gjegjësisht Ministrinë e Financave se a është përfshirë vendimi për rritjen e pagave në buxhetin për vitin 2018 dhe zoti ministër, mos manipuloni, ai vendim nuk ka qenë i përfshirë. Pra, ju me buxhetin e vitit 2018 nuk keni paraparë që do t'i rritet kryeministrit paga 100%, dyfish, ju i keni marrë diku, a na shpjegoni ku i keni marrë, te cila kategori, apo te stafi që keni pretenduar që t'i punësoni dhe tash nuk janë punësuar, qoftë për gjyqtarë, qoftë për prokurorë, qoftë për zyrtarë të tjerë.

Pra, pse edhe Gjykatës Kushtetuese nuk i keni treguar drejt, keni manipuluar edhe me Gjykatën Kushtetuese, domethënë na bëni të qartë këtë hipokrizi tuajën?

KRYETARI: Urdhëro, ministër, përgjigje!

MINISTRI BEDRI HAZMA: Deputete, si shenjë respekti ndaj kësaj foltoreje dhe ndaj këtij institucioni, nuk do të lëshohem në disa kualifikime e cilësime tuaja, nuk do të lejoj që ta degradoj gjuhën derisa të jem ministër i Financave. Ato janë konstatime tua, a është vendim i ligjshëm a i paligjshëm, nuk je ti edhe unë ai që e përcaktojmë, e përcaktojnë organet e tjera dhe ne nuk përzihemi në punën e organeve të tjera.

Nëse i ke lexuar me kujdes përgjigjet e Ministrisë së Financave, brenda përgjigjeve janë saktë të konstatuara. Nëse më përcolle me kujdes, e thashë 750 mijë euro është masa mujore deri në ditën që unë po raportoj në Kuvend. 750 mijë herë 12 muaj, vjen te shuma vjetore, e thashë për hir të korrektësisë, se ashtu është, disa organizata buxhetore në këtë rast, disa ministri të linjës që unë nuk kam të drejtë të hyj në arsyetimet e tyre pse, nuk e kanë sjellë listën e pagave duke e përfshirë edhe vendimin e fundit të Qeverisë për rritjen e pagave. Prandaj, ky është realiteti.

Deri më sot kur po raportoj unë këtu në Kuvend, janë shpenzuar më pak se 294 milionë euro te masa e pagave dhe nëse janë më pak se 294 milionë euro, edhe gjashtëmujori i dytë bëjnë 588 milionë euro, a në masën e pagave janë 592 milionë euro, duke i përfshirë edhe të hyrat vetjake që janë bartur te masa e pagave.

Do të thotë, me trendin aktual të shpenzimit të masës së pagave, ky vendim do të përfshihet brenda masës së pagave.

Sa u përket çështjeve të tjera, është çështje e organeve të drejtësisë, Gjykata Kushtetuese e ka thënë fjalën e vet, mund ta thonë fjalën e vet edhe institucionet e tjera. Kjo është përgjigjja ndaj pyetjes suaj. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Arbërie Nagavci, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit!

Zoti ministër, sivjet u zhvilluan punimet konferencës jubilarë “Java e Shkencës 2018”, e cila synon të paraqesë të arriturat e Kosovës dhe të rajonit në fushën e shkencës në periudhën njëvjeçare.

Në fjalën që ju mbajtët me rastin e hapjes së kësaj konference deklaruat se këtë vit fokusi është përqendruar në rritjen e cilësisë së punimeve shkencore të paraqitura dhe në ndërkombëtarizimin e kësaj ngjarjeje me vlera të prezantimit.

Përkundër kësaj që ju deklaruat dhe paraqitët se do të ndodhë, lajmet që u publikuan në media në lidhje me Javën e Shkencës dëshmuuan se një numër i konsiderueshëm i prezantuesve, kryesisht

nga lëmi i mjekësisë, ishin autorë që kanë publikuar punime shkencore në revistat boshnjake dhe ato maqedonase, të cilat po konsiderohen si mashtruese, tashmë të njohura si “revista të gjysheve”.

Duhet theksuar se ndonëse në Kosovë nuk realizohet mjaft shkencë, ka akoma autorë të mirëfilltë seriozë e të mirëpërgatitur që kanë botuar edhe në revistat prestigjioze ndërkombëtare, të cilët jo vetëm që shumë shpesh nuk po e gjejnë përkrahjen institucionale, por edhe po ofendojnë hapur duke lejuar që Java e Shkencës të mbizotërohet nga persona jokompetentë.

Pyetja parlamentare për ju, zoti ministër, është: a mund të na njoftoni çfarë keni ndërmarrë për të siguruar paraprakisht që të ruhet autoriteti i kësaj ngjarjeje kaq të rëndësishme dhe që punimet të jenë vërtet serioze dhe të paraqesin një shkencë të mirëfilltë dhe a keni krijuar ndonjë komision profesional për të hetuar rastet e raportuara? Nëse po, cilat janë gjetjet dhe nëse jo, a i keni në plan të merreni me këto raste apo do të lejoni që edhe në të ardhmen të ketë improvizime dhe joseriozitet të këtyre ngjarjeve kaq të rëndësishme për shkencën dhe për vendin. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, fjala për ju!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

E nderuar deputete Nagavci,

Faleminderit, për pyetjen!

E para, duhet të jem të qartë se të gjithë autorët e kanë të drejtën të aplikojnë në punimet e tyre shkencore në “Javën e Shkencës 2018”.

Në konferencën vjetore të “Javës së Shkencës 2018” në pjesëmarrje këtë vit kanë aplikuar rreth 300 aplikantë, në të gjitha fushat shkencore dhe këto aplikacione janë vlerësuar nga Këshilli Shkencor për fushat përkatëse shkencore.

Nga gjithsej 300 aplikacione, ku kanë marrë pjesë rreth 400 autorë dhe bashkautorë, punimet janë përzgjedhur në bazë të vlerave meritore shkencore, të përbërë nga Këshilli Shkencor, i cili ka përzgjedhur rreth 146 punime shkencore që janë prezantuar në Javën e Shkencës.

Nga ajo që ju potencuat, vlen të theksohet se të gjitha punimet janë të botuara në revistat të cilat janë të indeksuar në UNESCO, me qendër në Paris dhe të cilat e mbajnë shifrën ISCN, që faktikisht konsiderohen që janë të gjitha legale.

Ndërsa, lidhur me çështjen se çfarë vlere shkencore kanë, kjo u takon që ta përcaktojnë vetë shkencëtarët, gjegjësisht akademikët për vlerën e botimeve.

E se çka kemi ndërmarrë ne që kjo Javë e Shkencës ta ruajë autoritetin e lartë dhe të ketë vlera të larta shkencore, nga viti i ardhshëm ne kemi vendosur që Java e Shkencës të organizohet në universitetet publike, ndërsa Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë vetëm do ta mbështetë financiarisht dhe do ta ndihmojë në politika përkatëse.

Konsideroj që ky ndryshim do ta ndihmojë që kjo Javë e Shkencës të pasurohet dhe të kemi mundësi që të kemi edhe punime shumë më profesionale, se sa që i kemi pasur në vitet në vazhdim, por gjithsesi u mbetet të gjithë shkencëtarëve dhe autorëve që të aplikojnë brenda Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Faleminderit!

KRYETARI: Po, po ndërkohë nuk do të largohen pyetjet. A ka pyetje shtesë, vazhdoni?

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, ministër!

Ju thatë se ka qenë një këshill që i ka shqyrtua të gjitha kërkesat. Pyetja ime, po e përsëris edhe një herë: a keni hulumtuar ose a i keni shqyrtuar rastet e raportuara që ka pasur edhe punime të tilla, të cilat nuk do të duhej të ishin pjesë e asaj konference? Rastet janë të raportuara me emër, me mbiemër, edhe punimet se ku janë botuar. Unë për hir të korrektësisë nuk dua t'i përmend sot këtu, por shpresoj se ju si ministri jeni marrë me këtë çështje dhe e keni studiuar.

KRYETARI: Ministër, të lutem.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Ne e theksuam se të gjitha revistat përmbajnë numrin ISCN që konsiderohen që janë revista legale. Ndërsa problemin e tyre mbetet Këshilli Shkencor ta vlerësojë, pra punimet adekuate, të cilët kanë marrë vendim për punime të tilla. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetët të cilët kanë ardhur dhe ministrat janë, ju lutem ma bëni me dorë. Do të vazhdojmë, zoti Selmanaj, në të gjitha pyetjet do të shkojmë. I tejkaluam, po do të rikthehem, nuk prish punë. Nezir Çoçaj, pyetje për ministrin Pal Lekaj. Ministër, a je gati, atëherë vazhdo. Unë veç premtova publikisht se pyetjet do t'i rikthej, unë i kalova në mënyrë përshkruese.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit!

Më janë marrë sekondat, kryetar, kështu që faleminderit që ma dhe fjalën, po mos m'i harxhoni sekondat.

Sido që të jetë, faleminderit shumë, e falënderoj ministrin.

Unë dua t'i ngre disa çështje, besoj se ministri e ka pasur edhe pyetjen me shkrim.

Mirëpo, rajoni i Hasit që përfshihet në dy komuna, të Prizrenit dhe të Gjakovës, një periudhë të gjatë, po flas nga paraluftra, po i njëjti avaz pothuajse ka filluar edhe pas luftës, problematika me

rrymë dhe me çështje të ujit të pijes, po për ujë të pijes dua t'i falënderohem Zotit që këtë kohën e verës goxha shumë ka rënë shi dhe ata po kanë mundësi të mbledhin nëpër kova ujë, mirëpo e dini çfarë uji mund të jetë ai, nuk mund të përdoret si ujë i pijes.

Ka shumë kohë, shumë muaj që s'ka ujë të pijes, gjegjësisht mund të ketë ujë të pijes vetëm nga gjysmë ore në ditë.

Sido që të jetë, edhe infrastruktura tjetër në rajonin e Hasit, zoti ministër, për fat të keq nuk është e mirë, ajo që dihet publikisht është se ne në këtë vit buxhetor i kemi ndarë 350 mijë euro për sanimin e rrugëve në rajonin e Hasit, që përfshin të dy komunat, ndërsa në vitin 2019 janë të ndara 150 mijë euro të tjera.

I nderuar ministër,

Pyetja është: kur do të fillojë rregullimi i rrugëve në rajonin e Hasit, pasi që e kemi edhe buxhetin e ndarë si dhe a do të ketë shtim të buxhetit? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër, fjala për ju.

MINISTRI PAL LEKAJ: I nderuar kryetar i Parlamentit,

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

I nderuar deputet Nezir Çoçaj,

Sa i përket pyetjes suaj, keni plotësisht të drejtë, është shqetësim edhe i Ministrisë së Infrastrukturës dhe unë them që në kohën më të shkurtër të mundshme, pas përfundimit të procedurave që janë duke rrjedhur, mendoj që ne do të fillojmë me punimet.

Është e vërtetë që nuk mjafton buxheti që e kemi paraparë, por ne do të bëjmë kërkesë edhe në qarkoren buxhetore për vitin 2019 shtesë, por që e kemi një mundësi edhe në shtator që mund të lëvizim me atë që e lejon Ligji për buxhet dhe mendoj që qytetarët e Hasit dhe dy komunave, të Gjakovës dhe të Prizrenit, do të kenë një infrastrukturë shumë më të mirë se sa e kanë pasur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A ka pyetje shtesë? Urdhëro, zoti Çoçaj!

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, zoti ministër!

Unë të lutem, dua ta di në të njëjtën kohë nivelin e bashkëpunimit me pushtetin lokal, e thamë që jemi dy komuna dhe a ka ndarë, gjegjësisht a janë të interesuara edhe dy komunat të ndajnë buxhet shtesë në këto 350 mijë euro të ndara nga Qeveria?

MINISTRI PAL LEKAJ: Unë kam biseduar edhe me dy kryetarët e komunave, janë të gatshëm që edhe ta të participojnë, kemi marrëveshje të mirëkuptimit, kështu që asnjë problem procedural nuk do ta kemi. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Doruntina Maloku-Kastrati ka pyetje për ministrin Pal Lekaj.

DORUNTINA MALOKU-KASTRATI: Faleminderit!

Në muajin shtator të vitit 2016 ka filluar zgjerimi i rrugës nacionale Podujevë-Prishtinë, respektivisht deri te rrethrotullimi në Besi. Pesë segmentet e kësaj rruge, e cila ka qarkullim më së shumti në Kosovë, është paraparë të përfundojë brenda tre-katër vjetësh, mirëpo buxheti i ndarë për të është i pamjaftueshëm për t'i përmbushur afatet e parapara.

Zoti ministër, a mund të na tregoni se kur banorët e Llapit dhe të Gollakut do të udhëtojnë në rrugën e premtuar, respektivisht a do të përmbillet ky projekt në afatin e përcaktuar?

KRYETARI: Ministër, fjala për ju.

MINISTRI PAL LEKAJ: Sa u përket projekteve për Besi, ju e dini që zgjerimi i rrugës është duke ndodhur dhe mendoj që ne jemi të vëmendshëm dhe të kujdesshëm sa u përket kriterëve që të përmbushen në bazë të kontratës dhe e kemi thënë dhe prapë po e përsëris, asnjë projekt nuk do të ketë stërzgjatje sikur ka ndodhur deri tani.

Ju e dini që është filluar ajo procedurë, ka pasur pengesa, por tani janë eliminuar të gjitha pengesat dhe mendoj që ne do të jemi të saktë, sikur kemi qenë në fillim të projektit, por edhe në përfundim.

Është e vërtetë, jemi të kujdesshëm edhe për sigurinë e qytetarëve dhe mendoj që ka pasur ankesa nga qytetarët, menjëherë kemi dalë në vend, kemi komunikuar me qytetarët dhe mendoj që e kemi bërë një zgjidhje të mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Ka pyetje shtesë, urdhëroni zonja deputete.

DORUNTINA MALOKU-KASTRATI: Faleminderit!

A e vlerësoni, zoti ministër, si ndarje proporcionale të buxhetit, kur për vitin 2018 janë ndarë 2.5 milionë, më 2019 5 milionë, ndërsa për vitin 2020, 16 milionë euro. Si mendoni të kryhet në afatin e paraparë në vitin 2020, pesë segmente të rrugës, kur buxheti nuk është i ndarë mjaftueshëm, për shembull, për këtë vit që të punohet në segmentin e dytë dhe të tretë.

Edhe një pyetje shtesë: a keni menduar për ndërtimin e stacioneve të autobusëve përgjatë kësaj rruge? Sepse tashmë po shkaktojnë shumë telashe mungesa e stacioneve të autobusëve përgjatë rrugës. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, fjala për ju!

MINISTRI PAL LEKAJ: Faleminderit, kryetar!

Sa u përket vijave buxhetore, në qarkoren buxhetore ne do të jemi të kujdesshëm dhe do të përfundojë ashtu siç është kontrata. Të jeni të sigurt, nuk do të devijojë asnjë cent.

Sa u përket stacioneve të autobusëve, ne e kemi përpiluar projektin për tërë Kosovën, sepse ka qenë mungesë dhe së shpejti do ta shpallim interesin publik për ndërtim ose do të shkojmë edhe me partneritetin publiko-privat që të mos e harxhojmë buxhetin e Kosovës ose, nëse nuk ka të interesuar, ne do të fillojmë procedurat për ndërtimin e stacioneve në të gjitha rrugët regjionale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Avdullah Hoti ka pyetje për ministrin Kujtim Gashi.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Pyetja ime lidhet me Galerinë e Arteve në kullën e Ali Kadriut në Kroin e Vitakut, që është kërkesë e vazhdueshme banorëve të lagjes atje, në veri të Mitrovicës. Kjo është futur në buxhetin e vitit 2018, interesimi im është deri ku ka arritur ky projekt, sepse vazhdimisht ka kërkesa nga banorët e lagjes atje. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

Projekti për renovimin e Galerisë së Arteve në kullën e Ali Kadriut te Kroin e Vitakut, me kod 15775 dhe me buxhet të ndarë prej 20 mijë eurove, është hartuar nga Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore në Mitrovicë.

Bashkëpunëtorët tonë të QRTK-së në Mitrovicë kanë vizituar ndërtesën dhe kanë biseduar me personat përgjegjës, përfshirë edhe familjarët. Projekti përmban pjesën për adaptimin e hapësirës nga brenda, si dhe planin e prezantimit të pikturave. Jemi në pritje të fillimit të zbatimit të këtij projekti, jemi takuar edhe me djemtë e të ndjerit, por edhe me vëllain e tij dhe besoj që ditët në vazhdim ky projekt do të fillojë së jetësuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi te pyetjet parlamentare, a ka ndonjë deputet që e kam kaluar e s'i ka ardhur ministri? Ja, tani, të lutem! Deputeti Xhelal Sveçla, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

XHELAL SVEÇLA: Faleminderit, zoti kryetar!

Në interpelancën e thirrur nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje lidhur me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës keni theksuar se do të hetoni rastin e kthimit në punë të drejtorit të Departamentit të Prokurimit, zotit Nexhat Krasniqi, i cili ishte dënuar me aktgjykim të formës së prerë për shkak të kryerjes së veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje.

I nderuar zoti kryeministër, çfarë masash keni ndërmarrë në lidhje me këtë rast, kur dihet fare mirë rëndësia e pozitës, të cilën e mban dhe ushtron aktualisht i dënuari me aktgjykim të formës së prerë, zoti Nexhat Krasniqi?

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar deputet Sveçla,

Do të thotë, me shkrim s'kam përgatitur, por do t'ju bëj edhe një shkresë për atë që po u themi, por informatat që i kemi gojore është se gjykata e ka shpallur atë të pafajshëm dhe e ka paraparë, pra të drejtën e tij në vendin që i ka takuar. Të paktën kështu është informata zyrtare që kam prej kanaleve zyrtare. Mirëpo, nëse një afat të caktuar kohor do të interesohem që vërtet me shkresë, pra të përmbledhim ato që e vërtetojnë, nëse e vërtetojnë këtë që po them sot. Faleminderit për pyetjen.

KRYETARI: Deputeti ka pyetje shtesë.

XHELAL SVEÇLA: Po, faleminderit! Zoti kryeministri, herën e kaluar unë ju dhashë disa dokumente zyrtare, të cilat provojnë që ai nuk është liruar, është dënuar me gjykim të formës së prerë. Ju kisha lutur që radhën tjetër, në seancën e radhës unë prapë do të sjell dokumentacionin, meqenëse ministri Pal Lekaj po mohon me kokë, unë prapë do ta sjell vendimin e gjykatës. Unë ju kisha lutur që ju të ma sillni me shkrim arsyetimin pse ai nuk është larguar, apo nuk i është ndërruar pozita, meqenëse mban një pozitë jashtëzakonisht të rëndësishme.

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Kam kërkuar prej Zyrës tonë ligjore një, ne s'kemi të drejtë ta quajmë hetim, por një interesim për këtë temë, dhe ato materialet që i kemi marrë, i kemi në dispozicion, nëse ka edhe të tjera të reja, bën.

Ju siguroj që duam të dimë të vërtetën, nëse është e vërteta që del se ka vendim të prerë, atëherë dihet epilogu prej gjykatës, por nëse gjykata ka marrë vendim për pafajësi dhe na obligon, prapë është vullnet profesional e politik, a do dikë ta kthejë në pozicion të caktuar, mirëpo ju e dini, ka raste kur gjykatat tona i kanë kthyer në punë plot njerëz, pastaj është prapë vullneti i atyre vendimmarrësve a t'i kthejnë në ato vende të punës apo në vende të tjetër, por në raste të caktuara ka vendime të gjykatës që e ka obliguar palën ta rikthejë në vend të punës. Nëse ky rast është në kategorinë e njëjtë, atëherë kuptohet gjendja, nëse jo, prapë do t' ju informojnë si është gjendja.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Avdullah Hoti ka pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Zoti kryeministër, në konferencën për media të datës 26. 6. 2018 keni deklaruar se e keni pranuar, në fakt, nga grupi punues draftin e statutit të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe dhe se e keni rikthyer prapë te Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, me arsyetimin se dokumenti nuk ka qenë në gjuhë zyrtare, por vetëm në gjuhën serbe, madje me shkronja cirilikë.

Zoti kryeministër, çfarë po ndodh me këtë çështje? Pse në grupin punues nuk ka asnjë zyrtar të Qeverisë dhe të OSBE-së? Dhe, a keni takuar ndonjëherë këtë grup punues për atë se çfarë po punojnë në ndërkohë? Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër, fjala për ju.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Faleminderit, i nderuar deputet Hoti!

Do të thotë, grupi punues është produkt i mëhershëm, i tillë çfarë është, ndërsa shtimi në përbërje ose proceset e tjera kemi hasur në vështirësi, për shkak që na është mohuar kjo e drejtë, pra të shtojmë ekipin, të ndërhyjmë ose të plotësojmë. Unë e kam pasur një ide që këtë grup punues ta pasurojmë dhe e kam dhënë propozimin e parë si të tillë, mirëpo nga BE-ja është thënë se dakordimi ka qenë ky.

Çdo lloj shqetësimi që e kemi, qoftë për përbërjen e grupit punues, qoftë për materien, e ka një adresë që, në fakt, është një e mirë e atyre që kanë qenë në negociim më herët, se e kanë paraparë që materiali megjithatë ta marrë miratimin e Gjykatës Kushtetuese. Pra, grupi i sotëm dhe përbërja e tij nuk është produkt i kësaj Qeverie, tendenca që të ndërhyhet ose të pasurohet këtë grup nuk ka hasur në përkrahje, por garanci ose filtri i fundit megjithatë është Gjykata Kushtetuese që ka ndodhur në të kaluarën dhe mendoj që çdo shqetësim e shpjegon ose na siguron se vetë fakti që duhet të kalojë në Gjykatë Kushtetuese dhe të ndodhë sipas ligjeve të Kosovës. E kemi pasur këtë shqetësim në fillim, kemi kërkuar që ta pasurojmë, mirëpo na është

refuzuar fuqishëm prej misionit të BE-së, si ndërhyrje në atë që dikur ka qenë e dakorduar. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti ka pyetje shtesë.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Kryeministër, a është kjo, në fakt, rezultat i asaj që ju vetë keni deklaruar që nuk e keni hapur fare dosjen që merret me Asociacionin e Komunave me shumicë serbe dhe tash jemi para një situatë të tillë, ku përgatitet një statut, i cili as në gjuhën zyrtare të Kosovës nuk është dhe ju vjen në zyrën tuaj. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: E kam përshtypjen, Avdullah, që veç ke qejf të shpurdhësh në do gjëra që s'janë për diskutim sot. Shikoni, edhe grupi, edhe çdo gjë të Asociacionit ka qenë produkt i qeverisë suaj, po s'desha t'i them bash ashtu. Jam munduar t'i fus pak duart, por më kanë thënë: zotëri, qe qysh i ke letrat, qe qysh i ke shkresat, i kam vendimet këtu, po s'po dua t'i diskutoj.

Po ju siguroj që, është diçka e mirë, megjithatë është diçka e mirë, pa marrë parasysh në proces, ata para meje, në këtë rast kryeministri Mustafa, presidenti Thaçi, një punë e kishin bërë të mirë, shqyr, që e kishin lënë t'ia japë vlerësimin Gjykata Kushtetuese. Edhe, vonesat pse i kam bërë unë, kanë karakterin e asaj që unë kam menduar që Kosova duhet të japë një kontribut shtesë, të mos bazohet vetëm në ato të atëhershmet, njëkohësisht filtrin, pra shqyr e kemi Gjykatën.

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë edhe te një pyetje për kryeministrin nga zonja Besa Baftiu.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Në vitin 2013, Qeveria e Republikës së Kosovës, e udhëhequr në atë kohë nga kryeministri Hashim Thaçi, nëpërmjet një njoftimi për medie na është bërë e ditur se është marrë vendimi për krijimin e Komunës së Zhegrës. Zoti kryeministër, a mund të na tregoni çka keni ndërmarrë ju për të ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për themelimin e kësaj komune?

KRYETARI: Kryeministër, fjala për ju!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: E nderuar deputete Baftiu,

Do të thotë ekziston një vendim i Qeverisë së Kosovës, i datës 17 korrik 2013, nëpërmjet të cilit kryeministri i atëhershëm, zoti Hashim Thaçi, ka aprovuar një kërkesë të Ministrisë së Pushtetit Lokal për jetësimin dhe zhvillimin e procedurave ligjore për themelimin e Komunës së re të

Zhegrës bazuar në këtë, këtë e këtë. I vetmi material, pra e vetmja lëndë, e vetmja materie që kemi në dispozicion është ky vendim. Me gjasë që atëherë nuk ka kaluar në procedim, me sa e di unë, procesi i krijimit të komunave të reja involvon edhe Parlamentin. Sa i përket Qeverisë, ne mund t'ju propozojmë në të ardhmen krijimin e disa komunave të reja, janë disa raste specifike, si rasti i Zhegrës, pra mund të ketë edhe ndonjë tjetër. Mund të propozojmë një të ardhme krijimin e komunave të reja në Kosovë.

Por, me sa di unë vendimin final e merr po ashtu Parlamenti, pra Qeveri propozon, por vendimi vjen nga Parlamenti.

KRYETARI: Faleminderit! A është ndonjë koleg deputet që ka ardhur ministri ndërkohë, Ganimete Musliu.

A pyetje shtesë pati, kërkoj falje. Atëherë, vazhdo, të lutem!

BESA BAFTIU: Vendimin, të cilin e thatë ju, kryeministër, e kam edhe unë në dorë, është i datës 17.07.2013, që do të thotë se është një vendim që është marrë para fushatës së zgjedhjeve lokale të vitit 2013. Po më intereson të di a është anuluar ky vendim dhe cili është statusi i këtij vendimi?

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Me leje, se veç t'ju them kështu, nuk e di statusin e këtij vendimi, pra nuk kam mundur ta kthej në tavolinë unë. Duhet parë si është kjo materie, a ka nevojë të rimerret, apo është vetëm zbatimi i tij, por duhet gjetur, ju e shihni është i vitit 2013, ne po e përfundojmë 2018-ën, pra jemi pesë vjet diferencë kohore. Por, unë e di që ka edhe do propozime të tjera për krijim të komunave të reja, do ta shqyrtojmë këtë, ndoshta-ndoshta një propozim komplet për Kosovën, për ato vende që mendohet si të krijohen komuna të reja.

Mua më kujtohet kur janë krijuar në të kaluarën komunat si pilot-projekte, sa i përket këtij rasti e disa të tjerave që janë cekur, nuk ka, nuk ka ndodhur procedim fare, është vetëm ky vendim dhe s'ka bazë tjetër. Ju thashë që unë vetëm këtë e kam gjetur.

KRYETARI: Deputetja Ganimete Musliu ka pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar, për mundësinë.

Në debatet e shumta që kam realizuar me të rinjtë e Kosovës, në shumicën e rasteve si pengesë në ngritjen e cilësisë së arsimit ata e potencojnë edhe mungesën e laboratorëve dhe pajisjeve të tjera për hulumtime e punë shkencore, si në shkollat e mesme, ashtu edhe në universitete.

I nderuar ministër, a mund të na thoni sa shkolla në tërë territorin e Kosovës janë të pajisura me laboratorë dhe si është gjendja e tyre funksionale?

KRYETARI: Ministër, fjala për ju!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kryeministër,

Ministra,

Sipas gjenerimit të raportit nga SMIA për vitin 2017-2018, nga gjithsej 1 mijë e 118 shkolla që janë aktualisht në territorin e Kosovës, prej tyre gjithsej 280 laboratorë funksionalë i kemi në këtë vit, ndërsa 300 klasë janë të pajisura me sistemin e IT-së.

Vlen të ceket se të gjitha këto shkolla që ndërtohen nga MASHT janë të projektuara me hapësira përkatëse të laboratorëve dhe gjithsesi pajisjen edhe me inventarë bazikë. Ndërsa, për funksionalizimin e tyre mbetet që komunat t'i funksionalizojnë laboratorët. Megjithatë, duke pas parasysh se kemi mbingarkesë të nxënësve, shpesh komunat këto laboratorë i kthejnë në klasë mësimi, ajo çka i mbetet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe komunave përkatëse është që në të ardhmen të ndajmë buxhet më shumë për aktivizimin e laboratorëve në të gjitha shkollat e Kosovës, por realisht kemi mungesë të buxhetit jo vetëm për laboratorë, por kemi mungesë të buxhetit edhe për vetë shkollat.

KRYETARI: Pyetje shtesë? Po, të lutem!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, ministër, për përgjigjen. E thatë edhe vetë, në shumicën e rasteve këta laboratorë kthehen në salla mësimi në mungesë të hapësirave. Përveç funksionalizimit të këtyre laboratorëve që për mendimin tim nga statistikat që ju sapo i lexuat janë shumë pak, a mendoni që t'i rritni edhe hapësirat mësimore që laboratorit ta kryejë punën e laboratorit. Sepse, ne kemi raste kur na njoftojnë se shumica prej laboratorëve ose nuk kanë staf adekuat, të cilët do t'i trajnojnë nxënësit, të cilët kanë nevojë t'i përdorin këta laboratorë, ose thjesht është ajo edhe ajo që e the se shpeshherë këta laboratorë janë jashtë funksionit për shkak të mungesave të hapësirave shkollore.

KRYETARI: Urdhëro, ministër!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Konsideroj që përtej vullnetit dhe dëshirës që ne kemi paraqitur në elaborim të mungesës së hapësirave shkollore në territorin e Kosovës, ku mungojnë 148 shkolla dhe duhet buxhet shtesë mbi 300 milionë euro. Pra, kemi problemin e buxhetit shtesë dhe ne jemi të gatshëm në momentin kur kemi buxhet që t'i ndërtojmë shkollat dhe t'i ndërtojmë hapësirat e mjaftueshme, qoftë për laboratorë, por gjithsesi edhe për klasë mësimi.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Sali Zyba, a është këtu? Nuk është! Atëherë, po vazhdojmë pyetjet, me aq sa po e shoh nga këto çka kemi kaluar, më s'kanë mbetur asnjë pa u përgjigjur.

Sami, jam duke vazhduar në pyetje, jo nuk i përfundoj, po kalova nja 4-5 deputetë me marrëveshje, nuk ishin ministrat e u bë kombinimi, po vazhdojmë tash. Jam në pyetjen e 16-të, deputetja Albulena Haxhiu ka pyetje për ministrin Ablerad Tahiri, ministri nuk është këtu. A dëshironi ta bëni pyetjen?

ALBULENA HAXHIU: Pyetja është bërë më datë 3 korrik 2018 dhe meqë ministri nuk është këtu, unë po e bëj, për shkak se e konsideroj që është e rëndësishme. Fusha e së drejtës ndërkombëtare private në Kosovës është e rregulluar me Ligjin për zgjidhjen e kolizionit të ligjeve me dispozitat e vendeve të tjera në marrëdhënie të caktuara të ish-RSFJ-së, numër 43/82 dhe 78/822.

Ligji i cili i zgjidhur kontestet juridiko-private me elementë të huaj është në fuqi që nga 1 janari i vitit 1983. Ky ligj për shkak të rrethanave të ndryshuara politike, juridike, ekonomike në Republikën e Kosovës nuk ka gjetur zbatim funksional në praktikë. Andaj, pyetja për ministrin e Drejtësisë është: pse ende nuk është nxjerrë ligji i ri, i cili rregullon fushën e së drejtës ndërkombëtare private, kur dihet fare mirë që për shkak të rrethanave të ndryshuara politike, juridike dhe ekonomike, edhe shtetet që kanë dalë nga sistemi politik-juridik i ish-Jugosllavisë kanë nxjerrë ligjin e ri, me të cilin kanë rregulluar këtë fushë mjaft me rëndësi për qytetarët në përgjithësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë, deputeti Daut Haradinaj ka pyetje për ministrin e Arsimit, Shyqiri Bytyqi.

DAUT HARADINAJ: Kryetar, janë pyetje të vjetruara, pyetjet kanë pasur të bëjnë me mungesën e profesorëve gjatë afatit të provimeve dhe për ministrin e Punëve të Brendshme rreth një konkursi, ku është vërejtur që nuk ka transparencë në rekrutimin e policëve të rinj. Po këto pyetje po mendoj që e kanë humbur tash kuptimin, domethënë, besoj që në të ardhmen ministrat janë më të kujdesshëm.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, po vazhdojmë, deputetja Fitore Pacolli ka pyetje për zëvendëskryeministrin Behxhet Pacolli. Nuk është zëvendëskryeministri, a dëshironi, deputete, të bëni pyetje?

FITORE PACOLLI: Pyetja është bërë më datë 3 korrik 2018, mirëpo ministri i Punëve të Jashtme nuk e sheh të arsyeshme të vijë në seancë, ngase kryeministri iu ka siguruar mbi 10 zëvendësministra dhe këshilltarë, por prapë ministrat tuaj, kryeministër, nuk japin përgjegjësi para deputetëve, nuk gjenden në seancë, nuk vijnë në seancë kur ne kemi pyetje për ta. Pyetja ime është shumë e rëndësishme dhe ka të bëjë me Zyrën e Kosovës në Greqi dhe në Sllovaki.

Pra, këto dy shtete ende nuk e kanë njohur Kosovën dhe është e rëndësishme, sepse këto dy shtete kanë dërguar sinjale te Republika e Kosovës se janë të gatshme t'i hapin zyrat e Kosovës në vendet e tyre, mirëpo fatkeqësisht as Qeveria e kaluar, as kjo e tashme nuk ka ndonjë interes. Ne e kemi me rëndësi që Kosova të thellojë marrëdhëniet bilaterale me shtetet, të cilat e kanë njohur Kosovën, e sidomos me ato, të cilat nuk e kanë njohur. Pra, pyetja ime është kështu: më 22 mars të këtij viti ministri ka deklaruar se në një të ardhme të afërt Kosova do të hapë zyrat e saj në Greqi dhe Sllovakia. Dhe ne nuk e dimë nëse janë gati që të hapin këto zyra, sepse kështu është paralajmëruar edhe në vitin 2015, e sot jemi në vitin 2018.

A është Qeveria ose Ministria për Punë të Jashtme duke zhvilluar diskutime me zyrtarë të të dyja vendeve? Nëse po, ku ka arritur procesi? Dhe, të na tregojë nëse janë në diskutime për të hapur zyrat, pra me zyrtarët e Greqisë dhe Sllovakisë? Atëherë, nëse janë në diskutime, duhet të na tregojnë se deri ku kanë arritur dhe a bëhet fjalë për zyrë diplomatike apo për zyrë ekonomike? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Kryeministri dëshiron të përgjigjet.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Faleminderit, zonja deputete Pacolli!

Do të thotë, sa i përket hapjes së misioneve tona, e varësisht prej emrit si do t'i quajmë në vendet që s'na kanë njohur, personalisht kam qenë kundër. Sepse, kam menduar që po pranojmë një stad më të ulët se sa ajo kush jemi, pra shtet i pavarur dhe, ose marrëdhënie diplomatike, ose fare.

Së fundi, më kanë bindur që është mirë të veprojmë edhe në këtë formë, pra me disa prej shteteve, edhe pikërisht në këto dyja, Sllovakia dhe Greqia. Me sa e di unë, megjithatë ministri është edhe më kompetent se unë, por me sa e di unë, jemi në ato po them ashtu, periudhat më finale që t'i lansojmë, t'i nisim këto dy përfaqësi, me të cilat edhe unë jam pak skeptik, për shkak se ne e kemi shpallur veten të pavarur një herë, e ne duhet të insistojmë në njohje të plotë edhe në marrëdhënie bilaterale, diplomatike të nivelit mes shteteve, pra mos të improvizojmë më tutje. Sido që të jetë ndoshta-ndoshta, po them edhe një herë, e ardhmja do të tregojë se kemi të drejtë, pra të aplikojmë edhe këtë procedurë të tillë sikurse u propozua. Faleminderit! Kërkoj falje për ministrin, do ta bisedoj me të.

KRYETARI: Ka pyetje shtesë.

FITORE PACOLLI: Kryeministër, ty do të shkojë mandati duke kërkuar falje për mospunën e ministrave edhe mospunën tuaj. Paralajmërimet se zyrat do të hapen janë që nga viti 2015, a i bie kjo që ju i keni ndalur diskutimet kur keni ardhur ju në pushtet si Kryeministër i Kosovës për të hapur zyra, dhe ju po flisni se nuk keni dashur të hapni zyra të tjera të këtij niveli, sepse ne e kemi shpallur Kosovën të pavarur. Por tani, ditëve të fundit, ju sapo na folët edhe për negociim të sovranitetit dhe të pavarësisë së Kosovës.

Prandaj, jeni shumë i paqartë. A dëshironi zyra, të cilat do ta forcojnë tutje pavarësinë e Kosovës, apo ju do të vazhdoni tutje ta cenoni dhe ta shkatërroni këtë pavarësi që e kemi fituar nëpërmjet dialogut që po zhvillon në Bruksel?

KRYETARI: Kryeministri, prapë e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Ndoshta po dalim prej teme, edhe më gjerë në përgjegjësinë, në planin e jashtëm, por një gjë ju siguroj për ministrin e Jashtëm, shumicën e kohës është i detyruar të jetë jashtë vendit, besoni. Edhe sot ishim me të, tani veç është në Mal të Zi, por menjëherë duhet të vazhdojë më tutje, gjatë kësaj jave i ka tri ngjarje të tjera, është në përfaqësim tuajin, të Parlamentit, të Kosovës, temave nacionale.

Njëkohësisht, te diskutimi i pavarësisë, i sovranitetit, këto janë teme që së shpejti do të jemi në dialog dhe do t'i flasim, që të mos i përziejme dy herë. Nuk besoj që ndonjëherë e kam nxjerrë në pikëpyetje as sovranitetin, as atë kush jemi.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Haxhi Avdyli ka pyetje për ministrin Skender Reçica. Nuk qenka! Deputeti Imet Rrahmani ka pyetje për ministrin Uran Ismajli.

IMET RRAHMANI: Faleminderit, kryetar!

Unë, në fakt, i kam dy pyetje, tash meqenëse herën e kaluar pata rast ta bëj njërën, nuk e di cila është në agjendë, por unë do ta bëj njërën dhe të shohim.

I nderuar ministër, sa për rikujtim, në shtator të vitit 2015 në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës ka filluar së funksionuari Kardiokirurgjia. Gjithashtu, krahas kësaj u punua mjaft edhe në funksionalizimin e Kardiologjisë Invazive. Përpos që ai shërbim u bë 12 orë, patëm filluar edhe blerjen e aparaturës më moderne për kohën, për Kardiologjinë Invazive dhe Kardiokirurgjinë, dhe kemi mbështetur stafin me pagesa shtesë. E gjithë kjo, në mënyrë që të krijojmë një bazë të mirë, të qëndrueshme, që ky sektor, ose ky segment i shëndetësisë të zhvillohet edhe më tutje. Mirëpo, atëherë humbëm shumë kohë, sepse u kontestua mundësia që për 390 mijë euro të rregullohet hapësira, të shtohet mirëmbajtja nga një në dy vite dhe të trajnohet personeli në klinika të Austrisë.

Sot pas dy viteve, ende nuk e kemi aparaturën të instaluar e profesionistët e shkëlqyer po detyrohen të punojnë me aparaturë të stërvjetruar dhe të konsumuar tej mase.

Zoti ministër, mua më intereson kur do të vendoset koronarografi i ri?

KRYETARI: Ministër, fjala për ju.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit shumë, shumë i nderuar deputet Rrahmeni!

Kjo realisht, është ajo pyetja të cilën unë e kam sot.

Faleminderit shumë!

Ju e dini që aparati ekzistues i koronarografisë ka qenë mjaftë i vjetruar. Ne kemi bërë servisimin e plotë të tij, pra është bërë pothuajse i ri dhe kjo na ka mundësuar që shërbimin e kardio-kirurgjisë dhe kardiologjisë invazive nga 6/12 të bëhet në 24 orë.

Ju e dini vetë, që tani në Kosovë e bëjmë një shërbim 24-orësh, i cili s'ka ekzistuar asnjëherë më parë dhe kjo është mundësuar edhe përkundër problemeve që kemi pasur me aparatura të vjetruara. Kemi pasur, le ta themi, një punë të shtuar ku vetëm për gjashtë muaj janë bërë 1160 koronarografi dhe diku 647 stentime, pra një punë mjaftë e madhe, një vëllim shumë i madh. Por, përpos këtij vëllimi kaq të madh të punës, ajo që është e rëndësishme së veçantë është se janë kursyer shumë e madhe parash, që është dërguar me milionë euro jashtë vendit për trajtime, që realisht kanë mundur të kryhen në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Sa i përket aparaturës, ju vetë besoj se jeni në dijeni që disa projekte në Ministri të Shëndetësisë kanë pasur njëlloj odisejade, pra janë zgjatur për vite e vite më shumë se që është dashur. Ajo kontratë që ka qenë Ministria e Shëndetësisë ka bërë shkëputjen e kontratës me operatorin ekonomik, për arsye se ai as nuk i ka përfunduar punët e në anën tjetër na ka lënë ne pa i përfunduar, duke e ditur që kemi pasur nevojë për një aparat të tillë. Pra, kjo aparaturë e cila është blerë dhe ka mbetur në Austri për një kohë të gjatë, tani është në rrugëtim shumë më të mirë, për arsye se ne jemi duke përfunduar punën në vendin ku do të vendoset, e kemi bërë koordinimin së bashku me prodhuesin e aparaturës, në mënyrë që puna fizike apo konstruktimi i atij vendi të jetë në parametra me prodhuesin që do ta sjellë angiografin.

Angiografi do të silllet në Kosovë gjatë muajit gusht, gjersa funksionalizimi i tij pritet të bëhet në tetor. Unë e di që është zgjatur, pra është diku tre vite një projekt i tillë, nuk është dashur të zgjasë aq shumë, mirëpo jemi ku jemi. Jemi marrë me një prioritet të këtyllë mjaft shumë, mirëpo ka pasur probleme shumë gjatë rrugës. E para, kemi pasur një operator ekonomik, i cili nuk e ka kryer punën e vet e në anën tjetër na ka lënë peng, të cilin e kemi trashëguar.

Së dyti po ashtu, nuk kemi pasur një harmonizim në mes specifikacioneve të cilat ka kërkuar prodhuesi dhe atyre të cilat është dashur të kryhen në vend të punës. Faleminderit!

KRYETARI: Ka pyetje shtesë? Po. Vazhdo!

IMET RRAHMANI: Po, zoti ministër, faleminderit për këtë!

Por, unë nuk pajtohem me një çështje, se shërbimi i kardiologjisë invazive ka ekzistuar edhe para se të vijë si procedurë stentimi, në fakt kardiologjisë. Kardiologjia invazive përfshin edhe stentimin edhe procedurat tjera. Tash është bërë 24 orë, që është mirë, sepse keni vazhduar mbi

një bazë të shëndoshë ta trajtoni kardiologjinë invazive dhe kardiokirurgjinë me prioritet, për çka unë ju jam mirënjohës si profesionist shëndetësor që jam, mirëpo nuk e mora një përgjigje për pyetjen që dua ta bëj tash.

A do të kushtojë vendosja e koronarografit më shumë se 390 mijë euro, respektivisht përgatitja e hapësirave dhe e procedurave të tjera, që janë përcjellëse?

KRYETARI: Ministër, fjala për ju!

MINISTRI URAN ISMAJLI: Deputet,

Unë ua shpjegova se si ka qenë situata dhe ju e dini, se keni qenë ministër i Shëndetësisë. Domethënë, është gjetur një projekt i cili nuk ka qenë i harmonizuar me projektin e kaluar. Pra, nuk ke pasur harmonizim në mes specifikacioneve që i ka kërkuar prodhuesi për t'u vendosur dhe kemi hasur në një pozicion ku operatori ekonomik na thoshte neve "nuk mund të vazhdojmë", angiografi ka mbetur në Austri atje qysh ka mbetur që tre vjet. Në pamundësi të kësaj pune, ne kemi bërë ndërprerjen e kontratës, sepse operatori ekonomik nuk e ka kryer punën si duhet.

Ajo ndërprerje e kontratës realisht është dashur të ndodh më herët. Kur e kemi ndërprerë kontratën kemi dalë në një procedurë tre-ofertuese, kemi marrë një çmim shumë të lirë, shumë më lirë se herën e kaluar, dhe jemi duke e kryer punën për të ardhur angiografi.

Pra, gjithçka që është bërë është bërë në bazë të procedurave dhe e rëndësishmja është që një angiograf që është blerë, të mos mbetet nëpër depot e Austrisë, por të vijë në Kosovë. Përgjigja ime prapë është që do të vijë në gusht dhe do të funksionalizohet gjatë muajit tetor. Të gjitha procedurat tjera janë publike, janë transparente. Është me keqardhje dhe besoj se edhe ti i bashkëngjitesh kësaj keqardhjeje, që është vonuar.

Me siguri se ka qenë edhe vullneti yti që të vijë më shpejt, por nuk ka ndodhur të vijë. Ajo që është me rëndësi është që unë e kam marrë me shumë seriozitet, e kam parë që operatori ekonomik me të cilin është lidhur kontrata nuk ka mundësi ta përmbushë detyrën, i është bërë vërejtja, është përfunduar, është mbyllur kontrata, e kemi hapur edhe një herë, e kemi bërë në bazë të specifikacioneve që ka kërkuar prodhuesi ndërkombëtar i angiografit dhe gjithçka është përfunduar. Në gusht vjen angiografi, pra përfundon pjesa e ndërtimit që ka zgjatur me vite. Në gusht vjen angiografi që besoj se është një lajm shumë i mirë. Në tetor fillon funksionalizimi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: A dëshiron në vazhdim të sqarimit, për hir të deputetëve? Vazhdoja ministrit fjalën.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Çka është me rëndësi në fund të kësaj, është se edhe lista e pritjes për angiografi do të përfundojë, do të largohet.

Kemi pasur lista të ndryshme të pritjes, është larguar ajo në stentim, do të largohet në angiografi, po ashtu edhe deputetja më herët që tha për rezonancë, edhe aty do të blejmë një rezonancë. Pra, kemi një impenjim dhe një përpjekje të vazhdueshme, që kudo që kemi hasur listat e pritjes, të paktën t'i kthejmë ato në zero që pastaj të mund sa më mirë të punojmë në menaxhim të situatës në shëndetësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, ke ende pyetje. Po vazhdojmë. Deputetja Besa Baftiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryetar!

Pyetja ka të bëjë me specialistët e papunë.

Ministër Ismajli,

Siç e dimë, Kosova ka numrin më të vogël të mjekëve specialistë, mirëpo edhe të mjekëve familjarë për kokë banori. Në anën tjetër kemi një numër të madh të mjekëve specialistë të papunë të profileve të ndryshme të mjekësisë dhe veçanërisht kemi edhe të stomatologjisë dhe të psikologjisë klinike. Me të marrë mandatin ju si ministër u keni premtuar këtyre specialistëve, që do të punësohen që të gjithë.

Po ashtu, në buxhetin e vitit 2018 është paraparë e është ndarë buxhet për punësimin e 200 specialistëve. Më intereson të di se sa mjekë specialistë janë punësuar deri më tani dhe a keni ndonjë regjistër, se cilat profile të mjekëve specialistë janë të papunë?

KRYETARI: Ministër, fjala për ju.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Realisht, deputete, pyetja në të shkruar ka qenë për raste, nuk ka qenë për klinikat, pra sa janë për secilën klinikë, se në të kundërtën do ta kisha pru edhe atë. Por, do ta përcjell.

Çka është më me rëndësi është që dihet se si politikë në Ministrinë e Shëndetësisë kemi konsideruar që... Pajtohemi me ju, që numri i specialistëve pra nga të dhënat zyrtare që edhe ju i lexoni edhe ne, numri i specialistëve është më i vogël për kokë banori se sa i shteteve përreth. Prandaj, ka qenë që nga hapat e parë kur e kemi diskutuar Buxhetin me zotin Bedri Hamza, por edhe si politikë qeveritare, që të arrijmë ta shtojmë numrin e punëtorëve shëndetësorë. E kemi rritur numrin e punëtorëve shëndetësor edhe për 300 të tjerë.

Në anën tjetër kemi kërkuar nga të gjithë drejtorët e klinikave, që të fillojnë të punojnë me Bordin e SHSKUK-së, të identifikojnë se cilët janë nevojë që të shtohen, në mënyrë që të kemi

një numër më të madh të specialistëve për punën që na nevojitet. Ju e dini vet, se ne kemi bërë disa hapa në krijimin e një ambienti më të favorshëm për të gjithë mjekët në Kosovë. Kemi bërë një udhëzim administrativ të ri, i cili paguan edhe specializantët tani. Po ashtu, në anën tjetër jemi duke punuar në Ligjin për paga, në mënyrë që edhe aty të krijojmë një ngritje në bazë të punës që bëjnë, në mënyrë që mjekët specialistë në Kosovë të paguhen në bazë të punës dhe shkollimit, duke krijuar kushte më të favorshme për të gjithë specialistët në Kosovë.

Prandaj, të gjitha këto iniciativa shkojnë në përmbushjen e kësaj nevoje të madhe që e ka sistemi shëndetësor e që është, që mjekët specialistë të punësohen të gjithë. Është premtim yni, e kemi thënë dhe do ta mbajmë, që gjatë kësaj Qeverie do të bëjmë gjithçka që është e mundur dhe do të punësojmë të gjithë mjekët specialistë, të cilët kërkohen nga klinikat. Pra, në qoftë se klinika kërkon ndonjë lloj specialisti ata gjithsesi do të punësohen. Tani, natyrisht duke shtuar edhe shërbime të reja po na krijohen mundësi që të punësohen edhe profile të reja, të cilat më herët edhe nuk kanë qenë fare të punësuara në spitalet tona.

Pra, kemi një serë përpjekjesh që bëjnë dy gjëra: e para, që shtojnë numrin e specialistëve, por në anën tjetër edhe krijojnë një ambient më të favorshëm për të gjithë ata që të qëndrojnë në Kosovë, qoftë për mjekë specialistë, por natyrisht edhe për studentët apo specializantët e ndryshëm, të cilët dëshirojnë që të vijojnë studimet në mjekësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Ka pyetje shtesë.

BESA BAFTIU: Faleminderit!

Ministër,

Unë mendoj se duhet marrë hapa shumë konkretë në drejtim të punësimit të këtyre specialistëve të lëmenjve të ndryshëm, për arsye se e dimë se numri i madh i tyre po na ikin, po dalin dhe po shkojnë në vendet e Evropës. Prandaj, kjo iniciativa e juaj që të bëni një planifikim për resurset humane, gjegjësisht për specializimet e lëmenjve të ndryshëm është iniciativë e mirë, mirëpo duhet pasur parasysh që këta specialistë të punësohen sa më parë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri po e kërkon përsëri fjalën.

MINISTRI URAN ISMAJLI: E nderuar deputete,

Unë i përmenda disa hapa konkretë,

Hap konkret i pari ka qenë 300 vende të reja të punës. Hap i dytë konkret ka qenë pagesa për specializantë, të cilët janë në specializim dhe do të jenë specialistë në të ardhmen. Hapi i tretë konkret ka qenë puna në listën e pagave, në mënyrë që specialistët tanë ta marrin një pagë të dinjitetshme. Pra, të gjithë këta kanë qenë hapa për një afat shumë të shkurtër. Është trashëguar një gjendje e tillë me një numër kaq të vogël dhe në qoftë se, ne vazhdojmë të marrim specialistë pa një lloj planifikimi, atëherë çka na ndodh është se do të ketë një stërmushje të disa klinikave

e do të ketë spitale të përgjithshme, të cilët nuk do të kenë specialistë. Pra, çka ndodh? Ne e dimë se të gjithë dëshirojnë të punojnë në Prishtinë, mirëpo ajo çfarë mund të ndodhë është se në vet spitalin e Gjilanit, prej nga vini ju besoj, do të ketë mungesë të specialistëve dhe qytetarët e Gjilanit do të duhet pastaj të vijnë në Prishtinë edhe pse një person ka mundur të merret në punë në Gjilan.

Pra, e gjithë kjo kërkon që specialistët kur t'i marrim, mos t'i marrim vetëm për hatër të dikujt, por t'i marrim për qëllime që t'u shërbejnë pacientëve tanë në spitale të përgjithshme. Unë kam pasur raste, kur më është thënë, se për shembull, për një punë e cila ka mundur të kryhet në spitalin e Mitrovicës, ta quaj me një specialist, ai person duhet të vijë deri në spitalin e QKUK-së. E para, e ngarkon QKUK-në, e dyta krijon lista të pritjes dhe e treta, po ashtu krijon shpenzime për vet pacientin. Prandaj, qëllimi ynë është:

1. të krijojmë ambient të mirë;
2. të krijojmë paga të dinjitetshme.

Do të marrim sa më shumë prej tyre punë, por gjithnjë të jenë në shërbim të pacientëve tanë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, deputeti Elmi Reçica, se jemi në përfundim të kohës. Kisha lutur deputetët të kthehen gradualisht, se na duhet votimi për t'u futur 61 deputetë në seancë pas procesverbalit. Është me rëndësi se pa 61 deputetë s'mund të vazhdoj, kine parasysh.

Elmi Reçica, pyetje për ministrin Palë Lekaj.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje Kabinet qeveritar,

Përshëndetje zoti ministër Lekaj,

Unë e kam bërë një pyetje dhe në seancën e kaluar nuk kam mundur ta parashtroj, kështu që po e shfrytëzoj rastin që në këtë seancë të jua bëj një pyetje me shkrim: Çështja për të cilën unë e kam parashtruar pyetjen ka të bëjë lidhur me autostradën "Arbër Xhaferi", Prishtinë - Shkup.

Ferizaj është qyteti i tretë për nga numri i banorëve, ndërsa është qyteti i dytë për nga kontributi në Buxhetin e Kosovës, kurse e ka vetëm një kycje në këtë autostradë, e cila është në fshatin Bibaj.

Është e padrejtë dhe nuk është në rregull që banorët dhe qytetarët e Ferizajt, veçanërisht bizneset, të cilat kanë bërë kërkesa edhe me shkrim dhe ua kanë dorëzuar edhe juve gjithashtu, të mos e kenë edhe kycjen e dytë në këtë autostradë. Dhe është menduar se kjo kycje mund të bëhet

nëpërmjet rrugës “Driton Islami”, që është rrugë e bizneseve, nëpërmjet fshatrave Talinoc i Muhaxhirëve, Sazli dhe kyçja të bëhet në Papaz.

Do të thotë, pyetja është: I nderuar ministër, kur do të fillojnë procedurat për realizimin e këtij projekti jetik për bizneset dhe qytetarët e Ferizajt? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, fjala për ju!

MINISTRI PAL LEKAJ: I nderuar kryetar,
Kryeministër,
Zëvendëskryeministra, ministra, deputetë,
I nderuar mik Elmi,

Ajo që mund të them, ne së bashku e kemi filluar një rrugë dhe kemi premtuar para qytetarëve që do të ketë kyçje në autostradën “Arbër Xhaferi”, që është kyçje që duhet patjetër duhet të ndodhë, sepse autostradat dhe rrugët bëhen në shërbim të qytetarëve, e jo në shërbim të individëve dhe interesave, apo klaneve të ndryshme, dhe unë jam jetësisht i përkushtuar që në kohën më të shkurtër të mundshme t’i fillojmë procedurat, të fillojë dizajnimi i projektit, dhe të që ajo të ndodhë sa më parë. Faleminderit!

KRYETARI: Vetëm vazhdo, deputet!

ELMI REÇICA: Zoti ministër,
Ne të gjithë e dimë që këtë vit do të përmbillet autostrada “Arbër Xhaferi”, Prishtinë - Shkup, dhe po shpresoj që në kuadër të kësaj gjatë këtij viti duhet të ndodhë edhe kjo kyçje. Kështu që të falënderoj shumë. Faleminderit për përgjigjen!

KRYETARI: Ministër, u krye. Tanimë e kemi përfunduar kohën që e kemi pasur për pyetje parlamentare. I kemi përfunduar të gjitha pyetjet që kanë qenë të paraqitura nga seancat e mëparshme, përveç në rastet kur, ose deputeti, ose ministri nuk kanë qenë në sallë.

Jemi te pyetjet e parashtruara për herë të parë, të cilat do të barten në seancën e radhës.

Sami, urdhëro! Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryetar! Unë e kam bërë një pyetje për zotin ministër Palë Lekajn më 12 qershor. Kjo është mbledhja e katërt që nuk kam marrë përgjigje, e kam bërë dy herë. Dhe unë mendoj se megjithatë si deputet meritohet një përgjigje me gojë në pyetjen që e kam bërë. Kam bërë pyetje me gojë, po ashtu ministrit të Punëve të Jashtme. Pas një kohe shumë të gjatë më është përgjigjur me shkrim, por nuk është përgjigjur në materien e pyetjes.

Tash, ndoshta e ka pyetjen zoti ministër, por nëse nuk e ka unë mund t'ia përsëris. Është çështja e vendkalimit kufitar në mes Maqedonisë dhe Kosovës në vendkalimin Stanaj, ose Stançiq siç quhet, në karadake. Nëse pyetja nuk është me vend tek ju, t'ia përcillni edhe ministrit koleg, sepse jeni brenda një Qeverie.

Kur mund të presin qytetarët e Republikës së Kosovës të asaj ane, që të kalojnë nëpër vendkalimin kufitar me Maqedoninë në mënyrë zyrtare, sepse ai vendkalim është mbyllur, kurse infrastruktura rrugore është në rregull, por është çështja e ndërtimit të infrastrukturës ndihmëse e çka janë aty... Ndoshta është edhe pjesë për ministrin e Punëve të Brendshme, por sidoqoftë, një përgjigje për qytetarët që kanë interesim sepse është numër i madh i qytetarëve dhe zhvillon edhe ekonominë, edhe turizmin, edhe është me rëndësi. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri Palë Lekaj po shpreh gatishmëri dhe zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj, për t'u përgjigjur. Zëvendëskryeministër, urdhëro! Pastaj edhe ministri.

ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari zoti deputet,

Mendoj që situata në kohën kur ju po e shtroni pyetjen nuk është ajo që ju e përshkruat në fjalën tuaj. Me sa di unë, aktualisht ka kontejnerë të cilët e mundësojnë kalimin në Stançiq - Bellanovc dhe këta kontejnerë u shërbejnë qytetarëve të Kosovës, që kurdo që ka lëvizje të lirë kjo të ndodhë. Por përtej kësaj, para 5-6 javësh ne kemi vendosur gurëthemelin e një pike të përbashkët kufitare e cila do të jetë pikë kufitare e kategorisë A dhe e cila do të ndërtohet brenda një afati të shkurtë kohor dhe e cila do të jetë në dispozicion për lëvizje të lirë, edhe të njerëzve, edhe të mallrave dhe e cila do të jetë pikë e përbashkët kufitare në mes të autoriteteve të Kosovës dhe autoriteteve të Maqedonisë.

Ngjarja ka qenë publike dhe nesër e kemi një ngjarje të njëjtë në Morinë, në mes Kosovës dhe Shqipërisë, por ky realitet nuk përkon me atë se si ka qenë në Karadak, në këtë pjesë të Kosovës, para një kohe të caktuar. Çfarë mund të ju them, është se prej vitit 2011 ndërtimi i kësaj pike kufitare ka qenë prioritet dhe sa ka qenë Gruevski në pushtet si kryeministër ka qenë e pamundur, as s'mund kemi bërë marrëveshje, as autoritet financuese evropiane nuk kanë pasur vullnet ta financojnë, por me Qeverinë e re Haradinaj në Prishtinë, Zajevi në Shkup, ka një qasje të re. Ajo pikë kufitare besoj që shumë shpejt do të jetë në funksionim. E kemi për qëllim, po ashtu edhe pikën kufitare në Han të Elezit, ta bëjmë një pikë kufitare me kontroll të përbashkët. E njëjta do të duhej të ndodh edhe në Gilloboçicë. Por, informatat e mija janë që ndoshta edhe ministri Lekaj mund ta plotësojë, informatat e mija janë që kontejnerët që janë të vendosur në formë provizore e mundësojnë lëvizjen e lirë të qytetarëve sot. Natyrisht, që kur të përfundojë ndërtimi i pikës së përbashkët kufitare Maqedoni - Kosovë do të ketë lëvizje edhe më të madhe.

Se sa e shkurton rrugën e banorëve që kanë ecur 70 km prej kësaj ane të kufirit për ta vizituar dikë në pjesën tjetër të kufirit, mund të debatohet, por përtej kësaj kjo pikë e përbashkët kufitare është e rëndësishme dhe për transportin rrugor Kosovë – Bullgari, meqë e shkurton rrugën e cila e graviton Bullgarinë. Por, s'ma merr mendja që aktualisht forma se si ju thatë e përshkruan gjendjen aktuale në terren. Por, ka pasur problem prej vitit 2011...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputet, si Avokat i Popullit, më kishe qua në gjyq, se krejt po i shkeli Rregulloren. Hajde, pyetje plotësuese. E ke përfunduar më, për atë po të them.

SAMI KURTESHI: Megjithatë, është çështje e një të vërtete.

Zoti ministër,

Zëvendëskryeministër,

A jemi duke folur për të njëjtën pikë kufitare?

Në qoftë se, jemi duke folur për të njëjtën pikë kufitare, unë kam qenë bre para nja 3-4 ditësh dhe nuk ka kurrgjë, aty s'lënë të kalosh. Veç ti nëse ke kalua si zëvendëskryeministër, ndoshta!? Këtu diçka nuk është në rregull, ose unë jam qorr, ose ti diku ia paske futur për ndonjë pikë tjetër, por për pikën Stanaj jo. Se është bërë një gurëthemel ajo është në rregull, s'pati nevojë të zgjasë.

Çështja që unë po pyes dhe është për banorët, s'ka nevojë për rëndësinë të flitet, a do të bëhet ajo pikë kufitare, do të lëshohet në përdorim zyrtar dhe kur mund të shpresojnë qytetarët, në nëntor, në dhjetor, vitin e ardhshëm, pas dy vitesh, që të kalojnë atypari për të shkuar në Kumanovë, sepse unë e kaloj shpesh atë rrugë, për arsye...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Urdhëro, zëvendëskryeministër, edhe një herë dhe shkojmë në vazhdim të seancës, ju lutem, se një pjesë e deputetëve pastaj edhe ka për të udhëtuar, ka për të arritur në Tiranë sonte.

ENVER HOXHA: Zoti deputet, zoti Kurteshi,

Unë e pranoj atë se çfarë thoni ju. Kjo është një pikë kufitare provizore që funksionon me kontejner. Nuk ka pikë të përbashkët kufitare e cila do të mundësonte prani të përhershme të Policisë së doganave, por unë kur kam qenë në vendosje, vetëm ta sqaroj, jemi duke folur për Stançiq - Bellanovc, por unë kur kam qenë në vendosje të gurthemelit, mua më është thënë që është në përdorim.

Meqë është në kontejner mund të ketë situata ku gjatë ditës funksionon, mund të ketë situata kur nuk funksionon. Përtej kësaj, ajo që kemi folur... po, është provizore. O Sami, po është provizore. Unë po bëj përpjekje... që është me kontejner.

Atëherë, nëse nuk kalohet në verë të 2018, sigurisht në verë të 2019 do të kalojë edhe atë me kamionë edhe për mallra, por çfarë po synoj të them është se, është vendosur gurthemeli i ndërtimit të kësaj pike kufitare dhe se ka kontejnerë dhe ka polici, e cila herë pas here kryen shërbim, me sa e di unë.

KRYETARI: Faleminderit! Përfundoi kjo pikë e rendit të ditës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Derisa ne kemi folur është ulur shumë ndjeshëm numri i deputetëve. Po e shohim shumë, derisa ka debat mos po i ikim çështjeve madhore, të njëjtën kohë grupet parlamentare një pjesë e madhe po largohen. Unë për hir të korrektësisë, jemi brenda seance. Tash aktualisht janë 56 deputetë. Asnjë votim s'mund ta bëjmë, vetëm futemi formalisht. Jemi duke i rënë ziles, jemi duke u munduar...

Qysh po e shoh unë, kjo përgjegjësi e seancës. Unë nuk do ta ndërpres për arsye se dikush mendon edhe kështu, paradite u munduam ta arrijmë një konsensus, po mundohemi, lufta politike më shumë ka marrë dimension interesi të brendshëm, se sa ajo çfarë do të kemi ne si qëndrim ndaj një shteti me të cilin nuk kemi një të kaluar të mirë. Ne po futemi drejt në pikën e dialogut.

S'kemi mundësi votimi, 56 deputetë janë, ja shikoje sallën, ana e majtë e zbrastë, ana e djathtë gjysma, mesi po ashtu gjysma. Kjo është situata. Unë pastaj reagoj me e ndalë seancën. unë më vjen keq, kolegët deputetë e dinë edhe unë duhet të udhëtoj në ora pesë, kemi për të arritur në Tiranë për ta zënë avionin vizitë zyrtare në shtetin Italian. Por, unë me e ndërpre nuk e kam ndërmend, derisa ju si grupe parlamentare s'kërkoni, atëherë po shkojmë drejt në debat.

Po shkojmë drejtë në debat, a kështu. Urdhëro, Dritoni apo Visari. Shqipe Pantina, urdhëro. Fjala për ju!

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryetar!

Në fakt, çështja për të cilën ne kemi kërkuar të debatohet e që është dialogu me Serbinë, mendojmë që është jo vetëm çështje aktuale, por shumë e rëndësishme. Ndonëse, po shihet se ka rënë numri i deputetëve në sallë, ju përmendët po ashtu se një numër i deputetëve do të udhëtojnë po ashtu. Ne propozojmë që seanca të vazhdojë, do të thotë e njëjta seancë të vazhdojë për nesër, ose edhe gjatë gjithë javës nëse është e nevojshme, por që të mos shkojmë në pushim pa u kryer këto pika të rendit të ditës dhe veçanërisht për çështjen e dialogut të diskutohet kur janë edhe deputetët në sallë të pranishëm, por kur është edhe Kabineti qeveritar. Faleminderit!

KRYETARI: E kemi një propozim nga propozuesi. Ne në pushim, sa për korrektësi, një vendim i Kryesisë, unë s'mund ta thyej atë, është se pa i kryer projektligjet nuk mund të shkojmë. Në fund të fundit, projektligje kemi.

Kështu, nesër ata deputetë që udhëtojnë sonte, nuk do të jenë as nesër. Unë në qoftë se ishit pajtua edhe ju të enjten.

Të enjten në orën 10:00 e vazhdojmë seancën. A jeni për të enjten në orën 10:00.

Vetëm kisha pasur dëshirë, se po e shoh, as pozita e mobilizuar, as opozita nuk është e mobilizuar për mbajtjen e seancës.

Të enjten, në orën 10:00, vazhdim i seancës.

* * *

E enjte, 26 korrik 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 23 korrik 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Para se të futemi në pikat e rendit të ditës, më lejoni t’ju uroj për lajmin e djeshëm për marrjen e rekomandimit pozitiv për heqjen e vizave për qytetarët tanë.

Ju falënderoj si deputetë, edhe ata të legjislaturave të kaluara që kanë kontribuar për miratimin e shumë ligjeve të rëndësishme që ka ndikuar në këtë proces. Kemi pasur të gjithë bashkërisht sfida, besoj shumë se bashkërisht do të arrijmë me sukses të realizojmë edhe atë që është qëllim parësor i qytetarëve tanë, përmirësimi i jetës së tyre, në mënyrë që të qëndrojnë në Kosovë, të mos lëvizin jashtë dhe në të njëjtën kohë të kemi liberalizim të vizave.

Urime të gjithëve!

Po fillojmë me pikat e rendit të ditës si në vijim:

Pikat e papërfunduara nga seancat plenare të mbajtura më 8, 14, 19, 28 qershor 2018, si dhe më 5, 6 dhe 9 korrik 2018.

Aktualisht në sallë janë 69 deputetë.

Të nderuar deputetë,

Diskutimet për të gjitha pikat e rendit të ditës nga seancat e lartpërmendura kanë përfunduar, por nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Andaj, në këtë seancë procedojmë me votimin e tyre.

Visar Ymeri e ka kërkuar fjalën, sigurisht ka diçka.

VISAR YMERI: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

I nderuar kryeministër,

Kryetar i Kuvendit të Republikës,

Ne tash e një kohë jemi duke diskutuar për një çështje jashtëzakonisht të rëndësishme, e cila fatkeqësisht po vazhdon në Republikën e Kosovës, e në ndërkohë që po shpërfilllet nga Kuvendi i

Republikës së Kosovës. Të gjithë besoj e dini që e kam fjalën për dialogun me Serbinë, në të cilën Kosova prapë po nxitet pa kurrfarë përgatitje diskutimi, thua se deri tash asgjë nuk ka ndodhur e keqe nga ky dialog.

Deri tash, pra prej se ka filluar në vitin 2012 dialogu na e ka ndryshuar edhe emrin politik nga Republika në fusnotë...

KRYETARI: Zoti Ymeri, s'po ta ndal fjalën, se pastaj devijon seanca, po mundësisht për një minutë përmbyle e të futemi në votim.

Nuk prish punë, për një minutë përmbyle, jepe mesazhin, të mos e ndal, se nuk po dua ta ndal.

VISAR YMERI: Vetëm pak ju kisha lutur të dëgjoni, meqenëse po e trajtojmë si çështje urgjente, kjo ka nevojë për arsyetim dhe arsyetimi është ky...

KRYETARI: Zoti Ymeri vazhdo, një minutë e ke, koncentrohu, të lutem, nuk kemi nevojë të krijojmë skena, adresojë si shqetësim çështjen që e ke dhe vazhdojmë seancën.

VISAR YMERI: Çështja urgjente duhet të arsyetohet, sepse diçka që unë mendoj që është urgjente, ju mund të mendoni që nuk është urgjente, prandaj duhet dëgjuar arsyetimin e pastaj të vendoset, jo në fillim, në fund do të kisha thënë.

Pra, siç isha duke thënë, dialogu përveç se ndryshimit të emrit, na e ka fuqizuar edhe zyrtarizuar praninë politike të Serbisë në Kuvend e në Qeveri nëpërmjet Listës serbe dhe së fundit rrezikoi të na e kthejë me kokë poshtë rendin kushtetues nëpërmjet Bashkësisë së Komunave me shumicë serbe, për ta formalizuar kështu ndarjen e thelluar identifikimin etnik në politikë në dëm të barazisë së drejtësisë qytetare, në dëm të integritetit të njerëzve të territorit, në dëm të përbashkimit e funksionalizimit të resurseve të tregut.

Dhe, në vend se ta vemi gishtin në kokë dhe ta marrim seriozisht këtë situatë ku gjendemi, në vend se ta diskutojmë e ta ridizajnojmë dialogun, vendimmarrjen në të, vijat e kuqe për të, e temat që i flasim e ato që nuk i flasim, krerët institucionalë e quajnë...

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Ymeri, janë dy mundësi, nuk desha ta ndal fjalën, se më vjen keq. Është mocioni procedural, si e tha zonja deputete, e të njëjtën kohë e keni edhe një mundësi po sot, e kemi seancën e re, vetëm të shkojmë në votime dhe nuk e besoj se zgjat më shumë se një orë. Të gjithë kanë çka të flasin, të gjithë do të flasin edhe për çështjen e dialogut. Në qoftë se nuk inicion mocion procedural, të futemi në pika të rendit të ditës ose të shkojmë, mos më keqkupto, nuk po dua t'ia ndërpres fjalën as tënden as të askujt.

Shkojmë te pikat e rendit të ditës, Visar, ti e di, edhe kryeministri është këtu, edhe gjithë grupi parlamentar kanë dëshirë të flasin për dialog, po të shkojmë.

Unë nuk ta ndal fjalën për hir të respektit, edhe për hir të lajmit të djeshëm pozitiv, unë nuk po ik nga tema, as nuk po dua të vë në pozitë të vështirë. Po ka procedura, mocioni procedural e fut menjëherë, në qoftë se dëshiron, vetëm inicioje, e fus në votim, e ke edhe të dytën mundësi, menjëherë pas një ore shkojmë në seancën e re dhe pastaj ngrite si çështje, mos më keqkupto.

Ju kisha lutur, nuk është qëndrim politik me të cilën po dua të mbaj qëndrim autoritar, ndoshta do të duhej ndonjëherë, nuk po dëshiroj.

Visar, të lutem! Regjia, 30 sekonda, në qoftë se do të iniciosh mocion procedural.

VISAR YMERI: Kryetar,

Si shkojnë procedurat në Kuvend, nëse ka një çështje urgjente që deputeti ose grupi parlamentar do ta ngre, atëherë ai e merr fjalën menjëherë për ta ngritur këtë çështje urgjente.

Dhe, së dyti, çështja urgjente duhet të arsyetohet, në mënyrë që të tentoj t'i bind deputetët e tjerë që kjo është çështje urgjente dhe të pranojnë atë, pastaj vjen mocioni, ky nuk është diskutim për dialogun.

Unë po dua ta ngre një çështje urgjente që ta kemi pikë në rendin e ditës dialogun ku do të flasin të gjithë dhe pastaj natyrisht secili grup parlamentar do ta ketë të drejtën...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zoti Ymeri, ne po bisedojmë, për hir të publikut.

Kjo çështja e Rregullores është më e thjeshtë, vetëm se kur të duam e komplikojmë dhe filozofojmë, është shumë e thjeshtë, po, e ke çështjen urgjente, paraprakisht bisedohet, bile e ke, neni 49 në Rregulloren e Kuvendit, e shikoni, në qoftë se unë jam gabim, si grup parlamentar e shtroni si çështje. Sido që të jetë, po shkojmë me këto pika të rendit të ditës, edhe ne do të futemi, jemi në seancë të re, nuk po e bëj, Visar, pse mundem, bile po mundohem të të ruaj për shkak të respektit si deputet, po tash ndoshta edhe kjo butësia ime po krijon mundësi, por Rregullorja është kjo. Qe, Arbeni është i opozitës, mund të bëjë interpretimin nga opozita. Visar, a e vazhdojmë seancën, veç je duke e keqpërdorur butësinë time.

E vazhdojmë seancën...

I ka 30 sekonda, po kërkon të bëjë kërkesë për mocion procedural, kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së, pak më qetë, se dje ka qenë një ditë e mirë, të mos e prishim sot, do të bëjë propozim mocion procedural. Urdhëro, zoti Ymeri, bëje propozimin.

VISAR YMERI: Mirë, atëherë meqenëse nuk po doni ta dëgjoni arsyetimin, unë kërkoj që në mbështetje të nenit 65 të Rregullores, paragrafi 1, pika 1 ta diskutojmë sot si çështje urgjente dhe pastaj edhe ta miratojmë një rezolutë, të cilën do ta propozojmë ne, e të cilën edhe do ta modifikojmë, për të diskutuar për çështjen e dialogut dhe veçanërisht vendimmarrjes në këtë proces të dialogut, në të cilin ne kërkojmë që vendimmarrja t'i bartet Kuvendit, e jo aktualisht siç është një proces edhe jolegjitim, edhe jotransparent, e që është duke vazhduar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të mos ia prishim hijeshinë të djeshmes, do të bëhet edhe më mirë në të ardhmen, besoni!

Shkojmë në pauzë 10 minuta.

Shikoni, shefat e grupeve parlamentare, në qoftë se ka mundësi një minutë, prapë po takohemi këtu, të mos të dalim jashtë salle.

(Ndërprerje e incizimit)

Administrata, në qoftë se ka mundësi, zilen. Kthehemi në sallë. Po vazhdojmë seancën.

(Ndërprerje e incizimit)

I kisha lutur deputetët të kthehen në sallë.

(Ndërprerje e incizimit)

Administrata mundësisht, sa deputetë janë në sallë?

75 deputetë janë në sallë. Jemi tek amendamenti 4, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, projektligj tepër me rëndësi, konsensus i paparë brenda komisionit, por në seancë diçka s'po na ecën. Shkojmë në votim. Tash dalim edhe te ajo pjesë.

Votojmë amendamentin 4 me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Kush është për, kundër, abstenim, apo çfarëdo? Votojmë tash!

Kjo është situata. 51 deputetë. 41 për, 10 kundër, 0 abstenim.

Për hir të publikut dhe për hir të kolegëve deputetë, për afërsisht situata është pak a shumë e qartë. Një pjesë e opozitës nuk voton, zyrtarisht s'është thënë, nuk do të votojnë për të bërë 61 deputetë, është një lloj gjysmëbojkoti i pashpallur. Në raste të tilla, ne nuk mund të vazhdojmë seancën, për arsye se s'ka votim.

Atëherë, Memli Krasniqi, urdhëro! E ka kërkuar fjalën, se duhet të kemi një vendimmarrje. Fundi i fundit, është legjitime kjo.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Është evidente që jo vetëm në këtë seancë, por që disa seanca radhazi, veçanërisht javëve të fundit, një pjesë e opozitës nuk merr pjesë në votim, nuk e përmbush detyrën e vet, mandatin që e ka, qoftë të votojë pro, kundër. Me siguri mund të themi se është e drejtë legjitime e tyre, por në një situatë të tillë nuk ka kuptim as vazhdimi i kësaj seance e asnjë seance tjetër. Neve na vjen keq, sepse ne u dakorduar me iniciativën tuaj edhe për seancën e radhës, edhe për mocionin që e propozoi Grupi i PSD-së, që pasi të kryhen votime dhe këto votime nuk po kryhen, por pasi që të kryhen këto votime, ne të shkojmë në seancën e radhës, ta votojmë mocionin dhe të fillojmë të diskutojmë për temën që u ngrit.

Por, në një situatë të tillë ne nuk mund të marrim pjesë as në atë seancë, sepse nuk jemi në këtu..., nëse opozita s'është t'ia bëjë kuorumin pozitës, as pozita nuk është për t'ia plotësuar dëshirat opozitës.

Nuk besoj se ka kuptim që të vazhdojë kjo seancë, se po shihet, pozita nuk i ka 61 deputetë sot në sallë dhe nëse nuk marrin pjesë as për ligjet tepër të rëndësishme për qytetarët e Kosovës, si Ligji i trajtimit të ndërtimeve pa leje, ose të shkojmë edhe një hap tutje. Nëse një pjesë, në këtë rast konkretisht grupi i LDK-së, nuk i voton as Marrëveshjen e Kosovës me Bashkimin Evropian që u ndihmon ndërmarrjeve të Kosovës pas shumë vjetëve që kemi tentuar të gjithë bashkërisht të marrim pjesë në programet e BE-së dhe, edhe këtë e refuzojnë, kjo për mua, thënë të drejtën, personalisht po flas, kjo as politikë nuk është. Kësaj unë nuk di të vë emër, por është çështje e tyre.

Sidoqoftë, unë ju flas në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, nëse siç u pa edhe në këtë votim, nuk do të ketë sukses, ne mendojmë që ta përfundojmë këtë seancë. Do të shkojmë, nëse javën e ardhshme e caktojmë apo kurdo që të vendosë Kryesia, në një seancë. Do të konsolidohemi, vijmë dhe i votojmë pa pasur nevojë për opozitën fare. Faleminderit!

KRYETARI: Shkojmë në pauzë deri në orën 14:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

Të nderuar kolegë deputetë,
E kemi një situatë reale, në të cilën ka deputetë në sallë, deri në 87, por të njëjtën kohë ka një qëndrim të padeklaruar, që një pjesë e opozitës nuk do të votojë.

Në rrethana të tilla, unë do ta vë në votim edhe një herë.

(Ndërprerje e incizimit)

Jemi në vazhdim të seancës, amendamentin 4. Në qoftë se nuk kalon, ne duhet ta ndërpresim seancën. Kjo është ajo dhe të njëjtën kohë pastaj e thërrasim me Kryesinë mbledhjen e radhës për këtë çështje.

Atëherë, unë edhe një herë po e vë në votim, pastaj ua jap fjalën kryetarëve të grupeve parlamentare, për korrektësi, pasi që është situatë e re pas votimit edhe pastaj e bëjmë vendimmarrjen.

Amendamenti 4, Komisioni Funkcional, shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Votojmë tash!

46 deputetë kanë votuar. 75 janë në sallë. 40 kanë votuar për, 6 janë kundër. A jua jap fjalën nga pak dhe relaksoheni, apo dëshironi ta ndërpresim. Reagimet janë se pastaj sot nuk do të ketë seancë. Pak më herët kur i pata grupet parlamentare përfundon me kaq. Do të thotë, po ikni edhe prej dialogut, debatit për dialog, po largoheni?

Ndërpritet seanca. Kryesia mblidhet. E thërrasim seancën e radhës. Duhet përfunduar një herë një seancë për të dalë në tjetrën.

* * *

E enjte, 26 korrik 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 23 korrik 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës me procedimin e pikave të papërfunduara, si në vijim.

Ismajl Kurteshi e ka kërkuar fjalën. Urdhëro, zoti Kurteshi!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryetar!

Më lejoni që në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini Sport, Inovacione dhe Ndërmarrësi të propozoj plotësimin e rendit të ditës të mbledhjes plenare të Kuvendit, të datës 26 korrik 2018, me pikën e re, si në vijim: *Shqyrtimi i Projektligjit numër 06/L-095 për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës për pjesëmarrjen e Kosovës në "ERASMUS+", Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport.*

Unë e kisha lutur Kuvendin që ta pranojë këtë propozim të komisionit, i cili unanimisht ka qenë për këtë propozim, për arsye se nga ky anëtarësim përfitojnë sidomos studentët e Kosovës dhe koha për ratifikim, për kalim dhe miratim në Kuvend është e kufizuar. Kjo duhet të ndodhë para shtatorit dhe nuk i shkakton asnjë efekt Buxhetit të Kosovës.

Do të thotë, nga ky ligj ka vetëm përfitime për studentët, por nuk ka asnjë ngarkesë për buxhetin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kurteshi!

Kërkoj vëmendjen tuaj në këtë çka propozoi zoti Kurteshi, për t'u futur në rendin e ditës duhen 2/3 e deputetëve të pranishëm. Në të njëjtën kohë, i kam edhe dy kërkesa të njëjta, në qoftë se ka reagime për to për votim që të largohen, është mirë të më thoni përpara, para se ta dimë nëse i futim në rend të ditës, apo jo.

Është kërkesa për miratimin në parim të *Projektligjit numër 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.*

Edhe nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, po ashtu e kam një kërkesë që të futet në rend dite: *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit numër 06/L-038 për shërbimet postare.*

A i futim të tri projektligjet në votim për futje në rendin e ditës. Duhet 2/3 e të pranishmëve, ju lutem, 80 deputetë janë.

Regjia dhe deputetët përgatiten për votim për futjen e rendit të ditës të këtyre tri projektligjeve. A dëshironi një nga një? Avdullah, a të shkojmë një nga një? Avdullah Hoti ka kërkuar fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Grupi ynë parlamentar e mbështet propozimin që të futet në rend dite Marrëveshja ndërkombëtare që u propozua nga kryetari i Komisionit për Arsim, duke pasur parasysh urgjencën e çështjes.

Por ligjet tjera, ne nuk do t'i përkrahim. Ne kërkojmë që ato të shkojnë në procedura të rregullta parlamentare. Faleminderit!

KRYETARI: Shkojmë një nga një dhe seanca vendos, të mos futemi në grupe parlamentare.

Jemi në rastin e parë, propozimin Ismajl Kurteshit e keni dëgjua. A ka nevojë edhe një herë ta lexojë zoti Kurteshi, apo jo?

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim që ky projektligj të futet në rend të ditës. Të pranishëm janë 81 deputetë. Votojmë tash!

Kanë votuar 75 deputetë, 69 për, 6 abstenime, futet pikë e rendit të ditës *Shqyrtimi i Projektligjit numër 06/L-095 për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në "ERASMUS+", Programi i Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport.*

Propozimi për futjen në rend të ditës të Projektligjit për shërbimet postare. Votojmë tash!

Kanë votuar 60 deputetë, duhet edhe një herë ta vëmë në votim, a do ta futni në rend të ditës apo jo. Komisioni për Ekonomi me miratim unanim, *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimet postare.* Urdhëro, zoti Sejdiu!

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryetar!

Në mungesë të kryetares së Komisionit, në cilësinë e nënkryetarit më duhet thjesht t'i informoj deputetët që Projektligji për shërbime postare krijon mekanizma me të cilët Postës së Kosovës i krijohen mundësi të jashtëzakonshme për t'u siguruar hapësirë ligjore për të dalë prej telasheve që i ka. Pra, mbrohen disa dërgesa, mbrohet Posta, besoj që është ligj i cili i ndihmon Postës së Kosovës si ligj për dalje nga situatat, normalisht nëse menaxhmenti është në rregull.

Por si ligj besoj që është një prej ligjeve të mira për një ndërmarrje strategjike si Posta e Kosovës dhe i ftoj deputetët që ta votojnë ligjin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Qëndrimi është i komisionit, por si do që të jetë seanca do vendos. Votojmë tash! 52 deputetë.

Shkojmë te propozimi i Komisionit për Administratë Publike, *Projektligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës*, nga Nait Hasani. Votojmë tash për futjen në rend të ditës!

Ky është votimi. Votojmë edhe një herë, dy herë zakonisht dhe më mirë po i japim vulë. Votojmë tash!

Nuk e ka përkrahjen e seancës që të futet pikë e rendit të ditës.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: E vazhdojmë seancë në qoftë se ka mundësi, deputetët të kthehen në seancë. Në ndërkohë e shfrytëzojmë momentin Bilall Sherifi, shef i Grupit Parlamentar të Nismës me përvojë, e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryetar!

E kam një propozim kryetar, që këto tri ligje që kanë të bëjnë me marrëveshje ndërkombëtare t'i hedhim në votim dhe pasi të votohen këto tri ligje mund të vazhdojmë me pika tjera të rendit të ditës, shpresoj, besoj dhe e lus edhe opozitë që të merr pjesë në votim të këtyre ligjeve ndërkombëtare, sepse siç kemi thënë këto tri ligje që kanë të bëjnë me ratifikim të marrëveshjeve ndërkombëtare nuk do të duhej të mbeteshin vetëm në mëshirën e votave të mazhorancave, por gjithmonë duhet të kërkohet votë përtej mazhorancës. Pra, unë kërkoj që këto tri ligje të hedhen në votim së pari, pastaj të vazhdojmë më tej. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bilall, a ke marrë sinjale si herën e kaluar, apo veç po më fut... Bilall Sherifi e ka fjalën, dhe deputetët ju lutem le të kthehen në sallë.

BILALL SHERIFI: Jo herën e kaluar s'kam pasur, se t'i e dinë që nuk të gënjej unë sikur disa që gënjejnë, e kësaj radhe kanë thanë që janë të gatshëm që të marrin pjesë në votim në këto tri ligje që kanë të bëjnë me marrëveshje ndërkombëtare.

KRYETARI: Faleminderit! Sa deputetë janë në sallë?

Unë do të vazhdoj radhën e projektligjeve, pastaj nganjëherë kthehem për ligje, të cilat për mungesë të kuorumit konsiderohen pa votim, do të thotë nuk konsiderohet fare votim në bazë të një aktvendimi të Gjykatës Kushtetuese.

Po vazhdojmë me:

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-090 për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian

Duhet 80 vota për votimin e saj, zonja Blerta Deliu Kodra, kryetare e Komisionit a ka mundësi të na paraqesin dhe arsyetoni raportin e Komisionit.

BLERTA DELIU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Integritet Evropian, më 23 korrik e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe ka rekomanduar që kjo marrëveshje të miratohet në seancë plenare.

Me Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian synohet që të hyjë në fuqi Marrëveshja financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Kjo marrëveshje ka për qëllim miratimin e programit vjetor IPA 2017, pjesa e parë, me anë të së cilës do të zbatohet asistencë e dhënë nga Bashkimi Evropian për Kosovën në kuadër të IPA-s në formë të projekteve të përshkruara në kuadër të marrëveshjes në fjalë.

Asistencë financiare në kuadër të kësaj marrëveshjeje mund t'i mbulojë të gjithë sektorët e bashkëpunimit, duke i kushtuar kështu vëmendje të veçantë fushës së lirisë, të sigurisë, fushës së drejtësisë, si dhe përafrimit të legjislacionit të 'acquis communautaire' të Bashkimit Evropian, të zhvillimit socio-ekonomik, të qeverisjes së mirë, reformës së Administratës Publike, energjisë dhe bujqësisë, të gjithë këta sektorë që Kosovën e përafrojnë me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Kjo marrëveshje financiare parashihet të financohet në shumë prej 48 milionë euro nga Bashkimi Evropian për Kosovën, ndërsa shuma totale e përfshirë është 49 milionë e 478 mijë euro, ku përfshihet pra edhe bashkëfinancimi nga Kosova, në shumën prej 1 478 000 euro.

Duke marrë parasysh që afati përfundimtar për hyrjen e kësaj marrëveshje në fuqi është data 31 dhjetor 2018, si dhe duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj marrëveshje, Komisioni për Integritet Evropian në mbledhjen e fundit ka rekomanduar që kjo marrëveshje bashkë me amendamentet e propozuara nga komisionit të miratohet nga seanca plenare.

Prandaj, ju ftoj, kolegë deputetë, që nëse është kuorumi i nevojshëm me 2/3 e votave të miratohet Marrëveshja për ratifikimin IPA 2017 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, pjesa e parë.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të ministres zonjës Dhurata Hoxha, fjalën e ka zoti Uran Ismajli, ministër.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli,

Sot ju njoftoj rreth çështjes së miratimit të Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017, pjesa e parë, e cila do të duhej të ratifikohej me ligj nga Kuvendi i Republikës së Kosovës sikur parashihet në Kushtetutë dhe me Ligjin për marrëveshje ndërkombëtare.

Për ratifikimin e saj nevojiten së paku votat e 2/3 gjithë deputetëve të Kuvendit, pra së paku 80 vota.

Ministria e Integriteteve çdo vit lidh marrëveshje financiare me BE-në për programet e tyre në kuadër të Instrumentit të Para-anëtarësimit IPA.

Kjo marrëveshje financiare rregullon zbatimin e programit IPA 2017, pjesa e parë, e cila përfshin 11 projekte, e të cilat do të ndihmojnë përafrimin me legjislacionin e BE-së, të drejtat e njeriut, eficiencën e energjisë, ekonominë digjitale, sigurinë ushqimore, si dhe përkrahjen për lidhjen më të mirë të arsimit me tregun e punës dhe politikave sociale.

Në tërësi, programi konsiston në financimin e 48 milionë euro nga Bashkimi Evropian për Kosovën, ndërsa 1 478 000 euro nga Qeveria, pra totali është 49 478 000 euro.

Disa nga projektet të cilat do të përkrahen nga kjo ndihmë do të jenë ato në kuadër të demokracisë së qeverisjes, shuma totale do të jetë 14,8 milionë euro dhe do të përkrahet procesi i integritetit evropian nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve institucionale për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe përafrimit të legjislacionit të Kosovës me BE. Mbështetje do të ketë edhe për Autoritetin e Konkurrencës dhe Ndihmës shtetërore në shumën prej 3 milionë euro, si asistencë

teknike, si dhe përforcimin e sistemit të pronësisë intelektuale në Kosovë më shumë se 2 milionë euro. Në kuadër të sundimit të ligjit dhe të drejtave fundamentale do të ketë përkrahje për Institucionin e Avokatit të Popullit, për të forcuar këtë institucion me ekspertizën e nevojshme në shumën prej 3 milionë euro.

Në kuadër të sektorit të energjisë BE-ja parashihet të financohet 10 milionë euro krijimin e fondit të energjisë dhe eficiencës, në kuadër të konkurrueshmërisë dhe inovacionit do të ndahen 3 milionë euro për të përkrahur sektorin e teknologjisë së informimit dhe komunikimit. Në kuadër të bujqësisë dhe zhvillimit rural do të përkrahët siguria dhe cilësia e ushqimit me investimet që arrijnë në 5.2 milionë euro. Ndërsa, për fushën e arsimit, punësimit dhe politikave sociale përkrahja nga BE-ja do të arrijë në 12 milionë euro. Në këtë fushë do të përkrahët rritja e arsimit dhe qasjes në arsim duke ndihmuar infrastrukturën arsimore, si dhe qasjen në tregun e punës nëpërmjet arsimit vokacional.

Këto projekte do të zbatohen dhe kontraktimi do të kryhet nga Zyra e BE-së në Kosovë, e cila është autoritet kontraktues. Ata do të jenë të gatshëm për të filluar me zbatim sapo të kemi hyrje në fuqi të kësaj marrëveshje, përderisa afati përfundimtar për hyrjen në fuqi të saj është 31 dhjetor i këtij viti, ju kujtoj se është me rëndësi të kemi miratimin e saj sa më parë, ashtu që marrë parasysh procesin e gjatë të përgatitjes që nga shtatori 2016 do të ishte me rëndësi që mos të vonohet zbatimit i tyre. Informatat më të hollësishme, kushtet dhe obligimet e dyanshme gjenden të gjitha në kuadër të materialeve të projektligjit, të cilat janë përcjell në Qeveri dhe Kuvend nga ana e Ministrisë për Integrim. Andaj, ju kisha lutur që kjo marrëveshje të votohet sot në mënyrë që mos të humbin afatet e nevojshme për procedim të mëtejshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani radha e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, Armend Zema nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

E para, zoti kryetar po flas në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së nuk funksionojmë as me sinjale, as me të fala. I nënshtrohem rregullave kushtetuese dhe ligjore të mandatit tonë të lirë të deputetit. Ajo çka juve ju takon si kryesues nëse jeni akoma kryesues i PAN-it, të siguroni 61 deputetë të koalicionit të juaj qeverisës në sallë, atë të cilën ju dhe kolegët e juaj të pushtetit asnjëherë s'po mund ta bëni.

Për pjesën tjetër neve vendosim me votë edhe është pjesë e jona, edhe është detyrim i jonë që të reflektojmë në bazë të interesave të qytetarëve të vendit. Grupi Parlamentar e ka shqyrtuar, e përkrah në parim, por nuk e përkrah në atë që ju e thoni me ndonjë sinjal, apo edhe me ndonjë prapaskenë tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! I besoj shumë deklarament të juaj se kështu ia keni bërë edhe kryetarit të juaj tani pas dy viteve e keni votuar demarkacionin. Memli Krasniqi, e keni rrëzuar prej Qeverisë.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Po ma merr mendja që ishim duke fol për Marrëveshjen e IPA-s, por siç thotë populli “mizën mbas veshit” s’mund t’ia heqim askujt, as Grupit Parlamentar të LDK-së. Sa vota i ka ky koalicion e keni parë edhe javën e kaluar kur është kryer agjenda parlamentare, përkundër bojkotit të LDK-së veçanërisht, përkundër tentimit për ta penguar punën e këtij Kuvendi, jo vetëm atë ditë, por në vazhdimësi duke përfshirë edhe sot, përkundër tendencës për ta bllokuar miratimin e ligjeve që janë në interes të qytetarëve të Kosovës e jo koalicionit qeverisës, por sidoqoftë ju provojeni, vazhdoni, e keni provuar edhe në të kaluarën mund ta provoni edhe tash, por ta keni të qartë që problemet e juaja të brendshme nuk mundeni t’i kamufloni duke u munduar me i bartë në Kuvendin e Kosovës, sepse pavarësisht që është faza e përfundimit të sesionit dhe që shumë shpejt ky sesion do të përfundojë, ju të jeni të bindur që pikërisht ky koalicion qeverisës do të përmbushë programin e vetë, ka me implementuar agjendën legjislative edhe ka për t’i kryer krejt obligimet që ka marrë përsipër para qytetarëve të Kosovës.

Edhe, këto marrëveshje ndërkombëtare, të cilat s’i keni votuar absolutisht i keni penguar t’i votoni ju si LDK, s’i keni votuar deri në javën e kaluar, por kur e keni parë që koalicioni qeverisës e ka edhe potencën, edhe numrat për ta kryer agjendën, të cilën e ka miratuar Kryesia e Kuvendit, atëherë kërkuat t’ia kthejmë edhe një herë mundësinë për të mos u bërë ‘horë’ krejt, sepse disa herë s’keni marrë pjesë në votim dhe keni pamundësuar marrëveshjet pikërisht sikur kjo që është tash në votim. E, sa i përket qëndrimit të grupit tonë parlamentar, kjo është krejtësisht e vetëkuptueshme që ne do ta mbështesim, do ta votojmë edhe këtë marrëveshje, edhe marrëveshjet tjera ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYETARI: A ia ke përmendur emrin, a ? Atëherë, një duhet ta marrë Armendi, ose ju, ose Avdullahu, në emër të grupit. Jo, jo me emër s’kemi folur. Në emër të grupit, po. Armend, fjala për ju!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Ajo çka është e vërtetë dhe është tjetra e juaja e pavërtetë votim për demarkacion nuk ka pas në Qeverinë e kaluar asnjëherë në Kuvend të Kosovës, ky është paragjykim. Po, a din cili votim ka qenë? Votim ku ju i keni bërë 87 numra për me e rrëzua qeverinë tonë edhe qeverinë që ka udhëheq Lidhja Demokratike e Kosovës. Atë e keni edhe deklarim publik tuajin, kështu që unë prapë po them po e përsëris ne nuk merremi me konspiracione edhe një herë as me sinjale, as me të fala. Kjo është ajo evidente, ndërsa për kolegun nga Partia Demokratike nëse më dëgjoi, sepse ka qenë i koncentruar sigurisht të ju shikoj mimikat tuaja, unë e thashë këtë marrëveshje e

përkrah Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Kaq! Po, me këtë sjellje tuaj, ju nuk dëshironi që këto marrëveshje të kalojnë.

KRYETARI: A vazhdojmë, nuk po dua se pata diçka me përgjigj tani kundër replikë jam i fundit, e s'po dua. Memli, a dëshiron me çdo kush? Urdhëro, kundër replikë vetëm një minutë është, të lutem, se të kalojmë në rrjedhë të seancës. Unë e vlerësoj qëndrimin e nënkryetarit për ta bërë publik, Kujtim Shala, por sido që të jetë po mundohem t'i mbaj të gjitha, edhe ligjet, edhe këto, të cilat po të mundemi të mos shkojmë me 'huje', por megjithatë, jo këtë dua, këtë s'dua, pastaj edhe disa fjalë, kjo ishte arsyeja pse i thashë disa fjalë në kuptimin në praninë e kryesuesit. Për këtë ishte, jo për tjetër.

Urdhëro, Memli Krasniqi, kundër-replikë!

MEMLI KRASNIQI: Agjenda e Kuvendit të Kosovës nuk është tavolinë suedeze që secili grup të vendosë çka të dojë të marrë, e çka të dojë të mos marrë. Përgjegjësia është për ta dhënë votën kundër, pro, ose abstenim, për të gjitha. Ndërsa, unë e dëgjova shumë me saktësi Armendin, po ky s'më ka dëgjuar mua. Thashë s'i keni votuar ligjet e njëjta, s'keni votuar për ratifikim të këtyre marrëveshjeve pikërisht deri kur e keni parë që kalojnë këto marrëveshje dhe pa ju. E, tash sot po doni të thoni... nuk jemi ne bash aq të këqij, nuk jemi bash duke e penguar integrimin evropian, nuk jemi ne bash kundër liberalizimit të vizave sa po dukemi, po hajt se po marrim pjesë.

E, sa i përket demarkacionit, e di Armend, s'ka dalë në votim se keni qenë kundër gjysma e grupit parlamentar. Faleminderit!

KRYETARI: Glauk Konjufca, e keni fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Po të kishte qenë tema për demarkacion edhe unë për besë i kisha thënë nja 3-4 fjalë, por qenkemi këtu te pika për Fondet e IPA-s, edhe moti nuk ka pas në Kuvend debat për një pikë për të cilën të gjitha grupet parlamentare do të votojnë për.

Unë e kam dëgjuar që debatet janë më shumë kur njëra palë që nuk do të votohet marrëveshja dhe tjetra palë që duhet të votohet, por këtu unë me sa e di për këtë temë të gjitha grupet parlamentare do të votojnë për. Kështu që unë mendoj që do të kemi kohë boll me u grind edhe me debatua për pikat tjera, kështu që nuk po harxhohem në këtë pikë. Lëvizja Vetëvendosje do ta votojë, sepse është në interes të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Dardan Sejdiu, në emër të Grupit Parlamentar të PSD-së.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryetar!

Në emër të interesit të Kosovës siç po shprehemi edhe Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate e voton Marrëveshjen për fondet e IPA-së. Faleminderit!

KRYETARI: Dardan, sipas kësaj këto tjerat s'janë interes i Kosovës. Faleminderit! Po, urdhëro prapë Dardan Sejdiu e ka fjalën. Po, po ke të drejtë për atë ta përmenda emrin me na qartësua se s'e kuptuam këto tjera.

DARDAN SEJDIU: Ma përmende emrin, mendoj që edhe ndërmarrjet publike si Posta e Kosovës janë interes i Kosovës dhe duhet të votohet, Marrëveshja e IPA-së është në interes të Kosovës dhe duhet të votohet. Pra, për temat si këto që zgjidhin probleme edhe ekonomike e ndihmojnë rimëkëmbjen e një ekonomie të shkatërruar tash e 18 vite, duhet të votohen, sepse krijojnë infrastrukturë për një qeveri të mirë e jo për këtë që e kemi sot.

KRYETARI: Faleminderit! Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Kryetar, nuk është mirë ta zgjatim debati, sepse e kemi rendin e ditës dhe ju kisha lut që t'i futni në votim marrëveshjet ndërkombëtare dhe ta kryejmë këtë temë.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Isufi është procedurë, ta kini parasysh. Kemi obligim për çdo grup parlamentar me e marrë qëndrimin. Shkojmë tek Bilall Sherifi, tani. Bilall je në emër të grupit, po vetëm kryetarëve të grupeve ose përfaqësuesve ju jap fjalën se po e shoh edhe Milaimi e ka kërkuar fjalën, nuk mund t'ia jap fjalën.

Urdhëro, Bilall Sherifi!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Po, gjithsesi edhe Nisma Socialdemokrate e mbështet këtë marrëveshje dhe do ta votojë. Po, kryetar s'pate bre zor me dhez pa kurrfarë nevoje. Seriozisht, po vërtetë pate dëshirë mos me kalua ky ligj. Lëri njerëzit, u deklaruan që do ta votojnë, do të marrin pjesë në votim në marrëveshjen ndërkombëtare. Vetë e ndeze, vetë tani ...ta shuani. Nuk ka nevojë. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti kryetar, jo vetëm se do t'i lë, po jam tu tentu me i inkurajua për arsye se shumica e këtyre projektligjeve, të cilat janë në agjendë të juajën ne i sjellim, unë si kryetar përkatësisht për disa me dashamirësi si kryesues, vetëm i sjelli se janë të Kuvendit, nuk janë të mijat. E po mbesin me disa herë po vonohen në të njëjtën kohë po rrezikojnë paratë e Kosovës, po rrezikojnë liberalizimin e vizave, po rrezikojnë procesin integruar, kjo është. Albert Kinolli e ka fjalën! Votoni, s'votoni, unë e kam për obligim çdoherë me i sjellë.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetari Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Të gjitha ligjet janë në interes të qytetarëve dhe të Kosovës, po ashtu edhe marrëveshjet ndërkombëtare. Edhe ne e përkrahim dhe do të votojmë për marrëveshjet ndërkombëtare për shkak se janë interes i qytetarëve të Kosovës edhe kësaj radhe Grupi Parlamentar 6+ zakonisht deri tash është komplet dhe të gjithë jemi këtu dhe do të votojmë pro. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka nga grupet parlamentare të paraqitur. Atëherë, më lejoni vetëm të sqaroj procedurat, të cilat tashmë të gjithë i dimë, por megjithatë për protokoll 80 vota duhet për votimin e këtij projektligji, sepse është marrëveshje ratifikuese ndërkombëtare.

Aktualisht në sallë janë 96 deputetë. I përgëzoj kolegët deputetë që jemi bashkarish, e kemi një amendament, të cilin duhet të votojmë në fillim ndaras, edhe amendamenti duhet t'i ketë 80 vota. Unë do ta vë në votim vetëm amendamentin. Kryetarja e komisionit ka diçka, reagim.

BLERTA DELIU-KODRA: Jo, reagim kryetar është vetëm fjala për amendament të qartësoj meqë është para votimit. Komisioni për Integritet Evropian do të thotë ka propozuar një amendament, është amendamenti i parë në titullin e projektligjit para fjalës së “Kosovës” të shtohet “Republikës së Kosovës” natyrisht, marrëveshja ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

KRYETARI: Faleminderit! Me këtë vërejtje, të cilën e pat kryetarja e komisionit ky amendamenti, shkojmë e votojmë një amendament. Votojmë tash!

Prapë nuk ka numër të mjaftueshëm të votave. Do ta hedh në votim prapë, se kot flasim, po shkojmë në bazë të procedurave. Urdhëro, zoti Hoti!

AVDULLAH HOTI: Kryetar

E keni parë nga mëngjesi që ky Kuvend nuk është funksional. 47-48 vota ka pas vazhdimisht, ne shprehim një vullnet politik për të kaluar marrëveshjet që kërkojnë 2/3, pra që nuk janë vetëm çështje e pozitës, por me sjelljet e juaja, me fyerjet që ju bëni deputetëve, grupeve parlamentare ju e shkatërroi çfarëdo vullneti politik në Kuvend për të funksionuar normalisht në çështjet që kërkojnë 2/3.

Ne do të vazhdojmë dhe do ta thellojmë bojkotin e këtij Kuvendi derisa vendi të shkojë në zgjedhje, derisa ju ta merrni vesh që s'mund të shkoni përpara me këtë formë të qeverisjes. Unë ju ftoj juve me mirëkuptim të plotë që ju ta kryeni detyrën e kryetarit të Kuvendit në bazë të Rregullores, pa u lëshuar në komente dhe në kualifikime ndaj deputetëve, grupeve parlamentare ose kryetarëve të partive politike, sepse nuk ju takon. Me një njeri që keni punuar 2-3 vjet sot lëshoni kualifikime publike nuk është aspak etike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti kryetar i grupit parlamentar, përgjegjësia qytetare, publike dhe kushtetuese e secilit deputetë nuk varet nga dëshirat e njëri-tjetrit. Jemi 120 deputetë, secili e shpreh përgjegjësinë pavarësisht vullnetin ose dëshirat, ky nuk është vend fontanë dëshirave. Këtu votohet për interesin publik, për interesin qytetarë dhe për mbrojtjen e kushtetutshmërisë. Vendimi i votimit apo jo, në bazë të disponimit është çështje e pjekurisë politike, e cila, unë nuk dua... ajo çka është në mënyrë institucionale unë do t'i lexoj projektligjet, të cilat janë, shihet qartë pjesa e tendencës për bojkot, pavarësisht duhet ta themi fare qartazi, nuk e keni autoritetin as në grup parlamentar, ky është problem i juaj nuk është problem i kryetarit të Kuvendit dhe është vazhdimësi.

Shkojmë votojmë edhe një herë, kalon, s'kalon. Regjia, deputetët përgatiten për votim. Amendamenti 1. Votojmë tash!

Faleminderit! 70 vota, kisha pas dëshirë, jo se ka shumë. Urdhëro, Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i LDK-së po do të na kallëzojë diçka dhe këta po mendojnë që janë duke na kallëzuar që janë shumë të rëndësishëm edhe që ligjet, marrëveshjet ndërkombëtare për të cilat nevojiten 2/3 e votave nuk kalojnë pa ta. Po kjo nuk është kurrëgjë e çuditshme, po çka janë duke na treguar e që s'po e di a janë duke na treguar është fytyrën e vërtetë të tyre, që t'i ndërrojnë llafet çdo pesë minuta. Para pesë minutave thanë ne e mbështetim për interes të Kosovës, pas pesë minutave atë që e thanë e ndërruan nuk po e votojmë. Ku mbet interesi i Kosovës?!

A, interesi i Kosovës është disponimi juaj pesë minuta më vonë dhe më herët varësisht qysh ju flet juve kryetari i Kuvendit, ose një deputetë një prej kolegëve, a? A mendoni ju që duhet me ju marrë me të mirë juve secili njeri që është deputetë i Kuvendit të Kosovës dhe kur e keni gabim? Zoti kryetar, këtu janë pjek kushtet me e shpall pushimin veror, këtu është ardhur koha me e mbledh mbledhjen e Kryesisë edhe me e vendos përfundimin e këtij sesioni, unë këtë ju propozoj, për një arsye të thjeshtë shumica dërrmuese e ligjeve që kanë qenë agjendë legislative kanë përfunduar javën e kaluar. Ligjet tepër të rëndësishme sikur ky që LDK-ja po e bojkoton e po ia humb 48 milionë euro qytetarëve të Kosovës nëpërmjet fondeve të IPA-së nuk kalojnë tash më, kalojnë në shtator, ama ma merr mendja që nuk e meriton Kuvendi i Kosovës edhe qytetarët me e pru në këtë nivel për shkak të inateve politike që sot po shprehen qartë nga ana e LDK-së.

Nuk është normale çdo pesë minuta partitë politike me i ndërrua qëndrimet, nuk është. Unë besoj kush është duke na parë live sot në transmetuesit publik nuk e di çfarë mendimi ka, kjo nuk është dramë. Ti thua pesë minuta më herët e mbështes, edhe pesë minuta më vonë hidhet në votim, nuk e voton, çka me mendua? Çka me mendua?! A, ndërrohet më shpesh se çorapet qëndrimi politik, a? Kjo është përtej çdo mungese të përgjegjësisë, por është e drejtë e tyre edhe për të bërë hajgare, në rregull është. Unë ju propozoj ta mblidhni Kryesinë urgjent, nuk ka seancë, nuk po

procedon seanca, këta e kanë të drejtën e vet për ta bojkotuar, thanë do ta thellojnë, udha e mbarë u qoftë le ta thellojnë, le të bojkotojnë, le t'i bëjnë të gjitha, por sot në këtë situatë ma merr mendja duhet marrë disa vendime, të cilat e çlirojnë këtë farë situatë që e kemi pasur edhe herë të tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po e shoh ka reagime nga të gjitha taborët. A ka mundësi kështu, 9 deputetë janë të lajmëruar në qoftë se futemi në debat pa kufi seancën do të mundohem ta vazhdojmë, shkojmë në një mbledhje të Kryesisë, një pauzë, mbledhje e Kryesisë kryetarët e grupeve parlamentare, të bëjmë një qëndrim, pastaj në bazë asaj vendimmarrjeje e vazhdojmë seancën. Presim vendimmarrjen, ju kisha lutur në qoftë se ka mundësi shkojmë menjëherë në sallën 301. Tani, deputetë pauzë, besoj për 15 minuta merremi vesh se cili është qëndrimi ta dimë më saktësisht, të mos e maltretojmë as publikun, qytetarët. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritarë,

Jemi në vazhdim të seancës.

Aktualisht në sall janë 76 deputetë.

78 deputetë janë në sall.

Regjia nëse ka mundësi bini ziles se duhet 80 deputetë kjo është arsyeja pse po presim.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne patëm një mbledhje të Kryesisë me kryetarët e grupeve parlamentare kemi një vendimmarrje do të shkojmë në bazë të saj të gjitha projektligjet do t'i vejë nga dy herë në votim, nuk e kanë kuorumin e mjaftueshëm, nuk i rikthej më në votim të keni parasysh, kalojnë për seancën e radhës.

- Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-090 për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian

Të gjitha diskutimet kanë përfunduar, kemi qenë në procesin e votimit, është një amendament për votim është sqaruar nga Komisioni FunkSIONAL edhe amendamenti. Votojmë tash:

Edhe një herë, ky është rezultati i votimit nuk ka kuorum. Edhe një herë marrëveshjen ndërkombëtare një amendament i propozuar. Votojmë tash!

88 deputetë janë. Ky është rezultati i votimit, edhe kalon për seancën e radhës, pavarësisht se janë me dhjetëra miliona të cilat kanë të bëjnë me Kosovën në këtë marrëveshje.

- Shqyrtimi i Projektligjit numër 06/L-094 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Kosovës në programin “Evropa për qytetarët”

Komisioni Funkcional për Integritet Evropian ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e kësaj marrëveshje ndërkombëtare dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Zonja kryetare e Komisionit për Integritet Evropian e ka kërkuar fjalën, zonja Blerta Deliu Kodra, e ftoj për arsyetimin e raportit të Komisionit.

BLERTA DELIU KODRA: Faleminderit, kryetar!

Po i mbetem borxh qytetarëve vetëm të shprehë keqardhjen time që nuk është votuar ratifikimi IPA 2017 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, ndonëse deputetët të gjitha partive politike në mbledhjen e Komisionit kanë votuar unanimitisht u pa sot që të njëjtit deputetë nuk e votuan një marrëveshje ndërkombëtare e cila në interes kryesor i ka projektet për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Prandaj, në cilësinë e kryetares unë shpreh keqardhjen për votimin e sotëm në këtë seancë të Kuvendit.

Edhe kjo pikë për të cilën e kemi në rend të ditës do të thotë është marrëveshje ndërkombëtare e cila garanton pjesëmarrjen e Kosovës në programin Evropa për qytetarët.

Komisioni për Integritet Evropian më datën 23 korrik e ka shqyrtuar Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin Evropa për qytetarët dhe ka rekomanduar që kjo marrëveshje të miratohet në seancë plenare.

Qëllimi i kësaj marrëveshje ndërkombëtare është anëtarësimi i Kosovës në kuadër të programit Evropa për qytetarët.

Programi Evropa për qytetarët është krijuar me Rregulloren e Këshillit të BE-së numër 39/2014 të 14 prillit 2014 për themelimin e programit “Evropa për qytetarët për periudhën 2014-2020”.

Si synim kryesor ky program ka afrimin e Bashkimit Evropian për qytetarët e saj për të kontribuar që qytetarët të kuptojnë Bashkimin Evropian, historinë e tij diversitetin, të promovojnë qytetarinë evropiane dhe të përmirësojnë kushtet për pjesëmarrje civile dhe demokratike në nivel të unionit.

Bazuar në këtë marrëveshje kontributi financiar që duhet të paguhet nga Kosova në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian për të marrë pjesë në programin Evropa për qytetarët është gjithsejtë 15 mijë euro.

Prandaj, duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj marrëveshje si Komision kemi rekomanduar që kjo marrëveshje bashkë me amendamentet e propozuara nga Komisioni të votohet në seancë plenare.

Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi po thuaj se në situatë të njëjtë, ndonëse është marrëveshje ndërkombëtare dhe kërkon 2/3, përsëri edhe nga kjo marrëveshje përfitojnë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe gjithsesi e njëjta marrëveshje ka marr të gjitha votat nga të gjitha partitë politike në Komision.

Prandaj, kërkoj nga deputetët që të votojnë një marrëveshje të tillë për qytetarët e Republikës së Kosovës. faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të ministres së Integritimit Evropian, Uran Ismaili, në emër të Qeverisë.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Ju veç e dëgjuat ekspozenë e cila është paraqitur nga zonja Blerta Deliu-Kodra për programin Evropa për qytetarët.

Ju e dini që kjo është një marrëveshje, për të cilën nevojiten 80 vota të deputetëve.

Ju kisha inkurajuar që të gjithëve që të merrni pjesë dhe të votoni në të.

Ne patëm edhe rastin e projektligjit të mëhershëm i cili ka pasur një ndihmë financiare, nuk u miratua në Kuvend, ka pasur një ndihmë financiare e cila ka qenë mjaftë e prekshme për qytetarët tanë.

Andaj, deputetët të cilët janë në komisione të ndryshme të cilët realisht merren dhe nuk votojnë në çështje të cilat kanë rëndësi shumë të madhe për qytetarët tanë konsideroj se janë duke i deprivuar dhe janë duke i ndalë disa reforma të cilët janë të mundshme.

Në projektligjin e kaluar pamë që ka pasur qëndrime dhe ndihmë asistencë financiare për arsim, asistencë financiare për bujqësi, asistencë financiare për inovacion. Në këtë rast këtu kemi për qytete të ndryshme të cilat kanë mundësi që të përfitojnë dhe të bëjnë projekte të binjakëzimit.

Çdo mungesë e votës realisht mundëson që projektet tona të mos zhvillohen dhe qytetarët të mos marrin ato të cilat i presin nga ne. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka asnjë grup parlamentar të lajmëruar. Shkojmë në procedurë të votimit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Para se të vazhdojmë me votimin e projektligjit, konstatoj se në sall janë të pranishëm 87 deputetë edhe kjo është një marrëveshje ndërkombëtare, duhen 2/3 e deputetëve. Votojmë tash!

Kërkoj falje, dy amendamente kërkoj falje gabimi im, kërkoj falje.

Regjia të lutem, në këtë projektligj janë propozuar dy amendamente nga Komisioni Funkcional për miratimin e tyre kërkohen së paku 80 vota për.

Në qoftë se nuk ka vërejtje unë do t'i vejë të dy amendamentet përnjëherë në votim. Nuk ka vërejtje, atëherë shkojmë me dy amendamentet e propozuara nga Komisioni për çka do t'i arsyeton zonja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Edhe projektligji në fjalë në fakt marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin Evropa për qytetarët, Komisioni në këtë marrëveshje apo në këtë projektligj i ka propozuar dy amendamente.

Amendamenti i parë, në titullin e projektligjit para fjalën “Kosovës” të shtohet fjala “Republikës së Kosovës” dhe ky ndryshim vlen për tërë tekstin e projektligjit.

Po ashtu amendamenti i dytë në tekstin e preambulës fjala “Projektligji” zëvendësohet me fjalën “ligj” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë në votim.

Janë dy amendamente do t'i votojmë të dyja për, duhen 80 vota. Votojmë tash!

Do të shkojmë edhe një herë 67 vota nuk ka kuorum.

Votojmë edhe një herë ju lutem dy amendamente të propozuara, duhen 2/3 e deputetëve të Kuvendit për t'i votuar është marrëveshje ndërkombëtare. Votojmë tash!

Edhe kjo marrëveshje ndërkombëtare mbetet për seancën e rashës.

- Shqyrtimi i Projektligjit numër 06/L-095 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në “ERASMUS+”, Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin për ratifikimin e kësaj marrëveshje ndërkombëtare dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zotin Bedri Hamza që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në bazë të legjislacionit në fuqi ka zhvilluar të gjitha procedurat e parapara për miratimin e Projektligjit për Ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në “ERASMUS+” programin e Unionit Evropian për Arsim Trajnim rini dhe Sport.

Kosova do të merr pjesë në aktivitetet e programit në përputhje me objektivat, kriteret, procedurat dhe afatet e përcaktuara në Rregulloren e BE-së numër 1288/2013 dhe sipas kushteve dhe orarit të mëposhtëm.

Që nga 1 janari i vitit 2018 derisa Kosova nuk i ka plotësuar kushtet për pjesëmarrje të plotë në program, Kosova do të merr pjesë në mënyrë të barabartë me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian në veprime që nuk menaxhohen nga agjencitë kombëtare, platforma mbështetëse të AIT-së përfshirë binjakëzimin dhe mbështetjen për reformat e politikave.

Kosova do të merr pjesë në të gjitha aktivitetet e programit që nga 1 janari pas vitit të pranimit nga Komisioni i vlerësimit të përputhshmërisë ekzakte të Agjencisë Kombëtare nga Autoriteti Kombëtar siç referohet në nenin 27, pika 4 të Rregullores së BE-së numër 1288/2013 dhe në përputhje me nenin 29 të kësaj Rregullore.

Termat dhe kushtet e aplikueshme për paraqitje dhe vlerësime dhe për zgjedhjen e aplikacioneve dhe për zbatimin e veprimeve nga institucionet organizatat dhe individ të pranueshëm të Kosovës do të jenë të njëjta me ato që zbatohen për institucionet, organizatat dhe individ të pranueshëm të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

Për të marrë pjesë në programin Kosova paguan çdo vit një kontribut financiar në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian në përputhje me nenin 3.

Kontributi financiar i Kosovës në lidhje me pjesëmarrjen dhe zbatimin e programit do të shtohen në shumën e caktuar çdo vit në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian për ndarjen e zotimeve për të përmbushur detyrimet financiare që dalin nga format e ndryshme të masave të nevojshme të ekzekutimit, menaxhim dhe funksionimit të programit.

Një nga .. zyrtarë të Bashkimit Evropian do të përdoret për procedura lidhur me kërkesat, kontratat dhe raportet si dhe aspektet tjera administrative të programit.

Që nga janari i vitit 2018 deri në plotësimin e kushteve për pjesëmarrje të plotë të Kosovës në program kontributi vjetor financiar që duhet të paguhet nga buxheti i përgjithshëm i Bashkimit Evropian për të marrë pjesë në programin do të jetë 50 mijë euro.

Prandaj, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji kërkoj nga ju deputetë të nderuar që të jepni mbështetjen tuaj me votën e juaj për ratifikim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Ismajl Kurteshi, në emër të Komisionit Funkcional, e jep arsyetimin për raport.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Arsim Shkencë Teknologji Kulturë Rini Sport Inovacione dhe Ndërmarrësi, në bazë të nenit 60 dhe 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 25 korrik të vitit 2018, në cilësi të Komisionit Funkcional shqyrtoi Projektligjin numër 06/L-095 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në “ERASMUS+”, Programin e Unionit për Arsim Trajnim Rini dhe Sport dhe vendosi që Kuvendit t’i paraqes këtë rekomandim.

Të miratoj Projektligjin e lartë përmendur për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në “ERASMUS+”, Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport, dhe Komisioni vlerëson se projektligji ka për qëllim Ratifikimin e Marrëveshjes për pjesëmarrjen e Kosovës në programin e unionit mandej duke e pasur parasysh rëndësinë e projektligjit i rekomandon Kuvendit miratimin e këtij projektligji.

Me që në fillim të kësaj seance grupet parlamentare u deklaruan të gatshme që ta votojnë këtë projektligj po hoqën dorë sidomos Grupi Parlamentar i LDK-së pas komenteve që ju i bëtë zoti kryetar i Kuvendit, bashkë me shefin e Grupit Parlamentar të LDK-së dhe kjo ndikoj negativisht. Kërkoj nga ju që të hiqni dorë nga këto komente që po e pengojnë miratimin e këtyre ligjeve

shumë të rëndësishme t'i thjeshtësoni procedurat dhe të kalojmë në votim dhe në fund i lus të gjithë deputetët që ta votojnë këtë projektligj.

Kjo është edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, ne si grup do ta votojmë projektligjin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar Kurteshi!

Unë si kryetar i Kuvendit ju kisha ftuar që t'i votoni të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare vetëm po e them. Deri tash nuk kemi votua në kuadër të demokracisë dhe qeverisjes 14,8 milionë euro nuk i votuam, 3 milionë euro financiarisht zbatimin e prioriteteve që dalin nga dialogu politik, 3 milionë euro konkurrencën dhe ndihmën shtetërore, 3 milionë euro institucione për ekspertizë fushën e sistemit të drejtësisë, 10 milionë euro për krijimin e fondit të eficiencës së energjisë, 3 milionë euro sektorin e teknologjish së informimit dhe komunikimit, 5,2 milionë euro komunikimi në bujqësi, 12 milionë euro për fushën e arsimit dhe punësimit për bashkëqytetarët tanë.

I nderuar zoti Kurteshi,

Kjo është ajo si ka kaluar, unë po i ftoj, ka ende dhe kjo "ERASMUS+", në qoftë se ti zoti Kurteshi e thua se ndikimi im, duhet të përmend më shumë se sa për individin, se tek e fundit unë e ti nuk jemi fort për vendin të kalkuluar në kuptimin e asaj, duhet të mendojmë më shumë për vendin.

Urdhëro, zoti Kurteshi, pasi ta përmenda emrin edhe shkojmë në votim.

ISMAJL KURTESHI: Nëse ju kujtohet zoti kryetar para një dy jave këtu në Kuvend keni deklaruar se asnjëherë nuk keni pa opozitë më të dobët. E tani po e shini forcën e pozitës. Pse deklaratë siç kjo që e ke thënë para dy jave kjo që tha sot shefi i grupit natyrisht që ka ndikuar që këto marrëveshje të mos kalojnë dhe përgjegjësinë për këtë e bartni ju që jeni pakicë dhe s'po mundeni vetë me i kalua dhe në vend se të krijoni unitet në mes grupeve parlamentare po ndikoni që të ndodhë përçarja, nuk e di a po e bëni me pavetëdije apo vetishëm po ndikoni që këto marrëveshje aq të rëndësishme për vendin të mos kalojnë dhe mandej të mundoheni që fajin t'ia hidhni opozitës. Faji kryesor të jetë mbi ju që po deklaroheni në këtë formë.

Kurse unë edhe një herë ju bëj apel opozitës që të votojnë pavarësisht se çka ju deklaroni ata duhet ta kenë parasysh interesin e vendit dhe deklaratat e juaja duhet të mbeten deklarata të parëndësishme kur është në pyetje interesi i vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Kjo e fundit ishte eksilente ajo pjesa e parë dihet se Albini ka për të bërë titur "kur e mbani mbledhjen".

A shkojmë drejt, të mos hapim debat. Me emër nuk të ka përmendur. Memli Krasniqi, urdhëro!

MEMLI KRASNIQI: Zoti kryetar ne hymë në procedurë të votimit, zoti Kurteshi nuk ka nevojë të na moralizojë askujt edhe të na tregojë se ne nuk jemi nxënës këtu as nuk është klasë kjo edhe këtu nuk është në rolin e mësuesi. Unë e di që ka qenë në PDK përpara tash është në Vetëvendosje, tash është u bë edhe avokat i LDK-së.

Të lutna qiti sendet në votim se filluam mirë, përndryshe ne mundemi me hy në debat prapë edhe me e nxjerr edhe një herë situatën qysh e patëm më herët, por nuk po e di a jeni të interesuar përnjëmend të vazhdojë seanca apo po doni në opozitë të gjeni arsye për ta prishur pjesën e votimit e të hyni në debat për të mos e mbajtur seancën. Nëse doni seancë, hidheni në votim, mos na moralizoni e mos na mbani ligjërata, se secili i ka punët e veta dhe le ta shikojë secili grupin e vet parlamentar, ne i kemi qëndrimet tona, ju qëndrimet tuaja dhe kjo mjafton.

KRYETARI: Gjithsesi, kundër-replikë, një minutë.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Vërtet unë thashë që moralizimet po e dëmtojnë këtë vend dhe njeri që më së shumti moralizon këtë Kuvend është zoti Memli Krasniqi dhe është mirë që ai të heq dorë, e unë me këso gjëra rrallë merrem. Ku jam unë e ku kam qenë dihet publikisht, edhe pse kam qenë atje, e që jam sot Vetëvendosje, përherë mund ta arsyetoj atë që e veprojnë, unë po flas si deputet i Kuvendit të Kosovës, asi si ish-anëtar i një partie tjetër, as si deputet i Vetëvendosjes. Në këtë moment interes i këtij vendi është që të hiqni dorë nga provokimet e opozitës, ta dini hallin tuaj dhe të filloni të mundoheni për të krijuar unitet për çështjet që duhet krijuar dhe një herë ju ftoj që t'i votoni këto ligje. Faleminderit!

KRYETARI: I bashkëngjitem kësaj thirrje, tash grupet parlamentare janë për apo duhet të shkoj një nga një për shkak, jo megjithatë është Dardasn Sejdiu nga PSD-ja ka kërkuar fjalën, unë s'mund ta anashkaloj. Pastaj, bëhet gati Teuta Haxhiu ose Ahmeti, njëri prej grupeve parlamentare një, në emër të grupit, po veç edhe Ahmeti e ka kërkuar fjalën. Dardan fjala për ju, më fal.

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë, është për mua tashmë evidente e thashë edhe në mbledhje të Kryesisë që kryetari seancës, kryesuesi i seancës duhet të sigurohet që deputetët të mos, si me thënë shpihen në diskutime pa nevojë. Është tashmë e sata herë që qoftë deputetët e LDK-së, Vetëvendosjes apo edhe të PSD-së, pra të opozitës, po si me thënë kështu po provokohen në mënyrë të panevojshme dhe besa edhe po shkon deri në ofendime. Unë i bashkëngjitem thirrjes së deputetit Kurteshi që në këtë mënyrë mos të procedohet në seancë, në këtë mënyrë të mos punohet në

seancë dhe mos të përdoret kjo që të bëjmë njëfarë politike besoj kështu komplet koti e në dëm të punës që na pret si deputetë.

Rrjedhimisht, kryetar kërkoj dhe ju lutem, si deputet i këtij Kuvendi që të jemi sa më formal e sa më të orientuar në punë, e shumë më pak rreth diskutimeve që nuk kanë asnjë peshë politike e sidomos jo në politika publike e ligje që i trajtojmë këtu. Ne si Grup Parlamentar i Partisë Socialdemokrate normalisht që jemi për dhe do të votojmë për, e kemi shprehur këtë qëndrim, por gjithashtu mendoj dhe e thashë po ri përsëritëm që nuk i bëjmë nder këtij Kuvendi nëse vazhdojmë me këtë lloj diskutimi në secilën seancë dhe në secilin moment provokime të panevojshme dhe debate, të cilat nuk kanë të bëjnë fare me ligjin po i diskutojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Teuta Haxhiu në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Kemi një marrëveshje përpara ku Komisioni për Arsim është mbledh dje dhe sot kemi kërkuar me urgjencë që kjo marrëveshje të hyjë në rend dite, pra si pikë jashtë planifikimit që kishte Kryesia e Kuvendit dhe kërkuam si komision, pra kërkoi kryetari dhe kjo politikë, kjo lojë e kjo thirrje për interesa të vendit që sa herë u përmend sot, interes i vendit është me i lënë krejt fjalët, interes i vendit është me ia dhënë votën, ama sa për interesa të vendit prej orës 10:00 deri në ora 16:00 sot, kur të doni bëjmë debate, flasim për çfarëdo teme jemi këtu. Por, sot fjalët e juaja që shumë herë i thatë dhe i ratë u kthyer prapa unë këtë nuk po e kuptoj, ama s'po e kuptoj bash prej secilit që tha të ratifikohet e në anën tjetër foli më shumë për mos ratifikim e aq më tepër për veprimet që po ndodhin këtu. Pra, me votua në komision dhe me thënë në seancë që do të votojmë e mos me votua kjo për mua është pafytyrësi.

KRYETARI: Faleminderit! O, Islam vetëm të grupit parlamentar edhe Lumir a flet në emër të grupit se po e shoh, se e kaluat radhën më herët, urdhëro. Po, de po e humbni vetë radhën pastaj po e krijoni situatë. Urdhëro, Lumit Abdixhiku në të njëjtën kohë Andin Hoti ka kërkuar fjalën në emër të PDK-së. Ok!

LUMIR ABDIXHIKU: Atëherë, meqenëse u nisëm që t'i përmendim milionat e humbur në Kosovë unë po i përmendi disa të humbura të koalicionit të juaj. Pra, 53 milionë euro të dhëna në Bechtel Enkën pa asnjë vlerësim, pa asnjë verifikim, me një copë letër.

KRYETARI: Veç kthehu në temë se... po kritikojnë, jo s'ia ndërpres, por fol për temën, për këtë.

LUMIR ABDIXHIKU: Për serbët në Veri 36 milionë euro për të mbuluar humbjet e menaxherëve partiak në PTK, 10 milionë euro për paga të Qeverisë, 3 milionë euro për 80 zëvendësministra, e 80 milionë euro për lista fiktive që po ju dalin gjithandej. Pra, që ta keni të

qartë, interes i Kosovës është ndërprerja e punës së këtij koalicioni që bën kaq shumë dëm. Jeni të padijshëm, jeni të rrezikshëm, rrjedhimisht të dëmshëm. Hierarkinë e dëmeve të Kosovës lartë jeni ju, ligjet janë krejt poshtë.

Unë i ftoj edhe një herë partnerët tjerë të opozitës që të vazhdojnë bojkotimin e institucioneve të Kosovës në mënyrë që të kursejmë dëmin që i bëhet Kosovës, i ftoj edhe anëtarët e PSD-së që mos të bëhen pjesë e votimeve të shumicës po t'i bashkohen koordinimit bojkotues të LDK-së dhe Vetëvendosjes. Ne po e bëjmë gjënë e vetme demokratike që mund ta bëjmë, deklarimin tonë politik në mënyrë të civilizuar me votë. Faleminderit!

KRYETARI: Vetëm diçka, se unë s'desha të ndërpres fjalën, Islam si deputet pastaj po futemi në debat, nuk e kam problemin tjetër. Kualifikimet, pasha besën duhet me pas shumë moral, burrni, dijeni edhe duhet me pas shumë traditë as ajo çka e fole ti] më herët as me qenë Gjergj Kastrioti-Skënderbeu s'po hy te këta të vegjlit kënde, veç të padijshëm, të rrezikshëm dëgjo, ...kualifikime thuaji ato për shembull që janë, por mos se të gjithë kanë dinjitet. Unë s'ta ndala, por kujdes! Të kisha lut, dëgjo e donë edhe respekti pak a shumë se secili familja e tyre ka bërë një mundim për me e kryer një gjysmë shkolle, pastaj ti nuk je ligjërues, as nuk je profeti Muhamed. I padijshëm, dëgjo, i rrezikshëm janë çështje të rënda.

Këtë dëgjo unë s'ta ndërpreva veç me qëllim fjalën, po tjetër herë për këso gjëra e ndërpres po ta them drejtë. ... për arsye se po më duket shumë ke marrë hov të madh, a e kupton të jetë njëfarë forme si me qenë, por nuk është mirë se më qite në pozicion të vështirë mua. Më thuaj mua i padijshëm, vetë jeni... atëherë unë ta pranoj këtë ose të përgjigjem, por të gjithë deputetëve mos ju thuaj. Atëherë, Dardan a e kishim përfundua, Dardan të lutem, se ju përmendi po replikë. Po jo bre Lumir se veç po i rëndon pa pikë nevojë. Jepja Dardanit reagim edhe le të flasim në emër të grupeve parlamentare kush ka, shkojmë në votim, e votoni, s'e votoni ky është qëndrimi s'mund ta ndërroj unë këtë.

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

12 nënshkrime të Partisë Socialdemokrate për pesë minuta t'i dorëzoi Lumir Abixhiku, nise mocionin.

E dyta, ne i votojmë krejt ligjet, për, kundër ose abstenim dhe nuk votojmë ligje varësisht prej presioneve. Ka ardhur Ligji për Dhomë të Posaçme të Gjykatës Supreme në këtë Kuvend e keni lëshuar seancën, jeni kthyer e keni votuar kundër, ka kaluar ligji i cili mundëson me u dëmtua e u shpronësua kjo ekonomi. Sot në këtë Kuvend, këto 12 nënshkrime të PSD-së që ku i ke Lumir Abdixhiku, t'i dorëzoi. Jo, juve të LDK-së, juve të LDK-së e keni fare lehtë si partia më e madhe opozitare, t'i ftoni të gjitha subjektet opozitare dhe të ulemi e te bëjmë strategjinë, e te bëjmë

taktikën, e të punojmë bashkë, e te rrëzojmë këtë Qeveri. Edhe një diçka po ju them në gusht të vitit të kaluar, saktësisht në këtë kohë, kur kishim mundësi me bë Qeveri unë pranoja mesazhe që s'keni kohë për takime dhe këtë në gusht të vitit të kaluar, sot një vit më vonë moralizoni këtu për pamundësim të punës. Nënshkrimet i ki, thirrreni tryezën punojmë bashkë e rrëzojmë Qeverinë.

KRYETARI: A shkojmë në votim? Lumir të kisha lutur kthehu në vend, jo se në mënyrë demonstrative dole dhe në mënyrë demonstrative kam për të kthyer në vend. Kështu për të treguar edhe unë jo kulturën time, dëgjo në mënyrë demonstrative dole, në mënyrë demonstrative kam për të kthyer në vend, kjo është.

Vazhdojmë në votim, kështu-ashtu edhe kështu nuk ka kushte të vazhdimit të seancës po e shoh, s'prish punë ky rrinë në këmbë. Jo, jo Dardan se po lyp në mënyrë demonstrative. A shkojmë edhe në këtë votim edhe me aq sa po e shoh, jemi në situatë shumë të mirë, iniciativë merrni, ju lutem vetëm pak. Ju kisha lut, jemi në shqyrtimin e Projektligjit në ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës, edhe pak. Dardani e përmendi me emër, vetëm edhe diçka mos e vëni askënd në pozicion me u mundua me demonstru, me e tregua fuqinë absolute. As unë nuk do të mundohem, urdhëro merre fjalën si replikë, po mos demonstro të lutem, merre fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit!

Meqenëse është bërë vështirë me e marrë fjalën po i shfrytëzoj këta dy minuta shumë shpejt. Dardan edhe ju kolegë të PSD-së isha shqetësuar shumë me më duartrokit PDK-ja, prej fillimit të themelimit të juaj deri më sot kam besuar që e keni një qëllim të vetëm, në çdo deklaratë politike që e keni dhënë keni fol më shumë për LDK-në dhe për Vetëvendosjen sa që keni fol një herë për këtë Qeveri e për këtë koalicion qeverisës. Një herë të vetëm kur ju ka dhënë rasti me fol për këtë Qeveri keni thënë “paj, na e kanë dhënë Pallatin e Rinisë edhe janë burra të mirë”. Për një Pallat të Rinisë nuk bëhet ky muhabet. Tash, meqenëse diskutimi im ju solli 12 nënshkrime, aq sa jeni, unë këtu po ju falënderoj më vjen mirë që jeni kthyer në këtë drejtim, dhe i keni edhe nënshkrimet e LDK-së, po besoj se edhe Vetëvendosja do t'i jep edhe prej sodit zyrtarisht i kemi 57 nënshkrime. Na duhen edhe 4 nënshkrime për nisur mocionin e rrëzimit të kësaj Qeverie.

Mocioni niset dhe ju e dini shumë mirë në momentin që bëhen 61 nënshkrime. Deri atëherë ju ftoj të bëheni pjesë e opozitës dhe të mos votoni, dhe të bojkotoni secilin ligj që vjen në këtë Parlament. Kaq është e thjeshtë, votat e LDK-së, nënshkrimet e LDK-së janë në ardhje e sipër dhe do t'i sjell bashkë me nënshkrimet tuaja dhe po besoj me nënshkrimet e Lëvizjes Vetëvendosje. Më vjen mirë që jeni kthyer këndeje. Faleminderit!

KRYETARI: Kundër replikë, Dardan Sejdiu, jemi në përfundim të diskutimeve, ju kisha lut! Kundër replikë!

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryetar!

Lumir, nëse kritika ka të bëjë me aplauz atëherë me vend e ke, po unë po t'i përmendi tri sende: 8 200 hektarë prej opozitës i keni falë, i keni votuar, keni qëndruar në sallë. Contour Globalin rezolutën e cila është sjellë këtu prej PSD-së për me e ndal marrëveshjen më të dëmshme ekonomike, komerciale të kësaj Republike nuk e keni votuar dhe tash këtu më moralizon, më moralizon për dëme po ti po ia zgjat kësaj Qeveria duke mos e nis mocionin, duke fol për numra. Rrjedhimisht, edhe një herë po e ri përsëris çdo tryezë që e thirrni ju si partia më e madhe opozitare së bashku me ish kolegët e mi deputetët nga Lëvizja Vetëvendosje, Partia Socialdemokrate do të vjen, do e bëjmë strategjinë e ata tre deputetë që po të mungojnë besoj që nëse bëhemi bashkë e punojmë mirë e mbarë i bëjmë.

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka diskutime të grupeve parlamentare. A ka mundësi dy minuta vetëm ta verifikoj, jo jo prit pak grupet parlamentare kanë të drejtë. Islam fol deri ta verifikoj edhe për grupet parlamentare, fol në emër të Grupit të të Pavarurve.

ISLAM PACOLLI: Përsëritje kryetar, me të vërtetë më vjen keq për këtë seancë të sjellë kështu, nuk është e mundur unë jam që nga mëngjesi këtu edhe nuk mund ta marr fjalën si deputetë. Këtu nuk është që po fol vetëm kryetari i grupit, por në emër të grupit po flasim një nga një edhe më shumë replika, ku është esenca unë që duhet me qenë në këtë seancë e cila me të vërtetë më zhgënjën.

Ju si kryetar nuk e keni siguruar si deputetë që unë kam kërkuar sallën atje bufen, mos me u pi duhani që me pas qasje, por unë duhet me qëndruar tërë ditën këtu ju s'më jepni fjalën. Është e padrejtë, nuk funksionon kështu. Ne duhet me qenë jo me standarde të dyfishta po me qenë realisht edhe me pas të gjithë të drejtat e njëjta.

E dyta, nëse ne i duam votat duhet me qenë jo edhe lypës edhe zgjedhës...

KRYETARI: A ka mundësi veç pak vëmendje, veç pak vëmendje! Urdhëro, vazhdo...

ISLAM PACOLLI: Prandaj, ne duhet me qenë korrekt dhe t'u kisha lut që ne të jemi më korrekt në sjelljet e deputetëve për arsye që duke e sharë njëri-tjetrin nuk arrihet asnjëherë asnjë qëllim, asnjë votim. Unë i bëj thirrje të gjithë deputetëve që t'i përkrahin këto ligje, sidomos marrëveshjen ndërkombëtare, të cilat shkojnë në dëm të qytetarit të Republikës së Kosovës. Ne një herë e përgjithmonë duhet me qenë të kujdesshëm, me tregua kulturën tonë dhe me shkua përpara. Edhe një heër ju bëj thirrje zoti kryetar, duhet me qenë deputetët e barabartë për me mujt me e marrë fjalën përndryshe nuk ka esencë unë duhet me qëndruar vetëm për ta dhënë një votë. Faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem, pak seriozitet se fund të fundit deputetët që nuk kanë grup po e kanë këtë shqetësim, po në bazë të Rregullores nuk kam drejtë Islam, ta thashë edhe më herët. Munden deputetët, për qartësim të publikut, kur e autorizon në këtë rast Avdullah Hoti e ka autorizuar Lumir Abdixhikun kjo ke arsyeja pse ia dhashë fjalën. Në të njëjtën kohë Ahmet Isufi, Teuta Haxhiun.

Të shkojmë kështu, Glauk Konjufca fjala për ju, bëhet gati Bilall Sherifi.

GLAUK KONJUFCA: Këto tri seancat e fundit të Kuvendit të Kosovës është vërejt një gjë shumë e qartë, që nuk ka kaluar asnjë ligj e ato që kanë kaluar janë shumë pak në këto tri seancat e fundit. Asnjë pikë nuk ka kaluar nëse njëra prej pjesëve të opozitës nuk e ka mbështetur një pikë të tillë. Çka tregon kjo? Kjo tregon që Kuvendi i Republikës së Kosovës për nga përbërja e numrave është në njëfarë pozicioni që pa bashkëpunimin e opozitës vështirë që mund të kalojë ndonjë pikë në këtë Kuvend të Republikës së Kosovës dhe duke e ditur këtë fakt, mazhoranca në vend që të jetë falënderuese edhe mirënjohëse aty ku opozita merr pjesë për të kaluar ndonjë pikë që ne konsiderojmë që është e rëndësishme dhe në interes të qytetarëve të Kosovës përkundrazi ajo që unë kam dëgjuar në këto dy seancat e fundit, por sidomos në këtë të sotmen është një diskurs i paparë, arrogant i mazhorancës.

Në njërën anë e keni rezultatin që asnjë marrëveshje ndërkombëtare nuk mund të kalojë në këtë Kuvend pa opozitën, bile në disa pjesë të ligjeve ratë edhe në 47 vota, 45 vota, kurse krejt çka flisni janë ofendime, sharje, fyerje për opozitën. Mos thoni që duam të kalojmë ligje edhe duam t'i ndihmojmë Kosovës e në të njëjtën kohë e përdorni këtë gjuhë të papranueshme kundër deputetit, kundër opozitës. Unë nuk mendoj që problemi i këtij vendi është opozita, unë mendoj që problemi i këtij vendi është keqqeverisja edhe plotësisht ju jap të drejtë të gjithë atyre që e argumentojnë këtë faktin që ju e përmendni se Kosova po humb miliona me këto marrëveshje, i jap të drejtë po aq edhe kundër argumentimit që problemi kryesor në Kosovë nuk është që po marrim ne miliona edhe që po marrim fonde, problemi është qysh po shpenzohen ato, a po kontrollohen ato, a po i mbikëqyrë dikush. Sa ka korrupsion në këto fonde? Sa po keqpërdoren këto fonde? Kush po përfiton prej këtyre fondeve? A po përfiton përnjëmend qytetari i Kosovës a mos këtu në Kosovë është krijuar njëfarë rrjeti kriminal i filtrave që në fund po përfitojnë do klane jo qytetari i Kosovës. Çka u bë gjithë këta miliarda në Kosovë, diku sipas vlerësimeve të raporteve të ndryshme 40 miliardë euro Bashkësia Ndërkombëtare i ka dhënë në Kosovë. Ku është punësimi? Ku janë fabrikat? Domethënë ku qenka problemi, problemi është se kur je i korruptuar nëse donë edhe 1 miliardë euro me t'i dhënë është badihava. Pra, duhet ta shikojmë problemin në thelb.

Të gjithë ata që argumentojnë se nuk është e mjaftueshme me propagandua këtu e me bë demagogji i humbën kaq miliona, opozita është fajtorë për humbjen e kaq milionave, tregoni ju qysh po i menaxhoni. A ka kritikë në këtë menaxhim? A po vërehet në mirëqenien e qytetarëve

edhe ngritjen ekonomike këto fonde që po i marrim, kurrë hiq asnjë. Veç remitancat e Diasporës që po na vijnë këtu përndryshe buxhetin e ... krejt, s'ka kurrfarë, s'po e prek qytetari i Kosovës me punësim, me mirëqenie, me zhvillim këtë punë. Kështu që unë plotësisht ju jap të drejtë edhe atyre që kanë të drejtë me argumentua me të vërtetë, me ia bo kritikën këtyre fondeve. Ti po i merr fondet prej BE-së, por çfarë mekanizma demokratik edhe të mirëfilltë të mbikëqyrjes i ki.

KRYETARI: Po, kryeministër, gjithsesi fjala është për ju, po qëndrimin për çka folëm asnjë qëndrim nuk pat, prapë. Urdhëro, kryeministri i Republikës së Kosovës.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: A është e drejtë me Rregullore, mos po e shkeli Rregulloren. Dëgjoni se arsyeja pse kam ardhur në seancë nuk ishte votimi i ligjeve të caktuara, por ishte një debat parlamentar, të cilin unë po e pres te ju në Parlament që disa ditë. Pra, disa ditë të qeverisjes së mirë Glauk që ishte dashur me ia kushtuar qytetarëve po vij këtu, për shkak të do marrëdhënieve pozitive-opozitive, tema po shtyhet për një arsye të caktuar. Edhe këtë debat disa orë pune të qeverisjes që ishte dashur me ia kushtua njerëzve unë jam ardhur që dy herë, e dyta ditë që jam këtu duke u munduar me e zënë rendin me qenë ju për respekt të kësaj teme që e keni lajmëruar.

Sa i përket qeverisjes, ne kemi dhe do të kemi rast për të folur, një gjë ju siguroj, nuk është ndonjë qeverisje e partive që kryen punë për një parti. Vendimet e kësaj Qeverie i shkojnë qytetarëve e ata janë edhe Vetëvendosje, edhe LDK edhe PSD po edhe pozitive.

E dëgjova Lumirin i tha PSD-së për Pallat të Rinisë po Lumiri është i mençur e për shkak se është i mençur e dinë që është edhe Ligji për Prishtinën në qatë paket e kisha lutë me ja nis prej Ligjit për Prishtinën e pastaj krejt tjerat edhe Pallatin e Rinisë.

Ligji për Prishtinën ju e dini që në interes të gjithë neve që jetojnë në kryeqytet e në Kosovë. Pa vendimet e kësaj Qeverie nuk janë të tilla. Edhe diçka, unë nga pikëpamja e një qeveritari tash po ju them se shumë mirë që s'po mujka pozita me i votua ligjet pa dakordim me opozitës se atëherë përmbajtja e ligjeve nuk qenka arrogancë e pozitës por rezultat i kontributeve ndërsjella.

Sa i përket shifrave që janë humb sot, shikoni ju kisha lutë, ka diçka që mundeni me e lënë jashtë luftës opozitare janë ndjeshmëria e marrëdhënieve tona me BE-në, ndjeshmëria po flas për ndjeshmëri nuk po flas as për pare në këtë rast po ndjeshmëria e këtyre marrëdhënieve. Në kohën kur ne po aspirojmë për të avancuar nga MSA-ja një MSA që është specifike për ne me status kandidati e kur duhet avancuar me ERA-n në kohën kur e kem liberalizimin e vizave, në mëshirën e ministrave të brendshëm, ju lus po ju lus, jo për mua, por për familjarët tuaj që njëherë kërkojnë prej juve ndihmë me ja u qetë një mënyrë me ardhur deri te viza përjashtoni këtë pjesë, ndjeshmërinë e marrëdhënieve me BE-në mos e lëndoni për shkak të aspekteve tona

ndërpartaieke opozitare ruaje këtë lënë anash janë disa muaj ndoshta deri te një vendim i drejtë i lëvizjes së lirë. Mua më vjen keq që po na ik ky argument. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi, në emër të Grupit Parlamentar Nisma, nga Grupi Parlamentar 6+ nuk u lajmërua askush edhe shkojmë në votim.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Sa i përket marrëveshjes ndërkombëtare Nisma e mbështetë dhe do të votojë pro kësaj marrëveshje, ndërsa me që të gjithë dolën nga pak nga rendi i ditës po dal edhe unë nëse më lejon.

Ai mocioni, a ka për ta rrëzuar Qeverinë a pozitën, s'e e mora vesh, jo seriozisht po. ne vërtetë jemi pus ama ju hala ma pus.

Dallimi mes pozitës dhe opozitës është që ne jemi më të veshtë në mes veti po nuk po kemi deputetë mjaft. Ju jeni deputetë mjaft në sallë por s'po merreni vesh.

Kjo mazhorancë nuk e ka problemin e numrave, mblidhini sa të doni. Jo seriozisht po them Darda Sajdiu po ja përmendi emrin seriozisht tash e kam. Ju kërkoj falje për këtë digresion mund edhe të keqkuptohem tash po bashkë keni shkua qaty ku ju ka prit Kadri Veseli, ky me ju ngacmua ju me thanë jo se votoj. E unë të kisha qenë në vendin e juaj kisha thanë jo zoti kryetar nuk mundesh me më shti me një fjalë mos me votua për të mirë të Kosovës. Unë kështu ju kisha thënë, zoti kryetar unë kështu të kisha thanë ty, e di që ti e ke qëllimi me më shti mos me votua po jo unë do të votoj këto ligje sepse këto janë në shërbim të qytetarëve dhe të Republikës së Kosovës.

Unë sinqerisht po them bash ku ka prit qaty keni shkua, mos i shkoni ku ju... Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vetëm diçka, politikë lëvizet vetëm në këtë rast, i nderuar kryetar nuk e kisha fut për hir me i hup këto para, politikë lëvizet nganjëherë po për besë jo, merre si të duash.

Edhe një herë, unë derisa ishim duke folur s'ka tjetër grup parlamentar e verifikova, prit pak, vetëm pak. E verifikova nuk ja kam jap fjalën Grupit Parlamentar të PDK-së, Nezir Çoçaj. Urdhëro, fjala për ju, për marrëveshje të lutem.

NZIR ÇOÇAJ: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Zoti kryetar të kisha lut në emrin tim personal me i thirr nja 10 seanca rend për demagogji se ne jemi të njohur si shqiptar për demagogji asnjë për punë, asnjë për çështje praktike në interes të shtetit.

Është mirë thirr rend tash sidomos ose krejt muajin gusht leje ... vetëm për demagogji edhe studentët janë në pushim se sa herë që na ndjekin neve asnjëherë s'po mundën me lexua edhe po ndjehen shqetësuar.

Sa i përket marrëveshjes "ERASMUS+" zoti kryetar dhe të nderuar deputetë, Grupi Parlamentar i PDK-së e ka trajtuar mirë këtë marrëveshje dhe padyshim që do ta përkrahë për arsye se janë 36 miliard euro në këtë buxhet që përfshinë për Ballkanin perëndimorë.

Unë po ashtu shprehi shqetësim që institucionet e arsimit të lartë në Kosovë projektin horizont që ka përfshirë që ka kap një shifër me miliarda euro vetëm katër projekte kanë kalua.

Andaj, ne pa dyshim që duhet ta përkrahim por po kërkoj të njëjtën kohë edhe nga kryeministri i Kosovës e sidomos nga ministri i Arsimit që të ju del në ndihmë institucioneve të arsimit të lartë qofshin publike edhe private, është mirë t'i trajtojmë, është mirë në një farë mënyre të shfrytëzojmë këtë buxhet të madh të këtij programi dhe ne të arrijmë ... deri sa të mundemi maksimum me e shfrytëzua.

Unë e di që shumë kolegë deputetë janë shkollua në perëndim me fonde të ... ne si kemi pas mundësi disa të tjerë, edhe është mirë që të rinjtë e Kosovës të shfrytëzojnë këtë buxhet edhe programit horizont 20-20 edhe programit "ERASMUS+" po edhe të programeve tjerë që janë në kuadër të Komisionit Evropian. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk deputetë tjerë. Përfaqësuesi i Qeverisë s'e ka kërkuar fjalën.

Të nderuar deputetë,

Para se të vazhdojmë me procedurën e votimit e konstatojmë veç praninë në sallë.

Janë 85 deputetë, ka kushte të mjaftueshme.

Regjia dhe deputetët të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Edhe një herë do të votojmë, 59 deputetë, i nderuar kryetar i grupit parlamentar.

90 deputetë ndërkohë janë në sallë.

Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Edhe kjo marrëveshje mbetet për seancën e radhës.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-066 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për patentë shoferi

Komisionet Parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Shtatë amendamente janë gjithsejtë.

Shtatë amendamente kisha lutë në përmbajtje secili ka të drejtë të voton mos të voton, kjo është çështje e tij.

Shtatë amendamente i kemi, a të shkojmë t'i bëjmë bashkë krejt këto amendamente.

Atëherë do të votojmë, pesë amendamente janë me përkrahjen e Komisionit Funksional, dy janë me alternativa.

I votojmë të pestat përnjëherë me përkrahje të Komisionit Funksional, në qoftë se nuk ka reagim.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Edhe një herë ju lutem, është rezultati i votimit, nuk ka votim po thuaj se, më saktë vendimi i Gjykatës Kushtetuese, 56 deputetë kanë votuar po nuk konsiderohet i përmbushur kushti i votimit.

Shkojmë edhe një herë votimi për pesë amendamentet të propozuara me përkrahjen e Komisionit Funksional.

Votojmë tash!

Edhe kjo pikë e rendit të ditës për shkak të mungesës së kuorumit në votim kalon për seancën e radhës.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit numër 06/L-067 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës

Komisionet Parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Janë gjithsejtë katër amendamente të propozuara. Të katrat janë me përkrahjen e Komisionit Funksional.

Po shkojmë në votimin në tërësi të katër amendamenteve. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

55 deputetë kanë votuar, nuk ka kuorum të mjaftueshëm.

Votojmë edhe një herë, është vendim i Kryesisë të keni parasysh, këtë çfarë po e bëjë po shkoj në mënyrë procedurale e vendimi i Kryesisë i fundit.

Shkojmë edhe një herë e votojmë katër amendamentet e propozuara.

Votojmë tash:

Edhe kjo pikë e rendit të ditës në mungesë të kuorumit kalon për seancën e radhës.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120

Edhe këtë projektligj komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligji dhe i kanë rekomanduar Kuvendit miratimin e tij.

Janë tri amendamente me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë tash:

53 deputetë kanë votuar, nuk ka kuorum të mjaftueshëm.

Votojmë edhe një herë ju lutem, përgatitemi për votim, të njëjtat amendamente.

Votojmë tash:

Edhe kjo pikë e rendit të ditës për mungesë të kuorumit kalon seancën e radhës.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit numër 06/L-069 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit numër 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Janë gjithsejtë shtatë amendamentet.

Të gjitha janë me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë tash!

Në mungesë të kuorumit nuk ka votim, nuk konsiderohet votim, 56 deputetë kanë votuar por s'ka deputetë të mjaftueshëm.

Votojmë edhe njëherë shtatë amendamente të propozuara.

Votojmë tash!

Edhe kjo pikë e rendit të ditës në mungesë të kuorumit në votim, kalon seancën e radhës.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit numër 06/L-070 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit numër 04/L-179 për transportin rrugor

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Janë gjithsejtë katër amendamentet me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë tash:

Po e shihni edhe vetë 55 deputetë kanë votuar, por nuk ka shumicë e cila mund të konsiderohet me e përmbush kriterin e votimit.

Votojmë edhe një herë, votojmë tash:

Edhe kjo pikë e rendit të ditës në mungesë të kuorumit 56 deputetë ka votuar. Kalon për seancën e radhës.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit numër 06/L-071 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit numër 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme

Komisioni parlamentar e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij, janë tre amendamente.

Shkojmë në votim, votojmë tash:

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Nuk miratohet as ky për shkak të kuorumit.

Jemi në pikën e rendit të ditës:

9. Debat parlamentar për dialogun me Serbinë

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Social Demokratike ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar për dialogun me Serbinë.

Ftoj deputetin Visar Ymeri, që në emër të propozuesit ta paraqes çështjen për të cilën është kërkuar debat parlamentar.

Zoti Ymeri, e keni fjalën.

VISAR YMERI: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar qytetarë të Republikës,

Ne sa po e dëgjuam kryeministrin para 15 minutash që tha jam t'u e pritë këtë debat që tri ditë edhe kur erdh koha e debati shkoi, s'po e kuptoj qysh i ka pas tri ditë e si patë edhe gjysmë ore, shumë mirë që po vika.

Këtë debat e kemi kërkuar si çështje urgjente në fund të javës së kaluar dhe kemi synuar që ta bëjmë faktikisht si seancë të jashtëzakonshme me 40 nënshkrime para takimit që ndodhi me 18 korrik në mes të Hashim Thaçit si president i Kosovës dhe Aleksandër Vuçiqit si president i Serbisë, pra kemi menduar që ta bëjmë një debat parlamentar në të cilën tregohet vendosmëria e grupeve parlamentare dhe vendosmëria e Kuvendit të Republikës së Kosovës që t'i tregoj Hashim Thaçit që nuk e ka mandatin për të vazhduar me dialogun me Serbinë.

Mirëpo kjo nuk ndodhi për arsye do të thosha objektive dhe jemi tash në këtë pikë ku po diskutojmë dhe mendoj që nuk është vonë as tash sepse ky Kuvend dosmosdoshmërisht duhet ta marrë përsipër këtë diskutim edhe këtë proces kaq të rëndësishëm e të ndjeshëm për republikën e Kosovës.

Hashim Thaçi, prapë po ngutet që të vazhdoj me dialogun me Serbinë si përherë pa kurrfarë përgatitje e pa kurrfarë diskutimi publike thua asgjë nuk ka ndodhë në procesin e deritashëm.

Dhe sa për të ju kujtuar deri tash ky dialog, prej se ka filluar në vitin 2012 na e ka ndryshuar emrin politik nga Republika në fusnotë, na e ka fuqizuar e zyrtarizuar praninë politike të Serbisë në Kuvend e Qeveri nëpërmjet listës serbe, dhe së fundi rrezikoi të na e kthej me kokë te poshtë rendin kushtetues nëpërmjet Bashkësisë së Komunave me shumicë serbe, për ta formalizuar ndarjen, e thelluar identifikimin etnik politik në dëm të barazisë e drejtësisë qytetare, në dëm të integritetit të njerëzve e territorit, në dëm të përbashkimit e funksionalizimit të resurseve e tregut.

Dhe në vend se ta vemi gishtin në kokë dhe ta marrim seriozisht këtë situatë ku gjendemi, në vend se ta diskutojmë e ta ridisejnojme dialogun, vendimmarrjen në të, vijat e kuqe për të, temat që i flasim e ato që nuk i flasim, krerët institucional e quajnë reformatim bartjen e dialogut nga ekzekutivi të presidenca. Thua ti ky paska qenë problemi. Se Hashim Thaçi si kryeministër paska negociuar keq, por tash si President do të negociojë mirë. Por, fatkeqësisht, edhe një pjesë e kundërshtimit ka mbetur vetëm te kjo pikë. Pra, te ana tjetër e së njëjtës medale. Ky nuk është kundërshtim. Është konfirmim i së njëjtës logjikë - i asaj që thotë se nuk ka rëndësi procesi, agjenda e formati, platforma e strategjia - i rëndësishëm është vetëm njeriu.

Përgjatë këtij dialogu Republika e Kosovës është shndërruar në shtet për dialog, në shtet për të cilin dialogohet, e jo shtet që dialogon. E brenda Republikës dialogu është vendosur në funksion të një njeriu. Kah të shkon Thaçi aty shkon dialogu me Serbinë.

Deri tash deputetë të Kuvendit e të Republikës kanë ndodhur disa takime për të cilat nuk dimë gjë, dhe disa të tjera publike, por në të cilat nuk dimë çka është folur. Krejt çka dimë janë deklaratimet e krerëve institucional, më shumti të Presidentit, i cili disa herë e ka përmendur se në dialog nuk ka vija të kuqe, dhe se kompromisi do të jetë i dhimbshëm. Cili kompromis? Për çka është duke u diskutuar dhe çka e çka kanë vendosur të lëshojnë pe? A e di për këtë opinion publik? A po diskutohet ndarja e Kosovës? A është pikënisja e pozicionit të Kosovës Bashkësia e Komunave plus? Sepse Thaçi drejtpërdrejt dhe personalisht ka obligim ndaj kësaj marrëveshje duke qenë ai që e ka parafuar atë më 2013.

Kjo duhet ndalur.

Prandaj është tejet e rëndësishme që Kuvendi ta marrë përsipër dialogun. Që Kuvendi ta miratojë platformën strategjike e t'i ritheksoj vijat e kuqe, duke i ravijëzuar qartë edhe temat për të cilat nuk flasim fare. Është tejet e rëndësishme dhe siguresë e domosdoshme që Kuvendi ta ketë mbikëqyrjen e përhershme të dialogut dhe ta gëzojë të drejtën e heqjes së mandatit për dialog sa herë dhe kurdo që negociatorët shkelin parimet udhërrëfyese e platformën negociuese.

Natyrisht që përfaqësimi në dialog është i rëndësishëm. Dhe natyrisht që Zyra e Presidentit e as Presidenti nuk janë as të mandatuar e as të pranueshëm për ta bartur një proces të tillë. Por më me rëndësi se kjo është vendimmarrja legjitime demokratike, platforma e strategjia negociuese, agjenda e vijat e kuqe, si dhe përfaqësimi në dialog e mbikëqyrja institucionale karshi tij.

Propozimi i Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate për votim:

Në mbështetje të Nenit 65, paragrafit 1, pikës (1), si dhe paragrafit 9 e 14 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; Nenit 6, paragrafit 1 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, të nxirret një:

REZOLUTË

Për caktimin e përgjegjësive institucionale në procesin e dialogut mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë

1. Partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës dakordohen që përgjegjësia fundamentale për mbarëvajtjen e procesit të dialogut i takon Kuvendit të Republikës, duke qenë organi më i lartë legjislativ e vendimmarrës në vend;

2. Me votë të kualifikuar, me dy të tretat e numrit të përgjithshëm të deputetëve, Kuvendi e miraton Platformën Shtetërore për Dialogun e cila do të shërbejë si dokument bazë i parimeve themeltare dhe të pozicioneve shtetërore në këtë proces të rëndësishëm;

3. Me votë të kualifikuar, me dy të tretat e numrit të përgjithshëm të deputetëve, Kuvendi e mandaton bartësin/t e dialogut. I/të mandatuarit mbahen përgjegjës nga Kuvendi përgjatë secilës fazë të dialogut, dhe marrin vendime vetëm në dakordancë të plotë me të. Kuvendi i Republikës së Kosovës ruan të drejtën e shkarkimit të bartësit/ve kurdo që vlerëson se janë shkelur parimet themelore të Platformës dhe kur procesi rrezikon të dalë jashtë kornizave të saj;

4. Kuvendi i Republikës, në pajtim me nenin 69 paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit e themelon një Komision që do ta monitorojë për së afërmi procesin e dialogut.

Ky komision do të jetë përgjegjës që ta njoftojë Kryesinë e Kuvendit dhe seancën kuvendore për çdo zhvillim në procesin e dialogut e po ashtu, të kërkojë debate të rregullta parlamentare gjatë kohëzgjatjes së tij. Komisioni për Mbikëqyrjen e Dialogut do të drejtohet nga opozita parlamentare, kurse përbërja e tij do të caktohet sipas formulës së përdorur në komisionet e rregullat e Kuvendit. Pra, kjo rezolutë katër pikëshe është ajo që ne e propozojmë ta votojmë në fund të këtij debati, natyrisht të gatshëm edhe ta diskutojmë, e përafrojmë, e plotësojmë me idetë e propozimet që i keni ju si deputetë, mirëpo mendoj që një gjë është jashtëzakonisht e rëndësishme të kuptohet dhe të dihet në këtë fazë të diskutimit për dialogun siç e kemi menduar ne të paktën si grup parlamentar i Partisë Socialdemokrate është e rëndësishme që ne me votë të deputetëve t'ia përcaktojmë rolin e qartë vendimmarrës Kuvendit ose t'ia ritheksojmë këtë rol Kuvendit karshi këtij procesi dhe pastaj natyrisht që do të ketë diskutime tjera për platformën dhe mandatimin e bartësve ose përfaqësimit të Republikës së Kosovës në këtë dialog.

Pra, sot po flasim ose të paktën ne sot po propozojmë një rezolutë e cila vetëm e përcakton qartë atë se si dhe kush merr vendime për sa i përket procesit të dialogut dhe se si rregullohet institucionalisht ky proces. Faleminderit dhe kërkoj nga deputetët ose i thërras deputetët që ta votojnë këtë në mënyrë që ta fuqizojmë Kuvendin e Republikës nga një proces i cili është jashtëzakonisht i rëndësishëm, i ndjeshëm, mund të sjellë shumë probleme dhe rreziqe për Republikën e Kosovës, mirëpo të gjithë e dimë po duket se është edhe i pashmangshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kush e ka fjalën në emër të LDK-së? Zoti Hoti e ka!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë, më lejoni të paraqes qëndrimin e Grupit e Parlamentar të LDK-së lidhur me këtë çështje. Ne mendojmë se dialogu me Serbinë është procesi më i rëndësishëm nëpër të cilin kalon Kosova nga shpallja e pavarësisë, deri më tani ky proces është karakterizuar me shumë vështirësi.

Edhe pse i natyrës teknike deri më tash, dialogu ka dalë të jetë shumë kompleks, plot marrëveshje teknike që janë arritur nuk janë respektuar nga ana e Serbisë, trysnia ndërkombëtare nuk ka vënë

rezultat për këtë çështje. Prandaj, nisja e një dialogu të ri pa përgatitje paraprake është e rrezikshme dhe është e papërgjegjshme. Takimet jo publike të Thaçit dhe të Vuçiçit ku askush nuk dinë se çfarë bisedohet, ne nuk mund t'i konsiderojmë përgatitje teknike për dialog. Draft platforma për dialog e Qeverisë ishte një dokument i dobët, jo serioz dhe me pretendime jo kushtetuese. Fatkeqësisht, procesi i dialogut po tentohet të udhëhiqet nga institucione jo legjitime dhe jashtë mandatit të tyre kushtetues. Konteksti aktual i krijuar nga nevoja e kryeministrit për tu zmbarsur nga përgjegjësitë kushtetuese dhe nga nevoja e presidentit për tu imponuar si faktor përcaktues nuk mund të detyrojnë askënd të shpërfill rregullat e funksionimit të institucioneve kushtetuese. Institucioni më i lartë në vend që është Kuvendi i Kosovës ka nxjerr një rezolutë në vitin 2011, e cila është ende në fuqi dhe kushdo që sillet në kundërshtim me këtë rezolutë bindet me vullnetin e të zgjedhurve të qytetarëve.

Të nderuar deputetë, ky proces duhet të bazohet në parime të qarta. Ne besojmë se çështjet e hapura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mund të zgjidhen vetëm nëpërmjet dialogut dhe këtë frymë ne e mbështesim plotësisht procesin e dialogut. Për neve si parti e qendrës së djathtë dhe anëtare e partive popullore evropiane, dialogu është jo vetëm mjet për arritjen e marrëveshjeve, por është qenësi e jetës tonë politike. Ne vlerësojmë se marrëdhëniet e mira ndërshtetërore janë parakusht për paqen në rajon dhe për integritet euroatlantike. Ne vlerësojmë se subjektiviteti shtetëror i Kosovës është përcaktuar me deklaratën e pavarësisë, me opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të drejtësisë dhe se Kosova tash është pranuar nga shumica e kombeve të lira të votës. Ne vlerësojmë rolin e Bashkimit Evropian në këtë proces dhe përkrahjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe besojmë se të dyja duhet të jenë plotësisht të involvuara në këtë proces.

Të nderuar deputetë, dialogu duhet të bazohet në kornizë të qartë, marrëveshja përfundimtare me Serbinë duhet të nënkuptojë normalizim të plotë marrëdhënies mes dy shteteve. Normalizimi i plotë arrihet vetëm me njohje reciproke. Marrëveshja përfundimtare me Serbinë duhet t'i mundësojë Kosovës anëtarësim të menjëhershëm në organizatat ndërkombëtare para se gjithash në OKB, si dhe t'i hapë rrugë anëtarësimit në BE dhe në NATO, ndryshe nuk ka kuptim.

Qëndrimi jonë është i qartë, marrëveshja përfundimtare me Serbinë duhet të arrihet duke mos e cenuar integritetin territorial të Kosovës, duke e ruajtur karakterin unitar të shtetit të Kosovës dhe duke respektuar frymën e Kushtetutës së Kosovës. Si shenjë e vullnetit të mirë shteti i Serbisë duhet të ofrojë menjëherë të dhënat për të pagjeturit, të shpreh vullnet për kërkim falje dhe për kompensim të dëmeve të luftës. Lidhur me përfaqësimin në dialog ne vlerësojmë se dialogu duhet të udhëhiqet nga institucionet shtetërore që kanë kompetenca kushtetuese dhe që kanë legjitimitet politik. Ekipet që i tejkalojnë institucionet shtetërore cenojnë përfaqësimin kushtetues të Kosovës në këtë proces dhe përbëjnë kthim prapa. Ne vlerësojmë se institucionet momentalisht nuk kanë fuqi politike dhe legjitimitet qytetarë për të përfaqësuar Kosovën në këtë proces. Një pakicë parlamentare nuk mund të zhvillojë dialog, koalicioni PAN po qëndron

dhunshëm në pushtet duke shfrytëzuar situatën që është krijuar në Kuvendin e Kosovës. Prandaj, të nderuar deputetë nuk duhet të humbim kohë me diskutime pa asnjë rezultat. Ne jemi të gatshëm të bëhemi pjesë aktive e procesit të dialogut, por vetëm pas legjitimitit qytetarë nëpërmjet votës së lirë.

Ju siguroj që ne mbetemi të përkushtuar për një proces dialogues që është serioz, konsensual dhe brenda kornizave kushtetuese. Rrugë tjetër nuk ka, kushdo që mendon të silltet ndryshe do të përballet me refuzim qytetarë dhe politik në Kosovë, nuk duhet të mashtrohet askush se mund të vendos për fatin e Kosovës në tavolinën e dialogut. Ne nuk do të votojmë asnjë rezolutë që mandaton persona që nuk kanë legjitimitet dhe as kompetenca kushtetuese për një proces të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kryetar i grupit zoti Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues i seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës e shpreh vlerësimin dhe mbështetjen për debatin lidhur me një çështje të rëndësisë nacionale, siç është faza finale e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi, si një ndër temat më të rëndësishme me të cilat ballafaqohet Republika e Kosovës, në mënyrë që secili t'i shpreh qëndrimet dhe vlerësimet e veta politike për këtë çështje.

Që në fillim duhet theksuar se kjo është një temë që në takon të gjithë aktorëve politikë në vend pa përjashtim e që po ashtu, na takon të gjithëve për të dhënë kontributin aktiv në këtë proces nëpërmjet përfshirjes në të. Prandaj, ne besojmë se konsensusi për dialogun me Serbinë është më shumë se i dëshirueshëm, është përgjegjësi e të gjitha partive politike para së gjithash atyre të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës e kontributin për këtë proces e shohim si një obligim që e kemi të gjithë karshi vendit dhe qytetarëve tanë. Ka vite që Kosova ka dialoguar me Serbinë dhe deri tash ka numër të konsiderueshëm të marrëveshjeve që janë arritur me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Shumë prej këtyre marrëveshjeve nuk zbatohen plotësisht, e ka të tillë që nuk zbatohen fare. Megjithatë, nuk mund të mohohet fakti që dialogu ka prodhuar dhe hapa përpara në konsolidimin e sovranitetit shtetëror të Kosovës, por edhe në procesin e integritit tonë në familjen evropiane.

Është e natyrshme dhe krejtësisht e mirë kuptueshme që të kemi dallime në vlerësimet tona për procesin e deritashëm, por edhe dallime në konceptet tona politike qeverisëse. Megjithatë, mbyllja e një kapitulli të mosmarrëveshjeve me një shtet fqinj, përfundimi i konfliktit të ngrirë që kemi me Serbinë duhet të jetë pikë që na bashkon. Para se gjithash, përcaktimi dhe arritja e qëllimeve konkrete nga përfundimi i këtij dialogu siç është anëtarësimi i Kosovës në Organizatën

e Kombeve të Bashkuara dhe procesi integrues i vendit tonë në Bashkimin Evropian duhet të jenë pika të konsensusit tonë të përbashkët. Është qëndrim i qartë edhe i Partisë Demokratike të Kosovës që Kuvendi i Kosovës ta ketë rolin e mbikëqyrjes dhe vendimmarrjes finale në këtë proces të rëndësishëm dhe mbi këtë parim në të cilin besoj se duhet të pajtohemi të gjithë, duhet të ulemi dhe të punojmë bashkë në mënyrë që të kemi një platformë të përbashkët dhe një ekip të përbashkët përfaqësues.

Edhe në të kaluarën marrëveshjet e arritura në Bruksel janë ratifikuar në këtë Kuvend me 2/3 e votave të deputetëve të Kuvendit. Kjo do të ndodh edhe me marrëveshjen që potencialisht do të arrihet në përfundim të kësaj faze finale të dialogut. Por, duhet të them i qartë se kjo fazë dallon nga fazat e mëhershme, kjo fazë do ta përmbyll dialogun me Serbinë dhe do të prodhojë një marrëveshje ndërkombëtare të obligueshme si për Kosovën ashtu edhe për Serbinë, e njëjtë edhe për Bashkimin Evropian që do të jetë jo vetëm ndërmjetës po bashkë edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës edhe garantues i zbatimit të kësaj marrëveshje. Se cila do të jetë marrëveshja është një çështje që na takon të gjithëve këtu, por për të nxjerrë më të mirën e mundshme neve na duhet që t'i qasemi bashkarish dhe përtej pozicioneve partiake këtij procesi. Pozicioni i Kosovës në dialog fuqizohet vetëm nëse arrihet një konsensus, një gjithë përfshirje. Ne do të jemi më të dobët nëse në Bruksel shkojmë në mënyrë të fragmentuar.

Tek e fundit Kosova nuk është vetëm e koalicionit të sotëm qeveritar, Kosova është e të gjithëve pozitë e opozitë dhe është përgjegjësi e secilit për ta dhënë kontributin e tij në këtë proces. Kjo vlen edhe për të gjithë bartësit institucional në Kosovë duke përfshirë edhe Presidentin e Republikës, udhëheqjen e dialogut nga i cili disa prej kolegëve këtu ende e kontestojnë. Ne mund të bëjmë edhe interpretime të ndryshme të Kushtetutës sonë, por interpretimet kontestuese nuk mund t'i ndryshojnë prerogativat që ajo ia atribuon cildo institucion përfshirë edhe Presidentin e vendit. Po ashtu, askush nuk po kërkon që vetëm presidenti të merret me dialogun, përkundrazi kërkesa e të gjithë neve në koalicionin qeverisës është që të bëhemi bashkë pozitë e opozitë për këtë proces. Bashkë edhe me ndihmën e ekspertëve të ndryshëm, shoqërisë civile, botës akademike e të tjerë. Nuk duhet askush të frikësohet nga dialogu, ai ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian dhe mbështetet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ndërsa Kosova merr pjesë si shtet i pavarur dhe sovran në këtë proces.

Tek e fundit ne nuk kemi pse të frikësohemi për të shkuar aty ku na fton Brukseli dhe Uashingtoni. Sa herë që kemi negociuar me Serbinë me mbështetjen e partnerëve tanë përëndimor ne nuk kemi humbur, në Rambuje ne e fituam lirinë tonë, ndërsa me procesin e Vjenës e fituam pavarësinë tonë. Sot, në Bruksel ne duhet të kërkojmë dhe të marrim konsolidimin final të sovranitetit tonë shtetëror dhe legjitimitetin e subjektivitetin e plotë ndërkombëtar. Por, për të arritur këtë na duhet një arritje e një konsensusi nacional për parimet themeltare dhe për limitet e negociimit nga ana e Kosovës. Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Kadri Veseli tashmë ka prezantuar një dokument kornizë për dialogun Kosovë-

Serbi në të cilin janë paraparë këto parime dhe ky dokument mund të diskutohet dhe të pasurohet edhe më tutje nga të gjithë. Normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë duhet të ndodh, prandaj është mirë që koncentrimi ynë, fokusi ynë të jetë në përmbajtjen e dialogut në qëndrimet e Kosovës në këtë proces.

Nëse merremi vesh për këtë është shumë më e lehtë të pajtohem për formatën dhe për mënyrën e përfaqësimit tonë. E rëndësishme është që mos t'i ikim përgjegjësisë asnjëri, sepse këtë herë nuk po flasim për një temë që ka efekte për një mandat e prej të cilave mund të humb apo të përfitojë politikisht një parti apo një tjetër. Sot po flasim për përmbylljen e konfliktit me Serbinë që do të duhej të ketë efekt të përhershëm dhe që do të krijonte një kontekst të ri politik në rajon, që do të mundësonte paqen për të gjithë dhe integrimin e gjithë rajonit në Bashkimin Evropian. Andaj, ju ftoj që me gjithë dallimet që kemi ashtu siç kemi bërë edhe në të kaluarën për shumë çështje të tjera e në të cilat kemi dal fitimtarë ta bëjmë një debat përmbajtjesor dhe ta ndihmojmë arritjen e konsensusit, sepse kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme për vendin tonë dhe për qytetarët tonë. Në këtë drejtim Partia Demokratike e Kosovës do ta jep kontributin e vetë maksimal. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Ne të gjithë e dimë që në botë ekzistojnë presidentë gati sa edhe shtete pak më pak, se ka 100 e kusur presidentë bota, por në botë ka turli presidenti. Prej atyre më diktatorëve e deri te ata më të korruptuarit, unë mendoj që pozita publike nuk e bën karakterin e individit as individin, por është e kundërta unë mendoj që individit ia jep kuptimin edhe natyrën pozitës publike. Domethënë, varet çfarë individit është, varet kush është, varet çka bën. Unë jam kundër kësaj që t'i fetishizojmë pozitën si vlera në vetvete, unë mendoj që ka lloj-lloj individësh edhe ndonjëri prej tyre arrin të bëhet edhe president.

Edhe, kjo i ka ndodh Kosovës, fatkeqësisht edhe nëse shohim veprimet e presidentit tonë e kuptojmë gati pa e analizuar shumë thellë që ky është personi më së paku kredibil për të udhëhequr një proces të tillë. Pse ndodh kjo? Për shkak që, Presidenti Thaçi duke filluar prej mënyrës se si e trajton në përgjithësi kundërshtarin e tij politik, por edhe nëse kalojmë nëpërmjet veprimeve të tij kohëve të fundit qysh ka qenë ai lidhur me kidnapimin e gjashtë personave në mënyrë të paligjshme edhe kthimin e tyre në Turqi, duke i shkelur edhe konventat ndërkombëtare, mënyra qysh e ka hequr shefin e Inteligjencës edhe e ka vendosur një tjetër edhe mënyra qysh është vetë shpall, është vetë mandatuar pa biseduar me kurrkënd edhe pa kërkuar tash një konsensus që po kërkohet tash, por mua më kujtohet kur ka shkuar ai para 2 muajve edhe ka thënë që ai është i mandatuar për ta kryer këtë punë, nuk donte të fliste me kurrkënd, mendonte që opozita ka me i shkuar e gatshme kur e pa që mbeti vetëm tek tash ia ka nis këto thirrjet e tij për konsensus edhe për të krijuar një grup të unitetit.

Dialogu u deritashëm me Serbinë ka pas të meta të mëdha, unë mendoj që është udhëheq prej një pabarazia në tavolinë të bisedimeve, prej mos aplikimit të parimit të reciprocitetit nga ana e Kosovës, kemi pas zgjidhje asimetrike për problemet e ndryshme, për shembull Kosovës ju ka vendos fusnota, Kosova ia ka vendos fusnotën vetvetes, kurse Serbia nuk ka fusnotë. Pra, në njëfarë mënyre delegacioni i Kosovës ka gabuar në shumë pika dhe kjo sidomos i përket Qeverisë Thaçi, “Thaçi 2” ka pas qenë njëfarë lloj qeverie, pra e kam fjalën sidomos prej vitit 2011 deri në vitin 2014, por edhe qeveritë tjera e kanë vazhduar këtë farë lloj procesi me gabimet e njëjta. Për shembull, njëri prej gabimeve më trashanike i cili është vështirë me u përmirësua, por nuk jemi krejt të pashpresë është që marrëveshja e parë e parimeve me Serbinë na e ka sjell Zajednicën në Kosovë. Pra, atëherë procesi u patë konceptuar si njëfarë lloj zhvillimi me shumë etapa, me shumë faza, pra me shumë marrëveshje, marrëveshja e parë e dytë, e tretë e kështu me radhë, kurse marrëveshja e parë na e ka sjellë atë që është produkti më i dëmshëm i negociatave me Serbinë, që është krijimi i një Asociacioni të Komunave me shumicë serbe në Kosovë. Tash, shtrohet pyetja cila qenka marrëveshja e dytë? Nëse kjo që na e ka sjellë kjo e para qenka Asociacioni i Komunave, çka paska me na pru marrëveshja e dytë, të mos flasim pastaj për të tretën dhe të katërtën.

Edhe e keni parë vetë reagimin e institucioneve edhe të qeverisë po e papërgjegjshme ka qenë kur Gjykata jonë Kushtetuese e vërtetoi që në 23 prej pikave të kësaj marrëveshjeve ka pas shkelje të Kushtetutës. Reagimi ka qenë që nuk ka ndodh asgjë, pra kanë ndodh shkelje të Kushtetutës, por këto nuk janë asgjë dhe tash do ta bëjmë një Asociacion pa shkelje. Kjo me logjikën juridike a e dinë qysh i bie? Sikur me thënë hajni e ka vjedh bankën, po nëse hajni i kthen paratë është i lirë, nuk ka kurrfarë shkelje. Kjo i bie pra nëse vijmë te gjendja e mëparshme nuk ka vepër penale, nuk është shkelje, pra hajni lirohet. Logjika juridike nuk e ka kështu, logjika juridike thotë që vepra nuk anulohet nëse hajni i kthen paratë, hajni ka vjedh, ka bërë vepër penale duhet të dënohet, edhe pse policia e zë dhe ia merr paratë hajnit. Kështu është njëjtë edhe me shkeljen e Kushtetutës, nuk ka me e shkel Kushtetutën edhe me thënë “ e, na falni e kemi shkel Kushtetutën, por nuk do ta shkelim më”. Kjo është absurde, kjo veç në Kosovë ka ndodh, me u shkel 23 vende Kushtetutën edhe me thënë “a, qytetarë të nderuar, na falni tash do ta bëjmë një asociacion pa shkelje”.

Domethënë, kjo nuk ndodh kurrkund në botë edhe prej vitit 2004 neve na ka ndodh në përgjithësi duke filluar prej decentralizimit etnik që ka qenë njëfarë zhvillimi embrional i Asociacionit të Komunave me shumicë serbe, kjo kritika e Vetëvendosjes ka dalë e saktë. Ne kur e kemi refuzuar në 2004 decentralizimin e kemi refuzuar me argumentin që kjo një ditë mund të bëhet autonomi territoriale serbe. Pra, këta kanë për të krijuar komunat edhe këta një ditë kanë për të kërkuar me i bashkua komunat edhe kanë për tu lidhur me Serbinë dhe kanë për të kërkuar që të krijojnë njëfarë autonomie territoriale, bash qysh po bisedohet tash. Këtë Vetëvendosja e ka paraparë para 13 vjetëve edhe kemi shumë protesta, shumë aksione, shumë aktivitete për ta ndaluar këtë proces. Shtrohet pyetja, tash në këtë dialogun që jemi ne, për çka është duke folur

Kosova? A është duke folur për të drejtat e popullit serbë në Kosovë, apo është duke folur për të drejtat që po donë shteti i Serbisë në Kosovë? Ky është një dallim esencial.

Unë mendoj që Qeveria e Kosovës fatkeqësisht ka pranuar të flasë për të drejtat e Serbisë në Kosovë, se nëse i marrim të drejtat e popullatës serbe në Kosovë ato mos harroni nuk i ka kurrkush në Evropë. Gjermani një pakicë në Evropë e cila i ka të drejtat e pakicës serbe në Kosovë. Ku i ka komunat e reja të krijuara me plan të Ahtisarit të garantuara, 45 zona ... territoriale, kuota të diskriminimit pozitiv, në çdo institucion publik prej postës e deri në FSK, e në Polici të Kosovës nëpër të gjitha instancat, e në Qeveri i ka postet e rezervuara, zëvendëskryeministrin, ministritë që i ka hazër, e në Parlament të Kosovës 10 ulëse të rezervuara, më falni ne për çka po flasim këtu.

A po flasim për të drejtat e njerëzve? A po flasim për ambiciet e Vuçiqit? Nëse po flasim për të drejtat e njerëzve, të drejtat e njerëzve ekzistojnë këtu në Kosovë edhe nuk i ka asnjë vend në Evropë, a nëse po flisni për ambiciet e Serbisë edhe të Vuçiqit unë jam për t'i refuzuar ato, edhe për mos me u marrë fare me to. Pra, unë mendoj që nëse një rezolutë e çfarëdoshme e Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk i përmban pesë pika që për mua janë esenciale, atëherë nuk është kurrfarë rezolute.

1. Të ndalet ky lloj i formatit të dialogut me Serbinë. Do të ndalet ky dialog.
2. Askush nuk ka të drejtë të negociojë për çështjet e brendshme të Kosovës,
3. Duhet të ketë reciprocitet të plotë të të drejtave të Shqiptarëve në Serbi edhe të serbëve në Kosovë,
4. Reciprocitet i plotë politik, ekonomik dhe tregtar me Serbinë,
5. Padi për Serbinë, për gjenocidin që e ka bërë në Kosovë,
6. Hashim Thaçi nuk është personalitet kredibil për t'i udhëhequr negociatat me Serbinë.

Nëse këto pesë pika nuk janë pjesë e një rezolute çfarëdo qoftë ajo unë mendoj që nuk e keni me i ndihmua Kosovës po i ndihmojmë pushtetit.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Adem Mikullovc, më kanë lutur se s'është mirë.

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit!

Kërkoj falje fytin e kam pak të sëmurë, po desha vetëm të tregoj se të hënën isha në një tryezë të rrumbullakët në Mitrovicë, ku kryetari kishte organizuar bisedë me intelektual, parti të ndryshme të Kosovës, të gjitha përfaqësuesit e partive dhe nga diaspora. Po ajo që është kryesore të gjithë njëzëri shprehën frikën dhe njëfarë distance nga veprimet e kryetarit Hashim Thaçi dhe të gjithë m'u drejtuan mua duke më thënë "pse Kuvendi nuk po e ndalon?". Ne jemi Republikë parlamentare, nuk jemi republikë presidenciale. Madje Hashim Thaçi nuk ka të drejtë të marrë kurrfarë ingerencash e të flasë në emër të Kosovës.

Këtë desha të ju porosis, të ju shpalos këtë shqetësim të qytetarëve të Mitrovicës dhe, si duket gjithandej Kosovës ka shqetësime shumë të mëdha, zakonisht edhe përgjegjësi për fjalinë e famshme se ‘duhet të marrim vendime të dhimbshme’.

Çka kupton zoti president me ato vendime të dhimbshme, cilat janë ato vendime dhe pse ai nuk vjen këtu në Kuvend? Të mos harrojmë që vetëm Kuvendi ka kompetenca të bëjë marrëveshje të tilla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Dukagjin Gorani e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të PSD-së.

DUKAGJIN GORANI: Deputetë të nderuar,

Me sa mbaj mend, herën e fundit që u përmend fraza “dialogu nuk ka alternativë”, u nis një luftë në Ballkan. Horinë e saj e dinë të gjithë, edhe pse, si zakonisht, me mospajtime të mëdha rreth asaj se kush ia nisi dhe kush e fitoi.

Në këto kohë të sotme nuk mbaj mend të ketë filluar ndonjë konflikt në botë pa një proces të gjatë, të mundimshëm dhe të pasuksesshëm të negociatave e të dialogut. Para çdo konflikti prej ish-Jugosllavisë e deri te tragjedia e Sirisë rregullisht pati përpjekje për bisedime e për marrëveshje.

Fatkeqësitë e tyre na dëftojnë se është pikërisht mënyra se si përkufizohet një dialog ajo që e pamundëson ose që e shkakton një konflikt të ri. Të flasësh dhe të vendosësh në emër të një populli është nder i madh edhe punë shumë e rrezikshme. Historia dëshmon se janë dy lloje të njerëzve që e marrin guximin ta bëjnë atë: ata që ndjejnë përgjegjësi të madhe dhe ata që s’kanë fije ndërgjegje.

Sot kemi punë me llojin e dytë.

Shtatë vjet më herët filloi ajo që sot ne e njohim si ‘bisedimet e Brukselit’. Formalisht ato synuan normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë. Realisht, qëllim e patën që shefat e partive që aty hiqeshin si përfaqësues popullorë ta përdorin një proces ndërkombëtar për ta mbajtur veten në pushtet.

Sot, shtatë vjet më vonë, jetojmë në gjendje jonormale për shkak të një procesi të normalizimit. Në Kosovë sot hendeku ndëretnik kurrë s’ka qenë më i madh, kurse raportet me Serbinë janë të njëjta që kanë qenë në muajt e parë të pasluftës. Edhe pushteti mbeti i njëjtë në të dy anët. Shkeljet kushtetuese dhe përkrahjet ndërkombëtare ua mundësuan mbijetesën në emër të mashtrimit të quajtur normalizim.

Për këtë pushtet pjesëmarrja në bisedime gjithmonë ka nënkuptuar vetëm udhëtime, argëtim edhe protagonizëm, asnjëherë përgjegjësi dhe ballafaqim. Këtë punë rregullisht ia lëshonte mbështetësit të vet kryesor, bashkësisë ndërkombëtare. Atë e mashtronte në emër të popullit, e këtu mashtronte në emër të saj. Ç' është e vërteta, me sa mbaj mend, kështu ishte rendi i gjerave jo veç këto shtatë vjet, por këto 20 vjetët e fundit.

U ndërruan delegacionet popullore, ekipet negociatore, grupet e unitetit, po jo dhe zanati i mashtrimit. Me rëndësi ishte që diku në bashkësinë ndërkombëtare të hartoheshin marrëveshjet dhe të përzgjidhej fytyra që do t'i nënshkruante ato, ajo që mbetej mandej ishte veç grindja e madhe se kush do ta shoqëronte atë. Zakonisht krijimi i ekipit negociator ishte edhe fundi i angazhimit negociator.

Pse, mos rastësisht ne e hartuam Marrëveshjen e Rambujesë, apo mos rastësisht ndikuan në atë të Kumanovës, apo mos rastësisht vendosëm për këtë të fundit që me përkëdhelje e quajmë Pakoja e Ahtisarit, tek e fundit, a mos ishim ne ata që vendosëm ku, kur dhe si do të shpallet pavarësia!

Megjithatë, duket se këto ditë as bashkësia ndërkombëtare nuk është e interesuar që të vazhdojë të jetë burim i legjitimitet. Të jetë hartuese e marrëveshjeve dhe rrjedhimisht, edhe përgjegjëse për pasojat e moszbatimit të tyre. Tash e sa kohë ajo përdor terminologji tjetër për rolin e vet, ajo është këshilluese, është facilituese, lehtësuese, ndërmjetësuese, porse jo më edhe legjitimuese.

Meqenëse në të kundërtën, nëse do ta vazhdonte rolin e vet që e mbajti gati dy dekada, do ta rrezikonte edhe kuptimin e rendit demokratik në Kosovë, e të cilin e ndërtoi vetë, do t'i rrezikonte liritë politike dhe qeverisjen parlamentare.

Sot ajo insiston në zgjidhje që zbatohet nga të dy palët, e jo arsytetime, vonesa e fajësime. Thënë shkurt, në zhargonin e udhëheqjes sonë politike, këtë film më s'ta keni parë, dhe ky është një problem i madh për pushtetin aktual.

Meqë për herë të parë në histori ky ballafaqohet me negociata të vërteta. Aso ku me pjesëmarrje e merr edhe përgjegjësinë, edhe fajin dhe ku për gabimet që i bën e pëson një shoqëri e tërë.

Andaj, sot në mungesë të inxhinieringut negociator ndërkombëtar, ky proces varet kryekëput nga kjo sallë gjysmë e zbrazët dhe nga ju, kolegë të nderuar!

Nëse nuk jeni të bindur në këtë, pyeteni njeriun që po pretendon të jetë kryenegociator, ai e di. Asnjë marrëveshje, asnjë plan dhe asnjë orar nuk mund të vendoset pa mandatimin dhe autorizimin e këtij Kuvendi. E meqë ky dialog duhet të kurorëzohet me një marrëveshje ndërkombëtare dhe ndërsjellshëm të pranuar, ai nuk mund të zhvillohet e as të legjitimohet pa shumicën e kualifikuar të 2/3 të deputetëve. Pa këtë normë kushtetuese nuk mund të vendoset as

çështja për të cilën do të negociohet, as mënyra se si do të negociohet e, qe besa, as personi dhe ekipi që do të negociojë.

Deputetë të nderuar,

Pa tjetër Partia Socialdemokrate e përkrah një proces të dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë. Mirëpo, para së gjithash dhe mbi gjitha e përkrah rendin demokratik parlamentar. Për këtë arsye duhet të insistojmë që Kuvendi i Kosovës të jetë forumi i vetëm ku do të përcaktohen parimet dhe mënyra e funksionimit të ekipit tonë negociator. Mbi të gjitha insistojmë që këtu nëpërmjet votës së kualifikuar të 2/3 të përkufizohet çështja dhe çështjet për të cilat do të negociohet dhe veçanërisht ato për të cilat nuk do të negociohet.

Të mundësohet legjitimiteti përfaqësues në këtë proces, të përcaktohet qasja dhe mënyra e negocimit dhe krejt të fund, të vendoset mbikëqyrja e vazhdueshme e mbarë dialogut. Vetëm një shumicë e tillë në këtë sallë do ta përfaqësonte drejtësisht shumicën që ndodhet jashtë saj. Anashkalimi i këtij Kuvendi do ta pamundësojë zbatimin e çfarëdo marrëveshjeje. Para dialogut në Bruksel, duhet të zhvillohet dialog këtu, para marrëveshjes me Vuçiqin, duhet të merremi vesh mes veti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga AAK-ja, kush e ka fjalën? Kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra,

Dialogu është një temë e njohur për opinionin e Kosovës, për ne si deputetë, për të gjitha ato që kanë qenë angazhime, të cilat institucionet e Kosovës i kanë marrë përsipër që të jenë në bisedime me Serbinë.

Por ky dialog i tashëm, i cili është duke u afruar, duhet të jetë normalisht vetëm me një pikë, i përqendruar në njohjen reciproke të dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë. Asnjë temë tjetër nuk duhet pranuar, për shkak se kohëve të fundit është duke u përfolur edhe shumëçka lidhur me Kosovën, tema të brendshme, territori, pastaj edhe iniciativa të cilat mund ta dëmtojnë procesin, normalisht që ne jemi të interesuar që të ketë një dialog të mirëfilltë, duke i dhënë rëndësi të veçantë angazhimit të Parlamentit drejtpërdrejt në këtë dialog, duke e monitoruar dhe duke kërkuar llogaridhënie.

Roli i Parlamentit do të jetë i domosdoshëm, sepse është institucioni më i lartë i vendit, edhe në fund të fundit, të gjitha institucionet kanë përgjegjësi para Parlamentit të Republikës së Kosovës.

Duke e përcjellë deri tani sjelljen e shtetit serb dhe përfaqësuesve të këtij shteti, ne duhet t'i lëmë të gjitha interesat e ngushta politike, përkundrazi pavarësisht prej pozicioneve politike duhet të përqendrohemi në cilësinë e dialogut, në platformën e cila mund të votohet në këtë Parlament dhe po ashtu në ekipin që do të jetë pjesë e dialogut.

Sa herë kemi qenë të bashkuar rreth temave të rëndësishme kombëtare për vendin, ne kemi dalë më të suksesshëm. Sa herë kemi vepruar ndryshe, normalisht që kemi paguar çmim.

Dhe këtë e tregojnë edhe bisedimet e mëhershme që kanë ndodhur me marrëveshje që e kanë dëmtuar interesin e Kosovës, me marrëveshje, të cilat nuk janë zbatuar dhe po ashtu, edhe me një neglizhencë edhe nga Bashkimi Evropian, si iniciues i dialogut mes Kosovës e Serbisë.

Absolutisht duhet të jemi të angazhuar dhe të bashkuar rreth pozicionit, jo të politikës tonë të ngushtë, po pozicionit të Kosovës. Prandaj, ne si Aleancë për Ardhmërinë e Kosovës do të përkrahim rezolutën e cila unifikon qëndrimin tonë dhe po ashtu e obligon ekipin, i cili mund të jetë në bisedime që Kosova të përfitojë nga ky dialog, duke e rritur angazhimin dhe stabilizimin e institucioneve të Kosovës, duke krijuar mundësi që Kosova vërtet të jetë pastaj e aftë për integrimet e reja që na presin.

Unë i dëgjova edhe pikat, të cilat u lexuan nga rezoluta e propozuar nga Partia Socialdemokrate, po ashtu ishin edhe disa pika, të cilat u përmendën edhe nga Lëvizja Vetëvendosje, por duhet të harmonizohen të gjitha pikat, të cilat e bëjnë Parlamentin një institucion që vërtet kërkon llogari, e që normalisht edhe dialogu mund të ketë sukses.

Po e përsëris edhe një herë, e vetmja temë që mund të jetë në dialog është normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës e Serbisë, duke e njohur njëri-tjetrin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Nismës, zoti Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, Kosova duhet të hyjë si shtet i pavarur dhe sovran, i njohur si i tillë nga mbi 114 shtete dhe i legjitimuar nëpërmjet vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të datës 22 korrik 2010, që vë theksin se akti i miratimit të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 nuk e ka shkelur as të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare, as Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit, as Kornizën Kushtetuese të Kosovës dhe asnjë normë të aplikueshme të së drejtës ndërkombëtare.

Në përputhje të plotë me planin gjithëpërfshirës të Marti Ahtisarit, shteti i Kosovës ka bërë harmonizimin e ligjeve të saja me standarde më të larta ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut, me standarde të përcaktuara me Konventën Kornizë të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe në Kartën Evropiane për gjuhët rajonale ose të pakicave.

Madje, për disa çështje ka tejkaluar ato, duke krijuar standarde shumë më të avancuara se standardet e lartpërmendura.

Gjatë dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, Kosova duhet të ketë për bazë këto standarde ndërkombëtare vendore, të përfshira në Kushtetutën e saj. Kosova duhet të angazhohet me dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, sepse dialogu është mjet i patjetërsueshëm për krijimin dhe ruajtjen e stabilitetit dhe paqes në këtë pjesë të Evropës. Për të shmangur vështirësitë që kanë karakterizuar procesin e deritashëm të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, pjesëmarrja aktive e SHBA-së në fazën finale të përmbylljes së këtij dialogu është i domosdoshëm. Vetëm një proces i mbikëqyrur dhe i mbështetur nga SHBA dhe BE është garanci se dialogu do të përmbyllet me normalizimin e plotë të marrëdhënieve me Serbinë.

Që në takimin e parë të delegacioneve në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore, delegacioni i Kosovës duhet të kërkojë që Serbia së pari të njohë vendimin e GJND-së, të cilën e ka kërkuar vetë dhe të përmbushë obligimet që i dalin si shtet nga e drejta ndërkombëtare.

Njohja e vendimit të GJND-së nga Serbia do të shënonte në të njëjtën kohë njohjen nga ky shtet të traktatit ndërkombëtarë për paqe në Kosovë. Delegacioni i Kosovës duhet të kërkojë nga Bashkimi Evropian, si ndërmjetësues i këtij dialogu, që të ushtrojë ndikimin e plotë ndaj pesë shteteve të BE-së, të cilat ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës që të sensibilizohen me faktin se mosnjohja e pavarësisë së Kosovës inkurajon forcat reaksionare dhe luftënxitëse në Serbi për të mbajtur nën kërcënim të vazhdueshëm paqen dhe sigurinë në këtë pjesë të Evropës.

Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve të pavarura duhet të hapë perspektivën e re të integritimeve të dy vendeve në institucionet euro-atlantike.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian, si ndërmjetësues i këtij dialogu, duhet të mbesin garantues të vetëm se asnjëra palë nuk do të bllokojë palën tjetër në rrugëtimin drejt këtyre integritimeve.

Në përputhje me konkluzionet e Kuvendit të dytë të Nismës Socialdemokrate të mbajtur në qershor të këtij viti lidhur me fazën finale të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, Nisma insiston në domosdoshmërinë e konsensusit nacional. Së pari, në hartimin e një platforme të përbashkët

dhe menjëherë pas saj, edhe krijimin e ekipit gjithëpërfshirës nga forcat politike parlamentare për fillimin e kësaj faze finale të dialogut.

Vetëm në këtë mënyrë do të shmangen përvojat e deritashme të dialogut që kanë pasur pasoja negative në konsolidimin e shtetit të Kosovës. Nisma këmbëngul që asnjë marrëveshje të mos nënshkruhet nga ekipi negociator para se për përmbajtjen e saj të jetë debatuar në Kuvendin e Kosovës.

Harmonizimi paraprak i qëndrimeve tona do të evitonte konfliktet që kanë bllokuar vendin për vite të tëra. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Gospodin Slavko Simić ima reč.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedavajući!

Poštovani poslanici,

Poštovani građani,

Stav Srpske liste da se dijalog u Briselu mora nastaviti, jer je to jedino rešenje i jedini put za trajni mir.

Odgovornost političara ovde u Prištini treba da bude da građanima objasne potrebu kako bi se došlo do rešenja, a do rešenja može doći jedino putem kompromisa, i nikako drugačije.

I želeo bi da kažem da treba da znate da sa Srbijom neće biti kompromis ukoliko Priština ne prizna postojanje Srbije. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! LDK-ja nuk keni bërë listë, unë nuk di qysh, veç t'ju thërras me radhë qysh jeni paraqitur. Zoti Ilir Deda e ka fjalën. Meqenëse ka shumë diskutues, është mirë që grupet parlamentare ta kenë një orientim për renditje.

ILIR DEDA: Kolegë të dashur,

Të nderuar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Nuk po më duket që e ka ky Kuvend ose kjo Qeveri shumë seriozisht këtë diskutim për dialog, hiç nuk e kanë seriozisht. As nuk e kanë seriozisht që në vendet e tjera vizatohen kufijtë e ardhshëm të Kosovës, as që eksperimentohet ndoshta me zgjidhje të reja për këtë vendin tonë, kryesore, pasdite të mos jesh këtu! Turp qysh asnjë anëtar i Qeverisë së Kosovës nuk është! Asnjë hiç nuk është këtu, kryeministri, zëvendëskryeministrat, një pjesë e kryetarëve të partive politike.

Natyrisht që sot tjetërkush në Shtëpi të Bardhë diskuton për kufi në Ibër. Natyrisht që tjetërkush në emër të Kosovës, pa autorizim, merr mandat dhe e vetmandaton veten për kufirin në lumin Ibër. Natyrisht që ne sot ende jemi në një situatë ku një njeri dhe vetëm një njeri që 20 vjet mundohet ta personalizojë çdo proces të mundshëm politik në Republikën e Kosovës, po ndryshimi i vetëm sot është që forca e tij nuk është e njëjtë.

Dhe, sot, më shumë se kurrë ky Kuvend duhet ta sjellë një rezolutë, e cila i ka dy pika. E para, integriteti territorial i shtetit tonë është i paprekshëm, e dyta, vetëm Kuvendi i Republikës së Kosovës autorizon këdo me 2/3 për dialogun me Serbinë. Nuk ka njeri të autorizuar, Kuvendi nuk e ka marrë vendimin për autorizim të askujt tjetër, përpos kryeministri si pozicion.

Sot më shumë se kurrë duhet t'i themi atij njeriu, i cili mundohet ta blejë një 10-vjetësh të ardhshëm të karrierës së tij politike me këtë proces, kësaj here ti nuk do të vendosësh për Kosovën. Kësaj here janë 120 vetë, të cilët janë më të fortë se një, kësaj here partitë politike pa të mund të merren vesh për konsensusin tonë, më se të nevojshëm dhe ne do të vendosim kush është ai apo ajo që mund t'i fitojë 2/3 e votave të këtij Kuvendi dhe të shkojë me parime të panegociueshme, parime udhëheqëse dhe synime të qarta në dialog me Serbinë.

E synime të qarta, zonja e zotërinj, nuk janë çka kemi dëgjuar deri tash, çka do le të ndodhë, po citoj: "Çka do që ndodh brenda Kosovës, nuk është problematike", është problematike. A e dini për shumë njerëz jashtë Kosovës Ballkani është karrierë politike. Për neve është e ardhmja e fëmijëve tanë dhe nuk mundemi tash ne të bëjmë gara me miqtë tanë prej jashtë kush është më racional, e qysh kush po e kupton, më shumë apo më pak, një proces negociator.

Neve më shumë se kurrë na duhet dinjitet serioz shtetëror e institucional, edhe më pak se kurrë na duhet verbëri militante partiake.

Të bashkuar, le të dështojë ai proces, nëse ne nuk e thyejmë kurrizin tonë politik, faktikisht më mirë është asnjë marrëveshje me Serbinë, se sa marrëveshje e cila e shkatërron Kosovën, e shkatërrimi i Kosovës ndodh me kufirin në lumin Ibër apo marrëveshje, e cila na bën shtet absolutisht jofunksional në dekadat e ardhshme. Ne do të jetojmë me marrëveshjen me Serbinë.

Edhe të mos harrojmë diçka, ka njerëz edhe mes nesh këtu në politikë që bëjnë gara, a e di, duhet kuptuar që kompromisi është pjesë e çdo negociate. Më falni, kurrë nuk ka qenë më lehtë të ballafaqohet një tjetër grup politik i mandatar prej Kuvendit të Kosovës me Aleksandër Vuçiqin dhe Ivica Daçiqin.

Me njerëz të cilët kanë qenë në Qeveri kur është kryer pastrimi më i madh etnik në Kosovë, kur janë përzënë një milion njerëz prej shtëpive të veta, nuk është kompromis, nuk bëhet kompromis i dhimbshëm me këta. Nuk ka asgjë të dhimbshme që është para Kosovës.

Çfarë procesi do të jetë ai, varet prej këtij Kuvendi, prej 120 deputetëve. A do ta bëjmë konsensusin ne, a do të vendosim ne kush është udhëheqës i delegacionit të Republikës së Kosovës, apo do të lejojmë dikë të tentojë të fusë përçarje politike, e përçarja është ‘modus operandi’ i kryetarit të shtetit tonë, i cili me shantazh në të ’99-tën e bën, për shkak të shantazhit të tij, udhëheqës të delegacionit në Rambuje, me shantazh u bë kryeministër i QPK-së, me shantazh hyri në proces të Ahtisarit, u vodhën votat në vitin 2010 që ai të mbesë në Qeveri për dialog me Serbinë, gjashtë muaj ditë në vitin 2014 nuk mund të bënim qeveri se ai donte të mbeste në Qeveri për dialog me Serbinë, me zjarr jashtë këtij Kuvendi u zgjedh president! A e dini çka, është momenti i fundit që ne sot duhet t’i themi: nuk ka më shantazh prej një njeriu, asnjë njeri më nuk mund ta mbajë të shantazhuar Republikën e Kosovës dhe të ardhmen e shtetit tonë.

Nëse ai ka harruar që ka luftuar për pavarësinë e Kosovës, e ka harruar duke e këqyrur shumë lehtë këtë territor e duke i mashtruar edhe ata njerëz të Luginës sot që i pati aty! A e dini çka, ne shqyr Zotit jemi mësuar me lojëra të tilla dhe nuk do t’i pranojmë më.

Edhe qytetarëve të Kosovës, kur del kreu i shtetit edhe thotë se ne do të fitojmë në proces me Serbinë, po do të jetë kompromis i dhimbshëm, tash po ju tregoj. Asgjë ai nuk do të mbërrijë me këtë proces, hiç, pa këtë opozitë, nuk ka dialog! Opozita, bashkë me juve, do të vendosë kush do të udhëheqë dhe nuk ka konsensus nëse na vini këtu dhe na thoni po bëhemi bashkë, po Hashim Thaçi është i panegociueshëm, jo! I pari i negociueshmi që bjen konsensusin mes nesh është ai, e mandej shkojmë bashkë atje dhe kthehem me Kosovë funksionale, të njohur prej Serbisë, anëtar të Kombeve të Bashkuara. Përndryshe, për neve, duhet t’ua themi shteteve perëndimore nuk ka kuptim normalizimi, në qoftë se nuk përfundohen të gjitha çështjet e hapura me Republikën e Serbisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zëvendësministër,

Kryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të jesh në pozitë është përgjegjësi për t’ju dhënë zgjidhje proceseve politike dhe për të hapur perspektivën ekonomike për jetë më të mirë për të gjithë qytetarët dhe është mirë që të kërkohet transparencë e llogaridhënie në çdo kohë për të gjitha institucionet.

Por edhe opozita duhet t’i rishikojë veprimet e veta, sepse me veprimet e bëra në të kaluarën dhe me këto që po bën tani, ishin dhe janë pengues të proceseve për Kosovën. Kështu që për çështjet me interes për shtetësinë e Kosovës janë përgjegjës aq sa është përgjegjës edhe pozita.

Maturia jonë këtu në këtë Kuvendë pozitive e opozitive për t'ju shmangur tensioneve të reja në rrethana jo shumë të favorshme për vendin tonë, ku Serbia po bën çmos për të tensionuar situatën në Kosovë, e për të përfituar diçka duke shfrytëzuar shthurjen tonë, mençuria dhe serioziteti ynë këtu në vendimmarrje është imperativ i kohës.

Ne duhet të tregojmë unitetin tonë në mbrojtjen e vlerave tona, në mbrojtjen e fuqizimin e shtetit tonë, ne duhet të tregojmë unitetin tonë për të ndërtuar të ardhmen tonë.

Ata që janë jashtë mureve të kësaj ndërtese, ata njerëzit e thjeshtë të këtij vendi, e kërkojnë këtë prej neve dhe ne duhet t'i përgjigjemi kërkesës së tyre. Është shumë vendimtare vendosmëria, durimi dhe diplomacia që do të përdorim në mënyrë që të ruajmë interesin nacional e shtetëror, për të cilin është derdhur shumë gjak, gjeneratë pas gjenerate, e sidomos gjatë luftës së vitit 1998-1999.

Të nderuar deputetë,

Dialogu në Bruksel ka pasur shumë sfida, por edhe rezultate. Të arriturat në dialogun e Brukselit mund të konsiderohen substanciale, duke marrë parasysh rëndësinë e tyre për forcimin e shtetit të Kosovës si në planin e brendshëm, ashtu edhe atë të jashtëm. Republika e Kosovës është përcaktuar për rrugëtimin e saj drejt Bashkimit Evropian.

Rregullativa e Bashkimit Evropian e ka paraparë që shtetet që aspirojnë integrimin në BE duhet të rregullojnë marrëdhëniet e tyre fqinjësore, si ato të lirisë së lëvizjes, tregtisë me mallra, marrëdhëniet diplomatike dhe bashkëpunimin ekonomik, atëherë ka qenë dhe është e pashmangshme dialogu, i cili ishte dhe është i vështirë, por është e vetmja rrugë për të ecur përpara. Marrëveshjet e arritura mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë, në ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe me përkrahjen e fuqishme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës kanë kontribuar dukshëm në realizimin e objektivave strategjike të Republikës së Kosovës. Dialogu i Brukselit ka kontribuar për t'u shtrirë dhe konsoliduar më tej sovranitetin shtetëror në pjesën veriore të vendit nëpërmjet shuarjes së strukturave paralele serbe dhe për integrimin e komunitetit serb të asaj pjese në sistemin shtetëror të Republikës së Kosovës. Ne si Kosovë nuk do të donim të përballemi me probleme të tilla pas luftës, nuk do të donim ndërhyrjen e Serbisë në pjesën veriore të Kosovës, duke penguar integrimin e qytetarëve të Kosovës atje, gjë e cila është toleruar nga administrata e atëhershme e UNMIK-ut, por të ndodhur para këtij fakti jemi detyruar të gjejmë zgjidhje, e zgjidhja e vetme ka qenë dialogu.

Në këtë shtatëvjeçar të bisedimeve ka pasur sfida të shumta, por kanë ndodhur edhe ndryshime pozitive, ku sistemi shtetëror i Kosovës është shtrirë në veri të vendit, është vendosur kufiri ndërshtetëror me Serbinë, i cili ka qenë i cenuar që nga paslufta në pjesën veriore të kufirit. Kjo është arritur me marrëveshjen e IBM-së, e cila ka mundësuar që autoritetet shtetërore të Kosovës të vendosen në 2 pikë kalimet kufitare në veri, të cilat madje edhe ishin sulmuar dhe djegur në

kohën kur Kosova shpalli pavarësinë e saj në vitin 2008. Kosova ka arritur të shtrijë sovranitetin e saj në veri të vendit në fushën e sigurisë, ku Policia e Kosovës vepron që nga viti 2014, në fushën e doganave në vitin 2012. Kosova ka vendosur të gjitha ministritë dhe agjencitë e veta shtetërore që kanë veprimtari lokale dhe në këtë pjesë të vendit. Ka pasur lëvizje pozitive edhe në shuarjen e strukturave ilegale në premisa paramilitare.

Në planin ndërkombëtar, dialogu i Brukselit ka kontribuar për forcimin e pozicionit ndërkombëtar dhe avancimin e agjendës euroatlantike të Republikës së Kosovës, ka mundësuar nënshkrimin e Marrëveshjes për Asociim-Stabilizim me Bashkimin Evropian dhe realizoi dialogun e parë zyrtar me Bashkimin Evropian. Pesë vendet evropiane që ende nuk e kanë njohur Kosovën kanë mbështetur me votë hyrjen e Kosovës në marrëdhënie kontraktuale me Bashkimin Evropian nëpërmjet Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, e cila ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2016 që faktikisht i ka hapur mundësi zyrtare Kosovës për t'u integruar në Bashkimin Evropian.

Ne presim që gjatë këtij viti të kemi edhe liberalizimin e vizave, pasi kemi përmbushur të gjitha kriteret për liberalizim. Procesi i dialogut ka qenë sfidues si pasojë e qëndrimeve obstruksioniste të palës tjetër, dualizmi i Serbisë në zbatimin e marrëveshjeve, ku në njërin anë i zbaton marrëveshjet, e në anën tjetër vazhdon të mbështesë strukturat e saj paralele në Kosovë është shqetësuese. Ne duhet të koordinojmë aktivitetet tona që të bëhet presion nga ndërmjetësi i këtyre negociatave, Bashkimi Evropian, që të zbatohen marrëveshjet, sidomos marrëveshja për energjinë, të përdoret logoja dhe vula e shtetit të Kosovës e të mos manipulohet me vulat paralele, ndërtimi i pikave të përbashkëta të kalimit të kufirit dhe të ndërpritet manipulimi i shtetit serb me qytetarët e pjesës së veriut.

Të nderuar deputetë,

Të gjitha institucionet shtetërore, Parlamenti, Qeveria dhe Presidenti, e kanë bërë të qartë se dialogu mes Kosovës dhe Serbisë duhet të përfundojë me njohjen e ndërsjellët mes dy shteteve, sepse çelësi për paqe dhe fqinjësi të mirë dhe normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy shteteve është njohja reciproke mes dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, pa hyrë në lojëra të rrezikshme që do të tronditin jo vetëm të dy vendet tona, por tërë Ballkanin. Në këtë kohë kur Bashkimi Evropian ka gatishmërinë për t'i dhënë fund këtij procesi, ku Serbia po bën përpëlitjet e fundit në destruktivitetin e saj të paparaparë në raport me Kosovën, në Kosovë nuk gjendet konsensusi mes liderëve politikë për t'i dhënë mesazhin e fundit Serbisë se jemi bashkë atëherë kur kërkojnë interesat e shtetit, se jemi bashkë për t'i treguar se Kosova është shtet i pavarur dhe sovran, se jemi bashkë për të mbrojtur shtetin e Kosovës.

Për një grusht vota, të cilat nuk dihet nëse i marrin a jo, sepse qytetarët po kërkojnë alternativa për një jetë më të mirë, nuk është mirë të tronditen themelet e shtetit tonë të larë me gjak nëpër shekuj. Është momenti t'i japim mesazh botës se ne siç kemi ditur të bëjmë luftën e të krijojmë

aleatë në mbarë botën për të na mbështetur, dimë edhe të bëjmë paqen, dimë edhe të mbrojmë dhe të fuqizojmë shtetin tonë, dimë të krijojmë aleancë me miqtë ndërkombëtarë në interes të Kosovës, shtet sovran dhe të pavarur. Vota nuk sillet rreth nesh, këtë duhet ta kuptojë gjithsecili këtu, asnjë qytetar i Kosovës nuk do të pajtohet se punët që duhet të kryhen sot të mbesin peng i një grup politikanësh të papërgjegjshëm, që s'e kishin guximin e sakrificës në luftë, që s'e kishin guximin e forcën për të tejkaluar sfidat e shpalljes së pavarësisë, që s'e kanë vizionin e qartësinë të fuqizojnë integritetin e shtetit tonë në Bashkimin Evropian. Zërat se nuk duhet sot Presidenti i vendit, zoti Hashim Thaçi, të jetë në bisedime na dalin si zëra kukuvajkash. Qetësinë, guximin, qartësinë, aftësinë e menaxhimit, e komunikimit e deshëm ne dje në kohën e luftës në Rambuje, si rezultat i së cilës NATO u bë aleat i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e si rezultat i kësaj sot gëzojmë lirinë.

Qartësinë, vizionarët e tij e deshën edhe në bisedimet e Vjenës, ku Hashim Thaçi kryesonte një subjekt politik, atëherë në opozitë, e nuk hezitoi për t'iu bashkuar misionit për shtet të pavarur dhe sovran. Aftësinë e tij për bashkëpunim e koordinim e deshëm edhe kur u shpall pavarësia e Kosovës, e sot kur është President i vendit dhe bisedimet zhvillohen në nivel presidentësh, ne po u dashka t'i themi Serbisë, me presidentin tuaj duhet të flasë dikush tjetër dhe nuk po u dashka të flasë Presidenti i shtetit tonë, shtetit të Kosovës. Çfarë mesazhi është ky? A jemi ne shtet? Disa gjëra bëhen në nivele të shtetit, e jo sipas tekeve të një grupi njerëzish kontrovers që nuk dinë çka duan, e s'dinë çka bëjnë.

Të nderuar deputetë,

Bashkë mund të bëjmë shumë në fuqizimin e shtetit tonë. Kosova në këto momente ka nevojë për konsensus nacional për të ndërtuar platformën për përfundimin e bisedimeve me njohjen reciproke të dy shteteve. Ne duhet të ndërtojmë këtë konsensus nacional për hir të interesit të shtetit tonë, për hir të Republikës së Kosovës shtet të pavarur dhe sovran. Ne duhet të kemi konsensus që Kosova të jetë pjesë e OKB-së, e NATO-s dhe pjesë e Bashkimit Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bogujevci e ka fjalën.

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit, kryesues!

Të dashur qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Të premtën e javës që shkoi Qeveria sollti në Kuvend një raport rreth dialogut Kosovë-Serbi. Në këtë raport as edhe një fjalë të vetme nuk e gjeta rreth çështjes së krimeve të luftës të kryera në Kosovë nga Serbia. As edhe një fjalë rreth personave të pagjetur, as edhe një fjalë rreth grave të dhunuara gjatë luftës, sikur të mos kishte ndodhur lufta asnjëherë. Nuk ka dialog me Serbinë pa i kthyer Serbia trupat e personave të pagjetur dhe pa dënimin e kriminelëve të luftës. Unë nuk e kam kuptuar kurrë dhe ende nuk po arrij ta kuptoj si është e mundur, ju që pretendoni që keni

luftuar gjatë luftës për mbrojtjen e popullit, tani e mbani në robëri pa asnjë pikë përgjegjësie, pa ngritur zërin e tyre tani në liri.

Kryetari i Kuvendit në konferencën e së hënës tha se duhet të mendojmë për të ardhmen e të rinjve të vendit. Nuk ka të ardhme në këtë vend pa ballafaqim me të kaluarën, nuk ka dialog as ndërfaqinjësor, as teknik, as politik me Serbinë pa marrë Serbia përgjegjësinë për krimet që ka kryer në Kosovë gjatë luftës së fundit. Sot, Serbia le që nuk i dënon kriminelët e luftës, por i promovon ata në pozita të larta, edhe ata që kanë vuajtur një pjesë të dënimit i liron dhe i akomodon, e kanë lirinë e lëvizjes, të gjitha privilegjet. Serbia këta persona i trajton si heronj. Vetëm nga të dhënat e fundit për të drejtat humanitare, 13 mijë e 377 persona janë të vrarë gjatë luftës së fundit në Kosovë. Nga ky numër 1 mijë e 360 janë fëmijë, 139 nga ky numër janë fëmijë, që janë ende të zhdukur. Këta fëmijë janë të vrarë direkt nga ushtria serbe. Tregomëni qysh doni të ndërtoni të ardhmen për të rinj nëpërmjet këtij dialogu me Serbinë, a doni ta bëni këtë duke shkelur mbi gjakun e të gjithë këtyre të rinjve dhe fëmijëve që janë vrarë gjatë luftës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Blerim Kuçi e ka fjalën.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Normalisht ne të gjithë po pajtohemi se çështja e dialogut, ose më mirë të themi, e epilogut është e rëndësisë të veçantë. Dikush tha se është çështja më e rëndësishme pas pavarësisë së Republikës së Kosovës, po ashtu edhe unë po pajtohem.

Deshëm apo s'deshëm, me njëfarë forme po flasim për bartësit e dialogut, edhe kjo rezolutë ka kuptimin dhe bartësit edhe monitorimin e këtij dialogu, çka është shumë e mirë, një rezolutë e tillë me ndonjë përmirësim të këtij elementi do të ishte shumë e favorshme për sigurinë e këtij procesi kaq të rëndësishëm. Mirëpo, po flasim edhe për udhëheqjen e këtij dialogu. Konkretisht shumë zëra janë dëgjuar edhe për zotin Thaçi si president, edhe mundësia e tij për të udhëhequr dialogun. Unë do ta shtroj ndryshe këtë debat ose këtë element të debatit. Zotit Thaçi iu përmendën disa dobësi, ndoshta edhe i ka, po i përmend edhe unë: çështja e Gjykatës Speciale që është vërtet, mund të jetë njëra prej të metave e tij, të jetë në krye të dialogut. Po ashtu, çështja e lidhjeve në dukje të zotit Thaçi si President me politikën e Erdoganit, edhe ajo për mua është dobësi që të jetë zoti Thaçi në udhëheqje të këtij dialogu. Ose deklaratat rreth ndarjeve rrëshqitazi apo jorrëshqitazi të bëjnë të mendosh që është në anën e të metave të zotit Thaçi të jetë në krye të dialogut.

Mirëpo, asnjëri nuk i përmendi përparësitë e zotit Thaçi për të qenë në krye të këtij dialogu, e para ka të bëjë me Rambujenë. I ri apo jo i ri, megjithatë sukses ka qenë edhe i tij, pa marrë parasysh rrethanat si është vendosur në krye të dialogut në Rambuje. Pastaj kemi pjesëmarrjen në Grupin e Unitetit, zoti Thaçi ka udhëhequr edhe këto proceset e tjera të dialogut me Serbinë, të cilat sot ende nuk kemi ndonjë rezultat të dëmshëm, rezultat konkret të dëmshëm nuk kemi, sa u

përket pozitive ka qenë edhe ministër i Punëve të Jashtme, edhe kryeministër. Sot e kemi President, sot zoti Thaçi është President edhe ka të drejtën edhe me Kushtetutë. Elementi që është më me rëndësi, edhe atëherë për t'i mbuluar edhe dobësitë në qoftë se i ka, janë vendosja e mekanizmave të monitorimit të këtij procesi, qoftë nëpërmjet Kuvendit, qoftë edhe nëpërmjet Qeverisë. Edhe rezoluta e propozuar prej PSD-së i ka disa elemente që bëjnë monitorimin e përcjelljes së këtij procesi, po them të këtij procesi, sepse epilogu final e ka një mekanizëm që është vota jonë. Çdo marrëveshje e tillë do të vijë dhe do të aprovohet, miratohet me 2/3. Pra, çfarëdo marrëveshje, në fund duhet të vijë te ne.

Ne jemi këtu, dhe e votojmë ose nuk e votojmë, prandaj nuk duhet pasur frikë prej procesit final, prej finales së këtij epilogu, po duhet pasur ndoshta një lloj ndjeshmërie në procesin e zhvillimit të këtij procesi të epilogut, me mekanizma që mund t'i krijojmë këtu, mund të rregullojmë dhe këtë frikë ta heqim, sepse duhet monitoruar, edhe për shkak të rëndësisë, se vërtet është shumë i rëndësishëm. Më habiti çështja e LDK-së. LDK dhe zoti Hoti e përmendi që nuk është konsensual dhe të metat e presidentit. LDK-ja ka qenë dashur të mendojë shumë para se të votonte, sepse me votën e LDK-së zoti Thaçi sot është president. A është konsensual? Po, me njëfarë forme, sepse Kushtetuta është e rregulluar, edhe procesi i votimit duhet pasur një konsensus. LDK-ja e ka votuar vetë dhe tash ankohet. Kjo pasi s'janë, ndoshta nuk është edhe momenti, me një lloj mesele që është bërë mes dy fshatrave tregohet, Reçani edhe Bllaca janë dy fshatra të njohura për mesele, e sidomos në llogari të vetes, shpesh edhe bëhen miq mes vete. Ky i Reçanit shkon pasi të bëhen mik shkon në Bllacë dhe duke biseduar, fillojnë ato ngacmimet nëpërmjet meseleve dhe i zoti i shtëpisë ose ai miku i Bllacës i thotë:

“O, mik, po due me të vet diçka, a bën me më kallëzue drejt. Allahile me më kallëzue diçka drejt”. I thotë: “Po nëse di, du me të kallëzue”. Tha: “A ka ma keq ndokund në botë se Reçani?” Ai habitet edhe i thotë: “Po bre mik, po të kallëzoi drejt, më të keq se Reçani janë ata që janë bërë miq me Reçanin”.

Edhe në këtë rast LDK-ja ka qenë dashur ta ketë parasysh para se të bëhen miq me zotin Thaçi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Dërguti e ka fjalën.

AIDA DËRGUTI: Faleminderit! Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

I nderuari kryesues,

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Përderisa po flasim për atë që po quhet fillimi i dialogut final midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, është një çështje për të cilën nuk flitet që nga fillimi i dialogëve, ajo është çështja e Luginës së Preshevës. Në Rambuje, në Vjenë dhe në Bruksel nuk pati Luginë.

Nëpërmjet Luginës së Preshevës kupton më së miri asimetrinë e dialogëve të deritanishëm mes Kosovës dhe Serbisë.

Bisedo për Kosovën dhe mos bisedo për Serbinë, rezultati dihet. Një Kosovë e decentralizuar mbi baza etnike, një Serbi e centralizuar mbi bazë etnike. Një Kosovë me diskriminim pozitiv për serbët e Kosovës dhe një Serbi me diskriminim shtetëror ndaj shqiptarëve në Serbi. Një Kosovë kushtetutshmërisht dhe ligjërish me mbipërfaqësim të pakicave kombëtare, veçmas asaj serbe, në të gjitha nivelet. Një Serbi me nënpërfaqësim të pakicave kombëtare, veçmas asaj shqiptare, në të gjitha nivelet të institucioneve shtetërore dhe të sektorit publik. Dhe, lista e shpërputhshmërisë në të gjitha të drejtat kolektive mes pakicave kombëtare në Serbi dhe në Kosovë është e gjatë. Veçmas midis atyre të serbëve në Kosovë dhe shqiptarëve në Serbi.

Të respektuar kolegë,

Me asnjë kriter dhe arsytim nuk mund të arsyetohet mungesa e Luginës së Preshevës në një dialog mes Kosovës dhe Serbisë, aq më tepër që qeveritë e njëpasnjëshme të Serbisë kanë vrarë dialogun e tyre me shqiptarët e Luginës së Preshevës, njëherësh me vrasjen e kryenegociatorit të delegacionit shqiptar, më 2001, Ridvan Qazimi, të ashtuquajtur “Komandant Lleshi”. Vrasja e tij ishte edhe vrasje e negociatave dypalëshe, tentim për shuarjen e idealit dhe qëllimit për të cilin luftonte dhe vepronte. Vrasje e premtimeve të Beogradit në ndërmjetësimin ndërkombëtar për më shumë të drejta kolektive për shqiptarët e Luginës, vazhdim i shtypjes shtetërore, vazhdim i mohimit të dialogut për çështjen e Luginës së Preshevës. Edhe dialogu i rinisur rreth dhjetë vjet më vonë, pas largimit të dhunshëm të lapidarit të UÇPMB-së, u bllokua sërish nga Beogradi. Edhe pas rënies së Milosheviqit, qeveritë e njëpasnjëshme të Serbisë kishin të njëjtën qasje ndaj kësaj treve, përjashtojë Luginën nga çdo dialog dhe shtypin e diskriminojnë shqiptarët vendorë në mënyrë të heshtur. Qëllimi i njëjtë, metoda ndryshe. Çdo gjë njëjtë, mungon vetëm ai. Rezultati i sotëm: Beogradi nuk ka jetësuar asnjë marrëveshje që ka pranuar për Luginën e Preshevës, as atë të 2001, as atë të 2009 dhe as atë të 2013.

Shtyp nga Beogradi, dëbo e shpërngul nga Lugina. Atje në Luginën e Preshevës mbeten të ndaluara të drejtat elementare, si njohja e një diplome apo përdorimi i simboleve kombëtare. Atje në spital dhe në çdo institucion të rajonit nuk ka të punësuar asnjë shqiptar të vetëm. Atje shqiptarët mbeten policë trafikur, të rrethuar nga forca speciale dhe ushtria serbe. Atje shqiptarët mund të jenë më së shumti gjyqtarë komunalë. Atje nuk pati drejtësi as për dhjetëra civilë të zhdukur dhe të vrarë, për qindra të përndjekur dhe të arrestuar padrejtësisht, për mijëra të dëbuar. Dhe, lista e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe kombëtare të shqiptarëve të Luginës është tejet e gjatë.

Por, nën dritën e shtypjes së Serbisë shtetërore nuk duhet harruar harresën e Kosovës shtetërore. Mijëra qytetarë të Luginës jetojnë ende sot në Kosovën tonë pa status të rregulluar, pa të drejta në ndihmë sociale, në banim, në punësim, e tjerë. E kush, Lugina e Preshevës që ka një kontribut

të pashlyeshëm për çlirimin, lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Rezultati i sotëm: qeveritë e njëpasnjëshme të Kosovës nuk kanë treguar asnjë angazhim serioz për Luginën e Preshevës. Injoro në Bruksel, harro në Kosovë.

Të dashur deputetë,

Çështja e Luginës së Preshevës duhet doemos të jetë temë e dialogut, një nga parakushtet. Kjo është edhe kërkesa e fundit e të gjithë të zgjedhurve shqiptarë të Luginës së Preshevës. Nëse i keni injoruar në dialogët paraprakë, tashmë keni rastin ta përmirësoni. Për këtë e keni mbështetjen tonë, mbështetjen e Partisë Socialdemokrate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Sot Kuvendi i Kosovës po diskuton një nga çështjet tepër të rëndësishme për vendin dhe unë mendoj se ky Kuvend ka përgjegjësi kushtetuese për të diskutuar çështjet jetike për Kosovën, siç është ajo që na pret javët apo muajt në vijim, pra bisedimet me Serbinë.

Mendoj se dialogu që pritet të zhvillohet me Serbinë nuk e përmbyll konfliktin me Serbinë, sepse konflikti, sipas këndvështrimit tim me Serbinë, është përmbyllur në qershor të '99-ës, pas një lufte titanike që e kanë bërë qytetarët e Kosovës nën emblemën e UÇK-së, luftë e cila është mbështetur edhe nga aleatët e NATO-s, për t'i dhënë fund gjenocidit shekullor sllav në Kosovë dhe tokat shqiptare. Largimi i Serbisë me luftë të armatosur është pasuar nga disa zhvillime dhe procese, për të cilat besoj që edhe qytetarët edhe ne jemi në dijeni. Ka ndodhur shpallja e pavarësisë së Kosovës, pastaj opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për pavarësinë e Kosovës dhe mendoj se këto janë argumente të mjaftueshme për pozicionin e Kosovës në raport me dialogun. Mirëpo, ajo që unë mendoj se është shumë e rëndësishme, është uniteti i forcave politike në Kuvendin e Kosovës dhe ky unitet nuk besoj se mund të arrihet nga qasja që po e shoh deri tash në këtë debat që po ndodh në Kuvend.

Mendoj se Kuvendi duhet ta ketë një platformë, e cila e vendos kornizën nga e cila nuk lëvizet me asnjë çmim. Unë mendoj se duke pasur qëndrime të qarta, platformë të qartë, ne thjesht e krijojmë hapin e parë të domosdoshëm dhe të nevojshëm për këtë proces. Mirëpo, në këtë proces nuk mendoj se mund të futemi nga pozicionet aktuale, kur kemi parasysh se Serbia vazhdon Kosovën ta trajtojë edhe me Kushtetutë si provincë e saj në preambulën e Kushtetutës së vet dhe nga një rezolutë, një platformë duhet të nisët nga ky realitet jo i këndshëm. Bisedimet e deritashme me Serbinë, tashmë nuk do koment se kanë qenë të dëmshme dhe e dimë se si kanë rrjedhur ato bisedime. Aktorët e atyre bisedimeve dihet se kanë bërë lëshime edhe kushtetuese, edhe ligjore dhe unë po mendoj se ato lëshime që kanë ndodhur deri tash, nuk duhet të përsëriten në finale. Prandaj, Kuvendi duhet t'i formësojë qëndrimet e Kosovës në raport me procesin që na pret.

Në rast se Kuvendi vetëm ka fjalë dhe nuk ka qëndrime të formësuara, obliguese për aktorët që do të bisedojnë në finale me Serbinë, unë mendoj se jemi duke ia bërë me vetëdije një dëm të madh vendit tonë. Dialogu mendoj se nuk duhet të shikohet nga këndvështrimi i pozitës apo i opozitës, por si përfaqësues legjitimë të qytetarëve në këtë Kuvend, pasi të gjithë që jemi këtu, jemi rezultat i mbështetjes së qytetarëve nëpërmjet votës. Mirëpo, dyshoj se unifikimi i qëndrimeve mund të ndodhë në rast se ne e përziejmë platformën dhe Hashim Thaçin, dhe për këtë unë kam një mendim pak më ndryshe. Platformën që duhet ta ketë ky Kuvend, duhet ta nxjerrë për ekipin përfaqësues të Kosovës, duhet ndarë prej Hashim Thaçit. Se nëse ne i lëshojmë të dyja bashkë dhe Hashimi në të gjitha momentet del si ‘gogoli’ i të zezave të mëdha që kanë ndodhur viteve të fundit, atëherë ne nuk mund të kemi platformë unifikuese të qëndrimeve të subjekteve politike, që besoj që duhet të jenë edhe qëndrime të qytetarëve.

Prandaj, unë po mendoj se koncentrimi në këtë debat dhe përfundimi i këtij debati duhet përfunduar me një rezolutë apo me një platformë dhe pastaj tema e dytë duhet të jetë se kush do ta përfaqësojë Kosovën bazuar në atë platformë që e nxjerr ky Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, nënkryetar!

Ju përshëndes juve, kolegë të nderuar,

Qytetarë të nderuar,

Fillimisht ju përgëzoj për rekomandimin për liberalizimin e vizave, për të cilën ka mbetur edhe një hap, por nëse ne si qytetarë nuk e kërkojmë me çdo kusht që të hiqet korrupsioni dhe krimi, sigurisht në këtë hapin e fundit mund të dështojmë.

Prandaj, shpresoj që ne të gjithë së bashku do të punojmë në këtë drejtim dhe do t’ia arrijmë qëllimit. Sa u përket negociatave, askush nuk mund të luajë me kufijtë e Republikës së Kosovës, prandaj i ftoj të gjithë politikanët, të gjithë liderët e partive politike që të ulen dhe të bëjnë platformën për bisedimet me Serbinë, por të koordinuara ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me BE-në dhe të bëjnë një përgatitje të jashtëzakonshme, të marrin aprovimin e Parlamentit të Republikës së Kosovës dhe të negociojnë. Asnjëherë të papërgatitur, prandaj duhet rikujtuar që çdo person i cili negocion, do të thotë nëse bën veprime të gabuara, nuk i falet. Kjo Republikë e Kosovës është fituar me shumë gjak, me shumë mund dhe ne duhet ta ruajmë shumë. Ne duhet t’u jemi mirënjohës të gjithë atyre që na sollën deri këtu.

Unë po dëgjoj shumë debate, me të vërtetë nganjëherë është edhe zhgënjyese, se ne më shumë jemi të prirë të lavdërohemi, t’i themi njëri-tjetrit diçka dhe jo të kontribuojmë në rrethana të caktuara, të jemi unikë. Kush ka qenë trim dhe kush ka qenë frikacak, mendoj që koha do ta tregojë. Ne nuk jemi këtu për t’u thirrur kush është më trim dhe kush është më frikacak, por të punojmë në këtë drejtim. Të japim kontributin tonë, sigurisht që ne kur flasim edhe për viktimat,

të pagjeturit, për dëshmorët, sigurisht që ne i ngacmojmë ato familje, të cilët i kanë humbur më të dashurit e vet. Për t'iu treguar atyre që ne jemi ata që i përkujtojmë, ne duhet kontribuar që vendin tonë ta çojmë përpara. Prandaj, për arsyet që ata kanë dhënë më të dhembshmen, sot u bëj thirrje të gjitha partive të bashkohemi, të trajtojmë këtë çështje, të përgatitemi, të bëjmë delegacion të mirëfilltë me këshilltarë adekuatë, të cilët trajnohen dhe ata kur të shkojnë në negociata, nuk bëjnë gabime. Sigurisht që kur të dalin gabimet, do të jemi vonë, të mos harrojmë që kemi shumë troje shqiptare, të cilat nuk i gëzojnë të drejtat e tyre dhe me të vërtetë asnjëherë së paku nuk i kam dëgjuar që kjo trajtohet edhe në negociata.

Prandaj, ne duhet të mos i harrojmë ato. Të gjitha ato troje shqiptare janë tonat, ata shqiptarë që janë edhe nëpër pjesë të tjera, të cilët kanë mbetur të vetmuar, ne duhet të jemi të bashkuar. Këtu duhet të tregojmë që jemi unikë, brenda Parlamentit po kemi vështirësi, qysh do të shkojmë tutje? Prandaj, i ftoj edhe një herë liderët politikë, pozitë e opozitë, të jemi të bashkuar. Nuk mund të negociojë vetëm pozita, duhet qenë edhe opozita e bashkuar, të formojnë grupin negociues, pastaj do të shkojnë, të vazhdojnë tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Është debat i rëndësishëm, por kemi edhe një situatë të krijuar, e cila e rëndon pak debatin. Në këto momente u informova që, nuk di me çfarë fjalësh ta quaj, përveçse Mësuesi ynë i madh, Burri i madh i këtij vendi që ia dha Kosovës 28 vjet të tij nëpër kazamatet e Jugosllavisë ka ndërruar jetë. Ai është ndarë sot nga ne fizikisht, por jeta dhe vepra e tij do të lartësohet për aq sa kohë kombi shqiptar dhe shqiptarët në përgjithësi do të kenë jetë. Lavdi jetës dhe veprës së Adem Demaçit dhe ju lus për një minutë heshtje!

Lavdi!

Tani është në dorën tuaj që ta vazhdojmë apo ta ndërpresim debatin për shkak të rastit deri nesër, për ta vazhduar në orën 10:00 dhe po besoj që do të ishte mirë që kryetari kur të kthehet, ta thërrasë një mbledhje të Kryesisë, së bashku me kryetarët e grupeve parlamentare për të parë se çfarë obligimesh do të marrë Kuvendi i Kosovës sa i përket kësaj çështjeje. A jeni për ta ndërprerë, apo jo? A ka dikush që s'është dakord? Në rregull!

Mirupafshim!

* * *

E hënë, 30 korrik 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 23 korrik 2018

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Zonja dhe zotërinj deputetë,

Po e vazhdojmë me seancën e ndërprerë ditën e premte. Kemi ngelur te debati dhe po vazhdojmë me të paraqiturit siç kanë qenë në momentin e ndërprerjes së debatit. Fjalën e ka zoti Haxhi Avdyli.

HAXHI AVDYLI: Të nderuar qytetarë,

Ishte marsi i vitit 1999, kur shumë fshatra u rrethuan, u ndanë burrat dhe të rinjtë, u dogjën shtëpitë, shumë nga qytetarët e Kosovës u pushkatuan dhe u dëbuan 1 milion qytetarë. Ishin mu forcat serbe ushtarake paramilitare dhe aty gjithmonë pranë tyre ishin edhe fqinjët serbë, domethënë qytetarët e Kosovës, të cilët u rritën dhe jetuan bashkë me shqiptarët dhe brenda natës u shndërruan në vrasës e piromanë mu kundër fqinjëve të tyre.

Pas mbarimit të luftës, për hir të paqes dhe ardhmërisë, populli i Kosovës bëri kompromise të dhimbshme, duke punuar për pajtim pa kushte edhe me pakicën serbe, edhe me fqinjët serbë, të cilët shumë raste ishin bashkëpunëtorë të okupatorit. Edhe pse shteti serb dhe populli serb asnjëherë nuk kërkoi falje për të gjitha ato krime dhe terror, qytetarët e Kosovës e shtrinë dorën e pajtimit, duke garantuar të drejtat më afirmative për ta. Këto ishin ato kompromiset më të mëdha të dhimbshme, të cilat i bëri qytetari i Kosovës. Pastaj, konjunkturat politike vazhduan edhe me kompromise tjera, duke filluar me Marrëveshjen e Ahtisarit. Kompromis yni ishte edhe ndalimi i bashkimit me Shqipërinë, kompromis i dhimbshëm ishte edhe kur pakicës serbe iu garantuan super të drejta dhe u vendos që ata, edhe pse me një popullsi vetëm me 100 mijë qytetarë, të kenë veto për ligje të ndryshme, edhe veto për ndryshimet kushtetuese. Atyre nga fshatrat iu krijuan komuna, gjuha serbe u bë gjuhë zyrtare e dytë edhe në ato vende ku nuk kishte qytetarë serbë. Atyre iu krijua punësim nëpër të gjitha institucionet, duke iu garantuar kuotat e diskriminimit pozitiv. Kisha u pavarësua dhe u bë si shtet brenda shtetit.

Ata po ashtu vazhduan me arsim nëpër shkolla duke i ikur edhe programit të shtetit të Kosovës, e shumë drejta tjera, të cilat edhe qytetarët në shumicë nuk i kanë, dhe kjo u bë vetëm për hir të paqes dhe pajtimit.

Po tani, për çfarë kompromisesh të dhimbshme po flasim? Çfarë kompromisesh dhe cilat janë ato, për të cilat ne ende duhet të lëshojmë pe. Për çfarë kompromisesh po flet Presidenti i Kosovës, i cili sot është shndërruar në një figurë tragjike dhe të rrezikshme për shtetësinë e Kosovës. Ky njeri duhet të ndalet nga pazaret me ardhmërinë e shtetit, duke përfituar edhe interesa personale. A kanë fund këto kompromise të dhimbshme me interesa e vendit, këto kompromise të këtij presidenti, të cilën do ta shndërroj në Kosovën në një shtet të dështuar, apo

edhe një shtet brenda shtetit, siç është Asociacioni, apo edhe falja e territorit tonë të cunguar, për diçka që është fiktive, si perspektiva evropiane apo ulëset në OKB, gjë që nuk është edhe ajo e garantuar. Si duket ky njeri, me vetëdije dhe pa dije, është bërë argat i interesave të huaja për ta dështuar shtetësinë tonë.

Tani për tani Serbisë nuk po i duhet territor, sepse jugu i Serbisë është duke i mbetur shkret, djerrinë pa njerëz. Serbia edhe nuk është duke kërkuar të drejta më shumë për popullatën serbe, sepse ajo e di që të drejtat e pakicës serbe janë më se të garantuara në Kosovë. Domethënë, lufta e Serbisë për momentin nuk është luftë për territor dhe për të drejta, por ajo e ka vetëm një qëllim. Po duan që ta dështojnë këtë shtet dhe këtë dështim të këtij shteti po duan ta arrijnë me politikanë të dështuar dhe të shantazhuar dhe pastaj nëpërmjet këtyre dhe nëpërmjet dështimit të shtetit ta kontrollojnë tërë Kosovën dhe këtë mund ta arrijnë vetëm me politikanë të dështuar i tipit të Hashim Thaçit, por edhe disa politikanë, të cilët po ia rrahin krahun, duke u bërë argatë të tij dhe argatë të dështimit nëpërmjet kompromiseve të dhimbshme.

Prandaj, ndalja e Hashim Thaçit dhe ndërprerja e kompromiseve të dhimbshme jep shpresë për një rikthim, jep shpresë për forcimin edhe të aleancave me mbrojtësit e shtetësisë dhe lirisë tonë, gjithmonë duke punuar në forcimin e shtetësisë të gjithë aktorëve politikë, pa dallim. Vijat e kuqe duhet dhënë këtij negociatori të paautorizuar siç është Thaçi, kompromiset e të cilit janë të dobishme për veten e tij, por shkatërruese për shtetin tonë.

Neni 1 i Kushtetutës thotë “Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik dhe i pandarë” dhe atë që e shkel Kushtetutën, pikën 1, dihet se çka e pret. Dhe, mendoj që në këtë drejtim ne duhet të jemi të kujdesshëm se çka po bisedohet dhe apo shkelet neni 1 i Kushtetutës siç është shtet unik dhe i pandarë. Dhe, çdo gjë tjetër duhet të sanksionohet edhe nga Kuvendi, edhe nga qytetarët, edhe nga të gjitha institucionet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën.

ANDIN HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të respektuar,

Kryesues,

Më lejoni që paraprakisht të shpreh ngushëllimet e mia për familjen dhe gjithë botën e artit për aktorin e ndërë tashmë, Bekim Lumi. Njëkohësisht, më lejoni që të shpreh dhimbjen, sepse nuk mund të them ngushëllimet e mia për të gjithë shqiptarët kudo që janë për humbjen e madhe që ka pësuar Kosova dhe shqiptarët, në përgjithësi, për njeriun që në 100 vjetët e fundit nuk njih historia njeri më të madh se ai, e ai është baca Adem.

Kryesues, unë nuk do të zgjas shumë për dialogun me Serbinë, me siguri kanë edhe deputetët tjerë çka të thënë për këtë. Unë do të fokusohem në dy pika: e para, reagimet që kanë ndodhur kohëve të fundit dhe e dyta është rezoluta që ne e kemi nxjerrë në këtë Parlament. Kam parë reagime të ndryshme edhe këtu, por edhe jashtë kësaj seance në lidhje me atë se kush duhet të udhëheq dialogun. Në fjalimin tim të parë dhe pas tij, jam lutur po në këtë seancë për unitet në çështjet nacionale, e ky unitet kërkohet pikërisht sot, të nderuar kolegë. Ky unitet kërkon që sot t'i lini anash politikat ditore, inatet partiake dhe t'i dalim zot vendit tonë, ashtu për çka jemi zotuar.

Të nderuar qytetarë,

Përveç që nuk shoh asnjë problem që Presidenti ta udhëheqë dialogun, natyrisht në koordinim me Kuvendin, mendoj që është njeriu më adekuat i mundshëm, sepse i njëjti njeri i ka udhëhequr edhe kauzat tjera, ka udhëhequr edhe dialogët tjerë dhe ka dalë i suksesshëm deri më sot. Në këtë rast, po jua rikujtoj Rambujenë dhe të tjerat. Së paku, nuk di njeri tjetër që kemi provuar në dialogë dhe ka treguar rezultat. Presidenti ka thënë këto ditë, ditëve të fundit, që marrëveshja do të jetë e dhimbshme dhe për këtë deklaratë ka pasur reagime të ndryshme. Unë mendoj që është normale të jetë e dhimbshme, madje është shumë e dhimbshme të bëhet marrëveshje me armikun tënd. Është e dhimbshme, sepse neve na mungojnë ende 1 652 persona. Është e dhimbshme sepse të njëjtit na kanë vrarë, na kanë masakruar dhe na kanë djegur. Është e dhimbshme sepse ende sot pas 19 vjetësh sheh lot në sytë e nënave nga vuajtjet e shkaktuara prej kriminelëve serbë të vitit 1999.

Është e dhimbshme, sepse të njëjtit na kanë mbajtur të pushtuar me shekuj, sepse ende një pjesë e madhe e Kosovës është lënë anash, siç është Lugina, dhe fatkeqësisht po trajtohet shumë keq nga shteti i Serbisë, siç duket në Serbi pasardhësit e Milosheviqit ende po i vazhdojnë me nostalgji politikat monstruoze të tij.

Por, qytetarë të nderuar, më e dhimbshme se kaq nuk mund të jetë. Më e dhimbshme se kaq nuk bëhet, më të dhimbshme se kaq nuk do ta lejojmë të bëhet asnjëherë. Ky duhet të jetë definicioni i asaj që ka thënë Presidenti dhe nuk do të ketë dhimbje tjetër. Por, unë dua të jua rikujtoj juve, kolegë të nderuar, që në këtë Kuvend ne e kemi miratuar një rezolutë të iniciuar nga unë dhe Saranda, dhe është përkrahur nga të gjithë ju, me ç'rast ju falënderoj edhe një herë, dhe po jua lexoj pikën e parë të asaj rezolute: "Të bëhet zbardhja e fatit të personave të zhdukur me forcë, bazuar në të drejtën ndërkombëtare, përfshirë Konventën e Gjenevës të vitit 1949 dhe në Protokollin shtesë nr. 11977. Zbardhja e fatit për personat e zhdukur me forcë të vendoset si parakusht në dialogun Kosovë-Serbi dhe të bëhet pjesë e platformës shtetërore për dialogun.

Unë kam rastisur me një platformë shtetërore, po e quaj ashtu, e cila është tërhequr pastaj, por këtë pikë të rezolutës së votuar nga ne nuk e kam hasur aty. Prandaj, kërkohet nga Presidenti,

kërkoj nga Kryeministri dhe nga Kuvendi që ta fusin këtë pikë në bisedimet me Serbinë dhe të jetë njëra ndër pikat e para që diskutohet në nivelin e lartë, do të thotë në nivel presidentësh.

Të nderuar udhëheqës, President, Kryeministër, kryetar dhe ju kolegë të nderuar, unë dua ta di ku e kam babin, familjet duan të dinë ku i kanë më të dashurit e tyre, do të thotë edhe 1 652. Kjo nuk guxon të kalojë nën heshtje dhe këtë nuk e lejoj të kalojë nën heshtje. Pa këtë, nuk mendoj që ka kuptim asnjë marrëveshje që do të bëhet me Serbinë. Njëkohësisht, në javën e kaluar, në seancën që është ndërprerë, dikush nga Lista serbe, po e them si post-scriptum, sepse unë ata nuk i shoh që janë në sallë hiç, mirëpo nuk mund pa reaguari, ka thënë që ne duhet të bëjmë konsensus me Serbinë. Po unë pajtohem për të bërë konsensus me Serbinë. Ne do ta bëjmë një konsensus me Serbinë pasi të na i ktheni mbi 16 mijë jetë që na i keni marrë në Kosovë, pasi që t'ju falin mbi 20 mijë gra të dhunuara që janë në Kosovë...

KRYESUESI: Ju lutem, zoti Hoti, ne nuk kemi punë me Listën serbe këtu, mos e...

ANDIN HOTI: Është pikë e dialogut...

KRYESUESI: Mos iu drejtoni Listës serbe, nuk ka faj Lista serbe, ata janë deputetë të Parlamentit të Kosovës... Të lutem!

ANDIN HOTI: Mirë, atëherë unë e kreuva. Faleminderit!

KRYESUESI: Nuk kemi punë me Listën serbe, të lutem! E kemi rendin e ditës, në përputhje me rendin e ditës diskutojmë. Zoti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Pra, po flasim sërish për dialogun. Herën e shkuar thuhej se ishte hera e fundit dhe se nuk kemi më pse të flasim me Serbinë, pasi në përfundim të dialogut do të kemi njohjen nga Serbia dhe ne po flasim sërish, vetëm se kësaj radhe e keni zbritur cakun dhe po thuhet se në fund të dialogut do të kemi ulëse në OKB. Mendoj se as kësaj here nuk duhet besuar si herën e parë. Unë do të flas për çështjen e të drejtave të shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Dhe, më duhet të përsëris pothuaj të njëjtat fjalë si në fund të vitit 2011, si në vitet 2012, 2013, kur ndodhnin negociatat. Para se të filloj, dua të jap një statistikë që pata rastin ta dëgjoj në tryezën që mbajtëm ditë më parë për të drejtat e shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

Nga viti 2011, pra nga koha kur kanë filluar negociatat në Bruksel pas shpalljes së pavarësisë, jo pra ato të Vjenës, e deri më sot, në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc janë 4 mijë nxënës më pak. Nën shkollat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. Kjo ka ndodhur pra në kohën ku po negociojnë me Serbinë për të drejtat e serbëve në Kosovë me të njëjtin negociator, pra me Hashim Thaçin. Gjatë tërë kësaj kohe, qytetarëve shqiptarë atje u është ushqyer shpresa

vazhdimisht se do të bëhet diçka për ta, do të flitet diçka në negociatat për ta, si në ato të Vjenës, si në ato të Brukselit, njëjtë sikur edhe sot atyre po u premtohet se do të trajtohen të drejtat e tyre edhe kësaj radhe. As me negociatat e Vjenës, e as me ato të Brukselit nuk u bë asgjë. E tëra që u bë është që partneri negociues Serbia vetëm sa e shtroi terrorin, e atë vazhdon ta bëjë edhe sot.

Muajve të fundit, ky presion është shtuar edhe më tepër, e çka është edhe më e rëndë në masë po bëhet procesi i çregjistrimit të banorëve, të cilët nuk gjenden në shtëpitë e tyre. Ky proces po quhet “pasivizim i adresave” dhe në Medvegjë janë bërë rreth 3 000 deri më tani. Në qytetet e mëdha si Nishi e Vranja, ajo që quhet “pasivizim” është bërë në më pak se 200 raste. Në Medvegjën e vogël ku janë shqiptarët 3 000, pra në Nish më pak se 200.

Edhe përkundër kësaj, ata vazhdojnë të besojnë ende. Besojnë sepse kanë të drejtë të besojnë se Kosova do të bëjë diçka për ta, pasi ata kanë dhënë kontribut të madh në atë që kemi arritur ne sot në Kosovë. Në historikun e Kosovës nuk mund të ketë ngjarje apo ndërtim i ndonjë institucioni apo ndërmarrje, lëvizje çlirimtare, e as betejë në të cilën nuk morën pjesë qytetarë nga ajo anë. Edhe ata, edhe ne e dimë këtë, dhe me të drejtë ata besojnë se ne do të përpiqemi për ta. E, a ndodhi me të vërtetë kështu: Jo! Çka ndodhi? Vetëm premtime dhe mashtrime. Për serbët, Pakoja e Ahtisarit edhe më tej, e për shqiptarët në Serbi terror e dëbime. Dhe, gjatë tërë kësaj kohe ata ishin aktivë, bënë aktivitete të shumta dhe miratuan platformë ku kërkuan që të drejtat e tyre të trajtohen në bazë të reciprocitetit. Kjo platformë u miratua në vitin 2006 nga përfaqësuesit shqiptarë të të tria komunave në kuvendet komunale të të tri komunave dhe kjo platformë as që u mor për bazë ndonjëherë.

Tani ata i ripërsëritën qëndrimet e tyre në deklaratën që i miratuan sërish këta këshilltarë komunalë të këtyre komunave. Patëm rastin që ditë më parë të takojmë përfaqësues të tyre, nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja. Atyre u është ngjallur shpresa se do të ketë këmbim territoresh dhe ata sot po besojnë. Po besojnë sërish, edhe pse dy herë janë mashtruar. Dhe, unë mendoj se po mashtrohen sërish. Pra, sërish, duke mos qenë kusht para bisedimeve të drejtat e shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc, Medvegjë nuk do të jenë as temë. Prandaj, këto negociata duhet të ndalen menjëherë, dhe nuk duhet të fillojnë pa qenë njëri nga kushtet të drejtat e qytetarëve të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit.

Përfaqësuesit politikë nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci u kërkojmë të jenë unikë dhe të mos e ndalin presionin. Takimet informale të fshehta me negociatorët ku premtohet e u ngjallet shpresa nuk janë të duhura. Janë mashtruar dhe do të mashtrohen sërish, ashtu si kanë dalë hapur me kërkesë të aprovuar nga këshilltarët e tri komunave, ashtu hapur le të vijnë, le të bëjnë presionin e tyre hapur ndaj të gjithë neve. Gjithmonë do të ketë zëra që do t'i mbështetin. Por, për të drejtat e shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc nuk duhet vetëm të flasim. Duhet të përpiqemi, sepse e kemi obligim dhe e kemi edhe mundësinë.

Pati edhe të tjera fjalime në lidhje me të drejtat e shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc. Kjo nuk mjafton. Nuk kënaqen të drejtat e shqiptarëve atje me fjalime, e as me kërkime. Kjo çështje duhet të jetë në rezolutë dhe ne mendojmë se duhet patjetër të jetë si reciprocitet i të drejtave me serbët në Kosovë dhe duhet të jetë kusht para bisedimeve, në mënyrë që mos të na përsëritet fati i njëjtë si me negociatat deri tani.

Sa i përket rezolutës, e cila na ka ardhur si propozim për ta miratuar, unë mendoj se nuk duhet miratuar rezoluta si e tillë. Unë jam tejet i befashuar se në fundin e kësaj rezolute e shoh nënshkrimin e deputetit Visar Ymeri. Prisja që si pikë e parë e kësaj rezolute të jetë ndërprerja e këtij procesi të filluar negociator, por ja që nuk qenka. Ky proces i bisedimeve tanimë ka filluar dhe askush nuk e di gjithë se çka po ndodh. Rezoluta as që e merr parasysh faktin se bisedimet kanë filluar, e jo më ta trajtojë procesin deri më tani. Tjetra? Në rezolutë, procesi i dialogut thuhet se ka arritur në fazën përfundimtare, e konsiderimi si i tillë i procesit negociator nënkupton pajtim me fazat paraprake. Pa ndërprerje të këtyre negociatave të filluara dhe pa trajtim për këto procese të deritanishëm, i bie të pajtohesh edhe me procesin deri tani, edhe me vazhdimin e tij, e lëre më që unë jam i bindur që deputeti Ymeri e di që kjo nuk është faza përfundimtare e bisedimeve. Kështu përfundimtare janë quajtur të gjitha bisedimet deri më sot. Çdoherë ato ishin bisedime të fundit. Deputeti Ymeri e di këtë shumë mirë. Prandaj, nuk po e kuptoj pse po i quan të tilla këto bisedime.

Dhe tjetra, meqë qenkan përfundimtare dhe u dashka të ndodhin, a mund të na tregojnë nënshkruesit e rezolutës se për çka do të negociohet. Jo vetëm Visari, por cilido deputetë këtu, meqë qenkan shumë që s'janë dakord për vazhdimin e bisedimeve, a na tregoni se për çka konkretisht do të flitet në këto bisedime? Le të tregojë dikush se cila e drejtë ka mbetur pa iu dhënë pakicës serbe, me përjashtim të atyre të drejtave që e themelojnë Republikën serbe përbrenda si Kuvend paralel, ekzekutiv paralel e ushtri paralele. Cili do të jetë kompromisi ynë, deri ku do të shkojmë ne? Këtu në këtë rezolutë na vjen se çelësi i zgjidhjes së problemit në lidhje me negociatat qenka Kuvendi nëse vendimet i merr me 2/3 e numrit të përgjithshëm të deputetëve. A i bie që sikur të ishte përdorur kjo formulë më herët nuk do të kishim ardhur deri këtu? A i bie se nëse votojnë 2/3 e deputetëve, një vendim qenka i drejtë?

Mbi 2/3 e delegatëve kanë votuar në vitin 1945 në Prizren, kur Kosova ka mbetur nën Jugosllavi. Mbi 2/3 e delegatëve kanë votuar edhe suprimimin e autonomisë. Mbi 2/3 e deputetëve e kanë votuar Pakon e Ahtisarit, e kanë votuar Marrëveshjen e prillit 2013 për Zajednicë, Visar! Ata që ishin pro Zajednicës i kishin mbi 2/3 e votave, edhe për demarkacion po ashtu. Grupi ynë parlamentar nën udhëheqjen tënde si kryetar i Lëvizjes ishte kundër. A mendon se kemi gabuar? Me 2/3 e deputetëve kaloi edhe demarkacioni, a ishte vendim i drejtë ky? Çka u bë me të drejtën për referendum?

Këtij kompromisi të dhimbshëm që po na servohet po mjaftuaka t'i lidhet kryet me 2/3? Këtu po paralajmërohet ndarja dhe ju propozoni që vendimet të merren me 2/3. Kjo i bie të pajtoheni edhe me kompromisin, edhe me ndarjen, pasi e kemi të gjithë shumë të qartë se këto 2/3 janë bërë çdoherë dhe bëhen prapë. Marrëveshja e prillit 2013 na e dëshmon këtë. Asokohe sa vijonin negociatat, e gjithë opozita ishte kundër, ndërsa kur erdhi puna të votimi i marrëveshjes çdo gjë ndryshoi. E njëjta mund të ndodhë prapë dhe ju po e konsideroni ndarjen e mundshme si të mjaftueshme të lihet në dorë të 2/3.

Çka është bërë me kundërshtimin e reduktimit të demokracisë në demokracinë përfaqësuese? Çka është bërë me gazin lotsjellës, me demonstratat e shumta kundër Zajednicës, arrestimet dhe vdekjen e Astritit? Këto kanë ndodhur nën udhëheqjen tuaj, pasi asokohe ata që donin t'i bënin i kishin 2/3. Mendoj se duhet të deklaroheni hapur për këtë. Ju keni marrë njërin nga draftet e vjetra që ka hartuar Lëvizja Vetëvendosje në lidhje me referendumin dhe e keni iniciuar si ligj për referendum.

Kjo është e drejtë, pavarësisht që e keni marrë një draft të vjetër. Mirë do të ishte që ta merrni draftin e ri tani. Po, pse nuk po e tërhiqni dhe ta sillni një projektligj për 2/3 e deputetëve, meqenëse kjo po e përmbushka tani kërkesën e qytetarëve. Një vendim i tillë, çfarë do të presim tani me këto negociata, që do të jetë tejet i rëndësishëm për Kosovën, me 2/3, meqenëse qenka aq e... Një vendimi të tillë po mund t'i lidhet kryet me 2/3, silleni një projektligj e bëjmë për 2/3, e shohim si bëhet më mirë kjo.

Pra, për mua tani çdo gjë është e qartë. Ju keni ndryshuar shumë për të keq. Se nuk jeni me Vetëvendosjen, këtë e di. Por, se sillni rezoluta e tekste thuajse nuk keni qenë kurrë në Vetëvendosje, këtë nuk do ta kisha besuar. Këtë tekst ende nuk mund ta besoj që e keni shkruar ju. Po dyshoj se e ka shkruar dikush tjetër. Unë po kërkoj që ta tërhiqni këtë rezolutë, dhe të flasim tamam shtruar, e jo faktikisht që të mbështetet ky proces i dëmshëm dhe të luhet gjoja naivi.

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Visar Ymeri!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

E dëgjova me vëmendje Liburnin dhe mendoj që e ka së pari një keqkuptim për rezolutën. Aty shumë mirë ceket se platforma për negociata dhe çka nuk do të duhej që assesi të bisedohet duhet të miratohet me 2/3 në Kuvend. Pra, kjo është siguresa më e madhe që mund ta arrijë Kuvendi si i tillë, për ta mbikëqyrur e për ta drejtuar një proces negociator në të mirë dhe në dobi të Republikës së Kosovës. Dhe, në atë platformë, natyrisht që duhet të jenë edhe këto parakushte që i përmendi, njërin prej tyre Liburni, tjetrin Andin Hoti, e të tjera që mund të dalin nga deputetët. Pra, edhe ky diskutim këtu po e tregon se sa e rëndësishme është që Kuvendi ta miratojë e ta

draftojë, ta shkruajë më falni, platformën dhe strategjinë, e të mos i lihet kjo në duar një grupi të vogël të njerëzve, ose një njeriu, siç është aktualisht Thaçi. Dhe, e dyta, po, duhet të merret mandati kushdo që negocion me 2/3 në Kuvend, dhe ky për Kuvendin dhe për Republikën e Kosovës nënkupton fillim të procesit negociator.

Deri tash Thaçi ka shkuar në takime, por ky Kuvend me këtë rezolutë e tregon se ai nuk është legjitim dhe që nënkupton që ky proces negociator nuk pranohet, ose ai që ka ndodhur deri tash. Këto janë ato që janë paraparë në rezolutë, Liburn, nëse e lexon me vëmendje. Po, për ta lexuar me vëmendje duhet ta heqësh njëherë këtë inat që e ke karshi PSD-së dhe vullnetin e zellin për ta sulmuar PSD-në dhe të mendosh drejt. Dhe, tash ti nëse nuk i beson 2/3-tës së Kuvendit, pra ti ose nuk e ke besimin te PSD-ja, që thua që PSD-ja në fund mund ta ndryshojë votën, e unë këtu po të garantoj që ne nuk e ndryshojmë votën karshi këtyre çështjeve, ose nuk e ke besimin të LDK-ja, meqë po thua që opozita e ndërron mendjen. Po, LDK-ja e ka ndërruar mendjen në të kaluarën, mbase do ta ndërrojë mendjen edhe në të ardhmen. Mirëpo, është e rëndësishme që ta testojmë LDK-në, Liburn, në fillim të procesit, e jo në fund të procesit, kur praktikisht marrëveshja ose ndalja e marrëveshjes bëhet e pamundur, siç e dimë të gjithë e siç e kemi parë disa herë.

KYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Aliu.

LIBURN ALIU: Në 2013-tën, është e vërtetë që LDK-ja e pati kundërshtuar tërë kohën dhe në fund e pati nënshkruar marrëveshjen. Një gjë e tillë pres që mund të ndodhë edhe tani, sepse nuk ka ndonjë ndryshim të madh në këtë vend. Prandaj, siguresat e tilla nëpërmjet 2/3-tave të Kuvendit, bien. Dhe, nëse në rezolutë nuk do të jetë ndërprerja qartë e procesit, duhet ta kemi të qartë që ky proces i deritanishëm konsiderohet si valid. Nëse në rezolutë nuk flasin për konsiderimin e marrëveshjeve të deritanishme dhe këtë e konsiderojnë si përfundimtare, kjo i bie që kemi ardhur në fundin e saj. Prandaj, Kuvendi në këtë rast është formal dhe dallim shumë i vogël, kur bëhet fjalë për atë nëse do ta bëjmë para apo pas negociatave, sepse e kemi shumë të qartë që në momentet kritike ky Kuvend ka dështuar çdoherë.

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Ramush Haradinaj, kryeministër i Kosovës. Po, zoti Hoti, replikë! Regjia, fjalën Avdullah Hotit!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

LDK-ja po i bën tri dekada në përpjekjet e veta për ta konsoliduar shtetin e Kosovës, një shtet demokratik, të lirë e të integruar në BE dhe në NATO, dhe në miqësi të përhershme me SHBA-të.

Kjo është motoja jonë dhe mbetet ende aktuale. Nuk ka parti në kuvend, e në veçanti këto që tash vonë kanë filluar ta tregojnë veten që mund ta testojnë LDK-në. Me rezoluta të tilla nuk shkojmë askund. Mendoj që është parë në javët e fundit në këtë Kuvend se kush po i ndërron qëndrimet.

Ka tridhjetë vjet që LDK-ja nuk e ka ndërruar qëndrimin për shtet të pavarur të Kosovës. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryesues i Kuvendit, zoti Haliti,

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

E kam pritur me interesim këtë debat, jo kush e ka iniciuar, por për shkak se cila është tema. Mendoj që kontributi në këtë debat parlamentar është i nevojshëm nga të gjithë. Unë do të mundohem t'i ndihmoj Parlamentit sot, me aq sa mbërrij, aq sa di, si Qeveri. E para, e kam menduar të nevojshme që Parlamenti të ketë informata të sakta se çfarë ka ndodhur në dialog, cila është materia e dialogut. Çka janë këto marrëveshjet e famshme që i dëgjojmë në televizion, që i kemi dëgjuar prej Editës, prej njerëzve të tjerë. Çka janë ato? Pse kanë ndodhur? Ne jua kemi dhënë në përdorim një raport që është përshkrim i gjendjes, gjendje e incizuar, që të kontribuojë që çdo deputet i Kosovës, pa marrë parasysh i cilës parti është, edhe nëse është i komuniteteve, le ta dijë se çfarë ka ndodhur me dialogun e derisotëm.

Njëkohësisht, në këtë raport mund ta gjeni gjendjen si vijon: në marrëveshjen për zgjedhjet, Kosova i ka kryer të gjitha obligimet për zgjedhje, është vlerësuar nga BE-ja. Pra, ky raport e thotë atë. Në atë për Asociacionin e Komunave me shumicë serbe, Kosova i ka dhënë dritën e gjelbër procesit. Është një proces në zhvillim, është në vazhdim, pra nuk ka ndonjë epilog.

Në marrëveshjet tjera; policia, drejtësia, mbrojtja civile, aranzhimet ndërlidhëse, marrëveshje për telekomunikacion, çështje doganore, Kosova i ka kryer obligimet, vlerësohet lart nga BE-ja. Pra, janë në zbatim. Serbia po vazhdon të mos e zbatojë Marrëveshjen për energji, dhe me këtë Kosovës i shkaktohen humbje të mëdha. E kemi çrregullimin e tregut në veri, ashtu siç e dimë të gjithë. Menaxhimi i Integruar i Kufijve për pikat e përbashkëta të kalimit kufitar, Serbia nuk po e implimenton ndërtimin e tri pikave të vendkalimit kufitar në anën e saj, ashtu siç është paraparë në marrëveshje. Pra, është duke e bllokuar zbatimin e kësaj marrëveshjeje, ta dini ju, ta dinë deputetët, qytetarët çka ka ndodhur në bazë të marrëveshjeve. Unë kam pasur shumë palë që kam biseduar me to... Edhe ata kujtojnë që Serbia i ka zbatuar krejt në anën e vet, e Kosova po bllokton me Asociacionin, ose me një tjetër.

E vërteta është që Serbia po ashtu është duke i bllokuar disa marrëveshje, e rasti i Menaxhimit të Integruar të Kufirit është obligim ndërkombëtar, është proces i Berlinit, por nuk është duke e zbatuar. Te rasti i marrëveshjes për energjinë, gjendja është shumë keq, dhe i përmenda këto dyja. Kemi disa tjera që i gjeni që nuk qëndrojnë mirë në këtë raport. Sa i përket kontributit të Qeverisë për Parlamentin dhe informatave që i keni, i kisha lutur deputetët, lexojini, përpunojini, është në interesin e çdo përfaqësuesi të popullit për ta pasur të incizuar gjendjen sa më saktë. Jo

vetëm çfarë thonë mediat, jo vetëm çfarë i thoni njëri-tjetrit, por merreni materie, nëse gjeni më të saktë, shërbehuni edhe me të, por kjo është me rëndësi ta kemi ne. Duke qenë se këtë pjesë të kontributit të Qeverisë tash e shtjellova, aq sa e vlerësoj se është me rëndësi, se ju e keni vetë raportin, më lejoni të flas pak për dialogun në përgjithësi. E para duhet t'ia rikujtojmë vetes, këtu i kam të gjitha rezolutat e Parlamentit të Kosovës, fillojnë 2010, 2011, 2012. Të gjitha këto rezoluta e autorizojnë Ekzekutivin, kryetarin e Qeverisë për ta udhëhequr dialogun, por i gjithë dialogu për të cilin është autorizuar Qeveria është teknik. Mos e harroni këtë, ju e keni votuar. Ju lutem, më 2012, në cilën datë?

Cilën datë dëshiron? Më 18 tetor 2012, këtë të vetmen e kam gjetur të panëshkruar, nuk e di pse! Ju lutem, i kemi marrë në arkiva, ja të tjerat të nënshkruara. Ja për shembull, 20 janar 2012. E vazhdojmë diskutimin lidhur me përmbajtjen e rezolutave, pjesën që ju mendoni se është autorizimi për dialog politik. Çfarë kanë qenë temat e atij dialogu, më falni! Po! Urdhëro njëherë, pastaj vazhdojmë. S'ka problem, i kam edhe unë në rezolutë. Këtu i kemi, përpara nesh. Urdhëro, lexoje!

KRYESUESI: Fjalën e ka Dardan Molliqaj.

DARDAN MOLLIQAJ: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Ky debat që po ndodh në Kosovë është shumë vonë dhe po ndodh vetëm pas presionit të shoqërisë civile dhe të partive opozitare. Pra, kemi nisjen e procesit krejtësisht mbrapsht. Ne po dialogojmë me një shtet, i cili nuk e njeh Kosovën dhe që ka aspirata ndaj Kosovës, e që është Serbia. Por, duhet ta shohim se çfarë ka bërë Serbia edhe në të kaluarën, edhe tani.

Në krejt historikun e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Kosova shkon si palë gjithmonë pa platformë dhe pa projekt të zgjidhjes së problemit të Kosovës në raport me Serbinë.

E kemi një Qeveri dhe e kemi një president në shtetin fqinj, i cili ka pretendime ndaj nesh, i cili e ka ndërtuar një platformë për disa muaj dialogu dhe diskutimi se çfarë do të kërkojë në raportin e ri, ose në marrëveshjen e re, që do të ndodhë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Dhe, ku është pala e Kosovës? Pala e Kosovës është - kush po e drejton dialogun. Disa që duan t'i thyjnë këmbët, e ai i pari gjithmonë është Hashim Thaçi, që veç për të qenë në dialog, dhe shumë të tjerë, të cilët herë i bashkëngjiten, e herë ofrohen për ta zëvendësuar atë. Pra, mbrapsht jemi duke e nisur, e pashmangshëm mbrapsht do të dalë. Prandaj, rezoluta e Kuvendit tenton (e propozuar nga grupi ynë) ta normalizojë situatën, ta kthejë në binarë. Jeni duke shkuar mbrapsht. Edhe nëse e keni qëllimin e mirë, edhe pse unë nuk besoj që e ka qëllimin e mirë zoti Thaçi, nuk ka gjasa me këtë rrugë. Tentimi ynë është që ta kthejmë në gjendje normale situatën. Çfarë i bie kjo? Të ulemi si

Kuvend, si Qeveri, si krejt aktorët e tjerë që kanë interes për këtë punë, dhe në radhë të parë ta dimë se çfarë po kërkon Kosova në këtë dialog.

Pa e vendosur këtë dhe pa e vendosur mënyrën e vendimmarrjes për këtë çështje, dikush mund të propozojë referendum, dikush 2/3, kjo është çështje për të cilën bashkë mund të merremi vesh. Por, duhet ta dimë se çfarë po kërkojmë, si do të jetë vendimmarrja, e në fund kush i përfaqëson më së miri këto dy të parat për të cilat ne merremi vesh. Pa gatishmërinë për këtë çështje, qoftë ata të cilët po e drejtojnë, qoftë ata të cilët po ofrohen për ta drejtuar, nuk dallojnë përmbajtjesisht dhe nuk do të dallojnë as me rezultat. Këtë e kemi e thënë për vite të tëra dhe nuk besoj se ka ndërruar as tani. Pra, nuk është çështje thelbësore se kush e drejton, ndonëse ka rëndësi, çështje thelbësore janë parimet e rregullat mbi të cilat i vendosim. Pra, gara është mbrapsht. Gara është kush po i thyen këmbët i pari për të shkuar që ta bëjë marrëveshjen me Serbinë, e jo çfarë marrëveshje.

Hashim Thaçi është mjeshtër i manipulimit të opinionit publik. E ka nxjerrë një temë, si ndarja e Kosovës, që t'i arrijë dy efekte. Efekti i parë është që kur ta pranojë autonominë substanciale për serbët në Kosovë, të thotë “unë jam shpëtimtar i ndarjes së Kosovës”. Nuk ka ndarje të Kosovës. Është gënjeshtër, është mashtrim dhe është ide për të krijuar frikë dhe panik që kur të shpëtojë Kosova e ndarë nga brenda, të duket që ky megjithatë e shpëtoi. Jo pse nuk do Hashim Thaçi ta ndajë, ose do, jo pse nuk do Vuçiqi ta ndajë ose do ta ndajë, por rrethanat gjeopolitike nuk e lejojnë një gjë të tillë, përveç nëse na ndodhin disa ndryshime të mëdha që ne nuk i dimë.

Pra, nëse nisin konflikte të reja, e jo konflikte të vogla, dhe nuk mund të izoloohen vetëm në Kosovë më. Kështu që çdo tendencë për të folur për ndarjen e Kosovës, është plan që ta amortizojë autonominë substanciale që po përgatitet për veriun në veçanti, por edhe për pjesën tjetër. Kështu që kjo do të duket si shpëtim pastaj, ngase kushdo që e ka përfytyrimin për një ndarje të Kosovës, normalisht që kur të vijë autonomia, përfytyrimi është që shpëtuam, e në fakt nuk shpëtuam. Në fakt u bë më keq sesa që jemi tani.

Plani i dytë i Hashimit, si gjithmonë, është për ta shmangur vëmendjen nga përgjegjësia që e ka nisur dialogun pa mandat. Ai nuk na ka pyetur ne si Kuvend, as shoqërinë, as nuk ka platformë. Dëgjoni, platforma nuk nënkupton atë që themi “ne jemi për shtetin e Kosovës, shtet të pavarur, sovran” etj., etj. Platforma nënkupton që një problem që e ke, i cili po të imponohet për ta diskutuar, e që është marrëdhënia e shtetit të Kosovës me serbët e Kosovës, ta kemi planin se si duhet ta adresojmë. Nëse ti thua se “unë do ta ruaj sovranitetin”, nëse ti thua “do ta ruaj integritetin territorial”, kjo i bie që ti do të bësh marrëveshje. Fjalë të tilla ne kemi dëgjuar në këtë Kuvend, jo vetëm nga Hashim Thaçi, por edhe nga plot të tjerë, “nuk negociojmë për Kosovën”, “nuk negociojmë për të drejtat e shtetit të Kosovës”. Për territorin e Kosovës gjithmonë do të negociosh. Çështja është, a ke plan që e ruan shtetin e Kosovës, por e bën një ofertë për zgjidhjen e problemit të Kosovës.

Kosova nuk ka pasur asnjëherë, Serbia ka pasur gjithnjë, dhe a e dini çfarë ka ndodhur? Bashkësia ndërkombëtare e ka shkruar një propozim për kërkesat e Serbisë, duke ia refuzuar disa për shkak se e ka pyetur palën e Kosovës pak se çfarë po ia merr mendja. Edhe realisht nëse e shikoni planin e ish-presidentit të Serbisë, dhe e shikoni rezultatin e marrëveshjes së Asociacionit, diku 80% e atij plani është realizuar. Planin e ri që do ta paraqesë Vuçiqi, shikoni nëse ne nuk shkojmë me platformë të re, afro 80% e tij do të realizohet në marrëveshjen e re. Kështu që ky është plani i dytë i Hashim Thaçit që ta shmangë vëmendjen nëpërmjet idesë së ndarjes nga përgjegjësia e drejtimit të dialogut pa konsensus dhe pa plan.

Dua të flas për opozitën, dhe po shpresoj që do të kuptohem drejt. Jemi tri parti opozitare dhe nuk jemi e njëjta parti. Tendenca e cilit do prej neve, grupeve, për t'ia imponuar planin e mendimin tonë njëri-tjetrit është në favor të pushtetit.

Ne kemi qenë në opozitë edhe në mandatin e kaluar, dhe arsyeja pse ka pasur rezultat ajo opozitë ka qenë se jemi bërë bashkë, duke ia toleruar dhe duke ia mirëkuptuar dallimet që i kemi në çështje, dhe duke i nxjerrë vetëm temat e përbashkëta. Po të hynim në opozitë atëherë, për ta qartësuar deri në fund e për t'u barazuar, për të thënë “ja, kjo është e vërteta”, nuk do të ishte e mundshme opozita. Prandaj, tendenca e cilitdo prej nesh që ta drejtojmë gishtin nga opozita është gabim kësaj radhe. Në fakt, është për t'i shërbyer marrëveshjes me vetëdije, ose pa vetëdije.

Ftesa e PSD-së është e qartë. Meqenëse s'po mund të bëjmë platformë, meqenëse s'po mund të bëjmë konsensus me gjithë Kuvendin, ejani të ulemi partitë opozitare dhe ta ndërtojmë platformën tonë të veprimit, qëndrimin tonë për dialogun, për zgjedhjet, për çfarëdo. Edhe nëse PSD-ja dëshiron që ta mbajë Qeverinë, që këtu po pretendohet shpesh që kryetari i grupit i ka ofruar nënshkrimet, kur të doni e bëjmë, nëse ka nevojë edhe Vetëvendosjes ia japim ato nënshkrime, meqenëse nuk na i keni kërkuar, por ua kemi dhënë, nëse do ta rrëzosh e shkon e akuzon, kjo i bie që ti nuk do t'i marrësh votat e PSD-së.

Prandaj, po them - çështja është që ai që është më i madhi me numra në Kuvend, i dyti a i treti, ta marrë përsipër dhe ta bashkojë këtë opozitë. Arsyeja pse është bashkuar opozita herën e kaluar ka qenë që Vetëvendosje ka qenë subjekti më i madh dhe e kemi marrë përsipër dhe e kemi ofruar veten dhe kemi bashkëpunuar edhe me AAK-në dhe me Nismën. Nëse doni ta bashkoni opozitën për ta shpëtuar sa është e mundur, t'i ndalim këto të këqija në këtë vend, kjo është përgjegjësi e secilit prej nesh. Nëse doni të tentoni të paraqitni që dikush po i ndihmon, e dikush nuk po i ndihmon, e para del që është e pavërtetë, sepse i keni marrë nënshkrimet, e po e shoh që nuk po i jepni ju. E dyta, e dëmtoni. Ne nuk jemi në një parti politike me asnjërin, por mund ta ndërtojmë një platformë. Po ju bëj ftesë publike, nëse doni, nëse nuk e merrni ju primatin, po ju bëjmë ftesë edhe shkrim, dhe po ulemi e po e diskutojmë, nëse e keni përnjëmend. Nëse nuk e keni përnjëmend, në rregull është, dhe kjo është qasje e juaja.

Dhe, krejt në fund, besoj që duhet ta kemi një përfytyrim se si ne duam ta zgjidhim problemin e dialogut me Serbinë. Dhe në këtë përfytyrim, e kam një thirrje, e cila duhet të jetë sa më e sinqertë prej anës sime, por shumë më shumë e mirëkuptuar nga të tjerët, çështja e shqiptarëve në Luginë nuk duhet përdoret si mall për kusuritje. E dëgjova Presidentin, i cili tha do ta kisha marrë Luginën, dhe tha që nuk do të ketë ndarje. Çka nëse do të ketë ndarje, merremi me juve, nëse nuk ka ndarje, ju bëni çfarë të doni.

Është gabim kjo qasje, e cila është ndjekur në vazhdimësi. Nëse shkojmë te zgjidhjet, të cilat po i bën ky pushtet, atëherë duhet të ketë reciprocitet dhe të ketë përfshirje të shqiptarëve të Luginës. Është gabim çfarë jemi duke bërë me këtë çështje, është e padrejtë dhe e padobishme.

Kështu, kërkoj nga Qeveria, meqenëse Presidenti nuk po e bën, t'i thërrasë ata njerëz dhe ta marrë vesh se çfarë po duan, dhe ta bëjmë takimin, jo të themi se s'ka ndarje, por t'i dëgjojë seriozisht, sepse e keni obligim si Qeveri e Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryeministri i Kosovës, zoti Ramush Haradinaj.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Kërkoj falje, më herët nuk e kisha përfunduar fjalën. por dëgjoja zëra për një rezolutë. Shikoni, pa dashur të hyj në nene veç e veç, asnjë rezolutë e këtij Parlamenti nuk flet për dialogun final, për marrëveshjen ligjore obligative ndërmjet dy shteteve. Flet për një proces normalizimi, bazuar në ato që kanë ndodhur në atë kohë. Pra, më 19 prill, çfarë keni bërë.

Merrini këto katër rezoluta, lexojini me kujdes, e shihni vetë. Nëse ju doni ta vlerësoni njëherë nga këto, që vlen për këtë fazën finale të dialogut është diçka tjetër. Por, lexojini mirë, e shikoni, e fundit është më 2012, e ne sot jemi në vitin 2018. Në atë kohë, në procesin e normalizimit me Serbinë kanë qenë këto marrëveshje. Edhe është ky raport. Të sigurt e keni. Analizojeni mirë, e shikoni. Sido që të jetë, çfarë dua t'ju them sot juve, deputetë të nderuar.

Unë po e shoh, e keni hapur debatin, por me gjasë jo te thelbi i debatit, por te shumë elemente të caktuara, që na kanë zënë rrugën gjithnjë. Na e ka zënë rrugën mosbesimi ndaj njëri-tjetrit, na e ka zënë rrugën mosbesimi në Thaçin, ose në ndonjë tjetër. Na e kanë zënë rrugën plot tema të gjithë neve. Por, ajo që dua t'ju lus si deputetë, është mos e harroni këtë: një temë e vendit tuaj mund të shtrohet në tavolinat e vendimmarrjeve edhe pa kontributin tonë, edhe pa rolin tonë, dhe mund të ecin disa procese në mënyrën sikur kanë ecur në të kaluarën, e ne i kemi vajtuar pastaj qindra vjet, ose kemi provuar t'i sanojmë, por ka qenë vështirë të sanohen.

Për këtë arsye, unë dua t'ju them kështu, ajo që ka bërë Parlamenti në të kaluarën nuk është për dialogun që vjen. Keni bërë çfarë keni bërë, kemi bërë sa kam qenë dikur deputet me ju. Merreni në dorë procesin e ardhshëm të dialogut si Parlament, ka mjaft kontribute deri sot, ka mjaft

rezoluta deri sot, nuk ka parti në këtë Parlament që s'e ka pasur një ide, një rezolutë, një propozim. Sikur të ishin të vlefshme ato të mëhershmet, nuk e di pse do të kishim bërë të reja. Pra, shiheni, është një proces tjetër, sugjerimi është: uluni së bashku, merrini këto kontribute, është një edhe nga kryetari Veseli, është një nga LDK-ja, nga PDK-ja, nga Vetëvendosja.

Nuk e di kush nuk ka shkruar, nuk ka dhënë mendime. PSD-ja, Aleanca të gjithë. Uluni e merreni, pra jepeni ju vendimin për procesin, me këtë, kur po e them me këtë, shikoni, mos mendoni se në këtë kohë mund t'i lajmë llogaritë me njëri-tjetrin. Llogaritë e brendshme politike tërë jetën vazhdojnë, por në këto tema të ndjeshme si kjo, analizojeni si ta nxjerrin temën në këtë kohë. Ju kisha lutur të keni kujdes, pra të gjithë vendimmarrësit, qofshin ata të nivelit botëror, qofshin të kontinentin tonë, nëse e kanë paraparë një kohë të caktuar për temën tonë, në fund do t'ia japin një epilog kësaj teme, në fund të kohës së caktuar. E ne do të jetojmë me atë epilog.

Nëse nuk e japim pjesën tonë, kontributin tonë, në duar të kujt do që e lini, nëse e lini veç në duar të Qeverisë ose të institucioneve, do të jetoni me kontributin që e kanë dhënë institucionet në këtë temë. Nëse hyni edhe vetë, merrni përgjegjësi, do të jetojmë me kontributin që kemi dhënë të gjithë. Kjo është bindja ime prej informatave që kam, prej asaj nëpër çka kaloj. Duke qenë kështu, nuk dua të ju mendoj tepër, e sot po e shoh që po flasim përplot elemente përbërëse ndoshta të pozicionit të Kosovës, u fol këtu për Preshevën, u fol për të drejtat e serbëve në Kosovë, për interesat e Serbisë që provon t'i ruajë dhe t'i mbrojë në Kosovë në vazhdimësi. Por, janë edhe temat e dëmeve ekonomike që janë shkaktuar në të kaluarën në Kosovë, dëme njerëzore, e plot tema. Të gjitha këto.

Mos harroni, ajo që po synohet të arrihet në tavolinë është një kontratë definitive ndërmjet dy vendeve në të cilën do të inkorporohen këto elemente. Edhe nëse aty është paraparë që dëmet ekonomike ose borxhi ekonomik i Serbisë ndaj Kosovës është në një shifër, pastaj mund ta ndryshosh vetëm nëse e dërgon në gjykata ndërkombëtare, por pastaj do të jetosh me atë shifër. Kjo vlen, qoftë për fondet e marra, qofshin asetet e kompanive tona, qofshin trashëgimia, a çka do qoftë. Njëherë kur ke numra, kur ke kontratë obligative ligjore ndërkombëtare do të jetojmë me ata numra. Pa folur për këto anët emocionale, për anët tjera, historinë, të drejtat e krejt ato. Duke qenë kështu, nga ajo që shoh, ju kisha lutur, e keni një raport, vlerësojeni atë që ka shkuar në mënyrën më korrekte reale.

Por, jepini edhe rekomandime si duhet të ndodhë, qoftë nëpërmjet kësaj rezolute të propozuar, kyçuni të gjithë, jepni rekomandime si duhet të ndodhë procesi i ardhshëm. Nuk e kuptoj parlamentin e sotëm që duhet të ketë më shumë frikë se parlamentet në të kaluarën, t'u japë drejtim proceseve për vendin. Le ta lypin ashtu siç kanë vlerësuar në të kaluarën, le të vlerësojnë sot, le të ecin. Me këtë mund të them se konstelacioni i përfaqësimit të Kosovës, kryetari i Qeverisë nuk e ka mundësinë ta nxjerrë këtë temë dhe të merret vetëm me të. Do ta ndihmoj aq sa mund dhe sa mbërrin Qeveria, ashtu si me dialogun teknik, kolegu Avni Arifi e kolegë të tjerë,

të rinj e të reja të këtij vendi janë pjesë e këtij procesi dhe e bëjnë me profesionalizëm, por ta merrni pronësinë mbi këtë proces.

Nëse e bëni këtë, ju siguroj se Parlamenti e merr një vendim të vetin, atëherë e keni forcuar Kosovën, jo njërin prej atyre, cilin do qoftë që na përfaqëson, e keni forcuar pozicionin e Kosovës me tema që kanë të bëjnë edhe me mirëqenien ekonomike, pra jo vetëm fatin politik e të drejtën tonë historike, atë që jemi deklaruar ne, se dihet kush jemi. Por, me këtë ndihmoni edhe atë për të cilën votuesit tuaj presin prej juve. Unë kam ardhur sot jo për ta dhënë vizionin e Qeverisë për ju, por për t'ju ndihmuar në vizionin tuaj si Parlament, a doni t'i merrni përgjegjësitë si parlament. Disa herë rresht në këtë foltore ju kam thënë merrni përgjegjësitë në këtë proces. Sa herë që kam ardhur këtu, njëkohësisht ju kam sjellë një rezolutë njëherë herët, në pikën 9 të së cilës, krejt të drejtat për këtë proces ia kam bartur Parlamentit. Ka qenë Bibël, s'ka pasur të drejtë askush të prekë në të, zakonisht ashtu i merrni, ose Kuran. Faleminderit!

KRYESUESI: Replikë, a po do? Replikë, Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Vetëm një sqarim të shkurtër, që të kemi mirëkuptim rreth rezolutës që është miratuar në tetor të vitit 2012. Kjo rezolutë në radhë të parë është për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, flet për procesin e zgjidhjes së problemeve ndërmjet dy shteteve të pavarura, flet për sovranitetin, integritetin territorial, rregullimin e brendshëm, rendin unik kushtetues të Kosovës, flet për atë se kush do ta udhëheqë këtë proces, pa përcaktuar ndonjë afat kohor, por po ashtu edhe është protokolluar me numër 04-R08, datë 18 tetor 2012. Por, në vend se ta sqaroj unë, po e lexoj çka ka thënë atëherë në emër të grupit parlamentar të AAK-së, zoti Blerim Shala.

Ai thotë në emër të AAK-së pra se normalizimi të cilit i referohet, po i referohem transkriptit, kjo rezolutë e vitit 2012 nënkupton njohjen e ndërsjellë, pra njohjen e Kosovës nga Serbia, dhe po ashtu në paragrafin e fundit, kryeministri mund t'i gjejë në faqet 22, 23 dhe 24, thotë se kjo nënkupton anëtarësim të Kosovës në Kombet e Bashkuara dhe në organizatat e tjera. Pra kjo ka qenë ajo që edhe grupi juaj parlamentar që e ka votuar, siç dëshmohet në transkript, këtë rezolutë e ka nënkuptuar me rezolutën e tetorit 2012, e cila është protokolluar. Tash ju po hiqni dorë nga një mandat kushtetues, nga një prerogativë kushtetuese, të cilën jua jep jo vetëm Kushtetuta, por që ia ka dhënë edhe ky Kuvend cilësdo qeveri që vjen nga viti 2012 e këndeje. Me të njëjtën rezolutë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit. Kundër-replikë, zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Më 18 tetor 2012, Rezoluta që u thirr zonja deputete. Pra, 18 tetor 2012. Tash po ju lexoj rezolutën e datës 22 prill 2013. E keni besoj para vetes, ju ka rënë ta shihni. Çka thotë kjo rezolutë, shiheni! Për dhënien e pëlqimit për nënshkrimin e marrëveshjes së parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, dhe e elaboron më tutje. Me këtë, dua t'ju them se rezolutat të cilat i keni aprovuar në atë kohë i janë dedikuar atij procesi që ka qenë duke ndodhur politik, çka nuk është politike me fqinjin tonë, por... A mund t'ju pyes pra kështu, ku e kemi votuar ne për këtë marrëveshjen e parë kur e kemi aprovuar në atë kohë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ka qenë pjesë e marrëveshjes finale, a është folur për një marrëveshje finale ndërmjet dy vendeve? Keni të bëni me një marrëveshje finale, me një kontratë që do të ndodhë. Merreni procesin.

KRYSUESI: Faleminderit. Zonja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë!

Secili deputet i ka minutat e caktuar dhe ka të drejtë ta marrë fjalën dhe të komentojë pas secilit që ka për të diskutuar në këtë Kuvend. Kjo Qeveri ka dashur të jetë transparente dhe t'i japë rol këtij Kuvendi në procesin e bisedimeve. Ju e dini se mostransparenca e Qeverisë së Kosovës e pati sjellë Kuvendin në një arenë dyluftimesh, sepse fillimisht janë nënshkruar marrëveshjet, e më pas janë sjellë në Kuvendin e Kosovës. Tash nga kjo Qeveri ende asnjë marrëveshje nuk është arritur. Asnjë marrëveshje nuk guxon të arrihet dhe që bie në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, andaj duke u bazuar në këto ngjarje, Qeveria e hartoi një platformë për procesin e dialogut, mirëpo partitë parlamentare të cilat thirren në konsensus për tema të mëdha të Kosovës nuk po mund të dalin nga lëvozhga partiake, e kjo nuk u pa edhe seancën e kaluar me mosvotimin e shumë marrëveshjeve ndërkombëtare për fonde milionëshe që janë në interes të qytetarëve.

Kur platforma erdhi në komisionin parlamentar kërkuam që të votohet për t'u sjellë në Kuvend, për t'iu nënshtruar një debati, me mundësi të plotësimit të kësaj rezolute, e cila do të miratohej në Kuvendin e Kosovës dhe çdo marrëveshje fillimisht do të votohej me dy të tretat e votave të deputetëve. Jemi në fazën finale të bisedimeve dhe krejt çka kërkohet është që në delegacionin e bisedimeve të përfshihen përfaqësues nga secili grup parlamentar. Është mirë që ajo çka po thuhet sot këtu, është mundësia e secilit që po debaton, të gjitha ato t'i thotë në tavolinën e bisedimeve në Bruksel. Gjykata Ndërkombëtare e ka dhënë verdiktin për pavarësinë e Kosovës. Kosova është e pavarur dhe me kufij të pranuar ndërkombëtarisht. Askush nuk po e diskuton nga Qeveria dhe nuk e mirëpret nga miqtë ndërkombëtarë idenë e ndryshimit të kufijve. Kushdo që i plason këto ide, janë ide që nuk janë ide të miqve tanë, por të kundërshtarëve të pavarësisë dhe të sovranitetit të Kosovës.

Kërkesë e imja është të mos gënjëhet populli, sepse nuk ka ndryshim të kufijve. Krejt çka do të ndodhë është se dialogu duhet të vazhdojë dhe të përfundojë me njohjen e pavarësisë së Kosovës dhe nuk ka kompromis tjetër. Dhe tash shikoni, në vend se të unifikohet një rezolutë, nuk po arrin, sepse secili subjekt e ka një rezolutë, dhe këtu po shihet serioziteti i këtyre subjekteve. Më kujtohet në vitet e nëntëdhjeta e deri te lufta, e kam parë se shumë personalitete, duke dëgjuar fjalimet e tyre plot elan e patriotizëm, kam menduar se lum kombi ynë që i ka këto personalitete dhe se me fillimin e luftës do të jenë në ballë të frontit, dhe këta patriotë me fillimin e luftës, ata individë gjetën strehim në Shqipëri, Mal të Zi dhe në vendet e tjera të Perëndimit.

Edhe sot në Kuvend po shohim shumë patriotë që po flasin me plot patriotizëm se çka duhet të bëhet dhe si duhet të veprohet. Por, pse nuk po e merrni guximin të jeni në tavolinën e bisedimeve dhe vetë personalisht t'i mbronni këto qëndrime dhe të flisni edhe për temën e të pagjeturve dhe për temat e tjera të cilat po i theksoni sot. Shkoni e mbrojeni shtetësinë dhe shtetin e Kosovës. Nëse ju nuk e bëni këtë, thjesht po dezertoni dhe po i ikni përgjegjësisë që e keni si të votuar të popullit dhe presidentin Hashim Thaçi po e merrni si motiv që t'i ikni përgjegjësisë. Lini fjalimet dhe bëhuni pjesë e ekipit, sepse e keni obligim dhe përgjegjësi ndaj shtetit të Kosovës dhe ndaj qytetarëve të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Fjalimin tim po e filloj me një histori për Ataturkun, themeluesin e Turqisë moderne, i cili për fatin e tij ka pasur origjinë shqiptare. E kam parë një dokumentar, ku një shkrimtar i madh turk thotë Ataturku ka qenë krejt si turqit, por vetëm një diçka e ka dalluar prej turqve, inati i shqiptarit. Ismail Kadareja, disa herë kam zhvilluar intervistë me të, ma ka thënë një diçka, të gjithë popujt e kanë fjalën inat ose smirë, neve na është dukur pak edhe ia kemi shuar atë zinë prapa, inatëzi, smirëzi.

Krejt debati politik, edhe në të kaluarën, edhe tash është duke u zhvilluar mbi bazamentin e inatit shqiptar. Disa thirren në histori, disa në liderë politikë, dhe asnjëra nuk qëndron. Po të ishte gjallë ish-presidenti Rugova, jam shumë i sigurt se disa deputetë nuk do të debatonin fare për dialogun me Serbinë. Se a do të bëhet dialog me Serbinë, se a do të vazhdojë dialogu, jo që është në mënyrë absolute 100 për qind. Po, po, po...! Por, ju po e harroni faktorin kryesor kush e vendos këtë punë; a e vendosëm ne Atifete Jahjagën për presidente të Kosovës, a na erdhi presidentja midis zarfi dhe veç kur e çeli Kristofer Delli, dhe tha “bujrëm se këtë keni për ta pasur presidente”.

Ju të gjithë disa që paraqiteni trima e që thirreni në histori, e që e shani Hashim Thaçin, e që vetë e keni zgjedhur për poste, dikush të bëhet ambasador, dikush konsull, dikush që të ketë privilegje të tjera, dikush ka lobuar poshtë e lart që i kam përmendur këtu me emra e mbiemra. Sot jeni

çuar aras për të thënë ne po e shajmë Hashim Thaçin. Ju nuk po e shani Hashim Thaçin. Hashim Thaçin nuk po e shani, por po e shani ardhmërinë e Kosovës dhe po e shani dialogun, në vend se të flasim ne se çfarë platforme të dialogut do të ndërtojmë këtu. Këtu nuk ka parime, në politikë të Kosovës nuk ka parime. Këtu do të dalë dhe të flasë dikush që të marrë poenë në Drenicë, tash unë të nisë për fshatin tim Obri, prej nga vij, t'ju tregoj pak poezi e histori për Likocin, prej nga është gjyshja ime, pak histori për Llaushën, prej nga është nëna ime, pak për Prekazin që i kam kushërinj të gjakut, e tash të them se krejt këta që i kam përmend, do të më votojnë në mandatin e ardhshëm.

Juve ju ka kapur frika dhe thoni se në mandatin e ardhshëm nëse nuk vijmë në Parlament, a kishim për të shitur fara të kungujve, a kemi për të punuar në ferma të kafshëve, apo me domate. Shumica prej juve nuk keni ardhmëri në politikë dhe pasiguria që jua shkakton nga brenda boshllëku, vakumi njerëzor, politik, kombëtar, ju krijon turbulenca shpirtërore, e të mos them politike. Ju vetëm flisni këtu sa për të folur dhe sa për të marrë ndonjë votë. Disave u është prishur navigacioni. E kam pasur një kushëri, kur dilte në Komoran, thoshte kam qenë në Zagreb. U është prishur navigacioni politik. Nuk po e kuptoni se dialogun e vendosin Bruksel dhe Uashingtoni, numër një. Ju nuk po e kuptoni se Serbia ta çon presidentin, ti ke për ta dërguar presidentin. Serbia ta çon kryeministrin, ti duhet ta çosh kryeministrin. Çka duhet të bëjmë ne në krejt këtë tollovi?

Ne duhet të ulemi krejt partitë politike, jo pozitë e opozitë, nuk ka pozitë e opozitë për dialog. Të bashkohemi dhe ta ndërtojmë platformën politike, t'i vëmë kornizat e një platforme të dialogut dhe t'i themi jo presidentit Hashim Thaçi, por delegacionit, se kjo platformë nuk guxon të shkelet, kjo platformë nuk guxon të rrëzohet, sepse është tradhti kombëtare.

Tani lind pyetja, a do të ketë kompromise të dhimbshme, a do të jetë në tavolinë çështja e ndarjes së Kosovës. Unë po ju them, po. Unë po ju them se do të jetë në tavolinë edhe ndarja, edhe ka qenë ndarja, edhe është ndarja. Ja Vjosës po ia përmend emrin, për të ma vërtetuar, pasi e di shumë mirë. Edhe ne që jemi disa spiunë ndërkombëtarë, që takohemi herë në Bruksel, herë atje, na thonë neve se po është ky opsioni i ndarjes në tavolinë, pa asnjë diskutim. Edhe ai shkëmbimi i territoreve, mos kujtoni se Lutfi Haziri nuk është budalla, nuk ka folur krye më vete. Ai nuk ka folur në emër të LDK-së normalisht, edhe unë nuk guxoj t'i flasë këto fjalë në emër të Nismës, sepse si të kthehem atje më thonë kush të tha të flasësh emër të Nismës. Pra, po flas si deputet i Parlamentit të Kosovës. Pasha tokë e pasha qiell, po mos t'ia thoshte ndonjë zyrtar i lartë ndërkombëtar Lutfi Hazirit opsionin e ndarjes dhe shkëmbimit të territoreve, ai as ëndërr s'do të kishte guxuar ta përmendë. Harrojeni këtë farë pune! Ia ka thënë dikush prej amerikanëve, sepse amerikanët e thonë shumë qartë se nuk ka vija të kuqe.

Më ka pëlqyer Albin Kurti, e ka përmendur në një shkrim dje Konferencën e Londrës. Unë dua të shkoj më tej, dua të përmend Konferencën e Versajës. Aty kanë shkuar tetë delegacione

shqiptare dhe bota s'e ka ditur me kënd po bisedon. Po e lëmë anën historike, por po vijmë te Rambujeja. Pas Dukagjin Goranit dhe Xhavit Halitit, jam njeriu numër tre që e di qysh ka shkuar Rambujeja, si janë gjuajtur me shpuzore, çka ka thënë Bujar Bukoshi atje, që ka thënë ueeee. D.m.th., po të mos ishin amerikanët, po mos të ishte dada Medlin Ollbrajt me Toni Blerin e Xhejms Rubinin, pasha besën gullash do të na kishte bërë Serbia. Po, Zoti i madh në qiell e ata na lutnin sikur fëmijëve, “ejani, nënshkruajeni”.

Por, taktika e Milosheviqit për të refuzuar çdo dialog, çdo bisedë në tavolinë, e ka gjuhëzuar Milosheviqin. Pra nëse duam të marrim mësim nga historia, shikojeni pak Milosheviqin. Edhe te Gjykata Speciale, që thoshit jo pse po votoni, jo s'po votoni. Kurrfarë gjykate speciale Serbia nuk ka pasur, por kanë hyrë e kanë lidhur Milosheviqin në Beograd si qenin, edhe Mladiqin, edhe Karaxhiqin, e më falni se e fyeva qenin, se ai nuk bën të krahasohet as me qen, Milosheviqi pra. Prandaj, janë procese, në mënyrë absolute që varen nga Brukseli dhe nga Uashingtoni.

Dëgjoni çfarë po ju them, nëse ne si klasë politike dhe parlament, e krijojmë një klimë të disfavorshme politike, nëpërmjet së cilës neve na e kthejnë shpinën Brukseli dhe Uashingtoni, ky do të ishte çmimi më i rëndë që do të paguajë populli i Kosovës. Ne e kemi rrejtur që 18 vjet qytetarin e Kosovës se po të fitojmë ne, e bashkojmë Mitrovicën. Pasha besën, unë po ju them kushdo fitoni 100 apo 120 deputetë, pa miratimin e Brukselit dhe Uashingtonit, as nuk e bashkon Mitrovicën, as nuk i ndërron territoret, as nuk ke shkëmbim terriroresh. Sepse tani, duke folur, ne po dalim më trima se Ramush Haradinaj, më luftëtar e Zoti na ruajt, ashtu siç e kërcënonin Malin e Zi.

Prandaj, po e përfundoj fjalimin, ju bëj thirrje të gjitha partive politike, hajde të ulemi të gjithë bashkërisht, ta ndërtojmë një platformë politike dhe mbi bazën e asaj platforme të shkojmë në Bruksel. Unë mendoj se për të mirën e qytetarëve të Kosovës, kontributi ynë si deputetë kërkohet sot vetëm mbi ndërtimin e një platforme të qartë. Po të pyetsha unë, i vetmi njeri që do të udhëhiqte dialogun me Serbinë do të ishte Adem Demaçi. Por, Adem Demaçin ne nuk e zgjodhëm as deputet, as kryeministër, as president, kështu që ai na shkoi. Prandaj, ulemi e bisedojmë; në qoftë se ne si Parlament e bëjmë platformën politike, ju garantoj se presidenti Thaçi nuk mund ta shkelë atë platformë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! S'ka replikë a? Fjalën e ka Korab Sejdiu.

KORAB SEJDIU: Të dashur qytetarë,
Të nderuar kolegë!

Po flasim sot për një çështje të jashtëzakonshme dhe pesha rritet duke pasur parasysh faktin se po flitet se nëse jetësohet ajo që po thuhet se është përmbyllja e çështjes Kosovë-Serbi. Unë mendoj se kur flasim për këtë çështje, mund t'i adresojmë tri shtylla, apo duke iu përgjigjur tri pyetjeve: kur, kush dhe për çka? Më duhet t'i adresoj këto pyetje një nga një.

Së pari: kur? Ne mund të dialogojmë vetëm atëherë kur kemi bërë analizë të mirëfilltë se a është momenti i duhur që tani të adresohet kjo çështje me shpejtësinë e aluduar. Ne po shpenzojmë miliona euro të buxhetit të shtetit për të tentuar ta rehabilitojmë imazhin e disa personave që nuk janë të rehabilitueshëm. Pse të mos i shpenzojmë ato miliona euro nga ky buxhet në vend të asaj në të mirë të Kosovës, për të angazhuar ndoshta edhe ekspertë të jashtëm që e kuptojnë ndoshta edhe më mirë se ne të ardhmen dhe të na ndihmojnë për të përcaktuar se kur duhet të dialogojmë. Pra, dialogojmë vetëm atëherë kur kemi përgatitje dhe kapacitet të plotë të brendshëm për t'u ballafaquar me palën tjetër, me Serbinë. Vetëm atëherë kur kemi platformë të qartë me mandate, prioritet dhe kufizime edhe më të qarta. Ne mund të flasim me Serbinë vetëm atëherë kur përmbushen marrëveshjet, të cilat janë nënshkruar e nuk po zbatohen nga ajo, kur Serbia të shpallë moratorium të gjitha sulmet që po ia bën Kosovës, edhe brenda Kosovës, por edhe jashtë saj. Pra, po flasim për një moment kur ka angazhim të sinqertë nga Serbia për dialog, kur vjen në tavolinë me mirëbesim.

Çështja e dytë që unë mendoj që është tepër e rëndësishme, është kush? Kush na përfaqëson? Në rrethana normale, është ky Kuvend, natyrisht jo vetë deputetët, po një person, një ekip, të cilin e mandaton Kuvendi. Fatkeqësisht në këtë kohë kur ne po dialogojmë, po bisedojmë, besa edhe kur opozita po merret më shumë me vetveten, çka po ndodh. Presidenti po e uzurpon pikërisht mundësinë dhe mandatin për ta përfaqësuar Kosovën në këto bisedime. Unë nuk dua të flas sot për të metat e tij personale, morale e konfliktet e interesit, qëllimet egoiste të mbijetesës politike, e kështu me radhë. Po patjetër më duhet ta përmend atë që po e flasin pothuajse të gjithë ekspertët e drejtës kushtetuese. Shumë ekspertë e kanë diskutuar këtë çështje kohëve të fundit, por po flas për ata që vërtet e njohin lëmin dhe pothuajse në mënyrë unanime pajtohen që mandati kushtetues nuk i jep presidentit të drejtën që të na përfaqësojë, pa e marrë atë mandat prej këtij Kuvendi. Të gjithë pajtohen, këtë mandat nuk e fiton, pavarësisht frikës që mundohet të mbjellë te qytetarët nënëpërmjet lajmeve të rrejshme që i instalon në portale dhe mediumet, të cilat i shërbejnë atij dhe disave në pushtet.

Deputetë të nderuar,

Kjo është olimpiada e olimpiadave për dialogim dhe për negociata politike me Serbinë për të mirën e vendit dhe qytetarëve tanë. Kërkon përgatitje të jashtëzakonshme, përfaqësim prej më të mirëve të më të mirëve që mund të ofrojnë. Nëse mund ta kthejmë në terme që i njohim pak më mirë, na duhen Majlindat e Kosovës për dialogim politik. E çka bëjmë ne? Neve na përfaqëson presidenti, a vërtet kemi mbetur në atë derexhe? A nuk po mund të gjejmë njerëz që janë më të përgatitur edhe më adekuatë për t'i përfaqësuar interesat e Republikës së Kosovës? A vërtet interesat tona duhet të përfaqësohen nga një person, i cili ka histori të gjatë dështimesh në raport me Serbinë, veçanërisht në dekadën e fundit. Dikush që nuk ka as mandat kushtetues e as legjitimitet politik! Unë, si shumica e qytetarëve mendojmë se jo. Në fakt, që nga viti 2012 këtë rol edhe juridikisht e ka Ekzekutivi, natyrisht jo i vetëm, pasi që po flasim për diçka të rëndësishme historike dhe jetike për Kosovën. Rezoluta e 2012-ës që u përmend nuk e përmend Hashim

Thaçin me emër për të qenë pronë e tij personale, por e vesh kryeministrin, përkatësisht ekzekutivin me këtë detyrë dhe përgjegjësi. Shpresoj që kryeministri të ndërrojë mendje dhe të zbatojë urdhrat e punëdhënësit të tij, përkatësisht legjislativit. Vetë, kryeministër, keni thënë që jeni për punë të rënda, sot punë më të rëndë se kjo nuk ka. Nëse jo nga zoti kryeministër, ky Kuvend duhet të ofrojë alternativë...

KRYESUESJA: A ka mundësi për pak qetësi në sallë, ju lutem!

(Ndërhyrje)

Lidhur me atë se kush e përfaqëson vendin në këto bisedime, ide ka shumë, vetëm duhet zgjedhur së bashku alternativën më të mirë. Në fakt, ne e kemi obligim të bëjmë këtë dhe në ndërkohë është e rëndësishme të theksohet sa i përket pyetjes se kush? Le të jetë e qartë edhe për presidentin, edhe për Serbinë, edhe për BE-në si ndërmjetësuese, çfarëdo marrëveshje e nënshkruar nga ky president, nuk ka efekt juridik. Vlen vetëm personalisht për atë, për presidentin dhe askënd tjetër.

Si të tilla, as qeveritë e ardhshme, e veçanërisht qytetarët e këtij vendi nuk kanë obligim që t'i zbatojnë marrëveshjet e jashtëligjshme dhe jolegjitime. Pyetja e tretë, për çka? Edhe kjo përgjigje i ka dy komponentë, për atë se çka duhet të diskutohet, por edhe, më e rëndësishme, për çka nuk guxon assesit të diskutohet. Unë nuk besoj që ne mund t'u dalim vëllezërve dhe motrave tona nga Lugina përpara, nëse nuk kërkojmë reciprocitet të plotë për ta. Të kërkojmë që fati i të pagjeturve të zbardhet njëherë e përgjithmonë dhe familjet e tyre të pushojnë të qetë. Duhet të ketë zbatim të plotë të marrëveshjeve paraprake, të ketë reparacione nga lufta e shumë gjëra të tjera, që ne nëse i bëjmë së bashku, mund t'i adresojmë si platformë tonën të përbashkët. Po çka është edhe më e rëndësishme, kushdo që e diskuton ndarjen e Kosovës, krijimin e një mini-Serbie brenda Kosovës, faljen e krimeve serbe në Kosovë, pra heqjen e vijave të kuqe, vija të kuqe që janë bërë me gjakun e qytetarëve tanë, tradhton sakrificën, mundin edhe gjakun shekullor të këtij populli dhe ju siguroj që do të paguajë shumë shtrenjtë edhe para historisë, por edhe para vetë popullit.

Për fund, duhet theksuar se neve na duhet një qasje kolektive, një konsensus shoqëror dhe përfaqësim nga politika dhe jo vetëm, na duhen përfaqësues pa interesa personale dhe pa qëllime mbijetese personale apo politike, na duhet koordinim edhe me miqtë tanë, veçanërisht me Amerikën. Amerika që e njoh unë, nuk e lë mikun në lloç, në këto ditë, bile, më kujtohet një thënie e famshme e Jon F. Kenedit: "Le ta dijë çdo komb, pavarësisht a na e do të mirën apo të keqen, që do të paguajmë çdo çmim, do të mbajmë çdo barrë, do të ballafaqohemi me çdo sfidë, do të mbështesim çdo mik e kundërshtojmë çdo armik që të sigurojmë mbijetesën dhe suksesin e lirisë". Një Amerikë e tillë është krah nesh edhe në këtë sfidë, sepse jemi aleatë, sepse jemi vëllezër me ta. Por, të nderuar deputetë e qytetarë, Amerika nuk mund të na dojë neve më shumë

se ne vetveten. Prandaj na duhet një analizë e thellë dhe një planifikim strategjik, na duhet, të themi, një ‘dream tim’, i cili siguron që interesat e Kosovës të përfaqësohen ashtu si e meriton ky vend i bekuar. Ne kemi kapacitet ta fitojmë paqen, se na u pati thënë: “Luftën e fituat, por a do të dini ta fitoni paqen”. Unë besoj që ne kemi kapacitet ta fitojmë paqen. Të dalim fitues edhe nga ky proces, por krejt varet nga përgjigjja që ia japim një pyetje të vetme: a e qesim më së larti Kosovën, apo interesat personale të disave? Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka kryeministri.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Marrja e përgjegjësive nga Qeveria dhe ekzekutivi është edhe kjo formë e punës sot, duke qenë me ju në këtë temë. Rezolutën e vitit 2012 e kam parë prej Hagës, qysh i kam parë edhe disa procese të tjera, por e kam përkrahur atëherë dialogun. Kam qenë më herët i dakorduar prej opozite ta përkrah dialogun, nuk e kam bërë për hatër të ndokujt, as timin, as për hatër të Hashim Thaçit në atë kohë. Të gjitha proceset i kam përkrahur, por nuk kam qenë fizikisht në tavolinë. Unë nuk kam dalë kundër Rambujesë, por për të pasur sukses në Rambuje kam qenë në mal, ani pse kam qenë i thirrur të isha fizikisht ulur me ata të tjerët. I kemi ruajtur do garanci, do argumente që proceset do të shkojnë në rrjedhën e vet. Ne e dimë që çdo e arritur formale e karakterit juridik, të obligimeve juridike, do të vlerësohen në të ardhmen në bazë të zbatueshmërisë, nëse zbatueshmëria ka rezultuar edhe me një të arritur tjetër, pranohet.

Arsyeja pse unë nuk e marr përgjegjësinë është se unë dua ta ndihmoj vendin tim në këtë proces, unë nuk fshihem, nuk jam frikacak të ik prej temave, nuk kam ikur as atëherë, edhe kur ka qenë Rambujeja, as kur ka qenë ky dialogu para tij. I di rreziqet e marrjes së përgjegjësive, e di se çdo proces mund të mos shkojë perfekt, por ne perfekt s’kemi mbërritur deri këtu, kështu kemi mbërritur, pjesë-pjesë, duke hyrë në temë, duke dhënë diçka nga vetja, duke mbërritur diçka, duke marrë mësim, këtu kemi ardhur. Po ju them, po lidhem me Korabin. I kam dy vërejtje Korab, në ty: e para, është ti je jurist dhe pres prej teje të mos bësh gabime profesionale. Keni votuar presidentin, keni qenë 2/3 këtu, është i vetmi institucion që ka procedurën më të vështirë të votimit. Pra, nuk ka institucion tjetër në këtë vend që zgjidhet me 2/3 president. Me leje, veç mos e harroni këtë fakt, keni qëndruar në sallë 80 vetë, 2/3 e këtij Kuvendi për të pasur president. Me leje, lexoni pak Kushtetutën, pse të gjithë të tjerët zgjidhen më lehtë? Pse për Qeverinë duhen veç 61 të jenë në sallë? Dhe, ju e dini, edhe për të shkuar në zgjedhje tash, vetëm për Qeverinë shkoni, presidentin e keni aty. Nëse ka ndodhur kjo dhe nëse ekziston institucioni i presidentit, nuk mund ta kthesh Kosovën në pikën zero. Ka forma qysh kthehet, i dinë juristët, por jo kështu qysh po sillemi ne sot.

Është dashur të mendohet në atë kohë. Me leje, unë kam bërë koalicion me PDK-në, por s’kam bërë koalicion të bëhet Thaçi president. As nuk kam bërë koalicion që të bëhet Kadri Veseli kryetar i Kuvendit, ju e dini kush i ka bërë, ju e dini dhuratë të kujt i kemi, dhuratë të këtij krahu

të LDK-së. Presidentin Thaçi e kemi dhuratë të LDK-së, për ta marrë dikush udhëheqjen e Qeverisë, e ka bërë Thaçin president, ka qenë e pamundur të bëhet ndryshe, edhe zoti Veseli kryetar Parlamenti. Unë kam bërë koalicion me PDK-në sot, i kam marrë përgjegjësitë me ta, kam marrëdhënie korrekte me ta dhe i respektoj, po nuk i keni dhuratë prej meje dhe s'po e kuptoj hipokrizinë tuaj sot, të disave, që na i keni lënë këtu, e tash po thoni ndryshe. Ku keni qenë atëherë, kush jeni ju? Nëse doni t'i ndihmoni këtij vendi, kthjelluni pak, të mos i bëjmë gabimet një nga një. Vërejtja e dytë për Korabin: Amerikën po e përmend shpesh. Lëri amerikanët, se flasin vetë, ata na kallëzojnë për çka janë, ata s'po ndalën për ditë duke ardhur në Prishtinë e duke na thënë: “Mos dështoni, bëni ekip kredibil, uluni në tavolinë në mënyrë kredibile, mbrojeni të drejtën tuaj kredibile”. Krejt ata që i njoh unë, kështu po na thonë: “Bëni ekip kredibil”, po thonë “merruni vesh, uluni në tavolinë”, duke qenë që është kështu, ju lus, shikoni, Qeveria do ta përkrahë këtë proces me seriozitetin më të madh, unë do ta përkrah këtë proces. Unë do të respektoj të arriturat institucionale që i kam gjetur, pjesë e të cilave jam, por po ju lus, si Parlament merreni përgjegjësinë po ashtu, mos u fshihni nëpër bira të miut.

KRYESUESJA: Replikë, deputeti Korab Sejdiu!

KORAB SEJDIU: Zoti kryeministër, faleminderit për potencimin që presidenti është president, pajtohem që është, unë as nuk e kam zgjedhur, as s'e kam votuar, por sidoqoftë, është president. Por, nëse mund të më tregosh nëse ky president e paska atë kompetencë, pse nuk e pati Presidentja Jahjaga? Pse nuk e pati Presidenti Pacolli? Pse nuk e pati më herët Presidenti Sejdiu? Presidenti aktual atë kohë e mohonte, duke thënë që “ti je president ceremonial”. A qenka, do të thotë ky proces diçka personale, e lidhur me një person, apo në fakt, ne kemi institucione që janë të njëjta, pavarësisht kush e mban atë institucion? Nuk e shoh unë këtë si gabim profesional, sepse unë s'po flas për vete, po flas çka kam lexuar prej atyre që vërtet e njohin këtë çështje, e kanë trajtuar edhe në aspekt historik prej Kushtetutës së Vejmarit e tutje, dhe të gjithë pajtohen që në mënyrën se si është e formuar Republika jonë parlamentare është e tillë që institucioni i Presidentit në këto rrethana nuk e ka atë kompetencë, është legjislativi që të ka vesh, juve në këtë rast, jo drejtpërdrejt si person, po ekzekutivin, dhe unë kërkoj prej jush që ta zbatoni atë përgjegjësi që e ke dhe e ke marrë detyrën e kryeministrit.

Kështu që, ju lus, që vazhdoni punën, ne mund të përgatisim, duhet të gjithë të punojmë bashkë, jo vetëm pozitë, opozitë, duhet të gjithë së bashku të punojmë për këtë drejtim, por duhet të sigurohemi që jemi të përgatitur, jo një person të shkojë atje dhe pa e konsultuar askënd, pastaj më vonë të nënshkruajë marrëveshje që as nuk na i jep neve t'i konsultojmë. E sa i përket SHBA-së, SHBA-ja, po ju tregoj, kam jetuar në Amerikë një kohë shumë të gjatë. Nëse je i ligë, të ndihmojnë, por nëse do të të respektojnë, duhet të bëhesh zot i vetvetes. Unë atë po e kërkoj, ne të bëhemi zot të vetvetes dhe të vazhdojmë me ndihmën e tyre...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Zoti kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Korab, tri pyetje i pate, m'u duk. Kur dhe kush, qysh, a çka. Tash, unë po e shoh që ty të ka mbetur veç te kush.

Të dashur kolegë deputetë,

Unë po e di ku po na dhemb të gjithëve këtu në këtë sallë. Krejt, s'ka, hiç mos e fshihni këtë punë, krejt po e dimë, po pyetja është prej asaj dhimbje a doni ta lëmë këtë vend pa rezultatin që mund ta nxjerrë, a doni të arrini rezultat? Nëse doni rezultat, si Parlament mirë është të hyjmë në temë, t'i marrim përgjegjësitë, të përgatisim një rezolutë, ta autorizoni një delegacion të institucioneve dhe të opozitës, edhe të ekspertëve, besa, edhe t'i lajmëroni palët e të themi ne jemi të gatshëm të ecim tutje.

Po e marrim ndonjë variant tjetër: ne nuk e marrim përgjegjësinë, institucionet vazhdojnë të shkojnë, e përfaqësojmë Kosovën aq mirë sa dimë, ti the vetë që s'janë të mençur, e s'janë të mirë, se të mirët qenkan jashtë institucioneve, ose jashtë këtyre që i përfaqësojnë. Sido që të jetë, shikoni, po ju them kështu me kujdesin më të madh. Nëse kjo temë e kalon afatin e vet kohor, ciklin e vet kohor të agjendave të atyre që marrin vendime, disa prej të cilëve i përmende, gjysmën e tyre që janë gjysma kryesore, po ka edhe të tjerë, atëherë mund të mbesim në njëfarë konflikti të ngrirë, të cilin e kemi që nja dy dekada. Bukur shumë mund është dashur t'ia sjellim disave në agjendë këtë çështje, mundësisht t'i japim epilog. Kur kalon ky cikël kohor, ne do të vazhdojmë të vajtojmë qysh jemi mësuar, por nuk e di si do të jenë rrethanat e tjera, si do të vijë. Për këtë arsye, ju lus, mos e dështoni vendin tuaj, urdhëroni, uluni në tavolinë, bashkohuni këtij ekipi, kontribuoni, pengoni, ndihmoni, vlerësoni, shpjegoni qytetarëve, e në fund prapë votoni lirshëm, nuk ju obligon çfarëdo pjesëmarrje në votë të gabuar. Vota juaj është e lirë, po mos e leni vendin në mungesë të këtij cikli kohor. E di që jemi në prezantim publik, por shikoni, për shembull, presidenti i Amerikës, Donald Trump, ka shumë tema në agjendën e vet, kush e di sa i ka nëpër botë.

Pas shumë komunikimeve me plot zyrtarë të tyre që kanë ardhur deri te ne, e ne që kemi shkuar atje, kemi mbërritur disi vëmendjen e Uashingtonit zyrtar, e deri në tavolinën e presidentit, e të nënkryetarit Pens, e sekretarit Pompo, e të tjerëve ta kenë afërsisht çështjen tonë se ka mbetur kështu. Kancelarja Merkel, e dini sa punët i ka, qysh i ka problemet, jemi afruar deri te zyra e saj, e të tjerëve. Tani, a duam të nxjerrim diçka prej kësaj, a e lëmë kështu si është, është në përgjegjësinë tonë. Qysh kishim mund ta nxjerrim? Kishim mundur ta nxjerrim, ju siguroj, mund të mos jemi dakord në çdo kohë, nuk është marre të marrim pjesë në proces e në fund të themi s'mjafton kjo, s'është në rregull për Kosovën. Kishim mundur ta nxjerrim nëse Parlamenti e merr rolin e vet, e autorizon delegacionin e vet, presidentin, kryeministrin, kryeparlamentarin, opozitarët, grupet punuese, komisionet, ekspertët dhe thotë këtu jemi.

Sot dikush mund të jetë president, nesër tjetri, dikush kryeministër, nesër tjetri, kushdo qoftë, por delegacion nacional. Në emër të këtyre që punoj me ta jemi të hapur, edhe kjo është një konsensus yni dhe një ftesë për partitë politike opozitare, ju lutem, merreni rolin tuaj po ashtu në këtë proces.

KRYESUESJA: Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zonja Dërguti!

Kërkoj falje dhe kërkoj ndjesë për shkak të temës dhe specifikës që e kemi sot. Sidoqoftë do të bëj një përjashtim të shkurtër për shkak të humbjes së regjisorit dhe profesorit të Fakultetit të Arteve, zotit Bekim Lumi, i cili ka vdekur sot në Prishtinë. Unë i shpreh ngushëllime gjithë komunitetit artistik në Republikën e Kosovës. Mendoj që zoti Lumi ka dhënë shumë për artin dhe veçanërisht për teatrin në Republikën e Kosovës, prandaj nga ky Parlament unë shpreh ngushëllimet e mia të sinqerta familjes dhe gjithë komunitetit artistik në Republikën e Kosovës.

Zonja Dërguti, do të vazhdoj me temën time të diskutimit.

Atëherë, konsideroj që procesi i dialogimit, apo më mirë të themi faza finale e bisedimeve pa dyshim që është njëra prej proceseve më të rëndësishme dhe më sfiduese të vendit që nga shpallja e Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran. Prandaj, pajtohem me deklaratimet e kolegëve të mi që një temë e tillë është dashur të diskutohet në këtë Parlament dhe e kemi mirëpritur edhe si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës që të diskutohet sot këtu. Klasa politike në Kosovë mendoj që është përballë një konsensusi apo pajtimi të të gjitha partive politike që veprojnë në Kosovë dhe për një proces si ky nuk do të duhej që të kishte hisedarë më shumë nga Qeveria apo nga partitë në pozitë, e aq më shumë që opozita do të duhej që të mos e përjashtojë veten nga një proces i tillë tejet i rëndësishëm. Tema e cila po diskutohet sot në këtë Kuvend do të duhej të ishte përgjegjësi e të gjithë aktorëve politikë në Republikën e Kosovës, pozitë dhe opozitë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Është e domosdoshme të sigurojmë një pajtim politik, në mënyrë që Kosova të përfaqësohet në nivelin më të mirë të mundshëm përballë shtetit serb, meqë është ndër proceset më të rënda dhe Kosova nuk e ka luksin që një proces të tillë të jashtëzakonshëm të futet e përçarë. Si deputete e këtij Parlamenti, por edhe si qytetare e Republikës së Kosovës nuk mund kurrësi t'i kuptoj disa parti opozitare, të cilat preokupimin kryesor të tyre e kanë se cila do të jetë figura që do të jetë prijëse e këtyre bisedimeve dhe deklaratat e tyre publike sillen kryesisht rreth emrit të presidentit Hashim Thaçi, në vend që preokupim i tyre kryesor të jetë platforma e këtyre bisedimeve, të jenë pikat të cilat do të diskutohen, si dhe të jenë po ashtu edhe çështjet kryesore dhe themeltare të kësaj faze finale të bisedimeve. Në vend të kësaj, skena politike në Kosovë ka ditë të tëra, ka muaj të tërë që po përplasen rreth një emri, rreth figurës së Presidentit legjitim të këtij vendi, të

zgjedhur nga ky Kuvend i Republikës së Kosovës dhe i cili edhe me Kushtetutë përfaqëson unitetin dhe politikën e jashtme të vendit.

Deklaratat e tilla, të cilat janë thënë ditëve të fundit nga përfaqësues politikë vetëm sa po i kontribuojnë zbehjes së pozicionit të Kosovës si shtet në këto bisedime, duke pasur parasysh pozicionimin e Serbisë në fazën përfundimtare të bisedimeve apo të dialogut.

Të nderuar kolegë deputetë,

Konsideroj që sa më unike që është pala kosovare në këto bisedime, fitorja jonë do të jetë më e madhe. Përkundër dallimeve, të cilat tashmë i kemi të qarta në qasjen tonë në dialog, mbyllja e këtij procesi është interes i të gjitha partive politike në Kosovë, është interes i qytetarëve të Republikës së Kosovës, e sidomos kur kemi parasysh që mbyllja e këtij procesi e hap mundësinë e anëtarësimit të Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe në Bashkimin Evropian. Kjo pasi që vetë procesi i dialogut ka pasur rezultat në integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian dhe këtu po e përmend rastin e nënshkrimit të marrëveshjes kontraktuale ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, Marrëveshjes së Stabilizim-Associmit. Ky Kuvend natyrisht që do të duhej të kishte rol në marrëveshjen përfundimtare, prandaj duhet të ketë vullnet që ne të ulemi bashkë dhe të krijojmë një platformë politike pas kaq shumë tryezave, të cilat janë mbajtur nga të gjitha partitë politike në Kosovë.

Qasja serioze e Republikës së Kosovës në dialog mund të dëshmohej vetëm nëse arrijmë të kemi dakordim rreth pikave, të cilat na bashkojnë. Për fund, konsideroj se përgjegjësia e dialogut, përgjegjësia e kësaj faze përfundimtare e dialogut është e të gjithëve dhe nevoja për arritje të kësaj marrëveshjeje do të duhej t'i tejkaloje mandantet tona të përkohshme rreth një dakordimi të përbashkët, të cilin klasa politike në Kosovë e ka bërë sa herë që është bashkuar rreth një vullneti të përbashkët për të punuar për të ardhmen e Republikës së Kosovës. Dhe, unë këtu ndaj opinionin, ndaj qëndrimin e njëjtë edhe të Partisë Demokratike të Kosovës që ne i japim mbështetje kësaj faze të rëndësishme të dialogut dhe kërkojmë që rezolutat, të cilat kanë dalë nga partitë politike në këtë Parlament, të harmonizohen dhe të kemi një qëndrim të qartë, unik rreth kësaj çështjeje. E, assesi të mos lidhemi rreth emrave, të cilët në këtë fazë do të duhej që të bashkonin rreth një uniteti dhe rreth një qëndrimi tonë të përbashkët si shtet. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Fatmir Limaj, zëvendëskryeministër, e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI FATMIR LIMAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Besoj që iniciatorët e kësaj seance për të diskutuar për dialog duhet t'i përgëzoj dhe t'i inkurajojmë të gjithë që duke shfrytëzuar këtë iniciativë maksimalisht të japim kontributin tonë, në përputhshmëri me rëndësinë dhe peshën e temës për të cilën po flasim.

Unë besoj që kjo do të jetë një nga seancat në ditët ose muajt në vazhdim që ne duhet t'ia kushtojmë kësaj teme të rëndësishme. Është koha që së bashku me shumë seriozitet t'i qasemi, kjo temë do të na përcjellë në muajt në vazhdim, e që do të jetë vendimtare për drejtimin që do t'i japim vendit tonë.

Është momenti kur ne duhet të flasim paraprakisht dhe jo pastaj, sikurse në të kaluarën, të flasim pasi gjërat të kenë përfunduar. Unë dua ta filloj këtë diskutim tamin duke ju ftuar juve, kolegë deputetë, që ta bëjmë një prerje, një ndarje të dialogut të deritanishëm dhe asaj që do të fillojë.

Nëse flasim për një dialog, i cili do të ketë si përfundim marrëveshjen detyruese finale mes dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, e cila do të çojë në njohje reciproke, atëherë ne po flasim për një moment final, e që ende nuk ka filluar. Dialogu i deritanishëm ka qenë dialog i quajtur këtu teknik e politik, e shumë e shumë epitete të ndryshme dhe ai ka marrë fund. Ka marrë fund, sepse nuk ka arritur rezultat. Edhe në komunitetin ndërkombëtar, edhe ndërmjet dy shteteve tona, edhe në opinionin publik është parë që ajo që është bërë deri më tani, ka qenë dialog, i cili nuk ka arritur rezultate. Prandaj ka ardhur si nevojë e uljes dhe fillimit të një dialogu të ri, i cili do të ketë afat, do të ketë kohë dhe do të ketë përfundim të detyruar që duhet të respektohet nga të dyja palët.

Unë kështu e kuptoj, dhe kështu është. Dhe nëse flasim që nuk ka filluar ende dialogu, për të cilin po flasim për një marrëveshje finale, atëherë jemi në kohë që të gjithë të ulemi, të bashkohemi si grupe politike për të ndërtuar një konsensus sa më të gjerë, për të qenë sa më të përgatitur në atë që na pret.

Ajo fazë e dialogëve 2012, 2013 e deri më tani, besoj që nëse e marrim dhe e shohim si diçka në kontinuitet, do të na humbte kohë dhe do të na humbte orientimin nga përgatitja jonë që duhet të bëjmë për këtë pjesën finale.

Ne kemi kohën e mjaftueshme të ulemi si grupe politike, të përgatitemi, dikush po i quan platformë, dikush principe, sido që të jetë. Dikush ka nxjerrë edhe dokumente përkatëse, kemi edhe një rezolutë të propozuar nga iniciatori i këtij debati. Të ulemi, të harmonizojmë një qëndrim të përbashkët dhe të gjejmë një formulë të përbashkët, e cila rrezaton, përfshin ose inkorporon një konsensus sa më të gjerë të forcave politike të Kosovës dhe të jemi sa më të përgatitur për këtë pjesën finale, e cila është shumë e rëndësishme për vendin. Nuk ka asnjë dilemë, ne mund të flasim sa të doni, por nuk ka asnjë dilemë se dialogu i deritanishëm nuk ka sjellë rezultate edhe për arsye sepse ka qenë i papërgatitur, jotransparent. Një dialog tërësisht

kuturu, nga momenti në moment. Atëherë koha është që të ulemi, të përgatitemi seriozisht për atë që po vjen.

Ne kemi qasje të ndryshme në formën se si është shkuar me këtë dialog, kemi qasje të ndryshme për temat që do duhej të diskutojmë, por e rëndësishme është që të gjithë jemi, besoj, të pajtimit që kjo çështje duhet të përmbyllet. Atëherë, ejani, të ulemi dhe ta gjejmë një zgjidhje, një formulë. Edhe atë çka duhet ne ta dialogojmë, por edhe formulën e përfaqësimit. Unë po them që ai dialog i kaluar ka marrë fund dhe ende s'ka filluar ky dialogu final, kjo nënkupton që dialogu që të flasë për Kosovën një njeri, ka marrë fund.

Një njeri nuk mund të flasë më për Kosovën. Çfarëdo institucioni që përfaqëson. Ejani ta bëjmë ekipin bashkë, mes forcave politike që janë këtu në Parlament. Të provojmë, të paktën, të diskutojmë, të debatojmë, të dëgjojmë mënyrën se si e shohim secili nga ne, siç u tha këtu, të marrë një autorizim ai ekip nga Parlamenti i Kosovës, i cili përfaqëson shumicën e qytetarëve të Republikës. Të ndërtohet komunikimi mes ekipit dhe Parlamentit, të hiqet mundësia e jotransparencës që ka qenë në të kaluarën, të ketë mundësi që t'i japë llogari këtij Parlamenti ai ekip nesër, dhe ai ekip pastaj të jetë i kujdesshëm në inkorporimin e ekspertëve të shumtë që ka ky vend, e të mos shkojmë atje, siç ka ndodhur në të kaluarën, të bëhen gabime fatale, elementare, e që i kushtojnë Kosovës.

Një marrëveshje e mirë është e dobishme për vendin. Një marrëveshje e keqe do të na përcjellë tërë jetën të gjithëve së bashku. Besoj të gjithë jemi të qartë që një marrëveshje që mund të arrihet atje nuk mund të përmirësohet. Të themi, jo kjo e keqe, ejani ta ndryshojmë! Qëndrimi si vëzhgues dhe mosmarrja e përgjegjësisë nuk i takon Parlamentit të Kosovës. Ne mund të qëndrojmë vëzhgues dhe të shikojmë çfarë po ndodh, e të presim mos po gabojnë, por ai gabim nuk është për ta. Është gabim për vendin. Na kushton të gjithëve. Prandaj, e kemi një moment të rëndësishëm kohor që ta shfrytëzojmë maksimalisht, ditët dhe muajt në vijim, që dalëngadalë ta gjejmë edhe formulën e përfaqësimit, ta gjejmë edhe formulën e platformës dhe të parimeve dhe të jemi të gatshëm për të dhënë kontributin tonë. Për të përmbyllur ato çështje që ne i konsiderojmë të hapura në raport me Serbinë dhe Serbia që mund t'i konsiderojë të hapura në raport me Kosovën. Nëse kështu i qasemi, unë jam i bindur që nga ky proces vendi do të dalë shumë, shumë më mirë sesa që ka dalë në të kaluarën, kur vendimet dhe veprimet janë marrë pa konsultim paraprak mes forcave politike dhe me institucionet më të larta të vendit.

Në krejt këtë situatë, ftesa ime, e besoj edhe e shumicës këtu, sa dëgjuam deri më tani, është që ejani të bëhemi bashkë, optionet e formulave janë të gjitha të hapura. Mos lejoni të biem në propagandën që po përflitet, mos flisni për situata se si do të vijë çështja e Kosovës, siç po dëgjoj: jo do të jetë autonomi, jo do të jetë ndarje! Këtij Parlamenti nuk i takon t'i përflasë thashethemet dhe fjalët që fliten jashtë, qoftë edhe nëse kanë ardhur gjoja nga burimet ndërkombëtare. Nuk i takon Parlamentit të Kosovës.

Këtë Parlament tani për tani e obligon Kushtetuta, ligjet, dhe nuk lejohet, nuk i shkon Parlamentit të Kosovës të dalë deputeti të flasë jashtë asaj që ia njeh dhe e obligon Kushtetuta. Nuk mund t'i kthejmë kafenetë dhe takimet individuale me disa individë, gjoja të mirinformuar dhe të vijnë të bëjmë temë në Parlamentin e Kosovës. Është joserioze për Parlamentin e Kosovës. Në qoftë se vinë situata të tilla, përsëri është Parlamenti që duhet të vendosë mbi bazën e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë që e ka. Në qoftë se ka edhe situatë, të cilat janë në kundërshtim me Kushtetutën, përsëri ky Parlament duhet t'i akomodojë brenda Kushtetutës çfarëdo zgjidhje. Prandaj, në vend që të shpenzojmë edhe paraprakisht, siç e kemi fatkeqësisht zakon ne, që jemi jashtëzakonisht të shkathtë në thashetheme të panevojshme, nganjëherë edhe të qëllimshme e pavetëdije i bëjmë temë në Parlamentin tonë, ejani të merremi me temën që na takon. Nuk do të mund të ndërtojmë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe dy minuta, vazhdo!

FATMIR LIMAJ: Nuk do të mund të ndërtojmë një konsensus çfarë është propozuar, në qoftë se paraprakisht nuk ulemi ta harmonizojmë një dokument, një formulë dhe t'ia sjellim Parlamentit. Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm. Prandaj, le të na shërbejë ky inicimi i këtij dialogu që unë e përshëndes me kënaqësi, le të na shërbejë që ne, drejtuesit, forcat politike që janë të përfaqësuara në Parlament, seriozisht të ulemi, të ndërtojmë një dokument dhe të gjejmë formulën e duhur të përfaqësimit, të kthehemi në Parlament dhe të marrim miratimin e Parlamentit të Kosovës. Ky është apeli im dhe besoj që të gjithë ne jemi në krye të seriozitetit të çështjes që na vjen. Në qoftë se ne e kthejmë Parlamentin në garë dhe në qerim hesapësh, natyrisht nëpërmjet fjalëve, atëherë të gjithë e dinë që po i kontribuojmë dëmtimit të vendit tonë dhe humbjes së një mundësie të madhe që përfundimisht ta përmbyllim çështjen me Serbinë dhe përfundimisht të ndërtojmë një diçka që besoj do të jetë e mirë dhe në shërbim të qytetarëve të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit,

Qytetarë të Republikës,

Kabinet qeveritar,

Dialogu i ri me Serbinë po bëhet jo që Kosova të marrë ulëse në OKB, sepse ajo gjë është në dorë të Ruisë, por që Serbia të marrë ulëse në Bashkimin Evropian, sepse kjo gjë është në duar të shqiptarëve.

Për t'u anëtarësuar Serbia në BE, përgjatë negociatave ajo është e varur nga Kosova dhe shqiptarët. Paradoksalisht, ne kemi qenë të varur në të kaluarën nga Serbia, por tash është Serbia, e cila varet prej nesh.

Varësia e Serbisë nga Kosova quhet Kapitulli 35 (çështje të tjera), ndërkaq varësia e Serbisë nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci quhen Kapitujt 23 (gjuqësori dhe të drejtat themelore) si dhe Kapitulli 24 (drejtësia, liria dhe siguria).

Ne i kemi tri leva në raport me Serbinë: e para, është procesi i anëtarësimit të saj për në BE, që varet pra prej nesh dhe kjo është levë në duart tona që nuk guxojmë ta humbim. E dyta është tregu zyrtarisht gjysmë miliardi euro i Serbisë në Kosovë, e ne nuk eksportojmë dot në Serbi, siç dihet, dhe e treta është reciprociteti i të drejtave në Kosovë e Serbi, kur dihet që përgjithësisht ka më shumë shqiptarë në Serbi se sa që ka serbë në Kosovë.

Bosnjëzimi i Bosnjës nuk është bërë duke u synuar bosnjëzimi, por duke u synuar ndarja e Bosnjës apo shkëmbimi territorial midis Serbisë dhe Kroacisë. Në fund, duket që e duan një ‘Zajednicë’ të ndryshuar pak, me ç’rast ajo është asimetrike përbrenda. Veriu i Kosovës me një status më special se sa komunat me shumicë serbe në jug të Ibrit që po ashtu futen në ‘Zajednicë’, por me ç’rast Mitrovica Veriore bëhet kryeqytet, si Banja Luka për Republikën Serbe dhe jo Graçanica, e cila ngelet analoge me Palen në periferi të Sarajevës. Pra, një ‘Zajednicë’ me asimetri të brendshme. Ky është synimi i Serbisë dytësor, e synimi primar është negociatat për anëtarësim sa më të shpejtë në BE, gjë që iu varet nga Kosova dhe nga shqiptarët. Rezultati kryesor i dialogut të deritanishëm për të ashtuquajturin normalizim të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë ishte Lista serbe. Qëllimi i dialogut duket të ketë qenë vetë dialogu dhe këtë e vërteton fakti se është vrapuar pas marrëveshjeve të reja, pavarësisht moszbatimit të marrëveshjeve të vjetra.

Kur sheh që marrëveshjet aktuale nuk po zbatohen, e pavarësisht kësaj vazhdon dialogun për marrëveshje të reja, kjo do të thotë që e ke dialogun qëllim, në vetvete mjeti është qëllim. Ne sivjet nuk e kemi shënuar vetëm 10-vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ne e kemi shënuar edhe 10-vjetorin e decentralizimit mbi baza etnike të ingranuar në sistemin tonë juridik e kushtetues. Kjo Qeveri duhet ta bëjë një studim mbi efektet pozitive dhe negative të decentralizimit mbi baza etnike. Është e domosdoshme që pas një dekade të shohim çfarë të mire ua pamë këtyre komunave mbi baza etnike, paralelisht me atë që kemi kërkuar ne tash e disa muaj, e ky është vlerësimi nëpërmjet një raporti zyrtar i 6-vjetorit të dialogut të ashtuquajtur për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë. Para tri javësh kam bërë një tekst të shkurtër që besoj që është mirë ta risjell këtu, tekst i publikuar.

Përpara çfarëdo dialogu të ri me Serbinë, katër etapa përgatitore janë të domosdoshme në Kosovë:

E para, shqyrtim dhe vlerësim i dialogut 2011-2017 dhe i rezultateve të tij.

E dyta, synimet e Kosovës dhe kërkesat tona ndaj Serbisë.

E treta, parimet dhe kushtet e dialogut të ri dhe

E katërta, ekipi ynë negociator me strategji dhe udhëheqës.

Unë besoj që vetëm një gjë nuk duhet të jetë publike; strategjia e ekipit negociator. Të gjitha gjërat e tjera duhet të jenë publike. Por, ekipi negociator me udhëheqës edhe me strategji vinë në fund. Përbërja e ekipit duhet të jetë publike, udhëheqësi i ekipit duhet të jetë publik, por strategjia e ekipit negociator nuk duhet të jetë publike. Veçse para se të mbërrimë aty, duhet të kemi shqyrtim dhe vlerësim të dialogut të deritanishëm, t'i përcaktojmë synimet e Kosovës dhe kërkesat tona ndaj Serbisë dhe parimet dhe kushtet e dialogut të ri. Aq më tepër që Qeveria na e ka sjellë tashmë një material me 38 faqe, të cilin ne këtu do duhej ta diskutojmë. Çështja e dialogut me Serbinë nuk është çështje procedurale, është çështje përmbajtjesore. Ne nuk duhet të përsërisim ato çfarë parashohin ligjet e Kushtetuta. Ne duhet të marrim qëndrime politike.

Më tej, tri lloj debatesh besoj që duhen në Kosovë.

E para është debati në Kuvendin e Republikës, e dyta në shoqërinë kosovare, me shoqatat e familjeve të të pagjeturve, pakicat kombëtare, Universitetin e Prishtinës, ASHAK-un, me ekspertë të ekonomisë e të tjera, dhe e treta me BE-në, si ndërmjetësues.

Pasi që ta bëjmë diskutimin mbi raportin qeveritar për dialogun 6-vjeçar, Qeveria e Kosovës duhet ta marrë barrën e provës për të na e dëshmuar neve pse ky dialog është i nevojshëm mu tani dhe me këtë nguti. Nuk do të duhej që ne ta kemi barrën e provës për këtë dialog, Qeveria do të duhej ta ketë barrën e provës për këtë dialog. E unë tregova qysh në fillim pse besoj që po ndodh ky dialog?! Ky dialog po ndodh për shkak se Serbisë po i nevojitet ai. Jo për ta marrë Kosova ulësen në OKB, por për ta marrë Serbia ulësen në BE. Dhe, Qeveria duhet të sqarojë cili është kuptimi i saktë i shprehjeve: normalizim i plotë, normalizim, marrëveshje ligjërish e obligueshme, kompromis i dhembshëm, e kështu me radhë. Ne po proliferojmë shprehje e nocione të ndryshme pa u sqaruar kuptimi i tyre. Barrën e sqarimit të këtyre termave e ka sërish Qeveria e Kosovës. Pasi që ta bëjmë trajtimin e raportit qeveritar 38-faqesh, ai debat duhet të jetë para këtij debati (kjo është sikur ta vendosësh qerren para kuajve), njëherë duhet si erdhëm këtu. Nuk mund të vazhdojmë ne për dialogun e ri, pa e trajtuar si erdhëm këtu, çfarë ishte ai dialogu me ato 33 marrëveshje paraprakisht.

Pra, ta shqyrtojmë raportin qeveritar 38-faqesh, kur ta shqyrtojmë këtë raport, atëherë neve na nevojitet një seancë që këtu, si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, t'i definojmë kërkesat tona ndaj Serbisë, cilat janë synimet dhe kërkesat këto, dhe unë propozoj që ta krijojmë një ekip të përbashkët të të gjitha grupeve parlamentar për t'i formuluar kërkesat tona ndaj Serbisë, e jo të bëhemi bashkë për t'i lëshuar pe Serbisë, por të bëhemi bashkë për kërkesat tona ndaj Serbisë. Edhe kërkesat janë, prej atyre për të pagjeturit e dëmet e luftës që RIINVEST i ka vlerësuar në bazë të një studimi, nëse nuk e kam gabim, 20 miliardë euro, janë dëmet e luftës

vetëm në vitet '98, '99, e t'i shkruajmë të gjitha këto kërkesa, e ndoshta deri te kërkesa që në Bajtanicë të ketë një pllakë përkujtimore për ata 744 shqiptarë që u varrosen atje në fushën e pushkatimit.

Ne si Kuvend i Republikës së Kosovës duhet t'i formulojmë kërkesat për Serbinë dhe zyrtarisht t'ia dërgojmë Serbisë. Këto gjëra na i ke borxh, e mandej bëjmë dialog. Nuk bën dialog pa i formuluar kërkesat për Serbinë. Ajo neve na ka borxh, borxhliut duhet t'ia kërkojmë borxhin. Dhe, këtë gjë duhet ta bëjë Kuvendi i Republikës edhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Dhe, fare në fund, unë ju inkurajoj që secili prej jush të deklarojeni për dialogun e ri që tashmë ka filluar pa mandat. Presidenti aktual e takoi Vuçiqin vetëm pak ditë pasi e takoi presidentin Medvedev të Rusisë, me ç'rast deklaroi: "Kryeministrin Medvedev shkurtimisht e informova për zhvillimet në Kosovë dhe rajon". Presidenti nuk duhet të jetë informator. E informova për zhvillimet në Kosovë dhe rajon! Çfarë presidenti është ky kështu?! Edhe ka shkuar pa mandat të Kuvendit të Republikës. Pra kërkoj që secili prej jush të deklarojë për një aventurë personale që tashmë ka filluar. Është e domosdoshme që si Kuvend i Republikës të jemi në nivel të detyrës, ta përfaqësojmë popullin e të mos mbështesim aventura personale.

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Gani Dreshaj.

GANI DRESHAJ: Përshëndetje, të nderuar deputetë!

Unë mendoj që kësaj radhe ishte dashur të shkojë një ekip shumë i përgatitur që edhe sot e kësaj dite, ekipi i Vjenës në rrethe të ngushta diplomatike përqesh. Ngase kanë shkuar prej aeroplanit, i kanë lexuar disa letra dhe kanë hyrë në Vjenë. Edhe unë mendoj që edhe ne duhet të bëjmë më shumë, t'i thërrasim njerëzit, se s'jemi më të ndershmit dhe më të dijsmit në këtë Parlament. Të bëjmë takime me akademikë, të bëjmë një grup që i udhëheq këto bisedime pa interesa politike, se është një çështje shumë e madhe. Unë nuk e shoh të arsyeshme që ne gjithmonë t'i vrapojmë pas Serbisë. Ata edhe po na rrahin, edhe s'po na lënë të qajmë! Është e domosdoshme që serbëve të Kosovës t'ua përmirësojmë jetën, por më duket se jemi duke e falur shpejt dhunën, gjenocidin që kanë bërë, edhe disi po më duket, 'bjeri kah t'i biesh, kulaçi është imi'. Neve po na ofrohet këtu në Parlament diçka duam të votojmë, të ndihmojmë, por kulaçin po e ndalin për vete. Kaq kisha, faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Anton Quni.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues.

Përshëndetje për ministrat, të gjithë deputetët, për ata që na dëgjojnë. Mendova që do të jetë kryeministri këtu, pasi që fjala ime kryesisht i drejtohet atij. Por sidoqoftë, shpresoj që do t'i dëgjojë këto adresimet e mia. Para ca ditëve, në një takim të rastit e bëra një bisedë të shkurtër me kryeministrin Haradinaj në lidhje me përfaqësimin në dialog me Serbinë. Në fakt, zoti Haradinaj insistonte në idenë se duhet të jemi unikë dhe është mirë t'ia besojmë këtë mision

presidentit Thaçi. Unë i thashë se është mirë që këtë mision ta marrë ai vetë përsipër. Biseda jonë përfundoi me përshtypjen se kërkesën time kryeministri nuk po e merrte seriozisht. Prandaj, sot sërish me shumë sinqeritet do të mundohem ta arsyetoj qëndrimin tim. Të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tani kanë qenë në nivel të kryeministrave: Kushtetuta, ligjet dhe të gjitha rezolutat e nxjerra në Parlament i japin mandat autoritetit të kryeministrit. Kryeministri posedon me të gjitha burimet njerëzore dhe financiare për të përmbushur të gjitha misionet, sado që atë janë komplekse. Qeveria në tërësi dhe institucionet veç e veç i nënshtrohen drejtpërdrejt kontrollit demokratik të Parlamentit. Këto të gjitha janë fakte të pamohueshme, të cilat e bëjnë të pakuptimtë delegimin e përgjegjësive të kryeministrit në ndonjë instancë tjetër, në këtë rast te autoriteti i presidentit.

Tani unë shpreh shqetësimin pse zoti Haradinaj nuk e merr këtë përgjegjësi? Unë për vete nuk mund t'i jap përgjigje shqetësimit tim, e as shpjegimet e zotit Haradinaj nuk më bindin.

Nuk dua të merrem me supozime e as me përfolje të teorive konspirative, por jam më se i bindur se nëse gjërat nuk janë paraprakisht të përcaktuara, zoti Haradinaj do të duhej të merrej me përgjegjësitë të cilat i takojnë. Në rast se skenari është i përgatitur dhe dihet zgjidhja përfundimtare, kjo do të duhej të ishte edhe për kryeministrin një arsye shtesë që vetë ai ta ushtronte mandatin për të udhëhequr bisedimet me Serbinë, edhe për faktin se presidenti Thaçi ka paralajmëruar se zgjidhja do të jetë e dhimbshme për Kosovën.

Kjo deklaratë do të duhej të kumbonte si alarm në kokën e çdonjërit prej nesh, e para së gjithash në kokën e kryeministrit.

Para një situatë të tillë të mjegullt e të rrezikshme për të ardhmen e vendit, askush nga ne nuk bën të qëndrojnë indiferent, aq më pak Kryeministri i vendit.

Ju, zoti kryeministër, nuk është se e keni të vështirë të na përfaqësoni, sepse të gjitha faktet janë në anën tonë si vend. Provokimet e Vuçiqit nuk duhet të frikësojnë askënd, sepse e drejta historike, morale, politike e juridike, të gjitha janë në favorin tonë.

Çdo akuzë të Serbisë, të stilit se 'serbët e Kosovës janë të rrezikuar', ju mund ta hedhni poshtë me shembuj konkretë.

Në Kosovë ka fshatra dhe qyteza ku banojnë qytetarë serbë, të cilët jetojnë dhe punojnë të qetë e të lirë. Kishat dhe varrezat e tyre tashmë janë pa rrethoja gjembore dhe ato sigurohen nga policët shqiptarë. Veturat me tabelat e Serbisë mund të vërehen anekënd Kosovës. Tregtia në mes të shqiptarëve dhe serbëve zhvillohet pa asnjë pengesë, e shumë e shumë fakte të tjera. Ne e dimë se në diskutimet në Bruksel ekziston një agjendë, ekziston një protokoll, por nëse

bisedat banalizohen jashtë agjendës dhe protokollit, në stilin ashtu siç dinë serbët, mund të shërbeheni me disa shembuj.

Nëse ju vejnë në siklet me luftën e shqiptarëve në Siri, ju mund t'ua kujtoni mercenarët dhe paramilitarët serbë në Libi dhe Ukrainë. Nëse shkojnë edhe më larg dhe thonë se jemi agresivë dhe vritemi mes vete, thuaju po, ka raste, por trego se ne asnjëherë nuk kemi vrarë mbretër dhe kryeministra, siç kanë bërë ata.

Vuçiqi, së fundi, disa herë ka kërcënuar edhe me ushtri, por ju mund t'i përgjigjeni lirisht se gjeneralët e tij po e gënjejnë, se i ka të paaftë dhe të atillë që edhe humbjet i festojnë.

Kurse ne jemi shumë më të përgatitur, më të ditur dhe se shtetin tonë të ri, Kosovën, e duam më shumë se ata mund ta imagjinojnë. Krejt në fund, Kryeministër, kërkoj me ngulm që bisedimet të udhëhiqen nga Weveria, e jo nga Presidenti. Shko e bisedo me Vuçiqin, ofroi atij mundësinë e ndërtimit të paqes mes popujve, jepi garanci të fuqishme për mirëqenien dhe sigurinë e komunitetit serb në Kosovë. Kurse ai, nëse me të vërtetë është i interesuar të bëjë histori në ndërtimin e paqes, kërkoi le t'i zbardhë rastet e të pagjeturve tanë, të kërkojë falje për agresionin në Kosovë, të kthejë fondet e plaçkitura dhe të paguajë dëmshpërblimin e luftës.

Zotëri Kryeministër, ju tani e keni mundësinë të tregoheni sa jeni i shkathtë në politikë dhe diplomaci dhe e keni rastin ta arsyetoni gjithë këtë numër të madh të zëvendëskryeministrave, ministrave, zëvendësministrave, këshilltarëve dhe koordinatorëve, që nga buxheti i varfër i Kosovës po marrin superpaga.

Ju tani e keni mundësinë të bëni histori. Nëse e merrni mbi supë këtë përgjegjësi që ju takon, unë personalisht do t'ju mbështes dhe do të jem i gatshëm të lloboj për mbështetje edhe te kolegët e mi të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Në të kundërtën, ju duhet të hapni rrugë. Është korrekte dhe njerëzore ta pranoni se nuk mund ta përmbushni këtë mision. Ne duhet ta pranojmë këtë fakt. Dhe, e vetmja rrugëdalje mbetet të shkojmë në zgjedhje të reja, nga të cilat besoj se do të dalë një qeveri më e përgjegjshme dhe më kredibile.

Po e përmbyll fjalën time edhe një herë me kërkesën që të mos lejojmë që kjo çështje të kalojë në autoritetin e Presidentit, dhe këtë për shumë arsye, por më të fuqishmet ato që ai vetë publikisht i ka deklaruar: se nuk ka vija të kuqe me Serbinë dhe se ne duhet të përgatitemi për zgjidhje të dhimbshme. Për çfarë dhimbje e ka fjalën? Ne i kemi përjetuar të gjitha dhimbjet dhe nuk e di pse u dashka ende të përjetojmë dhimbje të tjera. Është koha që dhimbjet tona të shërohen njëherë e përgjithmonë. E nëse dikush personalisht ka dhimbje nga e kaluara e errët e tij, nuk mund ta shërojë atë duke ua kaluar dhimbjen bashkëkombësve të vet. Ai që nuk është në paqe me popullin e vet, nuk mund të ndërtojë paqen me Serbinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Nezir Çoçaj.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit.

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë!

Debati për dialogun në këtë seancë po zgjon kureshtjen e qytetarëve të Kosovës, por edhe të mekanizmave ndërkombëtarë. Në cilësinë e deputetit plotësisht dakordohem me mbajtjen e debatit, duke kërkuar dhe llogaritur në një debat përmbajtjesor, që do të ndihmonte këtë proces të rëndësishëm për sovranitetin e plotë të Kosovës, si dhe për mbylljen e kësaj çështjeje me marrëveshje ndërshtetërore në mes të dy shteteve.

Të nderuar kolegë dhe qytetarë të Kosovës!

Me çështjen e dialogut nuk mund të fitojmë poenë politike asnjë nga institucionet e Kosovës, duke përfshirë edhe subjektet joshqiptare, ashtu siç po shohim e dëgjojmë deklarata e prezantime në opinionin publik kohën e fundit.

Ne i kemi institucionet e dala nga vota qytetare si dhe të zgjedhurit nga Kuvendi i Kosovës. Kemi Kushtetutën e Kosovës dhe, para së gjithash, Kuvendi si organ ligjvënës dhe më i larti në hierarkinë e institucioneve të Republikës së Kosovës, duhet ta miratojë çdo marrëveshje ndërkombëtare dhe atë me dy të tretën e votave. Mbi të gjitha kemi amanetin e dëshmorëve dhe të rënëve të Kosovës që dhanë jetën për shtetin e Kosovës dhe kështu duhet të respektohet vullneti i tyre.

Unë kam prirjen dhe bindjen që të besoj te përfaqësuesit tanë, e në veçanti ata që bashkëvepruan aktivisht dhe me përkrahje të popullit në çlirimin e vendit si dhe në procese të tjera në shtetndërtimin e tij.

Të nderuar kolegë,

Ne duhet të dimë dhe duhet të marrim përgjegjësi në çështjet me interes vital për Kosovën. Madje, nëse ka të atillë që nuk dinë, duhet të mësohen, duke marrë përvojat e suksesshme nga vetë ne, nga njëri-tjetri dhe të bashkërendohemi. Jam i bindur se të gjitha mund t'i arrijmë së bashku, por edhe jam më se i bindur se guximin nuk mund t'ia japë askush askujt. Prandaj, shumë nga ju deputetët opozitarë po abstrahoni çdo gjë, duke mos kursyer asgjë, as fjalorin tuaj jo të përshtatshëm në paraqitjet publike. Të nderuar, mosgatishmëria për të marrë përgjegjësi për krijimin e një konsensusi nacional për dialog, nuk mund të sjellë përfitime politike dhe nuk mund t'i kontribuojë asnjë procesi me rëndësi për vendin. Prandaj, ju thërras që të mos pengoni dhe të mos hapni propagandë që as vetë nuk i besoni.

Kosova do t'ia dalë që denjësisht të përfundojë dialogun me Serbinë dhe do të arrijë marrëveshjen ndërshtetërore, duke i qetësuar qytetarët nga frika dhe paniku që po shkaktohet, si

nga qarqe serbe, ashtu edhe nga qarqe të brendshme, të cilat në mungesë të gatishmërisë për të pranuar realitetin, vazhdojnë të sabotojnë dhe të mohojnë çdo të arritur dhe madje duan të pengojnë edhe arritjet në të ardhmen.

Të nderuar, më lejoni që në fund të fjalimit tim të bëj thirrje që të lëmë anash inatet politike e personale dhe të arrijmë konsensusin për dialog të sinqertë e transparent, i cili do të bëjë të mundur arritjen e marrëveshjes përfundimtare ndërshtetërore dhe me mbështetjen e faktorit ndërkombëtar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit! Meqë pati shumë lëvdata për ata që kanë bërë negociata më herët, e në veçanti për Thaçin, atëherë unë dua t'ju them se në vazhdimësi ky njeri ka qenë negociator me Serbinë, pra është fakt. Për çdo rund të bisedimeve, ia ka shkëputur nga një copë të interesit Kosovës. Unë ndoshta do t'i ndaj vetëm disa prej tyre. E përfaqësoi UÇK-në në Rambuje dhe u kthye i çarmatosur. E përfaqësoi Qeverinë e Kosovës në shpalljen e pavarësisë dhe rifilloi menjëherë negociatat me Serbinë. I proklamoi si teknike dhe i shndërroi në politike. Nëse nuk është kështu, keni kurajën dhe ma thoni! E shoi TMK-në që donte të bëhej ushtri e Kosovës dhe nuk u bëri kurrë ushtrinë. E përfaqësoi Kosovën në Bruksel dhe e ndau policinë në baza etnike, duke ia dhënë nën kontroll një regjion Qeverisë së Serbisë, e cila emëron strukturat e Policisë së Kosovës në bazë të marrëveshjeve të arritura, referuar në këtë rast, Marrëveshjes së 19 prillit. E përfaqësoi Kosovën në negociata me Malin e Zi dhe ia aneksoi Kosovës 8200 hektarë. Kështu negocion ky! E përfaqësoi Qeverinë e Kosovës me Vuçiqin dhe u kthye me Listën serbe në çantë. E solli po ashtu edhe fusnotën. Kështu negocion ky njeri! Nëse doni të vazhdoni kështu, mund t'ia vazhdoni mandatin Thaçit edhe në të ardhmen. E tash ai po e bën një të mirë, po na paralajmëron vetë se do të ketë sërish vendime të rënda për Kosovën.

A duhet t'ia lëmë në dorë të ardhmen këtij njeriu? A duhet që ne të rrimë të heshtur dhe ky njeri t'i sjellë marrëveshje të tilla Kosovës? Natyrisht se jo!

Ky njeri jorastësisht ka qëndruar mes Kosovës dhe Serbisë në negociata. Pra, sa herë ka pasur Kosova negociata me Serbinë, ky ka qenë permanenti. Ky ka qenë kështu edhe kur ka qenë kryeministër, ka qenë kryenegociator. Po ashtu, ka qenë kështu edhe kur ka qenë ministër i Jashtëm. Kështu tani edhe si president dhe, mbajeni mend, po të ishte kryetar komune, bisedimet mes Kosovës dhe Serbisë do të ishin në nivel të kryetarëve të komunave. Të jeni të sigurt për këtë! Sepse permanenti është ky njeri. Pra, ky është permanent në relacion me Serbinë, nga cilido funksion që e mban, prandaj edhe është partneri i pazëvendësueshëm në bisedimet me Serbinë. Paramendojeni veç një herë t'ia hiqni Thaçin Vuçiqit, do të shihni reagimin e menjëhershëm të tyre. Pra, ata e duan këtë njeri në mes.

Pra, tash edhe vetë ai po thotë se e presin vendime të rënda, siç u tha këtu, por një gjë nuk po kuptoj nga Qeveria e tanishme, e cila neve na bën thirrje që të ulemi bashkë me të. Këtë e bëri edhe zëvendëskryeministri tani. Na fton të ulemi. Ku të ulemi? Jo, kjo nuk është ftesë e sinqertë. Kjo është ftesë në bashkëfajësi, të cilën ne nuk e marrim asnjëherë.

Përderisa ‘Zajednicën’ Thaçi e ka në grupin e vendimeve të lehta, paramendojeni kush është në grupin e vendimeve të rënda? Këtë ne nuk e dimë. Kur ndodhi marrëveshja e 19 prillit 2013, Lëvizja Vetëvendosje kishte paralajmëruar tashmë se rezultati do të jetë i rëndë dhe katastrofal për Kosovën. Madje, atë kohë marrëveshja e prillit u pati ratifikuar paraprakisht nga Kuvendi i Kosovës. Ishte ky një gabim fatal i shumicës së atëhershme të deputetëve. Prandaj ne kërkonim që të mos votohej nëse ju kujtohet në ato orë të vona të natës. Ju kujtohet besoj kur ju thoshim mos e votoni se dikur do të jetë vonë. E tash po del që është vonë për ta korrigjuar atë. Thaçi e grabiti këtë mandat nga Kuvendi dhe sot po e keqpërdor deri ne shkelje të Kushtetutës dhe të sovranitetit të vendit. Ai asnjëherë nuk iu drejtua Kuvendit të Kosovës, as për t’i raportuar, as për ta informuar. Madje, ai ka pasur shumë kujdes mosinformimin në Kuvend.

Madje, e ashtuquajtura marrëveshja e parë, referuar gjithmonë marrëveshjes së prillit 2013, paraqitet si sukses në bisedimet Kosovë-Serbi. E si mund të quhet sukses ajo marrëveshje kur i jepte kompetenca Serbisë në përzgjedhjen e strukturave të sigurisë në Kosovë, ku Serbia emëronte udhëheqësit e Policisë së Kosovës në veri të vendit. Quheshim edhe ‘paranoikë’ kur thoshim se Serbia po emëron policët dhe komandantët në regjionin e Mitrovicës së Veriut. Po tash po e shohim se ajo që e kemi paralajmëruar, paska qenë reale, për fat të keq. I vetmi dokument i lëshuar nga Qeveria e Kosovës, të cilën më herët kryeministri e prezantoi si raport, e thotë këtë gjë. Pra, ky raport është i këtij viti, 18 qershor 2018 dhe në kapitullin për Policinë, te paragrafi ku flet për sfida, thotë kështu: “Serbia është dashur të sigurojë një listë që tregon hollësisht numrin dhe gradën e punonjësit qeveritarë serbë të punësuar në Kosovë”. Edhe vetë Qeveria e pranon këtë. Atëherë nuk e thoshte këtë. Dhe, në fund në një paragraf thotë: “Pas krijimit të ekipit menaxhues, Serbia i siguroi emrat e kandidatëve”.

Pra, ne thoshim atëherë se Serbia po i emëron, ju thoshit se nuk po e bën një gjë të tillë. Ja pra se çfarë quhej sukses atëherë, për fat të keq thuhet edhe tani, madje shprehet edhe pakënaqësi në këtë rast e Qeverisë së Kosovës që Serbia nuk i paska dërguar emrat me kohë.

Në marrëveshjen e 2013, ka qenë marrëveshja e parë dhe e lehtë, kështu quhej pra e lehtë. Nëse quhej marrëveshja e parë dhe e lehta, atëherë ne duhet të dimë cila do të jetë e fundit dhe e rënda? Pse po mbahet e fshehtë agjenda dhe temat e bisedimeve? Pse nuk na thuhet se për çfarë po flitet, apo parakusht i dialogut me Serbinë është gjithmonë sekret? Tekefundit, kush është ky njeri që e përcakton pozitën e vështirë të Kosovës përballë Serbisë? Kush ia dha këtë të drejtë? A ia dhatë ju, deputetë të mazhorancës, a ia dhatë ju që e zgjodhët, qoftë sot në pushtet, apo dje në pushtet që sot jeni në opozitë? Unë besoj se jo. Ju ndoshta ia keni dhënë votën, por nuk ia keni

dhënë mandatin që ai ta shkelë Kushtetutën dhe rendin kushtetues, pra sovranitetin e Republikës së Kosovës. Prandaj, ju vetë duhet ta ndalni. Tashmë, ai po tregon se së paku është dorëzuar. Ai po mban dialogun për interesa të Serbisë, ngase vetë dialogu po del të jetë i ndërtuar për interesa të Serbisë. Kthejeni këtu në Kuvend dhe ndalojeni ta bëjë gabimin e radhës. Ai nuk e ka ndërmend të ndalet, pra në këtë rast, nëse Kuvendi nuk e ndal, atëherë duhet ta ndalë populli. Në rast se do të kishte rend ligjor në këtë vend, atij do të duhej t'i konfiskohej pasaporta, gjithmonë nëse ka vetëm një.

Po ta kishim ndalur në atë seancën e gjatë të Kuvendit, para marrëveshjes së prillit, sot nuk do ta kishim 'Zajednicën' si projekt, as komandë regjionale etnike, as polici të ndarë, as komandantë që do të emëroheshin nga ana e Serbisë. Pra, këtë do të duhej ta ndalnim dhe nuk e ndalëm. Tani është vonë që ta korrigjojmë atë që është bërë, është koha e duhur që të mos lejojmë atë që po shihet se çfarë mund të bëhet. Por, unë tash këtu, dhe me të drejtë edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, nuk ka besim as te Qeveria e sotme, opozita e djeshme që kundërshtonte 'Zajednicën'. Ata e patën kundërshtuar edhe demarkacionin me Malin e Zi, por sapo erdhën në pushtet, ia votuan 8200 hektarë dhe i kaluan Malit të Zi si territor. Shenjat e para se do të bëjnë kështu po japin edhe tani, kur iu bashkuan Thaçit në Bruksel. Përderisa i ranë pishman për demarkacionin, askush nuk mund të garantojë se këta nuk i bien pishman edhe për 'Zajednicën'. Prandaj ne nuk duhet t'ia lëmë në besë askujt Kosovën, as Thaçit, as atyre që i shkojnë pas. Le ta ndalim tash, cilindo që merr guximin ta dëmtojë Kosovën, le të veprojmë tash sa nuk është ndarë Kosova, le ta miratojmë një rezolutë, e cila fillimisht ndalon këto bisedime dhe pastaj ta miratojmë një rezolutë që askush të mos guxojë të veprojë në dëm të sovranitetit, integritetit dhe kundër rendit kushtetues të Kosovës dhe këtë duhet ta vendosë Kuvendi në mbrojtje të interesave shtetërore dhe në mbrojtje të rendit kushtetues. Nëse nuk veprojmë tash, shtatori do të jetë fatal për Kosovën.

Por, çfarë në të vërtet mund të bëjë Kosova tani? Sponsorizuesi ka dhënë një rezolutë, qëndrimet tona u thanë nga deputeti Liburn Aliu dhe nga deputetë të tjerë. Pra, ne nuk mund të korrigjojmë diçka që është në rrjedhë të keqe. Para se ta ndalojmë atë, krahasuar me një kirurg, kirurgu nuk mund ta bëjë operacionin nëse nuk e ndal paraprakisht gjakderdhjen. Serbia edhe po të donim ne, nuk është e ndryshme për ne. Serbia ka vazhduar të sillet armiçësisht me ne, as ne nuk mund të sillemi miqësisht me ta.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Çausi.

DRITON ÇAUSHI: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Natyrisht, duke qenë dita e dytë që po diskutohet në lidhje me dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, shumica e çështjeve janë trajtuar deri tani, shumica e kolegëve paraprakisht i potencuan

të gjitha ato dëme që janë bërë, është gjithashtu e rëndësishme të thuhet, e kjo gjë është konstatuar nga të gjithë, edhe nga shoqëria civile, që edhe ato marrëveshje, të cilat në masë të madhe kanë qenë të dëmshme për Republikën e Kosovës, shumica e marrëveshjeve të arritura në Bruksel kanë mbetur të pazbatuara nga ana e Serbisë.

Por, besoj se kur bëjmë një bilanc të tillë, është mirë të flasim për atë çfarë nuk është biseduar dhe këtu ka shumë për të folur. Unë do të ndalem në dy çështje më të ngushta, por që vazhdojnë të jenë tepër të rëndësishme për shumë qytetarë të Kosovës, e këto janë krimet e luftës, për të cilat nuk ka asnjë iniciativë serioze nga institucionet ligjore të Republikës së Kosovës, por edhe zbardhja e fatit të të pagjeturve. Besoj se ju kujtohet se në muajin maj kishim një debat në lidhje me këtë çështje. Sot me sa e di, është një debat parlamentar, por po e shoh një gatishmëri të kryeministrit që të përgjigjet në secilin diskutim. Do të ishte mirë që të ishte prapë kështu dhe të na e jepte një sqarim në lidhje me pozicionin e Qeverisë së tij për këtë çështje. Kujtoj se në këtë rezolutë për të pagjeturit më 3 maj 2018 zbardhja e fatit të të zhdukurve me forcë kërkohet të vendoset si parakusht në dialogun me Serbinë. Pika 8 thotë: “Institucionet kompetente në padisin Serbinë si përgjegjëse kryesore për personat e zhdukur, duke përfaqësuar familjet e tyre”. Ju kujtoj se kjo rezolutë është votuar me 71 për, 4 vota kundër dhe asnjë abstenim. Dhe çka ndodh ndërkohë, po citoj kryeministrin Haradinaj se çka tha para disa ditësh, më 24 korrik dhe do të ishte mirë që ta trajtonte këtë personalisht. Thotë s’ka kompromis më të dhimbshëm besoj, të gjithë e dinë se fakti i njohjes me Serbinë nënkupton njëfarë falje.

Pra, kur njihemi reciprokisht, është një fakt i dhimbshëm për Krushën, Mejen, për të gjitha këto vende. Unë këtë nuk e kuptoj ndryshe vetëm se braktisje, siç kanë bërë të gjithë kryeministrat paraprakë para familjarëve të të pagjeturve. Ju kujtoj edhe ish-kryeministrin Isa Mustafa, e mbaj së paku mend më 30 gusht të vitit 2015, kishte premtuar para familjarëve se çështja e të pagjeturve do të jetë prioritet në dialogun me Brukselin. Po dëgjoj nga ana e pushtetit për kredibilitetin e Hashim Thaçit për t’ia besuar këtë proces, shumë nga kolegët i thanë argumentet pse kjo nuk qëndron, por kur është çështja e të pagjeturve, herën e fundit në cilësinë e presidentit ishte më 30.12.2017, kur presidenti tha se kjo çështje do të shtrohet në Bruksel.

Ajo që bashkë me atë që citova nga kryeministri më shqetësojnë, është edhe i deleguari i kryeministrit për negociata, Avni Arifi, i cili më 21 korrik, pra para disa ditësh, tha se ne konsiderojmë se duhet të implementohen marrëveshjet ekzistuese dhe ne nuk synojmë hapjen e temave të reja, pra kjo i bie që jemi para një marrëveshjeje përfundimtare dhe familjarët e të pagjeturve arritën t’i mashtrojmë për një 7 vjet, të paktën, në procesin e fundit negociator dhe përfundimisht, ata që u kthyen që ishin meritë e protestave të nënave dhe të familjarëve të tjerë të këtyre të pagjeturve, ishte ajo që arritëm, kurse për 1 mijë e 650 të tjerë qytetarë të Republikës së Kosovës nuk do të ketë asnjë trajtim, negociim, kusht ose diçka tjetër në këtë proces, i cili po trajtohet në pjesën finale të tij.

Unë po kujtoj vetëm një rast ku ka qenë fare e lehtë për këto vite të pasluftës të shfrytëzoheshin mekanizmat ligjorë dhe të ngrihej një padi për krime lufte, e kjo është varreza e Batajnicës. Nuk ka më të thjeshtë se sa të kesh një poligon, i cili është shndërruar në një varrezë me 744 trupa të shqiptarëve dhe për gjithë këto vite nuk ishim në gjendje, gjithë këto institucione për krime lufte e të gjitha të tjerat që u formuan për këtë qëllim të ngrinin një padi. Më intereson prapë, do të ishte mirë, edhe pse nuk kemi asnjë përfaqësues të Qeverisë tani, le të na tregojnë, le të bëhen të sinqertë nëse është fundi i këtij procesi, nëse kaq ishin në gjendje të bëjnë, nëse edhe kjo çështje e krimeve të luftës do të mbetet e patrajtuar, edhe nëse edhe kjo kategori e qytetarëve të Republikës së Kosovës po braktiset përfundimisht në këtë proces. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shkumbin Demaliaj e ka fjalën. Regjia, fjalën zotit Demaliaj!

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, nënkryetar, zoti Haliti!

Të nderuar deputetë,

Për çka jemi thirrur askush sot nuk e trajtoi temën në mënyrë adekuate për çka po flasim, mirëpo parashtruan kërkesa, parashtruan histori, forma, djallëzi se qysh është dashur të ndodhë, çka ka mundur të ndodhë, qysh kanë shkuar vite të humbura, të gjitha këto ishin temë e diskutimit sot, kryesisht nga deputetët e opozitës. Kemi një kërkesë për një rezolutë nga Partia Socialdemokrate e Kosovës, por edhe ata i kanë parashtruar pikat e kësaj rezolute.

Tema të tjera çka po diskutohen është humbje kohës për ne, kurrkush nuk po parashtron diçka lidhur me një platformë apo për të ofruar një unitet, përpos asaj paqartësisë që gjithmonë për t' i dhënë një kuptim ndryshe, se diçka është duke ndodhur, sikur po ne po e dimë që po ndodh, po s'po duam të dimë çka është duke ndodhur. Në rastin adekuat kemi trajtime të ndryshme, kemi ofendime, krejt oponencat e kësaj opozite po shkon drejt asaj duke u marrë me Hashim Thaçin. Binduni se veç e keni rritur Hashim Thaçin në këtë rast, se kurrëgjë s'keni bërë, krejt po merreni vetëm me një figurë. Ne jemi duke folur për epilogun e dialogut në Kosovë. Pati tema se pse s'po futet dënimi i krimeve, gjenocidi, ne e dimë shumë mirë se po i kthijem ato tema mbrapa, ky dialog s'do të marrë fund. Ne nuk jemi pjesë e mekanizmave ndërkombëtarë, ne s'jemi pjesë as e OKB-së, as e Këshillit të Evropës. Menjëherë pas përfundimit të dialogut, të gjitha këto mund t'i bëjë Kosova, ju e dini sikur ka dashur mekanizmi institucional i Kosovës ta akuzojë në Gjykatën e Drejtësisë Serbinë për gjenocid, s'kemi mundur, bile ka pasur një formë tjetër për t'u trajtuar që nëpërmjet Shqipërisë ta akuzojmë. E përderisa i bëjmë të gjithë këto pengesa, ne jemi ata që po e pengojmë vetë zhvillimin e procesit.

Ana tjetër deklarative, po i them zotit Selimi, e përmendi se në kohën e kaluar nuk e ka bërë TMK-në ushtri. Ka qenë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, pse e kanë prishur UÇK-në së pari e s'e kanë bërë ushtri? Nuk është e lehtë për ta trajtuar një temë vetëm pse po më teket në atë formë. Pjesa e dytë sekondare, Rexhep Selimi ka qenë ministër i Punëve të Brendshme të Hashim Thaçit, qysh duhet t'i besojmë anës deklarative tash ne zotit Selimi në këtë rast, në qoftë

Hashim Thaçi është ai që i filtron njerëzit, më të parin e ka trajtuar në masa të sigurisë zotin Rexhep Selimi, ishte ministër i Hashimit në qeverinë e përkohshme, pse duhet t'i besojmë në fjalën së Rexhepit tash. Pastaj, ka qenë në Aleancë dhe ka thënë se unë nuk do të jem pjesë as e Kuvendit, as e Qeverisë pse Aleanca është bërë me Ibrahim Rugovën. Ne mund të kemi edhe forma të tjera, ky historik e ka edhe anën tjetër të medaljes. Kështu që kisha thënë më mirë të dalim me një platformë, të jemi të unifikuar rreth trajtimit të këtij problemi që është në përfundim të procesit. Le të ndodhë ajo njohja reciproke, jemi shtete të barabarta, atëherë të gjitha akuzat, jo t'i trajtojmë emocionalisht, se unë jam duke e trajtuar çështjen e të zhdukurve, jam duke e trajtuar çështjen e krimeve të luftës. Po ne nuk e kemi atë barabarësi me shtetet e tjera për t'i trajtuar këto segmente në mekanizmat ndërkombëtarë për momentin, fatkeqësisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë ka zoti Selimi.

REXHEP SELIMI: Shkumbin, a veç për replikë ma përmende emrin, a ? Shiko, Shkumbin, nëse doni të dini se kush po i udhëheq bisedimet me Serbinë, atëherë edhe ju e njihni. Unë fakt se kam qenë në UÇK dhe kur është transformuar UÇK-ja, shikoje mirë kush ka qenë përbërja, mos fol paushall pa emra saktësisht. Është njëfarë fotografie që e ruani nëpër zyre, shumë e madhe aty, në mesin e tyre është ai që sot po iu prin dhe po i shkoni përmbra në bisedime. Pra, nëse do të dish unë personalisht me Thaçin s'kam kurrëgjë, madje as nuk e konsideroj diçka problem personal. Kosova ka problem me këtë njeri, e aq më tepër kur ky njeri deri tash i udhëhoqi bisedimet dhe u pa çka sollët, e tash në valle ju futët mbrapa. Se kam qenë UÇK, se kam qenë në qeverinë e përkohshme të Kosovës ministër i Brendshëm, asnjë ditë nuk ia heq atij aktivitetit tim. Prandaj, mos e nxjerr dikë aty ku edhe vetë nuk mund ta fitosh atë debat, dhe në anën tjetër, kryeje porosinë pak më mirë, se s'e kreve mirë.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Demaliaj!

SHKUMBIN DEMALIAJ: Shkumbin Demaliaj asnjëherë nuk flet me porosi, zoti Selimi, edhe tjetra është, betohem në atë se kurrë s'flas me porosi, nuk e kam kërkuar fjalën deri në momentin pasi i the të gjitha ato. E dyta, keni qenë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kemi qenë miq dhe njihemi, e treta është kur do ta akuzosh dikë se po i shkon mbrapa dikujt, qysh në themelim zoti Selimi ke shkuar pas Hashim Thaçit dhe ke qenë ministër i tij. Përderisa ke qenë ministër i tij, edhe në Qeverinë e tij, pse neve duhet tash pas 18 vjetësh të na thuash pse po shkoni pas këtij njeriu? Kjo është ajo çka po dua të them.

KRYESUESI: Kryeministri Ramush Haradinaj e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Unë i thashë mendimet në fillim, nuk dëshiroj t'jua marr kohë, ju i keni pikëpamjet tuaja, nuk ndryshojnë ato që i thashë për mënyrën se si duhet të

shkojmë përpara. I dëgjova diskutimet edhe prej Antonit, edhe prej kolegëve të tjerë, të gjitha i dëgjova, po nuk erdha për atë, vetëm më erdhi keq prej Dritonit, Driton Çausi e dha një shpjegim lidhur me të zhdukurit, me deklaratën e Avniut, Avniu është këtu parapa, unë jam këtu, e dëgjova edhe Andinin kur foli, ne të gjithë jemi të ndjeshëm kur deklarohen fëmijët e atyre që prindërit e tyre janë, t'i quaj ashtu, "themel" i asaj kush jemi, pa u përcaktuar si është fati i tyre, se ne i quajmë ende të pagjetur, por është kohë e gjatë, kemi respekt për fëmijët e dëshmorëve, të martirëve, pra jemi jashtëzakonisht të ndjeshëm në këto deklarime, veç për shpjegim edhe te Dritonit, deklarata e Avniut është kjo, ose përmbajtja e kësaj që ka thënë Avniu është kjo: ne kemi marrë, kemi trashëguar një proces të dialogut teknik, i quajtur "teknik", që ka udhëhequr zonja Tahiri, që tani e udhëheq zoti Arifi. Për këtë dialog ne kemi trashëguar një marrëveshje, një marrëveshje të përgjithësuar dhe nën-marrëveshjet e saj. Ne e kemi marrë krejt këtë materie, e kemi publikuar një raport dhe ua kemi sjellë deputetëve ashtu si është, ndonjë qeveri tjetër e kish bërë pak më ndryshe, ne e kemi sjellë si është.

Deklarata e Avniut se nuk e hap temën e të pagjeturve në kontest të këtij dialogu që ka pasur format, pra mos e keqkuptoni, ju lutem, jeni gabim nëse e bëni këtë, e ndërlihdni deklarin e dikujt që është mjaft i sinqertë. Thotë unë e kam gjetur këtë materie, këto janë marrëveshjet, për këto kam marrë autorizimin, po i drejtoj këto, nuk hyn çështja e të pagjeturve në çështjen me energjinë a me diçka tjetër, përndryshe do të dilnim keq. Ndoshta, po të hynim në fillim, ka mundur, ndoshta ka kuptim, por tani kur shkon Avniu atje të flasë për IBM-në dhe të pagjeturit, nuk kemi bërë kështu, por nuk është kjo deklaratë të kuptohet se ne nuk e kuptojmë peshën e kësaj teme dhe nuk jemi të interesuar ta trajtojmë. Nuk mundemi në atë kontekst, se do ta zhvlerësonim maksimum temën dhe vetë problemin që është i ndjeshëm, ama një gjë duhet ta dini, jo vetëm ne që jemi sot në pushtet e në qeveri, por nuk e di kush është në këtë vend që nuk e ka parasysh ndjeshmërinë e asaj teme, rëndësinë e asaj teme, kujdesin ndaj asaj teme. Ju lus mos shkoni deri në atë shkallë se po na qitni në pozitë të keqe, jam i detyruar ndoshta jo të japim shpjegime, por të shkohet edhe më larg në shpjegime. Kjo Qeveri është e kujdesshme, jemi duke e trajtuar me kujdes këtë temë, nuk po duam ta keqpërdorim, nuk janë bërë keqpërdorime, por për t'iu treguar se a ka evoluar diçka në këtë temë, Driton, i kam takuar përfaqësuesit e Shoqatave të Pagjeturve në rezidencën e Princit Charls në Angli.

Për të hyrë këta njerëz dhe tema e tyre në atë rezidencë e të pritët baca Bajram prej Princit Charls, e të marrë peshën e atij samiti, pesha e të pagjeturve, ju lus për pak konsideratë. Nëse një temë s'e kemi pasur temë as në Kosovë, sot ajo temë ka mbërritur në atë nivel, në nivelin e një deklaratë në samitin e Londrës, në nivelin e pritjes në nder të familjarëve të pagjetur të Kosovës nga Princi Charls. Besoni, plot burra të shteteve nuk hyjnë në atë rezidencë, kanë hyrë njerëzit tanë, pra e kemi kthyer temën, e kemi kthyer në tavolinë, s'po di, jo për ta thënë sot këtu, kurrë s'e kisha thënë sikur të mos ishte kjo që thatë ju, po ju lutem, ndajeni këtë prej temave të tjera.

KRYESUESI: Replikë, zoti Çausi! Regjia, zotit Çausi fjalën!

DRITON ÇAUSHI: Zoti kryeministër, të jeni të sigurt për një gjë që nuk e kam temë të zgjedhur këtë që e trajtova pak më herët dhe nuk e kam, të them për qejf të flas për këtë çështje, të paktën personalisht nuk është çështje që më intereson, ka shumë vjet, mirëpo ajo që ka rëndësi është që duhet pranuar se të gjithë, domethënë kryeministrat paraprakë kanë premtuar trajtim të kësaj çështje në Bruksel dhe kjo çështje edhe nga Grupi për Dialogun Teknik, e udhëhequr nga Edita Tahiri, është hapur vetëm një herë gjatë kësaj faze, pra, ka pasur mundësi të hapet.

Fatkeqësisht është hapur nga përfaqësuesit e Bashkimit Evropian, të cilët i kanë kërkuar zonjës Tahiri një listë me të pagjeturit, informacion që ajo nuk e kishte me vete dhe kjo është hera e parë dhe e fundit që kjo çështje është trajtuar në Bruksel. Unë e çmoj gatishmërinë tuaj për këto takimet në Britani të Madhe, por unë po ju them që mund të gaboj, edhe pse secili është një jetë e një njeriu, por të paktën në dy vjetët e fundit nuk ka ndryshim të numrit të të pagjeturve. Njerëzve u interesojnë kthimi dhe jo përfaqësuesit, ku takohen përfaqësuesit e tyre dhe me kë takohen. Tjetra, nëse kjo është gabim dhe zoti Arifi ka marrë një mandat vetëm për çështje, të cilat i ka trashëguar, në rregull, unë po e tërheq këtë akuzë, ta them, që e bëra, vetëm se na premtoni ju, të lutem, që në këtë fazën përfundimtare, e cila nuk do të jetë teknike, siç ka qenë edhe kjo që quhet teknike tërësisht politike, na premtoni që kjo çështje do të trajtohet.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar Driton, edhe tash që ne të gjithë dëshirojmë ta themi atë përmbajtjen, ndoshta jo krejt ato elemente të tjera, por nga marrja e përgjegjësisë qeverisëse këto kategoritë e lirisë, kategoritë që e meritojnë kujdesin, me kujdesin më të madh jam interesuar për temë, edhe për temën e të pagjeturve ju siguroj që jam interesuar. Unë vetë kam mbajtur takime, vetë personalisht, kryeministri me ekspertët e Forenzikës që janë në kuadër të EULEX-it në Kosovë dhe jam interesuar personalisht për krejt ato ekshumime, identifikimin të eshtrave që qëndrojnë në morg këtu, që janë me qindra skelete të paidentifikuara, me atë që supozohen që janë vende fqinje e me procese të tjera, por nuk e kemi ngarkuar opinionin me këto për shkak të ndjeshmërisë së tyre.

Në të njëjtën kohë kemi punuar intensivisht, kam punuar intensivisht vetë që Kosova të aftësohet me Institutin e vet të Forenzikës, këtu është edhe ministri Tahiri, i kemi dhënë rëndësi këtij instituti që ta marrë fuqinë e vet dhe të mundemi edhe ne që ato që na barten të mos dështojmë. Në anën tjetër, me të gjitha palët bashkëbiseduese, ju e keni hetuar, unë kam thënë ne duhet të arrijmë një pajtim, edhe kompromis e kam quajtur pajtimin me Serbinë, ky pajtimi nuk është pajtim emocional e falje të krimeve, po faktin që vendos marrëdhënie bilaterale me dikë është një lloj pajtimi, si produkt ose si çështje që duhet ta ndihmon këtë pajtim është pikërisht edhe zgjidhja e çështjes së të pagjeturve. Kemi mbërritur këtë temë, nuk e them këtë krejt veç për shkak të simbolikës, po në këtë pritjen ku ishim ne ishte kancelarja Merkel, ishte kryeministri Izamej, ishte pastaj kryeministri i Polonisë, kancelari i Austrisë, baca Bajram me ekipin e vet të

familjeve të pagjeturve. Pse po flas kështu? Po flas se tema e të pagjeturve është rikthyer në peshën e vet, edhe pse nuk është formalisht njëra nga temat në agjendën e dialogut të deritashëm, po peshën e ka marrë, e ka fituar peshën kjo temë, tani duhet të kujdesemi, duhet të punojmë të gjithë që ta avancojmë. Njëkohësisht, ka qenë temë e diskutimit, pra, në Samitin e Londrës, ku ishim gjithë në Ballkani Perëndimor, e që është pjesë e procesit të Berlinit.

Nëse i kemi parasysh krejt këto, ju siguroj pra që me njëfarë, po them ashtu, modestie publike, po jo modesti në përmbajtje, jemi duke e trajtuar këtë temë dhe ju kërkoj falje edhe unë pse u riktheva, e nxita këtë, po ju lutem, për hir të së vërtetës të jemi të kujdesshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Unë po mendoj se ideja për debat përpos që është e mirë, është edhe një ide për ta rikthyer temën fundamentale për shoqërinë tonë në Kuvendin e Kosovës, Kuvend i cili ka obligime edhe ligjore, edhe kushtetuese, për t'i trajtuar, debatuar dhe, natyrisht të marrë edhe qëndrime rreth temave, siç është kjo e sotme.

Mirëpo, ajo që më shtyri edhe një herë ta marr fjalën është se kryesisht një pjesë e madhe e kolegëve po merren me marrëveshjet e deritashme, për të cilët edhe unë, edhe Nisma, por edhe shumë kolegë deputetë të tjerë kanë thënë me qindra herë në këtë Kuvend se janë marrëveshje tepër të dëmshme, jo veç të dëmshme, marrëveshje për të cilat unë mendoj se në një të ardhme të afërt dikush duhet të japë edhe përgjegjësi ligjore, sepse janë marrëveshje, të cilat kryesisht janë diskutuar dhe trajtuar me Serbinë, por që s'kanë pasur të bëjnë me Serbinë, por kanë qenë çështje të brendshme të Kosovës. Unë mendoj se këtu është një konsensus thuajse i përgjithshëm për atë që ka ndodhur deri tash, mirëpo problemi qëndron te ajo se ne mund të arrijmë atë që synojmë dhe që pret qytetari i Kosovës nëse merremi me marrëveshjet e dëmshme dhe nuk bëhemi unikë për një marrëveshje përfundimtare, e cila të gjitha këto marrëveshjet e dëmshme i lë nën hije ose i lë minore. Unë besoj se edhe kryeministri e ka idenë, sepse janë debatuar tema edhe për marrëveshjet e deritashme, edhe të arriturat dhe ato që janë arritur dhe nuk po realizohen, por që mendoj se marrëveshja që duhet të ndodhë si rezultat i një bashkimit të forcave politike qytetare në Kosovë thjesht duhet t'i përmirësojë ato lëshime dhe gabime, jo për t'ua falur atyre që i kanë bërë ato lëshime dhe gabime.

Unifikimi i qëndrimeve, siç thashë, është përgjegjësi e këtij Kuvendi dhe të gjitha forcave politike dhe politika konspirative që po paraqitet kohë pas kohe me dyshimet e hedhura se dikush e di përfundimin e bisedimeve të dhimbshme, unë mendoj se në rast se ne merremi me këtë politikë konspirative, po e pengojmë atë unifikimi për të cilin një numër i madh këtu po angazhohen. Vërtet në politikë, e veçanërisht në politikën ndërkombëtare ka edhe prapaskena, mirëpo ne nuk duhet mendoj të frikësohemi dhe në rast se e dimë që ka edhe prapaskena, ne

mund të tërhiqemi nga ajo që është synim dhe objektivi ynë. Besoj se kërkesa e Nismës dhe e zotit Limaj, zoti Rexhep Selimi, për bashkimin e forcave politike për këtë temë kardinale për vendin ka të bëjë edhe me atë që Kosova nuk është pronë private e Hashim Thaçit, që emri i tij të jetë ‘mollë shëri’ për të krijuar një unitet të forcave politike. Unë besoj se zoti Selimi e ka kuptuar mirë mesazhin e zëvendëskryeministrit Limaj dhe Nisma Socialdemokrate është ithtar e asaj që ne për tema si kjo që po diskutojmë të jemi bashkë, sepse duke u marrë me njëri-tjetrin, dyshojmë se domethënë më shumë po i bëjmë dëm Kosovës dhe perspektivës së saj, se që po e zgjidhim ndonjë problem.

Natyrisht se kur diskutohet për bisedime me Serbinë, lufta asnjëherë nuk po mbetet anash dhe lufta dhe gjithë ajo që ka ndodhur po përdoret nganjëherë edhe njëanshëm, por lufta, me gjithë lavdinë dhe tragjedinë që ka pasur, unë mendoj duhet të na shërbejë për të arritur atë që ka qenë dhe mendoj se duhet mbetur objektivi i luftës. Kosova është shtet i pavarur dhe sovran, me ambicie të pakontestueshme në të ardhmen për atë që unë e llogaris Shqipëri natyrale, por rrethanat historike na kanë nxjerrë këtu ku jemi dhe ne duhet të përballemi me këto rrethana. Seanca natyrisht po ka nuanca edhe të shprehjes së simptomave historike, mirëpo seancë që i paraprin zhvillimeve që do t’u paraprijë ngjarjeve historike, jo vetëm seanca të përdoret për të kaluarën historike, por kjo seancë të përdoret edhe për unifikim të forcave politike që t’u paraprijë ngjarjeve dhe zhvillimeve historike që mendoj se në të ardhmen, domethënë gjeneratat do ta vlerësojnë qëndrimin tonë edhe në këtë seancë, edhe në këto momente politike nëpër të cilën po kalon vendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, Rexhep Selimi!

REXHEP SELIMI: Zafir, sinqerisht po dua të përgjigjem në atë çfarë e përmende ti pak a shumë, ndonëse në emër të zotit Limaj, i cili qëndroi shkurt këtu, por sido që të jetë, thirrja e Fatmirit, Zafir, nuk ishte thirrje për bashkim, ishte thirrje për t’iu bashkuar Thaçit. Nuk jemi aq sa për të mos e kuptuar një gjë të tillë, pra thirrja e tij nuk ishte “eja bashkohemi”, sepse a e di cilët janë mekanizmat e bashkimit, por ishte thirrje “eja t’i bashkoheni Thaçit edhe ju, siç i jemi bashkuar ne”.

Pra, Qeveria komplet dhe faktorët e tjerë politikë të partive politike në qeverisje iu bashkuan Thaçit, i shkuan mbrapa deri në Bruksel, madje kishte rast edhe kur pritshim në korridor, pa e ditur se çfarë fliste ai me Vuçiçin dhe, tek e fundit, kjo nuk është thirrje për bashkim, është thirrje për bashkim në bashkëfajësi. Lëvizja Vetëvendosje nuk i bashkohet kësaj, jo për shkak se s’do të marrë faj, por për shkak se do të shpëtojë nga ajo që ka mbetur për të shpëtuar, Zafir.

KRYESUESI: Zafir Berisha, kundër-replikë!

ZAFIR BERISHA: Rexhep, unë pak kam dëshirë të replikoj, por gjithsesi do të përgjigjem, sepse unë gjatë fjalimit të zotit Limaj llogarita që është duke i përsëritur fjalët, ai me gjasë e ka bërë me qëllim që ta kuptosh edhe ti. S’di sa herë, bile nëse s’gaboj, katër herë e ka përsëritur të bëhemi bashkë për dialogun që na pret, duke ripërsëritur se dialogu, sipas këndvështrimit të zotit Limaj dhe të Nismës, nuk ka filluar dhe këtu unë e thashë edhe më herët, Hashimi të mos përdoret, edhe në seancën e kaluar e kam thënë, si një person i cili e prish synimin për unitet. Ne edhe mund të gjejmë, se gjuha, thotë populli, “është prej tultit edhe kah te çosh, shkon”, mund të gjejmë edhe ‘qime në vezë’. Mirëpo, unë sa e di qëndrimin zyrtar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Para saktësisht tetë vjetëve në selinë e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë dëgjonim shpalljen e opinionit të kësaj gjykate lidhur me deklaratën e pavarësisë së Kosovës. Një ndër argumentet tona kryesore, i cili u theksua edhe nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, kishte rol determinues në votimin e gjyqtarëve. Gjykata theksonte, ashtu siç kishte argumentuar Republika e Kosovës, se shpallja e pavarësisë ishte akt që reflektonte vullnetin e popullit të Kosovës. Pra, ishte vullnet i popullit, jo i aktorëve individualë politikë, e as institucioneve të veçanta, në Deklaratën e Pavarësisë kishte folur populli. Ky vullnet i reflektuar qartë në këtë deklaratë ishte burim themelor gjatë hartimit së Kushtetutës së Kosovës, ku theksohet se Kosova është shtet i pavarur, sovran, me karakter unitar, multietnik dhe kufij të cilës janë të paprekshëm, të pacenueshëm, të pandashëm dhe të patjetërsueshëm. Kushtetuta po ashtu tregon se si e shprehin qytetarët zërin e tyre si sovran, e para është nëpërmjet nesh, si përfaqësues të tyre dhe, e dyta, nëpërmjet referendumit.

Meqë çështjet që sot janë në tavolinën e negociatave nuk prekin çështje teknike, meqë ato prekin vetë përkufizimin e shtetit të Kosovës, karakterin e përcaktuar në Deklaratën e Pavarësisë, ku u shpreh vullneti i popullit, nuk ka sot politikanë në Kosovë brenda kësaj sale apo jashtë saj që mund të nënshkruajë marrëveshje për territorin apo çështje që e vë në rrezik funksionalitetin e brendshëm të Kosovës si shtet, për çështje të tilla duhet të flasë populli, pra të vendoset me referendum. Prandaj, nëse dikush sot po punon për ide të tilla të çmendura, le ta dijë që atë copë marrëveshje që e nënshkruan, mund ta palosë, ta fusë në xhep dhe ta çojë në shtëpinë e vetë si suvenir personal, sepse për marrëveshjet që rrezikojnë në esencë karakterin e shtetit të Kosovës, për të cilin u dha e u sakrifikuara shumë, pra të deformojë vullnetin e popullit, më së paku mund të vendosin individë pa asnjë legjitimitet e figura përçarëse e jounifikuese. Sot, të nderuar deputetë, me të drejtë po diskutohet për vendosjen e vijave të kuqe në këtë proces. Por, për kënd

po i vendosim ato vija të kuqe? Për një president, i cili tashmë ka thënë që nuk pranon as vija të kuqe, as ndonjë ngjyrë tjetër, madje as parime udhëheqëse për këtë proces? Çfarë kuptimi ka cilido dokument që ne sot e miratojmë për këtë kryenegociator të vetëshpallur? Për këdo që ka dyshime, po e përsëris, zonja e zotërinj, vijat e kuqe tashmë ekzistojnë. Mjafton të lexohet neni 1 i Kushtetutës së vendit, ku thuhet se Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, unik dhe i pandashëm. Këtë fatkeqësisht më nuk po e përsërit presidenti i vendit, por po kërkon që asnjë vijë kushtetuese ligjore, e madje as rezolutë të mos i pengojë driblinxhet e tij të rrezikshme politike.

Po flitet që pastaj mund të jetë një ide për autonomi në veriun e Kosovës. Secili prej nesh e dimë, duke i parë edhe rastet e tjera në rajon, duke e parë strategjinë që Rusia ka përdorur në shtetet, si Gjeorgjia, Ukraina, e të tjera, ndoshta edhe mund të merret një njohje nga ana e Serbisë, por për çka, për një shtet të gjymtuar, për një shtet që nuk mund ta kontrollojë territorin e vet, për një shtet që mund ta ketë në një ulëse në Kombet e Bashkuara, por njëjtë sikur Bosnja, me një ambasador që s'guxon as të flasë për Srebrenicën. A është ky një shtet që na duhet ne? A është ky një shtet për të cilin u nënshkrua Deklarata e Pavarësisë? Në fakt, autonomia për veriun apo cilido emër që ia vendosni, por me kompetenca të tilla, nuk nënkupton asgjë tjetër, pos një ndarje apo aneksim të vonuar nga ana e Serbisë, ashtu siç po e bën tashmë Rusia, pasi i ka njohur disa nga ish-republikat sovjetike.

Diçka edhe rreth bashkëbiseduesit të Thaçit në këtë proces. Për herë të parë një president i vendit, pra i Kosovës, thotë që marrëveshja të cilën e nënshkruajmë duhet të jetë e pranueshme edhe për Serbinë, ky është standard i ri. E dyta, për herë të parë një zyrtar i lartë në Kosovë e kualifikon Vuçiqin si lider të paqes, pra njeriun që ishte sekretar i përgjithshëm i Partisë Radikale në kohën kur kryheshin ato krimet monstruoze, për të cilën u fol sot nga shumë deputetë. Njeriun i cili një ditë para Srebrenicës mbante fjalime në Parlamentin e Serbisë dhe thoshte për secilin serb ne do të vrasim 100 myslimanë! Njeriun i cili ishte ministër i propagandës së Milosheviqit dhe sot konsiderohet kinse si lider i paqes e proevropian?! Pra, ne sot përfaqësohemi nga dikush që për interesa personale, krejtësisht personale, për të shpëtuar lëkurën e vet, është i gatshëm ta spastrojë nga krimet e bëra, nga përgjegjësia për krimet e bëra secilin politikan në Serbi. Pra, jemi duke u përfaqësuar nga dikush që dhunshëm po bën kompromise në emër të Kosovës, por pa u mandatuar nga Kosova. Kosovës definitivisht nuk i duhen njerëz që mbi tavolinë negociojnë fatin e Kosovës, ndërkaq nën tavolinë fatin e tyre politik.

Pra, po flasim për zhvleftësim të pavarësisë, zhvleftësim të Kushtetutës dhe zhvleftësim të mendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Por, për të gjithë ata që e kanë përcjellë politikën për një kohë të gjatë nuk është aspak çudi, meqë po flasim për pikërisht të njëjtin njeri, i cili qysh nga viti 2002 e këndej ka bërë aventura rreth çështjes së ndryshimit të kufijve. U fol këtu për çështjen e të pagjeturve dhe duhet të saktësohen informatat. Në fakt, Princi Charles, së bashku me bashkëshorten e tij, Kamila, ka qenë në Kosovë në mars të vitit 2016 dhe qysh

atëherë e ka marrë personalisht ngritjen e çështjes së të pagjeturve dhe viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës. Çështja e vendosjes në agjendë në Samitin e Londrës që është pjesë e procesit Berlinit, edhe të këtyre temave, edhe të temës së pajtimit, kanë qenë të vendosura qysh në Samitin e fundit që është mbajtur në Berlin. Megjithatë, mua më vjen mirë që edhe Qeveria e tanishme po thotë se do ta marrin përsipër që ta çojnë përpara këtë temë. Por si e marrin përsipër kur vetë nuk po e pranojnë përgjegjësinë të jenë në atë tavolinë në Bruksel?! Edhe thonë në të njëjtën fjali: “E kemi përgjegjësi, nuk i ikim përgjegjësisë, por ne nuk po e marrim këtë përgjegjësi”. Pra, kontradikta në të njëjtën fjali.

Tjetër. Sot më shumë se në çdo moment tjetër në historinë tonë, kush e determinon edhe çka? Në fakt, ai që për momentin është duke e udhëhequr këtë proces njëanshmërisht, është duke determinuar çka diskutohet, nuk ka pranuar asnjë kufizim kushtetues, pra nuk do të pranojë asnjë kufizim as nga ky Kuvend. Pra, ata që po thonë pse po kundërshtoni presidentin, ndoshta është më mirë të përgjigjen, po pse ju po insistoni në atë emër dhe asgjë tjetër?! Pse ju po insistoni që absolutisht këtë element që po e quani kozmetik, trivial, të parëndësishëm, ta keni aty? Në qoftë se vërtet qenka i parëndësishëm, largojeni. Largojeni pengesën!

Sot, vërtet Republikës së Kosovës i duhet uniteti, por i duhet uniteti për të parandaluar kompromiset që tashmë kanë filluar; për Gazivodën, për territorin, për Trepçën, për të dhënë falje pa u kërkuar kërkim-falja nga Serbia, e për shumëçka tjetër. Prandaj, si Kuvend na takon që t’u japim fund këtyre driblimeve politike të Hashim Thaçit, por mbi të gjitha është koha që për ato tema që ai njëanshmërisht i ka hapur në Bruksel, të flasë populli. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë

Të nderuar qytetarë të Republikës

Procesi i dialogut të Kosovës me Serbinë e ka historikun e tij edhe të para luftës, edhe të gjatë luftës, edhe pas saj. Ka dialogë që janë zhvilluar në mënyrë të hapur, janë debatuar edhe për platforma këtu në Kuvend. Ka të atillë që nuk e preferojnë këtë mënyrë të dialogut, e preferojnë një tjetër, më të fshehtë, jotransparent. Edhe këto shtatë vjetët e fundit ka një historik të dialogut, shikuar në të gjitha aspektet edhe te ajo e 19 marrëveshjeve të arritura gjatë kësaj periudhe, edhe për zbatimin apo respektimin e këtyre marrëveshjeve. Po ashtu edhe nga detyrimet të cilat dalin nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, e cila u aprovua pas mendimit këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shpalljen a Pavarësisë së Kosovës. Pra, dialogu me Serbinë është detyrimi yni ndërkombëtar, jo se ndonjëri nga ne këtu ka dëshirë të ulet në tavolinë me Vuçiqin apo Daçiqin. Dialogu mes Kosovës dhe Serbisë i lehtësuar nga Bashkimi Evropian dhe i mbështetur nga SHBA-ja duhet të na bashkojë për një të ardhme më të sigurt të vendit tonë dhe të fëmijëve tanë.

Ne sot do duhej të diskutonim për platformën, për formën e dialogut, për ekipin dialogues, do të duhej të përfshiheshin jo vetëm të gjitha partitë politike parlamentare, por të gjitha institucionet tona përfaqësuese, shoqëria civile dhe ekspertë të fushave të caktuara që do të jepnin kontributin e tyre gjatë këtij procesi jo të lehtë. Deri më tani është diskutuar për individë, për personalitete, për zgjedhje, për pushtet, se sa për unitet dhe platformë të përbashkët. Bisedat tona të subjekteve politike për dialogun me Serbinë kanë marrë kahun jo të duhur për shkak të inateve dhe kapriceve të pajustificueshme. Partitë opozitare po synojnë që të shfrytëzojnë dialogun për të krijuar një situatë për të shkuar në zgjedhje, me shpresën se ashtu do të arrijnë të vinë në pushtet. Pra, qëllim kryesor kanë që nëpërmjet dialogut të arrijnë deri te pushteti. Pozicionet aktuale pozitive - opozitë nuk na shpijnë askund në raport me të ardhmen e vendit dhe në raport me Serbinë, por edhe me partnerët tanë ndërkombëtarë, sepse nuk ka parti politike, e cila do të arrijë e vetme të bëjë 2/3 e nevojshme për votimin e këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare. Pra, na duhet një konsensus dhe një unitet mes nesh që është më se i domosdoshëm.

Deri më tani partitë në pushtet kanë propozuar një platformë dhe kryetari i Kuvendit ka prezantuar platformën e tij, ka pasur bisedime mes partive politike dhe Qeveria, do të thotë, partitë e koalicionit qeverisës kanë propozuar edhe udhëheqësin e dialogut, presidentin Thaçi, që është një dialogues i dëshmuar, të cilin Partia Demokratike e ka përkrahur, e që është kundërshtuar nga partitë opozitare, të cilat deri më tani nuk kanë dhënë as ide, as emër se kush mund të jetë personi që ata propozojnë për ta udhëhequr dialogun. Cili është ekipi që ata propozojnë? Nuk as marrëveshje ndërmjet partive opozitare të kenë një emër apo ekip, nëpërmjet të cilit ata do të përfaqësohen. Të krahasojmë ekipin e propozuar nga Qeveria dhe ekipin që propozohet nga opozita, apo të bëjmë bashkë ekipet pozitive dhe opozitive, shoqëri civile, ekspertë dhe të merremi vesh edhe për udhëheqësin e ekipit, në mënyrë që ai të jetë një person unifikues, të cilin të gjithë do ta ndihmojmë dhe kur të veprojmë të bashkuar, sigurisht që e ardhmja do të jetë e sigurt dhe do të dalim fitues.

Prandaj, edhe për t'ju vënë në sprovë se a keni për konsensus, për unitet, për të shkuar të bashkuar në dialog me Serbinë, unë propozoj një emër për udhëheqës të dialogut, propozoj Bekim Jasharin, djalin e heroit kombëtar Hamëz Jashari, për udhëheqës të ekipit të unitetit, ku do të jenë të përfaqësuar të gjitha partitë politike parlamentare, pozitive dhe opozitive, presidenti, kryetari i Kuvendit, kryeministri dhe ekspertët e nevojshëm. E propozoj Bekim Jasharin udhëheqës të ekipit të unitetit, sepse familja Jashari na ka bashkuar në ditët më të vështira të kombit tonë, na ka treguar rrugën e drejtë, edhe sot si asnjëherë më parë pas lufte kemi nevojë për një udhëheqës të pavarur që na ufikon të gjithëve, pozitive dhe opozitive, gjithë popullin dhe nuk lejon të ndodhin kurrfarë pazaresh me vendin. Prandaj të nderuar kolegë opozitarë, dëshmoni se nuk jeni vetëm kundërshtues, por edhe bashkëpunues gjatë këtij procesi dhe në procese të tjera të rëndësishme për vendin.

Të nderuar kolegë deputetë!

Procesi i dialogut me Serbinë është shndërruar në procesin më të rëndësishëm të vendit, edhe pse do duhej të ishte zhvillimi ekonomik, shëndetësia dhe arsimiti ndër proceset më të rëndësishme të këtij vendi. Sikur zhvillimi ekonomik të ndodhte në nivelin e dëshiruar, sigurisht se procesi i dialogut me Serbinë do të ishte shumë më i thjeshtë dhe ne do të ishim më të dëshiruar për BE-në dhe rruga evropiane për Kosovën do të ishte shumë më e lehtë. Kjo përbërje e Kuvendit ka dalë nga zgjedhjet parlamentare të viti 2017, të vlerësuara si ndër zgjedhjet më të mira të organizuara që nga paslufta, zgjedhje fer dhe demokratike. Prandaj ky Kuvend, ne si ligjvënës, kemi legjitimitetin e plotë të votojmë platformën dhe ekipin dialogues, apo ekipin e unitetit. Kushdo që e thotë ndryshe, e ka gabim, i është turbulluar mendja apo i janë verbuar sytë nga lakmia për të ardhur në pushtet. Është momenti i fundit që ne të zgjedhurit e popullit dhe tërë klasa politike të reflektojmë për formimin e një platforme të përbashkët dhe formimin e një grupi konsensual të unitetit, jo vetëm nga politika, por edhe nga shoqëria civile dhe profesionistët shkencorë. Kushdo që sot refuzon unitetin e ka gabim, sepse nesër nuk do të arrijë të votojë asnjë marrëveshje në Kuvend me 2/3 e nevojshme.

Të nderuar kolegë, nëse ne nuk arrijmë të merremi vesh mes vete, atëherë si synojmë të merremi vesh me Serbinë?! Si do të arrijmë traktat njohje me Serbinë kur ne nuk e pranojmë dhe nuk e njohim njëri-tjetrin! Nëse nuk e njohim presidentin, Qeverinë apo mohojmë vetë Kuvendin dhe legjitimitetin tonë. Kur ne jemi të koordinuar mes vete, të koordinuar me BE-në dhe SHBA-në, Serbia nuk mund të veprojë ndryshe veçse ta njohë shtetësinë e Kosovës nëse do të integrohen në BE. Njohja e pavarësisë së Kosovës dhe normalizimi i marrëdhënieve duhet të jetë kusht për Serbinë nëse dëshiron të jetë pjesë e familjes evropiane. Rruga tjetër është izoluese për Serbinë, por është liberalizuese dhe e hapur për Kosovën. Në ditët në vijim ne mund të merremi vesh për tema të cilat na preokupojnë; dialogu me Serbinë, reforma zgjedhore, zhvillimi ekonomik, lufta kundër korrupsionit, shëndetësia dhe arsimimi i mirë dhe integrimet evropiane. Të krijojmë unitetin për dialogun, pastaj ekspertët e tjerë të punojnë për reformën zgjedhore, të jetë një reformë e përfshirë nga të gjithë, një reformë zgjedhore e besueshme dhe posa të kryhen këto procese të rëndësishme, mund të merremi vesh për të shkuar në zgjedhje, të garojmë me projekte, me programe në të mitë të zhvillimi të vendit. Na priftë e mbara, Zoti na ndihmoftë e na e kthjelloftë mendjen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Mulhaxha e ka fjalën.

FATMIRE MULHAXHA: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës!

Jorastësisht fjalimin tim do ta filloj, apo ma mirë të them, ta citoj një deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës që është njëherësh edhe partner i këtij koalicioni, e i cili bëri një konstatim: “Dialogu i deritanishëm ka qenë shumë i dëmshëm dhe për këtë dialog dikush duhet dhënë përgjegjësi”. Këtë e tha zotëri Zafir Berisha, deputet i Nismës, i cili është partner i këtij koalicioni. Paramendoni pas një konstatimi të tillë, të kërkohet të vazhdohet ky dialog, aq më pak

edhe me njerëz të njëjtë, udhëheqësit e njëjtë. Qytetarë të Republikës së Kosovës, prandaj po them se jorastësisht e fillova kështu këtë fjalimin tim.

Këtu sot u dëgjuan thirrje; të mos i kthehemi të kaluarës, nuk ka nevojë të analizohet ajo çfarë u tha deri tani në këtë dialog që filloi si teknik e evoluoi aq shumë politik, i cili tani jemi në një pikë kur po flasim për kompromise të dëmshme. Pra, ka qytetarë që nuk flenë qetë, sepse në një mëngjes mund të zgjohen në Republikën e Serbisë, nuk do të jenë më qytetarë të Republikës së Kosovës. Ky është ankthi i shumë qytetarëve dhe nuk është rastësisht, sepse nëse i përcillni mediat e Beogradit, ata po flasin për ndarje dhe jorastësisht, sepse edhe dikush nga kolegët e tyre kosovarë diçka të tillë ka përmendur. Pra, ka ankth. Ky është rezultati i dialogut 2011-2017 dhe dikush këtu bën thirrje të mos e analizojmë, po të shikojmë tash e tutje. Pra edhe ne si opozitë jemi bashkëpjesëmarrës për atë çfarë u bë dhe na solli në një pikë kur flasim për kompromise të dhembshme. Cilat janë ato kompromise të dhembshme? Republika e Serbisë në vitin 1999 përfundimisht ka humbur të drejtën të flasë në emër dhe për Republikën e Kosovës. Mirëpo, falë gabimeve të njerëzve që me vite e udhëheqin Kosovën, e sidomos dialogun që e quajtën teknik, lojën e humbur në terren, ata po e fitojnë në tavolinë dhe çdo ditë e më tepër po bëhen faktorë, të cilët po i determinojnë përfundimin dhe ne që ishim ata ndaj të cilëve u ushtrua gjenocid, sot ne kokulur po shikojmë dhe po shikojmë se çfarë po mund të nxjerrim. Ky është rreziku që po i kanoset sot Republikës së Kosovës.

Lëvizja Vetëvendosje ka propozuar që para dialogut me Serbinë është e domosdoshme që të bëhet bilanci shtetëror i dialogut 2011-2017. Të raportohet në Kuvend dhe të kemi debat parlamentar, do të thotë nuk mund të ketë debat parlamentar për platformë të re pa u bërë bilanci i dialogut 2011-2017. Ka pasur shumë investim pa kthim dhe pak transparencë. Tridhjetë e tri marrëveshje i ka nënshkruar Kosova me Serbinë në dialogun 6-vjeçar, shumica dërmuese e tyre nuk janë realizuar. Në veçanti duhet theksuar bllokimi që na bën Serbia në fushën e energjisë elektrike, në urën mbi Ibër në Mitrovicë, në anëtarësimin në organizata ndërkombëtare dhe në reciprocitetin e njohjes së diplomave. Në anën tjetër, kemi edhe marrëveshje për efekt, si për shembull, zyrtarë ndërlidhës në Prishtinë dhe në Beograd, e që nuk kanë kurrfarë roli. Apo kemi edhe marrëveshje të arritura me kundërefekt, për shembull, fusnota në emërtimin e shtetit. Serbia na lufton njësoj kur duhet të anëtarësohemi në organizata ndërkombëtare.

Nuk ekziston një dokument zyrtar qeveritar që vlerëson dialogun 6-vjeçar dhe marrëveshjet e tij. Ai dokument moti është dashur të vijë në Kuvendin e Kosovës.

2. Të realizohet dialogu i brendshëm i hapur demokrat në institucionet e shoqërisë sonë. Debate në Kuvend para dialogut e për dialogun me Serbinë. Përparimet dhe agjendën për qëllimin dhe formatin. Dialogu që u zhvillua në vitin 2011-2017 me Serbinë ishte dialog sipas kushteve të Serbisë. Diskutohej për çështje të brendshme të Kosovës, pa u konsideruar Serbia si borxhli ndaj Kosovës dhe shqiptarëve.

Dialogu i brendshëm duhet zhvilluar me kategoritë e ndryshme shoqërore dhe grupet e interesit si dialogu prej poshtë. Për shembull, me Shoqatat e familjeve të të pagjeturve, Shoqatën e të ish-burgosurve politikë, komunitetin e biznesit, kryetarët e komunave të Kosovës, pakicat kombëtare etj.

Siguresat e procesit edhe duhet përcaktuar edhe duhet të jenë qysh në fillim, e jo veçse në fund. Pra, siguresa nuk ka pasur deri më tani.

3. Të zhvillohet një dialog me BE-në për dialogun me Serbinë, për natyrën, përmbajtjen dhe qëllimin e atij dialogu. Nuk mund të vazhdohet me dykuptimësinë creative, me ç'rast për vetë emërtimin e dialogut, pra normalizimin e marrëdhënieve në Prishtinë, Beograd dhe Bruksel kemi së paku tri kuptime të ndryshme. Po ashtu vetë procesi herë quhej dialog teknik, e herë politik, herë bisedime, e madje edhe negociata. Duhet sqaruar shprehjet dhe objektivat si dhe përfitimet e Kosovës në integrimin euroatlantik, ndërlidhja me procesin e Berlinit dhe kalimit nga normalizimi i marrëdhënieve të fqinjësia e mirë. Dialogu paraprak me BE-në është i nevojshëm edhe për vetë BE-në, e cila ka shprehur interesin të ripërtërijë integrimin e Ballkanit Perëndimor dhe ka filluar të mendojë për kalendarin përpara të gjashtë shteteve të Ballkanit, të cilat ngelen jashtë BE-së.

4. Të pajtohem që të mos ketë asnjë shmangie në Kosovë nga prioritizimi i punësimit dhe drejtësisë, si dhe nga dialogu me serbët e Kosovës dhe pakicat e tjera për zhvillim. Gjatë dialogut 2011-2017 është rrëmbyer agjenda shtetërore nga diplomacia e bisedimeve permanente të normalizimit. Zhvillimi ekonomik që sjell punësimi, luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit të lartë u patën lënë anash. Energjia qeveritare, koha mediale si dhe vëmendje qytetare u çorientuan prej preokupimeve të brendshme të shtetndërtimit demokratik, drejtësisë institucionale dhe zhvillimit socio-ekonomik.

Po ashtu dialogu me Beogradin i defaktorizojë qytetarët serbë të Kosovës dhe i la ata në harresë. Në zgjedhjet parlamentare të 11 qershorit të viti 2017 shkeljet më të rënda dhe më të shumta u bënë pikërisht në mjediset ku jetojnë serbët për shkak të ndërhyrjes së Serbisë, domethënë insistimit për njërin nga subjektet politike të serbëve të Kosovës që sot janë edhe anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në këtë mënyrë do të ndërtohej pajtueshmëria jonë shoqërore dhe nacionale për temat e parimet, strategjinë dhe përfaqësimin në dialog. Në asnjë moment, rrethanë apo rol kjo pajtueshmëri nuk mund të përfshijë emrat e atyre që e sollën këtë moment që sot po flasim për një kompromis të dhembshëm.

Pra, në dialog me Serbinë, nuk u ngrit çështja nga kryenegociatori zoti Hashim Thaçi, e të pagjeturve, të dëmeve të luftës, të ndarjes së Mitrovicës dhe shfrytëzimit të Trepçës, të shqiptarëve të shtypur në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, të 1200 artefakteve kulturore të plaçkitura nga Serbia, të kontributeve pensionale dhe depozitave bankare të vjedhura, të 172

pronave të Kosovës që janë nëpër ish-Jugosllavi. Për gjashtë vjet u hesht çështja e krimeve të luftës dhe të krimeve kundër njerëzimit të Serbisë në Kosovë dhe nuk u paditë Serbia për to.

Fatkeqësisht disa njerëz iu frikësuan shumë aktakuzës së mundshme nga Gjykata Speciale të cilën për interes personal edhe vet kryenegociatori që po pretendohet të vazhdojë këto negociata, presidenti aktual u orvat ta sulmojë natën e 22 dhjetorit ë viti 2017. Është protagonist edhe i aferës ‘Pronto’, të gjithë e mbajmë në mend se si i quajtën qytetarët e Malishevës dhe ish-kryeparlamentarin zotëri Jakup Krasniqi.

Fatkeqësisht ndodhi edhe një precedent ku vendosen lulet dhe u bë nderim te pllaka përkujtimore e strukturave të Serbisë në Kosovë, ku shkruan: “Viktimat e terrorizmit shqiptar dhe të agresionit të NATO-s”. Gjithë dialogu i tij me serbët lokalë faktikisht u fokusua dhe mbeti në memorie të kamerave kur iu fal një serbi një traktor, e të cilin ai pastaj edhe e shiti. Edhe në fund e mbështeti Zajednicën, pra Asociacionin e Komunave serbe, me shumicë serbe, që doli të jetë antikushtetuese. Më 20 janar 2012 i detyroi deputetët e Partisë Demokratike të rrëzojnë reciprocitetin e Kosovës me Serbinë, të...

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë

Në emër të grupit herën e kaluar, në seancën e parë, pra ditën e parë kur filloi debati, dhamë një qëndrim se si shohim ne se si do duhej të zhvillohet debati dhe çka, në fakt, duhet të kemi parasysh kur ky dialog me Serbinë, që po quhet kjo faza finale të fillojë, dhe kam pritur realisht që në këtë frymë të gjitha grupet parlamentare, të gjithë deputetët të vinë me ide se si duhet ta zhvillojmë këtë fazë të fundit të procesit të dialogut, i cili nuk është qëllim, por është mjet.

Deri më tash, të them të drejtën nuk e kisha ndërmend të dal, sepse konsiderova që edhe pikëpamjet e mia i shoh në kuadër të fjalës që kam mbajtur në emër të grupit. Por, meqë është bërë zakon që në mungesë të ideve se si e sheh secili, qoftë si grup, qoftë si deputet, të japë një kontribut rreth kësaj, të komentojë fjalët e të tjerëve. Tash edhe unë dola në funksion të kësaj që të komentojë pak fjalët e të tjerëve.

Dorën në zemër, unë këtu dëgjova zotin Limaj në fjalën e tij dhe menjëherë pas tij dëgjova zotin Kurti. Në essence, nuk pashë ndonjë dallim, në fakt, më falni, e pashë një dallim, se e kemi një evoluim radikal nga jo fare negociata në listim të kërkesave para negociatave. Pra, po bisedime, po dialog, por para dialogut duhet të listojmë kërkesat tona. Dhe, u ktheva e dëgjova, e rikujtova edhe një herë atë çka tha Limaj, nuk pashë ndonjë dallim. Pra, duhet të bëhemi bashkë që të shkojmë të përballemi me Serbinë në këtë fazë të fundit të dialogut. Atë që e dëgjova edhe nga zoti Kurti, pra një herë t’i listojmë kërkesat tona, pastaj të bëjmë grupin përfaqësues të Kosovës,

edhe udhëheqësin e krejt kësaj. Çka dëgjova pastaj nga Fatmiri, thotë se ‘dialogu ende nuk ka filluar’. Por dikush do t’i shohë takimet bilaterale të zotit Thaçi në cilësinë e presidentit me zotin Vuçiq si fillim të dialogut. E drejtë e tij. Le t’i shohë edhe si fillim të dialogut. Unë them që nuk është fillim i dialogut. Dhe ju do të bindeni se nuk është fillim i dialogut.

Nëse ju mendoni, kushdoqoftë mendon se z. Limaj si kryetar i Nismës nuk duhet të shkojë askund ku është zoti Thaçi, edhe aty ku flitet për Kosovën, për vizat, për dialogun, atëherë mendoj se ka pasur pritje të gabura. Është e drejtë e secilit të ketë edhe pritjet e vet, por është mirë të kufizohemi në pritjet që kemi ne për veten dhe jo për të tjerët. Në Bruksel po, ka shkuar dhe do të shkojë sa herë të ftohet nga Mogherini, nga përfaqësuesi Hahn, sa herë të ftohet në cilësinë e përfaqësuesit të Qeverisë nga institucionet, qoftë të Bashkimit Evropian, qoftë të Komisionit Evropian, qoftë ambasadave veç e veç, qoftë të ministrive të ndryshme a të qeverive të Bashkimit Evropian. Por të shkosh te Mogherini dhe të flasësh edhe për dialogun, nuk është fillim i dialogut, kjo është diçka tjetër, është kjo që po bëjmë ne tani. Por nuk besoj se e konsideroni si fillim i dialogut, ju jeni dialoguar tani me Serbinë. Jo. Të gjithë tani po flasim për dialogun se si e shohim, cili është këndvështrimi ynë, cilat janë pritjet tona dhe cilat janë ato që quhen ‘impute që ne dëshirojmë t’i japim këtij procesi të dialogut’, në këtë nivel unë ende e shoh debatin sa i përket dialogut me Serbinë, në fazën finale të zgjidhjes së problemit të Kosovës.

Pra në ensencë, unë nuk pashë ndonjë dallim për negociatat tash, por me kushte, listim, nuk e dëgjova kushtin kryesor të Vetëvendosjes që e ka pasur që një herë duhet të na njohë, pastaj të dialogojmë. I dëgjova të gjitha kërkesat me vëmendje dhe jam dakord me to, po, duhet të listohen të gjitha ato që i tha zoti Kurti, madje edhe ato që nuk i tha në raport me Serbinë, na ka shumë borxhe, duhet t’i listojmë. Kjo sa i përket polemikës rreth kësaj. Tash do të përpiqem të jap mendimin tim personal si e shoh këtë proces. Dialogun me Serbinë shumëkush po e sheh si detyrim ndërkombëtar, por është edhe detyrim vendor, sepse na nevojitet edhe neve po aq sa i nevojitet Serbisë, jo vetëm Serbisë. Po shihet qartë se po të kishte mjaftuar vetëm njohja e të gjitha shteteve të botës dhe Evropës dhe po të mos kishim pasur nevojë edhe për ato pesë njohje të Bashkimit Evropian, po të na kishin njohur edhe ato pesë shtete të Bashkimit Evropian, besoni se nuk do të kishim hyrë fare në dialog. S’do të kishte hyrë askush në atë dialog, s’do të kishte passur nevojë, jo së paku për këtë që po quhet ‘fazë e fundit për të na njohur Serbia’. Shihni, shpesh po flitet për njohje reciproke. Kjo është lojë fjalësh. Ne e kemi njohur Republikën e Serbisë.

Përderisa ia njuh pasaportat, përderisa ia njuh të gjitha dokumentet, ti nuk e konteston. Akti formal, Republika e Kosovës e njuh Republikën e Serbisë, është diçka tjetër. Por ne e njohim Republikën e Serbisë, ne nuk e kontestojmë atë, është ajo që e konteston Republikën e Kosovës dhe ne tash kemi hyrë në fazën finale të dialogut që t’ia marrim atë. Nëse nuk vjen ajo si çmim i fundit që Serbia duhet ta paguajë në raport me Kosovën, atëherë besoj që të gjithë jemi dakord këtu që nuk do të ketë marrëveshje finale. Çfarë marrëveshje finale do të jetë ajo nëse Serbia nuk

e njeh Kosovën. Pra, të jemi të qartë! Ne nga kjo fazë e fundit e dialogut presim që Serbia ta njohë Republikën e Kosovës, pra shtetin e pavarur të Kosovës. Kjo është ajo që presim. Si do të zhvillohet krejt ky proces? Edhe unë i kam dilemat e mia, që do të mund qeveria vetë, delegacioni qoftë vetë edhe i Qeverisë ta çojë këtë deri në fund me sukses. Prandaj konsideroj se opozita e ka rolin e domosdoshëm që të jetë pjesëmarrëse në këtë proces.

Po. Ejani të bisedojmë, a keni një alternativë, përpos asaj të Qeverisë. Nuk është duke iu imponuar zoti Thaçi, është Partia Demokratike e Kosovës, është Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës që e kanë kandidat të tyre të udhëheqë bisedimet, në cilësinë e Presidentit. Po të mos ishin këto dy parti, ai nuk do të mund të imponohej. Jo ai, por askush nuk do të mund të imponohej. Nëse mendoni, ashtu siç mendoj edhe unë, se ai nuk është i duhuri për të udhëhequr këtë proces, jo për arsye personale, sepse jam në hall, sepse sa herë flas, më thonë se e ka personale, por për arsye thjesht të mbamendjes së këtyre shtatë vjetëve të negociatave. Këto janë arsyet e mia. Ejani pra të bëhemi bashkë te listimi i kërkesave, siç e tha zoti Kurti, te ajo që tha zoti Limaj ta bëjmë delegacionin e përbashkët, kërkesat e përbashkëta dhe të ecim përpara. Por, të marrësh të drejtën dhe t'i thuash atij se ke shkuar pas atij apo pas këtij, kur dihet mirë se ka qenë takim me Mogherinin dhe jo me Vuçiqin, që ka qenë takim jo për të nisur dialogun, por ka qenë takim për të biseduar për dialogun dhe për vizat me Mogherinin dhe institucionet e Bashkimit Evropian, është asgjë më pak dhe asgjë më shumë se propagandë në funksion të përfitimit të ndonjë vote për partinë e vet dhe vote personale.

Unë këtu në emër të NISMA-s deklaroj që askush nuk do të mund ta zgjidhë vetë, as Qeveria, as koalicioni, pa një bashkim rreth të cilit merremi vesh për përmbajtjen. Kur ta kemi përmbajtjen, listimin e kërkesave, atëherë do të arrijmë të gjejmë edhe kompromisin se si do të shkojmë atje, kush do të udhëheqë, cilat forca politike do të jenë të përfaqësura dhe atëherë Kosova në këtë fazë të fundit të dialogut Kosova do të dalë mirë. Kështu në këtë formë si jemi duke e trajtuar, nuk mendoj se do të arrijmë ndonjë rezultat, madje nuk besoj edhe se mund të fillojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit, Bilall! Atëherë, replikë ka zoti Selimi.

REXHEP SELIMI: Meqë edhe ju e përmendët se do t'i referoheni fjalimit tim, dua të them se edhe subjekti juaj politik, bashkë me të tjerët iu bashkëngjitet Thaçit dhe i shkuat prapa deri në Bruksel, por jo deri aty ku flitej me Vuçiqin, por deri në korridor, pasi duket se Thaçi e Vuçiqi ende i mbajnë këto bisedime si të vetat. Por një diçka që ju e deklaruat dhe po e leni si rrëshqitas këtë punë, a është Kosova në dialog, apo nuk është në dialog me Serbinë?

Ju po përmendni fillimin e dialogut! Rrjedhimisht i bie a ka qenë Kosova deri sot në dialog me Serbinë dhe a i njihni ato marrëveshje të arritura deri më sot. Merreni guximin dhe dilni thoni se deri tash ka pasur dialog që ne nuk e njohim dhe po fillojmë një dialog të ri. Kur thuhet dialog i

ri, përmendeni a është dialog me njerëz të njëjtë apo jo? Edhe zoti Limaj, i cili edhe tani e ka të drejtën e fjalës, por nuk di pse nuk po rri këtu, e tha se do të ketë dialog të ri, do të fillojë dialogu. Thojeni a do të fillojë dialogu dhe respektivisht a ka përfunduar dialogu që deri tash ka qenë në proces? Interesant sepse ne kemi diskutuar dhe polemizuar dhe deputetët e PDK-së deri tash i kanë avokatët e vet për ta mbrojtur Thaçin dhe vetëm reagime nga ana juaj dhe AAK-ja kemi parë në mbrojtje të Thaçit dhe jo nga PDK-ja.

Nëse flitet për alternativë, ekzistojnë dy alternativa: njëra e Thaçit për të shkuar në bisedime dhe tjetra e Lëvizjes Vetëvendosje për t'i ndalë këto bisedime. Me cilën jeni ju, sepse ju nuk keni alternativë? Ju s'keni paraqitur deri tash alternativë se me cilën jeni. Ne si Lëvizje Vetëvendosje i kemi paraqitur, madje i kemi kodifikuar si 4+1. Ju, a keni apo s'keni alternativë? Ne kemi si alternativë stopimin dhe ndaljen e menjëhershme dhe kthimin e Thaçit këtu në Parlament që t'i raportojë këtij Parlamenti.

KRYESUESI: Zoti Sherifi, kundër-replikë. Regjia, ju lutem mikrofonin.

BILALL SHERIFI: Nuk e kam gjatë. NISMA është e qartë dhe jo pse ne jemi të qartë, por kjo është e evidente: Kosova është në dialog, është në atë dialogun që ka filluar më 2012 dhe pozicioni i atij dialogu nuk ka ndryshuar fare. Avni Arifi është kryesues i atij dialogu. Unë po them se dialogu për të cilën po flitet për fazën e fundit nuk ka filluar ende. Këtë e tha zoti Limaj dhe ju përpiqeni ta fusni në të njëjtin thes. Kjo është fazë tjetër.

Dy, sa u përket marrëveshjeve, nuk di a duhet ta përsëris edhe një herë apo jo. Ne vazhdojmë të besojmë se ato marrëveshje, jo të gjitha, por një numër i tyre kanë qenë të dëmshme dhe si të tilla nuk kanë mundur të implementohen. Bashkë i kemi kundërshtuar. Mos u bëni sikur...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Besa Gaxheri. Edhe ty a? Në rregull, Albin Kurti ka replikë.

ALBIN KURTI: Ta kujtojmë se neve na është sjellë më herët një lloj projekt-platforme për finalizimin e dialogut, por ajo u tërhoq. Më 23 prill është sjellë dhe pastaj është tërhequr. Aty më pati bërë përshtypje një pike, ku thuhet se delegacioni i Kosovës në bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, në bazë të nevojave dhe rrethanave që do të kërkohen prej BE-së, do të mund të përfaqësohet edhe nga përfaqësues të institucioneve të tjera të Kosovës. Pra është një mungesë totale e vizionit, në fund quhet projekt-platformë kjo, kur ti thua se varësisht se çka kërkon ai, do të sillemi ne. E para!

E dyta, ne nuk kemi qenë asnjëherë në parim kundër dialogut, por kemi qenë kundër dialogut pa parime. Prandaj kërkojmë së pari shqyrtimin e marrëveshjeve të deritanishme, nëse ka pasur lëshime, defekte, duhet të ketë edhe përgjegjësi.

Së dyti, të marrim qëndrim rreth dialogut, cili ka filluar pa mandat. Ne duhet ta ndërprejmë këtë lloj dialogu të pamandat.

Së treti, duhet t'i definojmë synimet e Kosovës dhe kërkesat tona përballë Serbisë. Disa prej këtyre kërkesave mund të bëhen edhe kushte ndaj Serbisë, por jo të gjitha këto kërkesa janë kushte. Po çdo kusht është edhe kërkesë dhe vetëm kërkesat që nuk janë edhe kushte, bëhen tema të dialogut. Kërkesat që janë edhe kushte, i paraprijnë dialogut dhe, krejt në fund, bëhet ekipi ynë negociator me udhëheqësin dhe me strategjinë, e cila nuk do të duhej të jetë publike. Krejt në fund, dialogu i deritanishëm na e ka vështirësuar njohjen prej pesë shteteve të Bashkimit Evropian që nuk na kanë njohur, sepse ato po presin marrëveshjen tonë me Serbinë. Tash e shtatë vjet ato po presin marrëveshjen tonë, prandaj edhe nuk janë duke na njohur.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Sherifi!

BILALL SHERIFI: Faleminderit z.kryesues! Nuk thashë asgjë më shumë se sa vetë atë që e tha zoti Kurti, nuk ka ndonjë dallim mes fjalës së Limajt dhe fjalës së Kurtit dhe vetëm se ky i listoi kërkesat, ndërsa zoti Limaj tha edhe ta bëjmë platformën, edhe ta caktojmë delegacionin. Pra, në kuadër të platformës, do të ishin këto kërkesa e kushte, sido që t'i quajmë. Por, rëndësi ka që ka evoluim nga ana e Lëvizjes Vetëvendosje dhe kjo është mirë, nuk është keq që, po dialog, por me kërkesa, jo siç ka qenë përpara: jo negociata, veç Vetëvendosje! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Besa Gaxherri e ka fjalën. Tash u paraqite me vonesë. Nuk e ka pasur emrin të shtypur.

BESA GAXHERRI: Kolegë të nderuar deputetë!

Siç e dimë të gjithë, kur Serbia dërgoi aktin e shpalljes së pavarësisë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe pas dhënies së mendimit të GJND-së rreth aktit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 9 shtator 2010 miratoi rezolutën e sponsorizuar atëherë nga 27 vende të BE-së dhe Serbisë, me të cilën kërkohet të fillojë dialogun Kosovë – Serbi i ndërmjetësuar nga BE-ja.

Kjo rezolutë e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së përshëndeste mendimin e GJND-së si dhe mirëpriste gatishmërinë e BE-së për të ndërmjetësuar procesin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke theksuar se ky proces do të shërbente si faktor i paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon. Ky proces u tha se do të promovojë bashkëpunimin, të përmirësojë jetën e qytetarëve dhe do të ndihmojë të dyja vendet të arrijnë progres në rrugën e tyre drejt BE-së.

Bazuar në këtë proces ndërkombëtar, Kuvendi i Kosovës më 10 mars 2011 miratoi një rezolutë, me të cilën mandatonte Qeverinë e Republikës së Kosovës për të nisur bisedimet teknike, po e ritheksoj, bisedimet teknike, me Serbinë. Kuvendi i Republikës së Kosovës i kërkonte Qeverisë së Republikës së Kosovës nëpërmjet kësaj rezolute që të sjellë dokumentin themelor për dialogun brenda afateve ligjore, duke specifikuar parimet e përgjithshme të dialogut teknik, objektivat si dhe çështjet e panegociueshme, e që kjo rezolutë nuk u respektua asnjëherë nga Qeveria Thaçi i asaj kohe. Kryeministri i vendit mashtroi opinionin, gënjeu Kuvendin e Kosovës se me Serbinë do të ketë vetëm dialog teknik dhe shkeli vendimin e Kuvendit të shprehur nëpërmjet rezolutës, rrëshqiti pa asnjë nevojë, tërësisht pa nevojë në një dialog politik dhe në fund të vitit 2012, bisedimet teknike i transferoi në bisedime politike. Fillimi i këtyre bisedimeve tejte të rëndësishme për vendin pasuan me injorim total të Kuvendit të Kosovës, mungesë totale të transparencës dhe asnjë raportim në Kuvend nga Qeveria.

Faktikisht, ne sot shohim se Kosova ka arritur vetëm ndonjë marrëveshje teknike, kurse Serbia ka arritur të bëjë vetëm marrëveshje politike, të dëmshme për Kosovën. E gjithë procesi i dialogut ka qenë i mbyllur, duke dëmtuar kështu kredibilitetin dhe besimin ndaj tij. Mungesa e transparencës dhe llogaridhënies ka ndikuar edhe në moszbatueshmërisë së marrëveshjeve si dhe në mungesë të informacionit lidhur me rrjedhën e procesit të këtij dialogu janë shtuar pakënaqësitë dhe kundërshtimet ndaj tij. Për më tepër, shtatë vjet nga fillimi i këtij dialogu, procesi i shënuar në marrëdhëniet në mes të dy vendeve është i papërfillshëm, ose i pasuksesshëm.

Arsyet e moszbatimit të këtyre marrëveshjeve kanë qenë mosvullnet politik nga Serbia si dhe konflikti i përmbajtjes së tyre me rendin kushtetues e juridik të Republikës së Kosovës. Në të njëjtën kohë, Serbia ka vazhduar të llobojë dhe të pengojë konsolidimin e shtetësisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare si dhe duke ndërhyrë drejtpërdrejt në punët e brendshme të Kosovës. Ne sot po dëgjojmë se ky dialog po hyn në fazën përfundimtare, ani pse për shtatë vjet shumë gjëra janë të paqarta. Paqartësia, arbitrariteti, injorimi i Kuvendit të Kosovës vazhdon. Ndërsa BE-ja kërkon që në një afat të shkurtër kohor të arrihet marrëveshja përfundimtare, ligjërisht e obligueshme për palët, kinse për avancimin e dy shteteve drejt BE-së.

Bashkimi Evropian, i cili është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të marrëveshjeve ishte inerte në punën e saj, në raste të shumta e painteresuar të përmbushë misionin e vet, qoftë përbrenda Kosovës me misionin e vet EULEX-in, qoftë nëpërmjet obligimeve dhe kapaciteteve të saj jashtë Kosovës. Asnjëherë nuk iu bë me dije Serbisë në mënyrë të prerë se dialogu është për paqe, përmirësim të raporteve, mosndërhyrje në punë të brendshme të Kosovës, moslobim në institucionet ndërkombëtare kundër Kosovës, e kështu me radhë. Në të kundërtën, qytetarët e Kosovës që janë më proevropianë në regjion, janë të vetmit që nuk kanë lëvizje të lirë. Edhe procesi i liberalizimit është lidhur me aneksim të territorit të Kosovës si dhe tani ky proces bëhet karrem për përmbylljen e dialogut me Serbinë, e që kjo gjë është e patolerueshme.

Qeveritë tona nuk arritën që për shtatë vjet në Bruksel të hapin tema politike e humane siç janë: gjenocidi i ushtruar nga Serbia mbi popullatën shqiptare të Kosovës së paku për luftën; mijëra qytetarë të zhdukur; mijëra qytetarë të masakruar e dhunuar; mijëra gra e burra të dhunuara seksualisht; mijëra gra e fëmijë të gjymtuar; 90 për qind e ekonomive familjare të Kosovës e plaçkitur, e djegur dhe e shkatërruar. Qeveritë tona dhe BE-ja nuk kërkuan kurrë përgjegjësi ndaj Serbisë. Qeveritë tona dhe BE-ja nuk u deklaruan kurrë se edhe mbi këto tmerre shqiptarët e Kosovës arritën të shpallin Kushtetutën më afirmative në botën demokratike, me privilegje të papara për minoritetin serb dhe për minoritetet e tjera në Republikën e Kosovës.

Qeveritë tona dhe BE-ja asnjëherë nuk kërkuan nga Serbia që të respektohen të drejtat e shqiptarëve në Kosovën Lindore, e cila administrohet nga Serbia. Shqiptarët e Preshevës, Bujanovcit e Medvegjës janë populli më i diskriminuar në Evropë dhe BE-ja nuk ka asnjë reagim. Deri tani nuk ka kërkesë për reciprocitet të respektimit të minoriteteve Kosovë-Serbi. Qeveritë tona dhe BE-ja ende nuk morën shembull para Serbisë dhe para pesë shteteve, të cilat nuk e kanë njohur ende Kosovën, se qytetarët shqiptarë të Kosovës të dërrmuar shpirtërisht, fizikisht dhe financiarisht, përveç që kanë gjetut forcën të shtrijnë dorën e pajtimit për fqinjët serbë, shqiptarët për vjet të tëra paguajnë faturat e shpenzimeve të energjisë elektrike, të ujit dhe të tjera për minoritetin serb. Për këto sjellje të shqiptarëve të Kosovës ka pasur izolim nga BE-ja dhe përcmim nga institucionet e Kosovës.

Fatkeqësisht, i tërë ky proces i rëndësishëm për vendin u orientua në emër të individëve dhe jo të institucioneve, siç kemi rastin aktualisht me zotin Thaçi, i cili për vite të tëra udhëhoqi këtë proces dhe nëpërmjet këtij dëmtoi shumë Republikën e Kosovës. Ishte shembull i papërgjegjësisë, mostransparencës, mosdijes, shkeljes së vendimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Mbi të gjitha këto, ai vazhdon në mënyrë arbitrare, jolegjitime dhe merret me përfaqësimin e dialogut me Serbinë. Zoti kryetar Thaçi, ju nuk jeni i mandatuar të përfaqësoni Kosovën në bisedime me Serbinë. Zoti Thaçi, Kosova është shtet parlamentar, e jo presidencial si dhe Kosova duhet të funksionojë bazuar në institucionet e saj kushtetuese, e jo në bazë të emrave, të cilët fuqizuan në fatkeqësitë, dhimbjet dhe varfërinë e këtij populli. Kuvendi e ka mandatuar Qeverinë për të përfaqësuar në këto bisedime. Ju kryeministër Haradinaj që nuk jeni këtu, po ju drejtohem dhe po ju them se nëse nuk di dhe nëse nuk je i zoti ta përfaqësosh vendin, ashtu siç kërkon Kushtetuta e Republikës së Kosovës, duhet të lëshosh rrugë. Vendi duhet të shkojë në zgjedhje dhe ai kryeministër që fiton legjitimitetin e sovranit, do ta përfaqësojë Kosovën. Duhet ta kuptoni se institucionet dhe proceset e Kosovës nuk janë pronë juaja që t'i bartni kur të doni dhe kujt të doni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, shkojmë në pushim të drekës deri në orën 15:15. Besoj se mund ta përfundojmë drekën deri atëherë. Mos i tërhiqni kartelat, sepse ju priset renditja!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Po vazhdojmë, pra. Xhevahire Izmaku e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Meqenëse kolegët deputetë ende nuk janë këtu, sidoqoftë përshëndetje për të gjithë qytetarët që janë duke na ndjekur. Po e diskutojmë temën, të cilën e kanë kërkuar kolegët nga opozita, një temë shumë e rëndësishme për të cilën muajve të fundit kemi dëgjuar shumë shpesh deklarata të ndryshme se fundi i bisedimeve me Serbinë do të jetë një fund i vështirë dhe i dhimbshëm, ashtu edhe mund të jetë, por konsideroj që po aq i dhimbshëm është edhe gjithë ky proces i dialogimit, i cili plot 10 vjet pas pavarësisë ende sot nuk arrin të gjejë një konsensus në mesin tonë si deputetë për ta ndërtuar një platformë, e cila do t'i orientonte këto bisedime të quajtura të vështira.

Ky nuk është proces, i cili duhej t'i takojë vetëm një lideri, një koalicioni, apo një parti politike, në këtë po pajtohemi të gjithë, pa dallim. Mirëpo, ky proces, i cili sido që të përfundojë, edhe për pasojat, por edhe për të mirat e tij në epilog konsideroj që këto do t'i bartin të gjithë. Andaj, në tavolinë duhet të jemi të gjithë. Nuk mund t'i ikë askush këtij procesi, sepse ne jemi të zgjedhur të popullit dhe ata na kanë zgjedhur që të merremi me të gjitha problemet, e jo të barrikadohemi në teoritë tona që shpesh nuk përkojnë me realitetin aktual. Bisedimet me Serbinë do të duhej të mbyllën sa më shpejt, në mënyrë që këtë çështje ta hedhim pas krahëve dhe të merremi me integrimin evropian të vendit. Të gjithë e dimë se sa më shumë që të merremi me këtë çështje, aq më larg do të jetë edhe integrimi ynë. Andaj, duke u bashkuar drejt këtij qëllimi, ne mund t'ia shkurtojmë vetes rrugën drejt BE-së.

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe këtu në mesin tonë ka të tillë që nuk i kanë besuar as bisedimet e Rambujesë, as bisedimet që Kosova të përfaqësohej nga Grupi i Unitetit dhe as GJND-në, por të gjitha këto raste kanë përfunduar, duke dalë vendi ynë fitimtar. Pra, nuk duhet të frikësohemi as sot. Këto bisedime që po bëhen në nivel presidentësh, por edhe ato në nivel kryeministrash, kanë pasur dhe mund të kenë edhe tutje defekte, sepse bisedimet edhe nënkuptojnë kompromise, dhe ato edhe mund të mos na pëlqejnë të gjithëve, gjë që është e natyrshme.

Është koha e fundit, jo për ta marrë të gjithë fajin nëse ndëshkohemi në këto bisedime, apo nëse i humbim, por është koha e fundit që të bashkohemi të gjithë dhe të nxjerrim më të mirën nga këto bisedime, sepse ne të gjithë këtu do të jetojmë dhe këtu mendojmë t'i rritim fëmijët tanë. Konsideroj që ky unifikim është interes nacional dhe jo çështje e interesave të ngushta partiake, ose edhe inateve të tjera tërësisht të pajustificueshme.

Të nderuar kolegë deputetë,
Qytetarë të vendit,

Mendoj se koha është e fundit edhe ta mbyllim debatin për rolin tonë këtu si Kuvend në procesin e dialogut. Nëse deri sot dhe deri këtu kemi qenë bashkë në mënyrë të plotë ose të pjesshme për probleme dhe për procese të rënda, cila është arsyeja që sot të mos kemi konsensus për çështjen e përfshirjes së opozitës në këtë proces dhe ndërtimit të kësaj platforme aq shumë të diskutuar për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Dialogu Kosovë - Serbi duhet të ketë legjitimitet, po pra nga ky Kuvend, i cili nuk guxon ta ketë rolin vrojtues dhe unë besoj që vetëdijshëm nuk duhet askush në këtë sallë të ndihet i papërgjegjshëm. Nëse opozita ka rezerva ndaj rolit të Presidentit, konsideroj që duhet ta rilexojë edhe një herë Kushtetutën dhe t'i shohë përgjegjësitë, të cilat i takojnë Presidentit si një pozitë për rolin dhe përfaqësimin e tij brenda dhe jashtë vendit. Nëse dikush e konteston legjitimitetin, unë e rikujtoj, pra kemi të bëjmë me Presidentin, i cili si një lider deri sot është lideri më i votuar në Kosovë, pra me mbi 170 mijë vota në vend. Po ashtu, është lideri i cili edhe në bazë të Kushtetutës, edhe një herë them fuqisë kushtetuese, i lejohet ta përfaqësojë vendin brenda dhe jashtë. Po ashtu, në bazë të gjitha sondazheve, kemi të bëjmë me besimin popullor që vendi dhe qytetarët e besojnë që mund të jetë në krye të dialogut të vështirë.

Konsideroj që në fund të këtij debati ne do të kemi një besim ndërmjet vete që ta ndërtojmë një platformë dhe veçanërisht ftesën e bëj për kolegët e mi opozitarë, të LDK-së, e cila në procesin e shtet ndërtimit kishte një rol, pra këtë besoj që në fund do të nxjerrim si një konsensus. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Deputetë të nderuar të Kuvendit,

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Së pari më duhet t'i bëj kritikë Qeverisë dhe kryeministrit, në fillim të kësaj seance ai tha që debati për dialogun për të është i rëndësishëm, mirëpo shumë pak minuta ishte i pranishëm. Si duket, ai po e përcjell këtë seancë prej zyrës së tij dhe kur ka nevojë për ndonjë replikë, siç ishte më herët me zotin Çausi, vjen e bën replikë dhe del nga kjo sallë.

Kjo është natyrisht qasje e papërgjegjshme dhe është tendencë për ta zhvleftësuar edhe Kuvendin e Republikës së Kosovës, por edhe për t'i injoruar deputetët që në fakt janë përfaqësues të popullit. Por, po ashtu unë e ftoj edhe Grupin Parlamentar që e ka thirrur këtë seancë që të qëndrojë në sallë për shkak se këtu deputetët bëjnë propozime, prandaj do të duhej që të qëndroni edhe ju, meqë e keni thirrur këtë seancë dhe t'i dëgjoni edhe propozimet tjera që vijnë nga grupet parlamentare. Në këtë rast, në seancën e së premtes ne i kemi dhënë propozimet se çka duhet të përmbajë rezoluta dhe besoj që i keni dhe do t'i adresoni.

Të gjithëve besoj na kujtohet sikur sot kur para shtatë vjetëve nisi procesi i dialogut me Serbinë, asokohe thuhej se do të jetë një dialog teknik dhe se nuk do të flitet për çështjet e brendshme të Kosovës, por në fakt ishte komplet një dialog politik dhe në vazhdimësi u diskutua për çështjet e brendshme të Kosovës. Sot pak më shumë se gjashtë vjet, nëse e bëjmë një analizë të detajuar të këtij procesi të dëmshëm, del se ne kemi pasur të drejtë në kundërshtimin tonë, sepse Kosova nuk ka përfituar asgjë në raport me këtë dialog, përkundrazi Kosova ka qenë më shumë temë sesa palë në këtë dialog, prandaj edhe Serbia në vazhdimësi i ka shtyrë përpara interesat e saj përbrenda Kosovës. Pra, çfarëdo që ka kërkuar Serbia është pranuar lehtësisht nga Hashim Thaçi dhe Edita Tahiri.

Arsyetimi për nisjen e këtij procesi ishte se ky dialog do të sjellë njohjen e Serbisë, do të ketë integrim të serbëve në jetën shoqërore dhe institucionale dhe se do të anëtarësohemi në Bashkimin Evropian. Sot, shtatë vjet pas, asnjëra prej tyre nuk ka ndodhur dhe tani shtrohet pyetja nëse do të duhej të japin përgjegjësi ata që kanë nënshkruar marrëveshje të dëmshme dhe që i kanë sjellë dëme vendit në emër kinse të njohjes dhe anëtarësimit. Përgjegjësia bie së pari mbi ish-kryeministrin dhe tani president Hashim Thaçi. Në një shtet normal as nuk do të mund të paramendohej që një person që nuk ka asnjë lloj kredibiliteti, është figurë përçarëse dhe që përbën rrezik për vendin, ta drejtojë tashmë një fazë të re të bisedimeve. Ky person do të duhej që të jepte llogari për të gjitha dëmet që i ka sjellë vendit dhe ne si Kuvend e kemi obligim si përfaqësues të popullit që ta ndalim këtë person. Nuk mund të vazhdojmë me një fazë të re pa pasur një diskutim dialogun gjashtëvjeçar dhe unë s'i kuptoj as Hashim Thaçin dhe as Qeverinë që marrin frysh për t'iu vizatuar Serbisë sa herë që ajo ka nevojë. Pse duhet që t'i vizatohemi Serbisë në Bruksel pa e bërë një herë një vlerësim të dialogut, pa vendosur kushte, pa i diskutuar synimet e Republikës së Kosovës, pa i qartësuar kërkesat e Republikës së Kosovës.

Kur jemi këtu më lejoni që t'i përmend para jush vetëm disa nga koncesionet e këtij dialogu, sepse për disa kanë folur deputetët e grupit tonë parlamentar, për disa të tjera do të flasim tutje.

Së pari, nga ky proces i dialogut u krijua Lista serbe që e lufton Republikën e Kosovës, e që është dorë e zgjatur e Serbisë përbrenda Kuvendit të Republikës së Kosovës. Pra, ne Serbinë e kemi këtu në mes të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e kemi në Qeveri. Ata i gëzojnë të gjitha privilegjet, por ama e luftojnë Republikën e Kosovës. Sigurisht që ne jemi për bashkëpunim e dialog me serbët e Kosovës, por jo me një subjekt politik që e lufton Republikën e Kosovës, siç është Lista serbe, e që në fakt nuk përfaqëson as interesat e qytetarëve serbë që jetojnë në Kosovë. E dini edhe ju, votat e tyre u kontrabanduan nga Serbia dhe atë me miratimin e Qeverisë së kaluar dhe të KQZ-së, u sollën 4 000 aplikacione nga Serbia në mënyrë të kundërligjshme, u votua me dokumente të Serbisë. Pra, Lista serbe nuk e përfaqëson vullnetin e qytetarëve serbë që jetojnë në Kosovë, madje ka pasur edhe presion mbi partitë tjera lokale, madje Partia Liberale e drejtuar nga Slobodan Petroviq nuk kishte bërë fare fushatë parazgjedhore për shkak se njerëzit e saj kërcënoheshin nga Lista serbe.

Gjithashtu, u amnistuan strukturat kriminale me Ligjin për amnisti, pazaret pra në Bruksel e detyruan këtë Kuvend që të miratojë Ligjin për amnisti, pra u amnistuan ata që dogjën pikat kufitare, maltretuan e dhunuan qytetarët, pra pikërisht ata u instaluan në institucione. U nda në dysh drejtësia, së pari me krijimin e Gjykatës etnike të Apelit enkas për serbët dhe në shpërputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, përfshirë edhe Kushtetutën, edhe Ligjin për Gjykatat. Pastaj, pazaret në Bruksel me Serbinë e krijuan Gjykatën e Apelit në kundërshtim pra, përveç Gjykatës së Apelit, përfaqësuesit e institucioneve të drejtësisë u morën në Bruksel për t'u bërë pjesë e një dialogu politik për pazaret e reja, dhe kjo ishte e paprecedent. Ata e pranuan listën e Vuçiqit me emra gjyqtarësh kinse për t'i integruar me marrëveshjen për drejtësi të vitit 2015 dhe këtu në Kosovë u krijua një proces fals, kinse për integrimin e gjyqtarëve në sistemin tonë të drejtësisë, por në fakt ata gjyqtarë i kishte caktuar në Bruksel Vuçiqi, ai ua kishte dhënë atë letër dhe ata atë letër e kanë sjellë në Kosovë dhe kinse i kanë integruar në sistemin e drejtësisë.

Unë e kam lexuar me vëmendje raportin që na është proceduar nga Qeveria dhe dua ta ndaj një paragraf të këtij raporti, në faqen 10 të tij, që lidhet me këtë çështje që e përmenda. Qeveria thotë: “Serbia i vulos dokumentet me mbishkrimin ‘Republika e Serbisë, Kosova dhe Metohija, nën administrimin e OKB-së dhe Rezolutës 1244’”. Kjo vulë vendoset në dokumentet origjinale të gjykatave dhe organeve tjera të Kosovës dhe thotë që Qeveria ka shprehur shqetësime, por Qeverinë ne s’e kemi për të shprehur shqetësime. Qeveria do të duhej që të ndërmerre veprime konkrete karshi këtij mohimi të shtetësisë, sepse në qoftë se gjyqtarët atje nënshkruajnë dokumente origjinale “Kosova dhe Metohija” dhe Qeveria në fakt veç shpreh shqetësime, s’është Qeveria për të shprehë shqetësime. As Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim, as ministri i Drejtësisë që Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial i ka shndërruar në vegla të Ministrisë së Drejtësisë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim, veçse paska shprehur shqetësime. Pra, ja për çfarë integri mi po flasim dhe kjo shkruhet në vetë raportin që e ka sjellë Qeveria në Kuvendin e Kosovës. Madje, u nënshkrua edhe një marrëveshje, të cilën ende sot e mbajnë të fshehur, ministri ka thënë që s’ekziston, Këshilli Gjyqësor ka thënë që ekziston, zoti Haradinaj s’e di fare ekziston apo jo, ndonëse është kryeministër, e që ka të bëjë me njohjen e aktgjykimeve të strukturave paralele të Serbisë, që është një goditje shumëdimensionale për Republikën e Kosovës.

Dhe, në fund marrëveshja për Zajednicën për të cilën kemi folur, kemi protestuar edhe në Kuvend edhe jashtë. Për Lëvizjen Vetëvendosje, për qytetarët e Republikës së Kosovës, Thaçi në dy takimet e fundit nuk e përfaqëson Republikën e Kosovës. Ai e përfaqëson vetëm vetveten dhe në mënyrë autoritare i ka marrë këto përgjegjësi për hir të vetvetes, sepse s’ka asnjë dyshim se sa bën koncesione të reja në dëm të vendit është i amnistuar nga Specialja. Edhe Bashkimi Evropian duhet ta dijë që kjo formë e dialogimit, e sidomos me Thaçin në krye do të prodhojë pasoja të mëdha për vendin. Nuk ruhet kësisoj stabiliteti dhe nuk mund të ruhet stabiliteti në vazhdimësi, në kurriz të Kosovës. Hashim Thaçi, përveç disa deputetëve të partisë së tij, edhe disa të

Aleancës që sot i dëgjova, askush tjetër nuk e do atë përfaqësues, aq më pak në një dialog të ri që nuk i dihet as qëllimi dhe as përfundimi.

Ne nuk mund të vazhdojmë në një fazë të re të dialogut pa e pasur një vlerësim për dialogun, pa vendosur me çfarë kornize do të paraqitemi në marrëdhënie të tilla dhe se çfarë do të fitojë Kosova prej proceseve të tilla. Kërkesa jonë për ndërprerje të kësaj forme të dialogimit është kërkesa më e drejtë për shpëtimin e vendit nga pazare e koncesione të reja, Hashim Thaçi ka stërprovuar që as nuk di dhe as nuk do ta mbrojë interesin e Kosovës. Dëshmi kemi jashtëzakonisht shumë, dëshmi e kemi edhe faljen e territorit, por dëshmi e kemi edhe Zajednicën.

Sot ka deputetë këtu edhe nga opozita që thonë që s'ka rëndësi kush e udhëheq. Kjo, përveç që është e papranueshme, është edhe amnistim i Thaçit. Po e them edhe një herë, Thaçi duhet ndaluar dhe unë ju ftoj të gjithëve që të veprojmë në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Tahiri e ka kërkuar fjalën, në emër të Qeverisë.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Nëse është një çështje që dialogu ka pasur sukses pra ndërmjet Republikës së Serbisë dhe Republikës së Kosovës, ky proces teknik është pikërisht pra marrëveshja për drejtësi. Në marrëveshjen për drejtësi janë gjyqtarët dhe prokurorët serbë, të cilët janë integruar në kuadër të sistemit tonë gjyqësor dhe prokurorial. Pra, pikërisht janë këta gjyqtarë dhe prokurorë serbë, shtetas të shtetit të Kosovës, të cilët janë betuar para presidentit Thaçi për punën e tyre, prandaj unë sot si ministër i Drejtësisë po ashtu ju njoftoj që i kam bërë dy ekstradime të kriminelëve, të cilët janë sjellë në veri, e deri para disa viteve s'kemi pasur mundësi ta bëjmë një gjë të tillë, ndërsa sot institucionet e Kosovës arrijnë pra t'i kapin kriminelët edhe në atë pjesë dhe i kam ekstraduar për në vendet prej nga janë kërkuar, s'po i përmend shtetet.

Ndërsa, juve si Lëvizje Vetëvendosje ju ftoj që të qëndroni në pozicionet tuaja politike, të cilat i keni pasur deri sot. Ju deri sot e keni luftuar çdo proces të shtetndërtimit të Republikës së Kosovës. Prej para shpalljes së pavarësisë, pas shpalljes së pavarësisë, ju e keni kundërshtuar fuqishëm procesin e mbikëqyrjes së pavarësisë së mbikëqyrur, në atë kohë nga Piter Feit. Ju keni votuar kundër asaj pakoje ligjore që e ka sjellë Qeveria e Republikës së Kosovës, e para. Për dialogun po flasim, që ndërlihet me aktivitetin tuaj. E dyta, mendoj që është ndryshim jashtëzakonisht i madh, ju e kërkon republikën e tretë. Dilni dhe tregojuni qytetarëve të Republikës së Kosovës që kërkon zhbërjen e këtij rendi kushtetues, pra dhe ju sot nuk mund të jeni pjesë e një procesi të dialogut. Dhe, unë besoj pikërisht pra që Lëvizja Vetëvendosje, dhe sidomos lideri i saj nuk bën dhe nuk duhet të jetë pjesë e dialogut, sepse e ka luftuar çdo proces të shtetndërtimit të Republikës së Kosovës. Pra, është mendimi imi që mendoj dhe do ta mbroj

fuqishëm dhe për këtë arsye qëndroni në pozicionet tuaja qysh keni qenë kundër dialogut, qëndroni në pozicionin tuaj në luftimin e rendit kushtetues së Republikës së Kosovës...

(Ndërhyrje)

Unë kam ende për të folur, pastaj e merr fjalën... Jo, unë kam të drejtë të flas... absolutisht kam të drejtë dhe pikërisht për këtë arsye qëndroni në pozicionet e juaja.

Dua të ndërlihem edhe me fjalën që më herët e pati deputeti Rexhep Selimi. Unë pikërisht mendoj pra që adresa më e rëndësishme politike në këtë vend e Uashingtonit dhe e Brukselit është presidenti Thaçi. Presidenti Thaçi në asnjë takim, qoftë në Bruksel, qoftë në Uashington, kur është takuar në presidentin Vuçiq nuk ka shkuar krye në vete. Ka shkuar me një ftesë, qoftë nga Mogerini, qoftë nga zëvendëspresidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Pra, ju duhet ta keni të qartë këtë dhe është obligim i tij ligjor dhe kushtetues ta përfaqësojë Republikën e Kosovës në takime të tilla, qofshin ato forume, kudo qofshin ato. Ndërsa sa i përket Lidhjes Demokratike të Kosovës, unë besoj që edhe këta i kanë disa nënkryetarë, të cilët kanë dalë me ide të ndryshme, me projekte të ndryshme, njëri kërkon këmbim të territoreve, tjetri e mbron tërësinë territoriale. Mirë është që ju të vini me një qëndrim para këtij procesi, pra me një qëndrim, e pastaj flasim se si do të vazhdojmë më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zonja Haxhiu!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

E para, për Grupin Parlamentar të Vetëvendosjes është e papranueshme që një ministër i Drejtësisë e merr rolin e një militanti të Hashim Thaçit. Ky zotëri, që sapo foli këtu, ia ka mbajtur çantën deri vonë Hashim Thaçit dhe unë të kuptoj pse je i frustruar. Unë ju kuptoj pse ju jeni i frustruar, por nuk është në rregull që në mungesë të argumenteve të shpifni për Lëvizjen Vetëvendosje.

Unë sot jam këtu për të diskutuar për dialogun me Serbinë. Kurdo që je i interesuar nëpërmjet deputetëve të partisë tuaj, thirrni një debat parlamentar për Vetëvendosjen, flasim kur të doni. Dhe tjetra, është e pavërtetë që dekretimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve është bërë njësoj si dekretimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Kosovës, që janë dekretuar ndër vite me radhë. Unë i kam përpara letrat që i kam marrë me kërkesë për qasje në dokumentet publike dhe i kam krahasuar dekretet e një gjyqtari shqiptar apo boshnjak, turk, ashkali, rom, egjiptian dhe një gjyqtari tash që po thuhet është integruar dhe nuk është i njëjtë. Ata nuk e kanë vendosur firmën në dokument që shkruan Republika e Kosovës dhe juve si ministër i Drejtësisë do të duhej që të ju shqetësonte ky raport për shkak se po mohohet shtetësia. Nëse gjyqtarët që ti po i quan se janë integruar e vendosin vulën “Kosova dhe Metohija”, kjo duhet të shqetësojë, e jo veprimet e Vetëvendosjes që edhe ashtu po i keqinterpretimi dhe po shpifni për to. Meqë i keni shndërruar

Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial në vegla të Ministrisë së Drejtësisë, pse s'u ke shkruar një letër pse ata s'kanë kërkuar llogari nga ata gjyqtarë, sepse këta gjyqtarë që nënshkruajnë dokumente të tilla do të duhej që të ishin para përgjegjësive. Ligji kështu e thotë.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, ministri Tahiri!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Po të siguroj edhe ty, edhe qytetarët e Republikës së Kosovës, sepse kanë qenë pjesë në atë ceremoni, kur janë betuar gjyqtarët dhe prokurorët serbë, që ata punojnë sipas ligjeve të Kosovës dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Madje këtë e ka thënë edhe publikisht kryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, zoti Kabashiq, që unë e përfaqësoj Gjykatën Themelore të Mitrovicës në kuadër të sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës. Pra, kjo është e pavërtetë. Ata janë gjyqtarë dhe prokurorë që punojnë në kuadër të sistemit tonë gjyqësor dhe prokurorial që deri dje nuk i kemi pasur, sot fatmirësisht i kemi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

E përgëzoj Grupin Parlamentar të PSD-së për këtë debat që e vlerësoj si më të rëndësishmin të muajve në vijim për Republikën e Kosovës. Duam apo nuk duam ta pranojmë, Republika e Kosovës e ka një kontest politik, historik, pretendime territoriale, ka edhe agresion kushtetues sepse fqinji ynë verior, Kosovën e ka në Kushtetutën e vet. Prandaj, unë bëj apel që t'i lëmë ato qasjet personale partiake sepse nuk jemi në zgjedhje, por t'i adresohemi kësaj problematike me përgjegjësinë e nivelit të të zgjedhurit të popullit dhe në njëfarë forme atë kornizën kushtetuese, atë integritetin e të zgjedhurit të popullit që është i obliguar ta respektojë Kushtetutën e shtetit të Kosovës, thjesht t'i vëmë në binarë të raporteve institucionale, por ta ruajmë edhe njerëzoren. Sepse, çështja e dialogut tani e gjashtë vjet ka kaluar nëpër disa periudha jo bash të mira për të cilat pothuajse në plotëni spektri politik i Kosovës e ka përgjegjësinë e vet.

Fjala konsensus, pse është zbehur ditëve dhe muajve të fundit kjo fjalë aq shumë për politikën dhe politikë-bërësit në Kosovë. Çka është ky fjalor? Tani po i drejtohem kryeministrit Haradinaj.

Zoti kryeministër,

Opozita në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ana e djathë dhe e majtë, prej popullit mazhorancë që përfaqësojnë 58%, respekt edhe për të tjerët që janë këtu dhe një pjesë të konsiderueshme, mos të them të gjitha komunitetet i ke në koalicion. Kërkoj nga ju gjuhë kushtetuese, gjuhë parlamentare, gjuhë unifikuuese sepse vendi rrezikon ditëve dhe muajve të fundit të futet në një rrugë pa krye. Mungon ai sensi i gjetjes së formulës, të ulet në sofër dhe të bisedohet për çështje të rëndësishme shtetërore dhe të interesit nacional strategjik. Çka po

ndodh? I dimë ndarjet dhe vakumet e mëdha edhe të vitit '99 por jemi bërë bashkë. Edhe në vitin 2001 edhe 2004 edhe në procesin për zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Por, ka pasur nga liderët institucionalë të asaj kohe përgjegjësi edhe nacionale edhe kushtetuese edhe shtetërore edhe pse nuk ishim shtet.

Zoti ministër i Drejtësisë,

Nuk duhet të ngjallni debate dhe të lëshoheni në polemika me deputetë, sepse është përgjegjësi e institucioneve të vendit dhe e kësaj mazhorance për të cilën s'jemi të sigurt a e keni këtë mazhorancë dhe a keni legjitimitet që ta shtyjme këtë proces tutje. Dhe në fund. Gjithsesi, të gjithë duhet të ulemi bashkë edhe ta gjejmë një formulë. Kam frikë që ditëve dhe muajve në vijim, me këtë qasje çfarë e kemi ne, do të vjen një propozim të cilin nuk do të mund ta refuzojmë. Dhe ky tetëmbëdhjetë-vjetësh i fundit në skenën politike në Kosovë, në jetën publike, politike dhe institucionale e ka emërues të përbashkët.

Dhe po e citoj një historian të diplomacisë që thotë: “Shqiptarët kanë bërë beteja të jashtëzakonshme në terren, por fatkeqësisht i kanë humbur në tavolinën e bisedimeve”.

Legjislatura e Gjashtë, edhe pak i bëjmë 11 vjet shtet, harrojeni atë periudhën deri më 17 shkurt 2008, duhet logjikojmë të funksionojmë dhe të sillemi si shtet normal. Kemi procese jashtëzakonisht sensitive dhe shteti i Kosovës zoti kryeministër duhet të ndërtojë parime normale reciprociteti, duhet të ndërtojë partneritet normal si shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor me Brukselin me Uashingtonin, por të shkojë me këto parime të reciprocitet dhe si shtet, pa fusnota dhe pa barra të tjera edhe në bisedime me Beogradin zyrtar. Unë sot nuk dua të lëshohem në emra, nuk dua të jap klasifikime sepse e kemi qëndrimin zyrtar të partisë. Por, me këtë logjikë dhe me këtë qasje që e ka mazhoranca nuk jeni mirë, thjesht nuk jeni mirë.

Unë bëj apel edhe te opozita, tek të dyja këto rendet e Kuvendit ku jemi ulur, sepse jemi më shumë dhe kemi përgjegjësi, po flas për popullin mazhorancë pa dashur ta ndajë asnjë komunitet që jeton në Republikën e Kosovës.

Prandaj, është imediate që të ulemi të merremi vesh për aspekte jashtëzakonisht kryesore. Do të na pengojnë edhe në liberalizim të vizave, do të na kushtëzojnë edhe me elemente të tjera. Vërtetë kemi mbetur si popull dhe si vend sui generis. Dhe e fundit. Kam një apel për miqtë ndërkombëtarë. Keni ndërhyrë, keni facilituar, keni ndihmuar nganjëherë edhe na keni shty të marrim vendime që nuk jemi të sigurt a kanë qenë komplet në interesin e popullit mazhorancë këtu.

Kemi bërë mjaft kompromise të dhembshme. Pakoja e Ahtisarit dhe kjo pavarësi e tillë që më në fund nuk do të mbikëqyret më, por që të jemi mjaft të matur, të ditur, kompetent dhe me përvojë që të udhëheqim me institucionet e një shteti të pavarur është kompromis. Unë nuk dua të besoj që aspekte që kanë të bëjnë me integrimin e Kosovës në BE, liberalizimi i vizave, na keni gëtozuar, na keni izoluar nuk po na lejon që të funksionojmë si shtet normal. Dhe unë

frikësohem që po të mos realizohet ky premtim edhe politik edhe publik edhe institucional dhe jo elektoral, frikësohem se edhe ky qorrsokak politik në të cilin nuk po mundemi ta gjejmë një formulë të caktuar t'ia japim alternativën konform vullnetit të Republikës së Kosovës. Po ka teori të konspiracionit për një qëndrim, për një alternativë, për një propozim. Askush nuk guxon të luajë me kushtetutshmërinë, me sovranitetin e Republikës së Kosovës sepse hapet Kutia e Pandorës.

Prandaj, kërkoj fleksibilitet, qëndrime racionale, veprime dhe artikulime të mençura politike në interes të shtetit dhe të vendit. Përndryshe si vend dhe si shtet nuk na këndohet këngë e mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryeministri Ramush Haradinaj.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Do të thotë, po e shoh se, aq sa po mbërri me i përcjell diskutimet, e ka plot elemente që po i diskutojmë sot, që kishin mundur të jenë pjesë e një platforme ose një formule se si të ecim përpara.

Por, nuk po e shoh fokusimin e juaj as te formula as te platforma, fatkeqësisht, të deputetëve! Edhe po e shoh që do ta shpenzojmë këtë debat sot në Parlament prapë për t'i thënë disa gjëra m'i dhënë disa shpjegime, me la ndonjë llogari nga e kaluara ose për të fituar ndonjë poen për ata që vinë ndonjëherë, por nuk po e shoh fokusimin të ndonjë platformë, të një formulë, të një ekip. U nxita prej profesorit Rugova, Naserit. Unë kam qenë në luftë atëherë nuk e kam njohur presidentin Rugova. Nuk kam pasur kontakt fizik me të. Bacën Adem nuk e kam pas takuar ndonjëherë e kam ditur kush është! Por jam pajtuar prej luftës edhe mjaft vështirë e kemi pasur që; Rexhep Qosja, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, presidenti Rugova, Veton Surroi, Bajram Kosumi të na përfaqësojnë edhe disa të tjerë që kanë qenë aty.

Por, ne i kemi mbajtur disa argumente, i kemi mbajtur disa garanci për atë çfarë është substanca. Nuk atëherë nuk i kam njohur të gjithë këta njerëz, besoni. Unë kam qenë në mal, i kemi marrë disa rreziqe, kanë ecur këto procese ku jemi sot.

I kemi parë edhe në etapa të tjera, presidenti Rugova ka kryesuar, janë bashkuar nga opozita këta të tjerët, Thaçi etj. Kemi parë edhe në 2013-ën, këto produkte që po i flasim sot. Parlamenti i ka marr disa përgjegjësi nëpër etapa. Pyetja ime për Parlamentin është; A vërtetë doni të vazhdoni me këtë retorikë kështu pa dhënë ndonjë produkt, pa marr ndonjë rol, pa gjetur ndonjë formulë, edhe në rregull nëse është kështu! Por çka do të ndodh pastaj me ne, me Kosovë? Vlerësimi se Serbia është e varur nga ne, dhe nëse nuk zgjidhet çështja e Kosovës, ata e pësojnë, në njëfarë mase qëndron, është kusht për ta. Është kusht nga BE-ja, është kusht nga të tjerët për ta...

Mirëpo, Serbia ende nuk ka mbërri në atë fazën finale që nëse nuk i ka zgjidhur këto probleme nuk mund të ecë tutje përpara. Pra, Serbia ka kohë deri në ditën kur nënshkruan anëtarësimin në BE, ka, po them ashtu, hapësirë kohore për të manovruar me të. Edhe nëse ajo ditë është 23-ta, 25-ta, nëse është 23-ta pra i ka edhe pesë vite, nëse është 25-ta i ka edhe shtatë vite. Shtatë vite të tilla për Kosovën në pritje pa një marrëveshje mund të jenë të dhembshme. Mund të na ikin më shumë të rinj, mund të mbesim pa këto njohjet, mund të mbesim një lloj status quo-je siç ka mbetur Maqedonia që një kohë, me shpresë që po del. Për shkak të mos avancimit të këtyre proceseve, edhe të na ikën rinia më shumë nga vendi.

Unë mendoj që të gjithë pajtoheni që edhe Kosova e ka një interes të caktuar, që ta zgjidh, pra ta zgjidh situatën e njohjeve të ndërsjella Kosovë-Serbi. Nëse dikush mendon që nuk kemi edhe ne interes, edhe kohorë, atëherë është diçka tjetër. Nëse i kemi ne shumë vite dhe mund të presim këtë kështu si jemi, në rregull. Mundet që ai të jetë skenari. Por, çka tjetër. Nëse konstatohet që Kosova nuk është e aftë, nuk është në gjendje të vetorganizohet edhe ta përfaqësojë vetën, por edhe platformën e vet, atëherë është edhe pyetja tjetër: A do ta bëjë këtë si dikur bashkësia ndërkombëtare, që na ka paketuar për në Rambuje apo diku tjetër? Mund të pres LDK-ja ose mund të pres PSD-ja ose dikush se do të vije dikush shumë i madh të na bëjë bashkë. Më falni, ose Vetëvendosja ose Aleanca ose dikush tjetër, mund ta pres. Mirëpo, kjo bie në kundërshtim me faktin se i kemi cenuar 10 vjet shtet.

Edhe kemi institucione, jetë politike, vendimmarrje, proces të partneritet të mëtutjeshëm me këto vende. Ne po i kthejmë edhe njëherë ata në kohën kur nuk kishim institucione! E po i detyrojmë ata për ta pranuar një fakt që Kosova është po aq e brishtë sa ishte para pavarësisë së vet, pra institucioneve. Nëse nuk e bëjnë, bashkësia ndërkombëtare nëse nuk na bëjnë bashkë nuk vjen, edhe nuk e di a do të vjen në këtë etapë. Por nëse nuk vjen. Shikoni ne do ta bartim përgjegjësinë për mos arritjen e një marrëveshje apo një suksesi mes dy palëve, të dyja janë aspiruese për BE-në, është Kosova dhe Serbia. Edhe me këtë çfarë do të bëhet? Do të ndodhë ajo që tani po ndodh. Do t'i lejohet Serbisë të ecë përpara, në hapjen e kapitujve dhe mbylljen e tyre. Do ta avancojë procesin e vet integruar drejt anëtarësimin në BE, e ne do të ngecim.

Kjo nuk besoj që është ndonjë imagjinatë. Të gjithë ju që i keni përcjellë proceset e dini pse ju them këtë. Andaj ju kisha lutur, të nderuar deputetë, unë e shoh që do të thotë të gjithë kemi diçka për të kritikuar, për të gjetur defekte, edhe e vërtetë që ka për kritikë edhe ka për defekte. Por, a jemi në gjendje ne si Kosovë, a jemi në gjendje partitë politike ta gjejmë një formulë, që të paktën nuk na vjen puna më keq sesa e kemi?! Edhe të përfaqësimit edhe të platformës edhe të krejt formulës si të ecim përpara. Të çështja e institucioneve se nuk bën Hashimi, bën Ramushi, bën ky tjetri, bën ai. Shiko edhe dikur ka qenë Hashimi, Ibra, Qosja, Surroi, ai-ky, baca Adem ka qenë në tavolinë, baca Adem nuk është pajtuar është tërhequr, ka thënë; 'nuk ua nënshkruaj këtë', edhe ne nuk jemi shumë më burra të mirë se të gjithë këta që ishin atëherë.

Domethënë, nëse i marrim të LDK-së, nuk janë më burra të mirë se Ibrahim Rugova, as ata bash ashtu! Nëse i marrim edhe të Vetëvendosjes, e kanë respektuar bacën Adem, baca Adem nuk ka ikur nga tavolina, ka shkuar, ka bërë probleme, ka thënë: pajtohem, nuk pajtohem ia kemi zënë për të madhe. Po ka qenë aty ndonjëherë. Të gjithë ne me rend kështu. Ju lutem, të dashur deputetë, për kohën që ka mbetur prej këtij debati përderisa të jemi këtu, shfrytëzoni mundësinë mos të shkojmë në pauzë të verës pa ndonjë të arritur në këtë drejtim që është e juaja. E të gjithëve, pra jo e vetëm e njëjës palë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Deda në emër të grupit, replikë!

ILIR DEDA: Faleminderit shumë.

Pasi që i kam dy minuta, dua shpejt, tri kontekste, pastaj edhe një përfundim.

Së pari është shumë e padrejtë me i frikësuar qytetarët e Kosovës, t'u themi që, nëse ne nuk arrijmë tani marrëveshje me Serbinë do të bëhemi si Qiproja e Palestina ose do të mbesim si dikush tjetër. Derisa ekziston opinioni i GJND-së për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës kurrë nuk do të bëhemi si Palestina dhe Qiproja Veriore. Kjo, së pari Hashim Thaçi le ta marr vesh e pastaj ata të tjerët të cilët po i bindë, e para. E dyta, kjo çështja e frikës në qoftë se nuk mbërrim ne për gjashtë muaj ditë marrëveshje me Serbinë, ne do të pësojmë, ngadalë, neve mund e gjithë bota të çohet dhe të thotë; hiqni dorë nga Gazivoda, hiqni dorë nga Veriu, hiqni dorë prej të gjithave çka ekzistoni ju si shtet edhe ne nëse refuzojmë, atëherë ne me qenë fajtorë.

Domethënë nuk mundemi në kësi konteksti të diskutojmë mes vete. E treta, arritja e konsensusit kryeministër është vështirësuar edhe për shkak të vendimit tuaj që të mos e udhëhiqni dialogun, edhe për shkak të insistimit të PDK-së edhe të tuajit që me çdo kusht një njeri ta udhëheqë dialogun me Serbinë. Ne të tjerët po themi; jo, nuk po duam me kushte me mbërriri konsensus. E fatmirësisht është një evoluim jashtë Kosovës që këndo që e mandaton Kuvendi me 2/3 do ta udhëheqë procesin, nëse mbërrin. Edhe në fund. Debati parlamentar kurrë në histori të parlamentarizmit të Kosovës nuk ka prodhuar konsensus, kurrë, asnjëherë. Ajo bëhet në tryezë të rrumbullakët, e ne tryezat nuk po i thërrasim më. Sepse nuk po flasim njëri me tjetrin pa kushte, duke e ditur situatën e rëndë në të cilën gjendemi. Edhe në fund, një sqarim që neve të gjithëve na nevojitet! Pasi që po flasim për tërheqjen e njohjeve, nuk domethënë që duhet sot në seancë ta bëjmë, mundemi edhe në të mbyllur. A bën vetëm të na e sqarosh, a janë tërhequr më të vërtetë ato gjashtë njohje apo jo?

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë ka kryeministri.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Me siguri s'i ka, të gjitha Iliri të drejtuara diskutimit tim të fundit se unë konfliktin e ngrirë nuk e mendova në diskutimet e mia, ose të paktën nuk e solla modelin e Qipros këtu. Njëkohësisht nuk fola për asetet ekonomike si; Gazivodën. Ai me siguri, nuk po di po, ne ishim duke folur mbase i ka të përgjithshme por nuk

ka lidhje. Vetëm le të qartësohem se secili e ka një mendim një pozicion të tij, besoj që e dini cilat janë të miat, i kam thënë publikisht, nuk i fsheh. Pra, nuk janë elemente të diskutimit për mua këto! E di që vonesa e zgjidhjes, Ilir, me Serbinë e ka një kosto edhe për neve, për Kosovën. Nëse dikush mendon ndryshe, faleminderit! Por, e ka.

Te konsensusi edhe te debati parlamentar, nuk e di sa vjet je deputet, po unë këto rezoluta që i lexova ju i keni aprovuar në Parlament, ajo është konsensus-rezoluta. Edhe mendoj që...Unë nuk mendova ndonjë... Më falni?! Unë e di që ju i keni votuar disa rezoluta! Jo, jo unë e di që...Shikoni, shikoni, unë e di që rezolutën që u citua më herët e tetorit 2012, që unë nuk kam qenë fare në Kosovë ashtu si thash më herët, e di që keni rënë dakord në atë kohë, nuk di individualisht kush sa, por e di.

Tani shikoni, dua edhe njëherë sigurisht t'ju them. Ju mundeni të vendosni elemente të ndjeshme sa të doni; frikësuese, shqetësuese, të këqija të rrezikshme! Edhe ato mund t'ju ndalin që ta vendosni asnjë hap, askënd. Mund të ruheni të thoni; t'ua lëmë Hashimit edhe çka do të dalë le të dalë. Edhe nëse del keq i merr ai, e ku ta di. Të gjitha këto janë skenarë që diskutohen diku.

Mendimi im është që të shërbeheni në disa shembuj të atyre që edhe ata kanë ditur diçka. Edhe unë e di kur ka qenë LDK gati 70% e di çfarë pozicioni ka mbajtur presidenti po me të njëjtit njerëz që janë sot. Me siguri, me siguri. Edhe pse po i flas këto; dëgjoni. Një anëtar i komisionit ose i delegacionit të Kosovës, qoftë edhe kryesuesi në këtë rast nuk mund ta devijojë substancën, nëse jeni në tavolinë. Nëse e leni në duar të tjetërkujt të ardhmen e juaj e të vendit tuaj, e të fëmijëve tuaj, atëherë po e leni me dëshirë. Ju po dëshironi mbase që t'ju vijë ndonjë zgjidhje që nuk është në rregull, se nga fakti që nuk po keni kurajë të uleni në tavolinë, besoni më leni të dyshoj se aty është qëllimi. Domethënë që vjen çfarë të vjen por ky le ta hajë e ne vazhdojmë. Po ejani uluni në tavolinë...

KRYESUESI: Faleminderit! Jo kundër-replikë veç ky ka, nuk je ti. A pate Albulenë replikë ti? A dëshiron të flasësh?

ALBULENA HAXHIU: Nuk po e kuptoj... Më herët, domethënë kur foli kryeministri tha deputetët po ikin në birë të miut, kështu diçka tha. Zoti kryeministër, unë po ju pyes; ku po shkoni?! Në qoftë se ju sapo dhatë një deklaratë dhe bëtë akuza edhe në drejtim të opozitës, është mirë që të ktheheni! T'i dëgjoni edhe komentet e opozitës. Nuk e di nëse ke mundur ta përcjellësh të premtën, seancën e së premtës. Në emër të Grupi Parlamentar të Vetëvendosjes ka folur Shefi i grupit që është zoti Glauk Konjufca.

Ju po deklaroni që ju nuk keni asnjë propozim, nuk jeni për konsensus por megjithatë ne po ndihmojmë në këtë drejtim. Ne kemi dal me 6 pika të cilat i konsiderojmë si pika të pakalueshme po t'i përmend nëse nuk i dini.

Ne kemi propozuar që të ndërpritet formati aktual i dialogut me Serbinë. Askush në emër të Kosovës nuk mund t'i negociojë çështje e brendshme të Republikës së Kosovës, reciprocitet i plotë politik, ekonomik, tregtar me Serbinë, reciprocitet i të drejtave të popullit shqiptar në Serbi me popullin serb në Kosovë, padi për gjenocid kundër Serbisë dhe Hashim Thaçi është person jokredibil për ta udhëhequr dialogun e ardhshëm me Serbinë. Dhe këto janë gjashtë pikat që i propozon Vetëvendosje! Ju ftoj që t'i përkrahni këto, por po ashtu edhe njëherë ua kam thënë po ua them prapë, ju jeni sot kryeministër vetëm për dy çështje: e para që ta kaloni demarkacionin dhe e bëtë, ndonëse e kundërshtuat dhe e dyta që ta bëni Zajednicën, pra që ta bosnjëzoni Kosovën. Prandaj, PDK-ja ju ka bërë juve kryeministër për t'ia përfunduar edhe këto dy projekte të dëmshme, dhe pastaj, besoni, ia bëjnë njësoj sikur kur ia kanë bërë LDK-së. Pra, e rrëzojnë nga pushteti! Edhe ju kështu do ta pësoni.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Dëgjo e nderuar Albulena Haxhiu!

Kush më ka bërë kryeministër më ka bërë 10% të këtij populli. 10% janë, jo më shumë, po që nuk më ka lëshuar asnjëherë. Edhe kur kam qenë në Hagë, edhe në ditët e kiametit, edhe nuk janë ndarë nga unë. Më kanë besuar prej që kam filluar rrugës politike. Edhe dikush më në fund e ka çmuar atë besnikëri të atyre dhe më ka ftuar të jem partner. Pra, është një realitet politik në vend që buron nga viti 2000, Aleanca e mirë e keq, po kurrë, kurrë nuk është lëkundur. Këta më kanë bërë kryeministër. Por janë bukur të hurit e të konopit edhe janë shumica prej tyre që nuk kanë ikur as në ditët më të vështira të këtij vendi.

Simbolikë e atyre që nuk kanë ikur, prej plotëve që janë këtu, jam unë. Nuk e kam lëshuar asnjë ditë vendin, asnjë ditë, asnjë orë. Gjatë krejt kohës mars '98 qershor '99, vijën e luftës, zonën e përgjegjesisë kurrë një orë nuk e kam lëshuar. Nuk kam qejf askujt, si të themi, pse ashtu pse kështu, por kjo është e vërteta dhe historia. Nuk me kanë bërë për qejf Hashimi e Kadriu. Më kanë bërë për partner, për qejf ishin bërë vetë. Por, më kanë bërë për partner, kanë munguar disa numra, nuk i kanë pasur të gjitha votat, si janë parimet e koalicioneve ja para zgjedhjeve ja pas zgjedhjeve, e vetmja, unë nuk kam hy pas zgjedhjeve sikur ka ndodhur në të kaluarën, por para zgjedhjeve hapur kam bërë koalicion. Jam vetvetja, nuk më ka bërë Hashimi as Kadriu besoni. E kam bërë vetën, më ka bërë vota, edhe besimi i tyre në mua që e respektoj edhe e nderoj atë besim.

Sot kam ardhur te ju për një temë që është shumë me rëndësi. Shikoni... Ky është debat i Parlamentit. Një grup parlamentar e ka thirrur. Unë kam ardhur për temën, tema është e ndjeshme. Ne mundemi sot të gjitha aspektet e tjera t'i drejtojmë, por do të vijë një etapë tjetër që do të pyesim veten pse nuk kemi qenë më të saktë, pse nuk i kemi marrë vendimet e duhura, pse nuk kemi ditur se çka po lypset në atë kohë, e po na ikin hapat si vend?

Unë në kujdesin maksimal që po e bëjë gjatë punës, p.sh. shikoni ne kemi marrë rekomandimin për liberalizimin e vizave, ka qenë një kohë më skeptike e mundur në BE, koha më e vështirë e mundshme. Shihni si kaloi Maqedonia, si kaloi Shqipëria. Ndoshta pa i kryer disa punë të shtëpisë, pa qenë aty me qeverisje, pa u marrë me disa tema që ky vend duhet t'i kryejë ndoshta do të na kishte munguar ai minutë. Nuk di tash sa ka peshë për kënd apo jo, sepse dikush mund të thotë se kemi lëvizur lirshëm edhe në kohën e Jugosllavisë së Titos. Edhe unë e di se ka qenë ashtu, por prapë po na duhet të kthehemi në lirinë njerëzore e më tutje.

Ju lus edhe një herë krahas krejt atyre që keni për të m'i thënë për shumë aspekte, shfrytëzoni kohën e mbetur të diskutimit tuaj për një të arritur në Parlament. Nëse nuk e bëni këtë, një pjesë e përgjegjësishë bie mbi Parlamentin, mbi pozitën po se po mbi ne, por unë mendoj se edhe opozita duhet ta diskutojë seriozisht kontributin e vet. Nëse ka një rezolutë prej jush më herët, shumë mirë. Me siguri e ka bazën e mirë. Ka pasur një rezolutë prej zotit Veseli, prej LDK-së. Kemi marrë pjesë në tryezën e parë të LDK-së, na ka ftuar LDK dhe kemi marrë pjesë në të gjitha tryezat që janë ftuar. Uluni pra dhe gjejini një gjuhë të përbashkët dhe Parlamentit ia jep një legjitimitet të procesit. Fjala nuk është për legjitimitet të individit, por për atë që doni të nxirrni prej këtij procesi, prandaj merreni përgjegjësinë. Nëse jo, ne do të vazhdojmë si kemi ardhur deri sot, dikush andej e dikush këndeje, por do të vonohemi si Kosovë, pra do ta vonojmë veten në raport me fqinjët tanë, të cilët them se i shfrytëzojnë mirë dobësitë tona sikurse në të kaluarë edhe tash.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka znj. Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit nënkryetar i Kuvendit, zoti Haliti!

I nderuar kryeministër, ministra, të nderuar kolegë deputetë, ju të pranishëm dhe qytetarë të Kosovës!

Disa herë më rastisi ta editoj fjalën time në lidhje me pikën e sotme. Më në fund nuk di a do të mund të përmbledh atë që desha të them pa u ndikuar në esencë nga diskutimet e kolegëve të mi deputetë, as majtas dhe as djathtas. Mendoj se askush nuk duhet të mos ndiejë përgjegjësinë në ngecjet e Kosovës sikurse nuk duhet të ndihet kontribuues në ecjet e Kosovës. Ecjet dhe ngecjet janë të përbashkëta dhe gishtin akuzues ose gishtin meritues nuk duhet të jetë i njëanshëm. Kështu bashkërisht të gjithë po e bëjmë Kosovën të ecë apo të ngecë.

Mendoj se çështjet të cilat e kanë një rëndësi të jshhtëzakonshme për vendin duhet të mos përdoren për konsum të brendshëm politik. Shpresoj që energjitë e mëtutjeshme të mos i shfrytëzojmë në çështje negative, por në kontribut për vendin.

Të nderuar kolegë deputetë!

Nuk dua të paragjykoj qëllimin e thirrjes së debatit për dialogun Kosovë-Serbi, sepse kjo ka qenë kërkesë edhe e opinionit të gjerë që debati për dialogun të zhvendoset në Kuvend. Kjo është parë

si mundësi që grupet parlamentare dhe partitë politike, përveç qëndrimeve të tyre tashmë të njohura rreth çështjes mund të dalin edhe me ide dhe qasje që do të mund të përafroheshin dhe në këtë mënyrë qëndrimet e palës kosovare në dialogun që do të vazhdojë në muajt e ardhshëm do të ishin të sakta, të qarta, të mbështetura nga të gjithë dhe që do të garantonin kompaktësinë e politikës së Kosovës në raport me dialogun. Por, edhe nga vetë ajo që edhe thirrësit e debatit kanë paraqitur në diskutimet e tyre, e lëre më diskutuesit e partive të tjera, po shihet se debati në Kuvend po zhvillohet njëjtë sikurse në tryezat që janë thirrur me radhë nga partitë, me të njëjtat qëndrime të ngurta që mendoj se është një gabim, është koncentruar vetëm në një pikë, që është tërësisht e parëndësishme, se kush nuk duhet ta udhëheqë dialogun.

Mendoj se kjo duhet patjetër të diskutohet, pra ekipi dialogues, por jo të vendoset si çështje më e rëndësishme apo si e para. Zoti Veseli në prill të këtij viti ka paraqitur platformën për konsensus dhe një prej pesë pikave të kësaj platforme është dialogu me Serbinë i udhëhequr nga BE-ja apo unifikimi i qëndrimeve dhe platforma shtetërore lidhur me këtë çështje do të ishte një garanci për kompletimin më të mirë të procesit të bisedimeve. Mendoj se ne duhet të punojmë pikërisht në këtë drejtim, pra në krijimin e një kornize të platformës shtetërore e cila do të ishte udhërrëfyese dhe dokumenti bazë për pozicionin e delegacionit të Kosovës në bisedime. Mirëpo për ta arritur këtë, na duhet punë e sinqertë, vizion për të ardhmen, largpamësi, të jemi realistë, t'i njohim rrethanat, ku kemi qenë, ku jemi, çfarë mund të fitojmë apo të humbim në të ardhmen.

Prandaj, është e domosdoshme që të tregojmë konstruktivitet, maturi, t'i tejkalojmë inatet, të tregojmë vlerat për të cilat qëndrojmë dhe në këtë mënyrë që të shkojmë të përgatitur në këtë dialog përball një kundërshtari i cili po përdor çdo mekanizëm të mundshëm për ta penguar Kosovës në rrugën e saj drejt integritit euroatlantik.

Marrëveshja finale mes dy shteteve sovrane do të jetë kalim në një epokë krejtësisht të re të paqes dhe zhvillimit jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon dhe më gjerë.

Të nderuar kolegë deputetë!

E kemi rastin të mbyllim një kapitull të dhimbshëm të historisë sonë dhe gjenerata jonë i bie që të jetë gjenerata e fundit që i bie të marrë vendime kaq të vështira e ne duhet të gjejmë forcën që pavarësisht të gjitha këtyre çështjeve që na ndajnë të jemi unik në pikë kthese në mënyrë që fëmijët tanë, nipërit dhe mbesat tona të mos trashëgojnë konflikte të çfarëdo lloji qofshin ato. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Sveçla. Atëherë zoti Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë!

Rezultatet e dialogut të Brukselit varen shumë nga cilësia në të cilën Kosova ka hyrë në dialog me Serbinë. Në nenin 1, pikën 1, të Kushtetutës së Kosovës thuhet: Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe i pandashëm. Derisa në Kushtetutën e Serbisë, Kosova trajtohet si pjesë e Serbisë. Kurse Bashkimi Evropian, si lehtësuese e dialogut, mban qëndrim neutral ndaj statusit të Kosovës. Pas Pakos së Ahtisarit, ku u bënë lëshime shumë të dëmshme për vendin, siç ishte e drejta për veto e pakicave nëpërmjet shumicës së dyfishitë për çështje vitale të vendit, siç është ushtria dhe shumë çështje të tjera, e sidomos decentralizimi, që në të vërtetë është ndarje në baza etnike e territoriale, që sot po shfrytëzohet si bazë për organizimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe, që realisht është shumë më shumë se asociacion.

Këto koncesione që fillimisht u prezantuan si suksese të palës kosovare e pastaj si çmim për pavarësinë, duke theksuar se ishin lëshimet e fundit dhe fund i dialogut me Serbinë, por doli se nuk ishin lëshimet e fundit karshi Serbisë. Në vitin 2011, kreu shtetëror prapë pranoi të futet në dialog të quajtur teknik, i cili më vonë ishte shndërruar në dialog politik, ku filluan lëshimet shtesë. Nevoja për dialogun teknik, është arsyetuar atëherë me nevojën për lehtësimin e jetës së qytetarëve, me integrimin e komunitetit serb në Kosovë dhe avancimin e Kosovës drejt integritimeve evropiane. Por, pas shtatë viteve të dialogut, faktet flasin se minoriteti serb që jeton në Kosovë nuk është integruar, jeta e shqiptarëve të Luginës së Preshevës nuk është lehtësuar, kurse Kosova nuk ka arritur përparime në drejtim të integritimit në Bashkimin Evropian, derisa Serbia ka arritur të bëhet faktor vendimmarrës në çështjet e brendshme të Kosovës dhe të avancojë shpejt në procesin e integritimit drejt BE-së.

Protagonisti kryesor i këtyre lëshimeve të panevojshme dhe shumë të dëmshme ka qenë dhe mbetet presidenti aktual i vendit, bashkë me disa nga ata që edhe tani po e përkrahin udhëheqjen e dialogut nga i njëjti, me qëllim të rehabilitimit të vetvetes.

Bazuar në Programin e Qeverisë për dialogun e Brukselit, 2014-2018, Qeveria e Republikës së Kosovës ka pranuar obligimin ndërkombëtar për të hyrë në dialogun ndërshtetëror midis Republikës së Kosovës dhe të Serbisë. Në të vërtetë, dialogu i zhvilluar nuk ishte dhe nuk është ndërshtetëror, sepse Serbia nuk e ka pranuar Pavarësinë e Kosovës; tema të dialogut nuk kanë qenë marrëdhëniet në mes të dy vendeve, por çështjet e brendshme të Kosovës; dialogu nuk është zhvilluar mbi parimin e reciprocitetit, siç ndodh në dialogët ndërshtetërorë.

Bazuar në këto që u thanë më lart, del se ata që e kanë përfaqësuar Kosovën, kanë pranuar të dialogojnë për çështje të brendshme të Kosovës, që nënkupton pranimin e statusit të pabarabartë me Serbinë, rrjedhimisht dialogu me Serbinë nuk ka qenë ndërshtetëror dhe si i tillë është në kundërshtim me nenin 1, pikën 1, të Kushtetutës së Kosovës. Derisa jemi te Kushtetuta, në pikën 7 të nenit 84 thuhet: Presidenti nënshkruan marrëveshje ndërkombëtare në pajtim me këtë

Kushtetutë. Kurse Presidenti aktual i vendit në vitin 2013 ka nënshkruar marrëveshje për Asociacionin e Komunave me shumicë serbe, në kundërshtim me Kushtetutën.

Gjykata Kushtetuese në dhjetor të vitit 2015 pati konstatuar se: Parimet e Asociacionit, në formën e një akti juridik të miratuar nga presidenti aktual, atëherë kryeministër i Republikës së Kosovës, rregullojnë çështje që hyjnë në gamën e çështjeve që prekin frymën e Kushtetutës.

Sipas Kushtetueses, parimet e Asociacionit janë një dokument i nënshkruar nga kryeministri dhe paraqesin zotimin e Qeverisë për të krijuar një entitet juridik që prodhon efekte juridike në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës. Në nenin 44 të Kushtetutës bëhet fjalë për lirinë e asociacionit dhe në pikën 1 të këtij neni thuhet se liria e asociimit është e garantuar dhe ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje.

Megjithatë për Asociacionin e Komunave me shumicë serbe, që është çështje e brendshme e Kosovës u debatua me Serbinë në Bruksel, kështu që Serbisë iu mundësua të bëhet pjesë e vendimmarrjes për rregullimin e brendshëm të Kosovës. Ky veprim i delegacionit të Kosovës konsiderohet heqje dorë nga pavarësia dhe shkelje e rëndë e Kushtetutës. Me Serbinë është biseduar edhe për FSK-në dhe Policinë e Kosovës, por asnjëherë nuk është përmendur e diskutuar për shqiptarët e Luginës së Preshevës dhe zgjidhjen e problemeve të tyre mbi bazën e reciprocitetit.

Presidenti aktual që ka nënshkruar marrëveshje të dëmshme, kundërkushtetuese, që ka zhvilluar dialog jotransparent dhe është përkulur para përmendores ku shqiptarët cilësohen si terroristë, po insiston t'i udhëheqë bisedimet përfundimtare me Serbinë dhe po vazhdon të shkojë në Bruksel pa platformë dhe i paautorizuar e që njëkohësisht po paralajmëron koncesione të reja, jo vetëm që nuk mund ta udhëheqë dialogun, por për arsye të shkeljeve të lartpërmendura, Ky Kuvend duhet të fillojë procedurën e shkarkimit të tij. Delegacionin që do ta zgjedhë Kuvendi pas analizës së rezultateve dhe pasojave të dialogut të gjertanishëm dhe hartimit të platformës, duhet të udhëheqë dialog ndërshtetëror që rregullon marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve të pavarura. Kurse çështjet e pakicave kombëtare në dy shtete, duhet të rregullohen mbi parimin e reciprocitetit. Për të arritur deri në këtë pikë, duhet që Serbia të ndërmarrë disa obligime e para së gjithash ta njohë pavarësinë e Kosovës.

Në fund, mendoj se do të ishte e dobishme që në përfundim të këtij debati në vend të rezolutës, Kuvendi të dalë me një platformë politike për dialogun me Serbinë, duke i paraprirë me hapa të cilët u përmendën më lart. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rasim Selmanaj e ka fjalën.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë.

Nga krejt diskutimet që i dëgjuam sot, unë seriozisht nuk po arrij të kuptojë nëse e kemi seriozisht të arrijmë një konsensus për platformën dhe ekipin negociues. Nga diskutimet nuk po duket se ka vullnet të ndodhë konsensusi. Dëshiroj që unë ta kem gabim. Ja disa konstatime nga diskutimet nga të nderuarit kolegë deputetë. U tha sot se sovraniteti është i paprekshëm dhe i panegociueshëm, të gjithë po deklarohemi se jemi pro dialogut dhe marrëveshjes përfundimtare me Serbinë e krejt po pajtohemi me disa përjashtime. Dallimet po shpërfaqen te emri i presidentit Hashim Thaçi. Për mua s'ka rëndësi a do të jetë Hashim Thaçi në krye të ekipit të Kosovës, këtu po kërkohet një kompromis dhe nëse jemi të sigurtë me njëri-tjetrin dhe përtej kësaj ta vlerësojmë peshën, rreziqet dhe rëndësinë që e ka ky proces aspak i lehtë për Kosovën, atëherë unë mendoj se kompromisi është i mundshëm dhe i duhet të arrihet. Përderisa Serbia në dialog në krye e ka presidentin e vet, atëherë edhe Kosova duhet të përfaqësohet me të njëjtin nivel. Hiqni inatet për këtë proces dhe ruani ato për situata të tjera elektorale se sigurisht do t'ju vyejnë.

Të nderuar kolegë të LDK-së,

Ju kur e keni arritur koalicionin me PDK-në, e keni vlerësuar si koalicion për interesin e Kosovës, e keni vlerësuar si koalicion për interesin e Kosovës dhe jo për pushtet dhe rrjedhimisht me votën tuaj zgjidhet Hashim Thaçi president. Mendoj se e njëjta qasje po kërkohet edhe rreth kësaj teme. Dëshiroj të përmend një shembull pozitiv deputetin Naser Rugova, i cili në fjalimin e tij ishte konstruktiv dhe mendoj se ishte në frymën e arritjes së një konsensusi.

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja po shtrohet sot këtu a duam dhe a jemi ta marrim në dorë si Parlament procesin e dialogut, cili është i pashmangshëm dhe me afate kohore?

Të nderuar deputetë,

Këtu sot po del sikur më i rëndësishëm është Hashim Thaçi se krejt procesi. Gabim e keni qasjen në këtë proces. Kështu nuk arrihet konsensusi, e as platforma për dialogun. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e deputetit Lumir Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit kryesues! Të nderuar kolegë deputetë!

Në fakt sot do të duhej të flisnim për përmbajtje dhe jo për proces, por ja që procesi po e determinon edhe përmbajtjen e dialogut, meqenëse ka disa veprime që akterët kryesorë institucionalë i kanë marrë me dije ose jo. I pari veprim që e shkakton vënien e procesit para përmbajtjes është i abstenimit të Qeverisë. Pra Qeveria e Republikës së Kosovës e ardhur në pushtet me moton e punëve të mëdha, ka vendosur të heq dorë vullnetarisht nga puna më e madhe që Kosova mund ta ketë në një dekadë të tërë dhe kjo Qeveri, kryeministri jonë saktësisht ka deklaruar në disa raste rresht se nuk është për këtë punë. Rrjedhimisht, kompetencën e vet

kushtetuese të liderit të vendit nuk dëshiron ta ushtrojë. Këtë kompetencë, por jo vetëm këtë kompetencë, por edhe obligimin kushtetues, kryeministri dëshiron ta kontrakttojë te dikush tjetër. Tash fillimisht nëse një kryeministër i një vendi nuk është për këtë punë, unë pyes për çka janë, për çfarë na duhet Qeveria dhe kryeministri. Për çfarë na duhet një Qeveri që refuzon të merret me elementin më thelbësor të shtetësisë tonë. Punë të mëdha nuk janë aneks-kontratrat me Bektelin, nuk janë as rritja e pagave për veten, as emërimi i 100 zëvendësministrave. Këto janë dëme të mëdha, gabime të mëdha! Punë e madhe për Kosovën është përcaktimi i fatit shtetëror të saj, i definimit të subjektivitetit ndërkombëtar dhe i marrjes së përgjegjësisë kushtetuese mbi këtë pozitë.

Si Qeveri, si institucion... së individit. Dhe ka arsye pse Qeveria është e përcaktuar me kushtetutë të bartë një proces të tillë. E para sepse ka fuqi politike, ose duhej së paku të ketë në teori dhe e dyta sepse mbikëqyret prej këtij Parlamenti. Por forca politike e koalicionit të tanishëm është njëra prej arsyeve pse Qeveria ka vendosur abstenimin, pse kryeministri nuk e ushtron obligimin e vet kushtetues në procesin dialogues, për ta thënë thjeshtë Qeveria e sotme nuk e ka shumicën është Qeveri e pakicës. Forcat politike në këtë pakicë për më tepër janë të ndara në 22 parti dhe në disa qendra vendimmarrëse gjithandej dhe vëreni se si konsensusi politik nuk kërkohet prej Beogradi sepse atje qeveria e përfaqëson këtë konsensus me votë të qytetarëve. Kërkohet më tepër nga Kosova dhe nuk mund të pritët nga Qeveria asnjë vendim kapital kur kryeministri i ka vetëm dhjetë deputetë në Parlament.

Çfarë qenka ekipi negociues kur kryenegociatori përfaqëson një të dhjetën e qytetarëve të vet dhe me çfarë kompetence, me çfarë force politike apo me çfarë garancie mund të flasë një përfaqësues i tillë? E në ndihmë të kësaj dobësie politike, në atë udhëtimin e fundit negociator, në atë udhëtimin e thirrjes: hajde Bacë, ishin mbledhur e disa përfaqësues të tjerë në një alamet përforcimi dhe një nga këto përforcimet që flet në emër të fatit të përgjithshëm të Kosovës, paramendojeni ishte një zëvendëskryeministër që nuk ka madje asnjë votë të vetme. Për fatin përfundimtar të Kosovës flet edhe një individ që s'ka një votë të vetme politike të përfaqësuar në këtë Parlament dhe nuk po flas për zëvendëskryeministrin tjetër që ka dy deputetë të vetëm dhe flet tani në emër të qytetarëve. Kurrë më pak në asnjë proces tjetër dialogues nuk ka pasur më pak përfaqësim politik sesa sot. Delegacioni i tillë përfaqëson vetëm 38 për qind të qytetarëve të Kosovës. Kaq vota kanë marrë!

Pra, me një të tretën të votuesve të vendit dëshirojnë të flasin për dy të tretën e tyre dhe këtu lind problemi dhe në këtë rrethanë politike e që shkaktoi krizë institucionale të përfaqësimit në dialog gjendet edhe vetë imponimi i presidentit të vendit në procesin e dialogut. Ky vetimponim i një figure krejtësisht ceremoniale, është tejkallim i kompetencave kushtetuese. Presidenti nuk ka kompetencë të ndërtojë dialogun dhe nuk ka kompetencë të ndërtojë politikën e jashtme. Ka kompetencë ta përfaqësoj politikën që e ndërton Qeveria e Kosovës, por jo ta ndërtojë të njëjtën politikë. Dhe ne kemi në njërin anë një kryeministër që nuk përfaqëson obligimin kushtetues dhe

kemi në tjetrën anë një president që merr përsipër një detyrë që është përtej obligimit të tij kushtetues dhe baza e këtij shkëmbimi nuk është ndonjë logjikë institucionale, as ndonjë precedent historik i vendit, por baza e këtij shkëmbimi është në marrëveshjet politike individuale.

Pra, interesi personal e mbizotëron rendin kushtetues të vendit. Paralele që po bëhen me kohën kur Kosova nuk ka qenë shtet dhe nuk ka pasur institucione janë të trishta. Kosovën nuk mund ta përfaqësojë sot një pozitë që nuk mandatohet për këtë punë nga Kuvendi. Kosovën nuk mund ta përfaqësojë një pozitë që nuk ka s mekanizma ekzekutues të marrëveshjes, sepse nuk është Qeveri, e as nuk ka mekanizma llogaridhënës ndaj Kuvendit sepse nuk i raporton atij. Pozita e tillë është thjeshtë jolegjitime dhe jashtë rolit kushtetues, Hashim Thaçi është edhe një figurë kontraverse me dështime enorme në dialog, është përçarës i skenës politike e i refuzuar sot nga shumica shqiptare që ka derivuar deputetët e vet në Parlament. Një figurë e tillë nuk është figurë uniteti. Në fakt, uniteti i vetëm që ai mund të ndërtojë është ai i refuzimit politik në Kosovë ashtu siç po ndodh sot.

Të nderuar zonja e zotërinj,

Qeveria mund të abstenojë nga obligimi politik, është e drejtë e tyre, por nuk mund ta ushtrojë të njëjtën pozitë qeverisëse pas abstenimit, dhe aq më pak nuk mund të autorizojnë dikë tjetër e as të kërkojnë nga opozita ta marrë këtë rol prijës. Një kërkesë e tillë i ngjan njëfarë relacioni punëdhënësit e punëmarrësit, ku punëdhënësi në cilësinë e shefit e kontraktin dikë t'ia bëjë punën që është i obliguar ta kryejë. Qeveria mund ta shohë veten të tillë si pronare të Kosovës, e më pas ta kontraktojë opozitën që ta bartë procesin në Bruksel, po s'është e tillë. Pronarë të Kosovës janë qytetarët e tyre dhe ata kanë zgjedhur me votë të lirë këtë Parlament. Asnjë përforcim dostnor, fisnor, klanor nuk e kompenson nevojën e përfaqësimit legjitim të Parlamentit, zërit të qytetarëve të tyre me secilin dialog dhe na duhet ky zë. Këtë zë, këto institucione, siç argumentova, me 38% të qytetarëve nuk e kanë, për të marrë këtë zë Kosovës i duhen zgjedhje të reja, i duhet legjitimitet i ri institucional, ardhja e një qeverie të re që vendos të marrë mbi vete punën për çfarë edhe ekziston në rend të parë, lidërshtipin ndaj vendit.

Pa një qeveri legjitime, si një proces delegates mbetet proces i pakicës legjitime, i destinuar të dështojë që në fillim dhe nuk ka forcë ndërkombëtare që do të pranojë një proces të tillë, nuk do të ndodhë një dialog pa përfshirjen e shumicës shqiptare në të. Para dialogut na duhet legjitimitet, pas legjitimitetit na duhet unitet, e pas unitetit na duhet kornizë e vijave të kuqe në tri parime, pra na duhet përmbajtje. Parimin e parë, integritetin territorial të Kosovës, të dytin, karakterin unitar të Republikës së Kosovës dhe, të tretin, frymën aktuale kushtetuese. Rrezikimi i njerëzve nga këto parime nënkupton rrezikim të vetë Republikës dhe në qoftë se alternativa të tjera na dalin në tavolinë që thyen njërin prej këtyre parimeve, nuk ka Parlament, nuk ka deputetë, e nuk ka forcë politike që do të mund të marrë mbi vete rrezikun në fjalë, e

përgjegjësinë në fjalë, e vetmja zgjidhje do të mbetet referendumi dhe drejtimi për kërkimin e zërit të qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nitaj ka replikë.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Debati interesant, po përmbajtja lë shumë për të dëshiruar. Në fakt, sa Hashim Thaçi ka qenë në Qeveri me LDK-në, ka funksionuar perfekt. Unë nuk e kam fare problem nëse Hashim Thaçi nuk do të jetë shef i delegacionit, por nuk po arrij ta kuptoj Lumirin, një herë thotë, për shembull, që ky kryeministër nuk ka mandat për të negociuar që i ka vetëm dhjetë deputetë, e mandej thotë që Qeveria e Kosovës nuk duhet të heqë dorë prej dialogut.

Prandaj, Lumir, të lutem, nëse ka mundësi ta sqarosh, ku e ke problemin, cila është realisht teoria jote e saktë, apo e ke në plan veç të flasësh çka do qoftë.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Abdixhiku!

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Tash unë mund ta qartësoj për dikë që s'dëshiron të kuptojë dallimin në mes të një individi dhe Qeverisë si institucion. Organ kushtetues i Kosovës që mund të flasë në emër të Kosovës, që ka forcën politike për Kosovën, për qytetarët e saj, është Kuvendi, i cili mandaton Qeverinë e Kosovës. Këto janë relacione kushtetuese, kryeministri i Kosovës vazhdon t'i ketë dhjetë deputetë dhe për aq mund të flasë si përfaqësues i qytetarëve të Kosovës, jo më shumë se kaq. Neve na duhen 2/3 e këtij Parlamenti, neve na duhet përfaqësimi politik i shumicës shqiptare në këtë Parlament, i artikuluar më pas nëpër institucionet kushtetuese, siç është Qeveria. Në rrethana të tanishme kryeministri nuk ka shumicë politike dhe nuk dëshiron ta ushtrojë rolin e tij kushtetues brenda Qeverisë, e do ta kontrakttojë dikë tjetër, një gjë të tillë s'mund të ndodhë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Kolegë deputetë,

Qytetarë të nderuar,

Ministër,

Pritja ka qenë që ky debat të jetë pak më shumë përmbajtjesor, më shumë konkret, por nuk është çudi të mos dallojë ky debat edhe prej debateve të tjera në këtë Kuvend, sidomos kohëve të fundit, por ka gjëra pozitive. Është mirë që po debatohet për çështje kaq të rëndësishme dhe debati është i qetë. Pra, ka një normalizim të debatit për sa u përket temave të rëndësishme për

vendin dhe, edhe nëse është i vonuar, edhe nëse është i tillë, me siguri do të sjellë diçka edhe në vazhdimin e tij.

Ma merr mendja që ky debat është po ashtu i rëndësishëm siç ishin edhe iniciativa për tryeza të ndryshme për t'u dakorduar për dialogun, sikur që ishte e rëndësishme një platformë e sjellë nga zoti Veseli, ashtu siç ishte dhe është e rëndësishme edhe kërkesa e një grupi parlamentar për këtë debat, edhe me disa kërkesa ose pika të kërkuara, po ashtu mund të jenë të rëndësishme edhe disa kërkesa të tjera ose pika të lansuara sot nga grupet parlamentare, por assesi nuk mund ta çojë përpara, ose nuk mund të jetë i dobishëm ky debat nëse kemi kërkesa përjashtuese ose kërkesa të skajshme që nuk lënë shtegun hapur që të gjithë ne të jemi pjesë e rëndësishme e këtij kontributi. U tha këtu nga dikush se është vështirë, tash qëndrimet tona të mos na imponohen nga fjalimet e njëri-tjetrit, a jemi vonuar a s'jemi vonuar.

Ne jemi vonuar gjithmonë në historinë tonë, kemi ecur dikur më shpejt, atëherë kur kemi ecur më shpejt, kemi pasur më shumë miq, kemi pasur më shumë mbështetje, historia jonë më e re na ka treguar dhe na e dëshmon këtë. Në vitin 200 më ka rënë mua si një prej njerëzve që kam qenë i involvuar, shumë prej jush po ashtu, të kontaktoj dhe të jem pjesë e kontakteve me ndërkombëtarët, me miq. Në atë kohë, kemi pasur misionin e Kombeve të Bashkuara. Besoj që liderët politikë kanë pasur rastin këso kontakte, mesazhe dhe kërkesa nga miqtë partnerë të marrin më shumë. Dy prej tyre dua t'i veçoj si porosi që sot më kujtohen, njëri prej tyre francez, më thoshte në vitin 2000: duhet të nguteni të merrni përgjegjësitë tuaja, në atë kohë ne e kishim bërë vetëm policinë tonë, thoshte është keq për ju të mos merrni përgjegjësi, t'i mbron vetë këto monumente fetare historike dhe serbët që jetojnë në Kosovë.

Ne jo që u vonuam, por tetë vjet më vonë nuk arritëm atë mision ta zëvendësojmë vetëm me institucionet tona, por me një mision tjetër evropian, i cili është ende në Kosovë. Pra, ne nuk arritëm, arritëm ta çlirojmë vendin, ta shpallim pavarësinë, por të bëhemi krejt me përgjegjësitë tona zot të vetvetes, t'i mbrojmë të gjithë, jo vetëm monumentet, por të gjithë qytetarët pa dallim dhe të mos lejojmë që ende sot në emër të këtij misioni të harxhohen fonde për Kosovën, ose të jepen fonde për Kosovën dhe aq më tepër ata që sot hiqen si viktima, e sot s'i kemi as në Kuvendin e Kosovës, nëpërmjet Qeverisë së Beogradit manipulojnë ende. Sot jemi të varur si shtet për të ardhmen tonë nga shumëçka që ne kemi mundur ta kryejmë më herët.

Dhe, një tjetër po ashtu më thoshte që s'ishte evropian, më thoshte: "Ju duhet të merrni iniciativë për pajtimin, pavarësisht se ju jeni viktima, sepse nuk mund ta keni misionin ndërkombëtar përherë këtu dhe nuk është interesimi gjithmonë i njëjtë". Sot po dëshmohet se nuk është i njëjti interesim, prandaj edhe ka në tavolinën e bisedimeve shpeshherë edhe zëra që mund të jenë shqetësues për punën tonë. Pse sot është dialogu, shtrohet pyetja, kaq temë e rëndësishme? A është për dëshirën tonë? Nuk e besoj! S'e besoj që dikush do të kishte dëshirë të merrej me këtë temë, të gjithë e dimë që nuk mund, nuk jemi komod për të bërë një zgjidhje aq më tepër

historike, siç po donë të thonë. Por, sepse interesi ynë është jetik për integrimin në BE dhe kushtet për BE janë të tilla, eksplicite edhe për ne, edhe për Serbinë. Madje, kohëve të fundit secili prej jush që keni kontaktuar me miqtë dhe me të tjerë nga BE dhe nga vende të tjera mikenë e kanë thënë hapur: “Nuk jemi të gatshëm t’ ju integrojmë në proces, nëse ju nuk i kryeni çështjet tuaja të pazgjidhura”. Pra, secilën herë e më shumë, edhe ata që i kemi partnerë po duan të na lënë që ne t’i zgjidhim punët tona vetë. A jemi ne të gatshëm t’i zgjidhim këto probleme? A i kemi ende partnerët tanë siç i kemi pasur? A kemi kapacitete? A jemi ne bashkë njëri me tjetrin? A kemi ne një platformë? Kjo është një pyetje që duhet sot të na drejtojë të gjithëve në këtë debat.

Mendoj që ishte shumë e rëndësishme sot kur dëgjova se duhet të ketë njëfarë vlerësimi për marrëveshjet e arritura deri tash, kishte po ashtu kërkesa që duhet të ulemi dhe si Kuvend të bëjmë një zgjidhje, por u tha po ashtu se nuk ka besim. Pse s’ka besim? Çka ka ndodhur mes nesh që ka humbur besimi? Nuk është problemi që ne s’kemi besim mes pozitës-opozitës, kjo edhe s’është megjithatë shumë e rëndësishme. Ne të gjithë tash pa dallim nuk është edhe se kemi një besim të mirë solid të qytetarët e vendit tonë, jo për shkak çka ka ndodhur në procesin e dialogut. Ka qenë një proces i monitoruar, i fasilituar, edhe i këshilluar prej partnerëve ndërkombëtarë. Më shumë ka ndodhur humbje e këtij besimi për çka ka ndodhur mes këtyre proceseve të rëndësishme, e që ka të bëjë me jetën tonë politike të përditshme, pozitë-opozitë, edhe me qeverisjen, edhe me trajtimin e çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me të ardhmen e fëmijëve tanë e të ardhmen e vendit tonë.

Duhet ta kthejmë, zonja dhe zotërinj, këtë besim dhe ky besim nuk mund të kthehet duke përjashtuar njëri-tjetrin. Ne jetojmë këtu dhe kemi qenë të angazhuar dhe e dimë çka ka ndodhur në këto 10, 20, 30 vjet në këtë vend. Nuk mund ta quajmë as procesin historik, as presidentin historik, as kryeministrin historik në këtu me fjalimet tona. Janë këto procese që varen edhe nga të tjerët, koha i shënon të gjitha këto dhe i çmon të gjitha këto, por duhet të them edhe një diçka tjetër, krejt debati u soll rreth presidentit, madje edhe nga ata që dëshirojnë të bëjnë një zgjidhje për këtë çështje. Mendoj që është një gabim shumë, shumë i madh, mendoj që ne duhet ta thërrasim të gjithë këtu në Parlament presidentin, kryeministrin, institucionet e vendit t’i kryejnë detyrat e veta në përputhje me Kushtetutën, për aq sa ne në Kuvend nuk bëjmë një ofertë tjetër për këtë proces të rëndësishëm. Nëse ne s’jemi të gatshëm ta bëjmë këtë, duhet të kërkojmë që ata të përfaqësojnë në përputhje me Kushtetutën vendin tonë dhe interesat e këtij vendi, dhe interesat e këtij vendi janë shfaqur edhe disa herë, si integrimi ynë në BE dhe interesat, të cilat shfaqen edhe nëpërmjet përfaqësuesve politikë.

Pra, ne duhet ta dimë që ky është një interes yni dhe interes yni nuk është drejtpërdrejt dialogu, por është procesi i integritit në BE dhe rrjedhimisht ne jemi të detyruar të bëjmë ose të ndalemi edhe në këtë proces. Në kushte normale një komb që ka kësi problemesh, edhe pa pasur kushte të tilla do të ishte normale që një lidhësi, një udhëheqje, një politikë e atij vendi të kërkonte që

me dialog t'i kalonte krejt problemet dhe të mos ua linte gjeneratave të tjera. Po them edhe një herë, ne duhet t'i kthehemi si të thuash idesë që të bëjmë diçka bashkë, por pa përjashtuar një platformë të përbashkët, një platformë e nxjerrë nga ky Kuvend, me kërkesa të qarta dhe me pika të qarta do t'i bënte mirë cilido që të ishte pjesë e udhëheqjes së këtij procesi, i cili është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe po shihet se ka një seriozitet më të madh, jo për shkak nesh, por për shkak të atyre që na mbështesin ose për shkak të atyre që thjesht duan të na kenë edhe neve në rrugëtimin drejt integritimit evropian. Edhe një herë po them, një rikthim, një dokument i përbashkët i nxjerrë në këtë Kuvend do ta kthente një besim të madh edhe ndaj qytetarëve, por përveç tjerash, në vjeshtën e këtij viti që, siç po shihet, do të jetë goxha e vështirë për krejt ne, do ta bënte përfaqësimin tonë sa më dinjitoz në proceset e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Pas opinionit pozitiv të Gjykatës Ndërkombëtare më 2010 për Kosovën dhe pavarësinë e saj, në vend se ky veprim të shfrytëzohet për përparimin e pozitës së Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare, ka ngjarë krejtësisht e kundërta. Jo vetëm që nuk kishte një stabilizim dhe përparim të pozitës ndërkombëtare të Kosovës, por pasoi një përkeqësim i dukshëm i situatës.

Edhe në planin e brendshëm Kosova hyri në një spirale të rrezikshme të bisedimeve me Serbinë, e cila në vend që të detyrohet të pranojë përgjegjësinë dhe fajësinë për krimet e luftës kundër njerëzimit, me mbi 13 mijë viktima civile, për plaçkitje dhe shkatërrimin e infrastrukturës së përgjithshme publike dhe private gjatë luftës në Kosovë, ajo e fitoi betejën politike. Dialogu dhe Bashkësia e Komunave serbe, apo Zajednica në Kosovë janë rezultat i presionit personal mbi udhëheqës të atëhershëm të dialogut që edhe tani vazhdojnë dialogun në mënyrë të pamandatur nga Kuvendi i Kosovës, kryesisht Hashim Thaçit.

Ashtu sikur decentralizimi, ky Asociacion është rezultat i veprimeve injorante, bishtzënëse, të dëmshme, të zbatuara nga politikanët e shantazhuar nga faktorë të jashtëm dhe të brendshëm për veprimet e tyre personale në të kaluarën e largët dhe të afërt, qoftë në aspektin ekonomik, ligjor apo politik. Nuk është aspak e rastit që pikërisht personat e tillë e kanë shtyrë përpara, madje i kanë nënshkruar dokumentet për jetësimin e decentralizimit, pastaj të demarkacionit me Maqedoninë dhe pastaj me Malin e Zi, të Zajednicës, ndërsa tash e hapin gojën vesh më vesh edhe për ndryshim të kufijve apo këmbim të territoreve të tokave shqiptare. Këta farë tyxharësh tokash kombëtare nuk do të ndalen duke bërë pazare me tokat shqiptare, sepse duhet të lajnë borxhe personale.

Këta tyxharë tokash nuk lodhin kokën për shqiptarët e Luginës së Preshevës, apo të Kosovës Lindore, sido që t'i quani, në rastin më të mirë që po dëshmohet shumë tragjik, shqiptarët e Bujanovcit, Medvegjës e Preshevës me vendbanime shqiptare në ato pjesë, përdoren vetëm për mashtrime elektorale të kohëpaskohshme, fatkeqësisht, prandaj këta farë tyxharësh duhet t'i ndalë Kuvendi, e nëse jo Kuvendi atëherë populli në sheshe e në rrugë. E këtu parimi kryesor me shqiptarët e asaj pjese të tokave shqiptare është parimi i reciprocitetit.

Tani të kthehemi te ashtuquajtura Asociacioni apo Zajednica serbe. Ky asociacion është vazhdimësi e atyre pazareve që janë thjesht tyxharllëqe të rrezikshme. Menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes për asociacionin Hashim Thaçi personalisht ka deklaruar se vetë Serbia ka kërkuar që ky asociacion të jetë me karakter ekzekutiv. Pra, deklaroi si Serbia ka kërkuar dhe se kjo marrëveshje në asnjë pikë nuk e shkel Kushtetutën e Kosovës. Gjykata Kushtetuese ka konstatuar krejtësisht të kundërtën, se kjo marrëveshje e shkel Kushtetutën në 23 nene, të shprehur me eufemizëm nga Gjykata Kushtetuese me shprehjen 'nuk plotësojnë tërësisht standardet kushtetuese'. E vërteta është se nuk ka asnjë pikë, asnjë fjali, asnjë fjalë të vetme në atë marrëveshje që nuk e shkel Kushtetutën e Kosovës. Kur lexohet me vëmendje aktgjykimi i datës 23 dhjetor 2015, edhe vetë teksti i marrëveshjes për Asociacionin serb shihet qartë. Në asnjë pikë të marrëveshjes së 25 gushtit 2015 nuk gjendet, madje asnjë fjalë apo shprehje e vetme gjuhësore që kërkon ruajtjen, mbrojtjen apo edhe prezervimin e të drejtave dhe lirive themelore, gjegjësisht të traditës, kulturës apo gjuhës së serbëve në Kosovë. Asnjë kërkesë nga kapitulli dy i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Pra, hartuesit e kësaj marrëveshje, është fjala për ekipin menaxhues, nuk kanë kërkesa, shqetësime apo brenga për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, por kanë kërkesa destruktive, kundër kushtetuese, me karakter shovinist, sepse ata kërkojnë diskriminimin e të tjerëve, duke synuar jo vetëm marrjen e tërësishtme, por edhe "monopolizimin e pushtetit", gjoja 'për serbët', që në të vërtetë është pushtet për Serbinë, e ky është thelbi i Zajednicës serbe në Kosovë. Kërkesat shprehimore të marrëveshjes janë krejtësisht politike, krijimi i entitetit politik territorial me kërkesa të qarta që përmbajnë attribute shtetërore, me kompetenca të qarta ekzekutive, gjyqësore, legjislativë, por të maskuara me konceptin e Bashkësisë së Komunave serbe, e bordi i këtij Asociacioni nuk është gjë tjetër vetëm një miniqeveri serbe në Kosovë.

Zoti Haradinaj sot kërkoi nga deputetët që të marrin përgjegjësinë për çështjet e rëndësishme për dialogun. Unë po them kështu, zoti Haradinaj për demarkacionin dhe marrëveshjen Isa Mustafën dhe Hashim Thaçin i quante edhe të paditur, shpirtshitur, të pashkollë dhe gjithçka tjetër. Kur erdhi në pushtet, siç duket e ndërroi qëndrimin për demarkacionin, e solli këtu atë demarkacion të pandryshuar dhe i detyroi deputetët që ta votojnë, natyrisht jo me pikë të zorit i ka detyruar. Mandej, çështja tjetër që po kërkon që ne të marrim përgjegjësi, zoti Haradinaj në një nga përgjigjet që i dha deputetit Hoti në një nga seancat e kaluara për përbërjen e ekipit menaxhues, tha: "Unë nuk kam qenë i kënaqur, kam bërë përpjeke për ta ndryshuar, mirëpo më kanë thënë

miqtë, të huajt, nuk mund ta ndryshosh”. Këndej thotë “Zajednica është çështje e Kosovës brenda Kushtetutës”, qysh është e mundur një kryeministër i vendit për çështje të brendshme të Kosovës të deklarojë se unë s’mund të ndryshojë këtë çështje, a është e mundur kjo?

Po ashtu, zoti Haradinaj, në çështjen e shtetasve turq të larguar nga Kosova del në foltore dhe thotë: “Unë nuk e di çka ka ngjarë, nuk kam informata”. I vetmi veprim politik që është, është domethënë shkarkimi nga funksioni i dy qytetarëve, por Shpend Maxhuni që është ndër fajtorët kryesor, nuk guxoi ta përjashtojë. Këto janë çështje, kur vjen çështja te dialogu thotë unë nuk jam i gatshëm, nuk jam i aftë, nuk jam i përgatitur të udhëheq dialogun, më mirë është të shkojë Hashim Thaçi, të cilin para dy vjetësh e quante “të paditur, të shitur dhe të pashkolluar”. Qysh është e mundur ky ndryshim? Këto janë çështje, këto janë veprime politike, ne vetë e kemi dëgjuar zotin Haradinaj duke thënë se unë jam njeri i vendimeve dhe veprimeve të mëdha politike. Nëse këto nuk janë veprime dhe vendime politike, unë nuk e di cilat janë, sigurisht vendimi për të ndarë mbi 50 milionë euro për Bechtel Enkën, për të ndarë mjete për ambalazhuesit e ujit, për banorët e Shipitullës, për të nënshkruar Contour Globalin, për të rritur pagat e veta, për të paguar rrymën e shpenzuar në Veri. Ato janë çështje financiare, ato mund t’i nënshkruajë një arkëtar i mirë apo një drejtor i departamentit të Ministrisë së Financave që e ka për obligim, por nuk janë vendime të mëdha politike, për të cilat unë kam shpresuar se zoti Haradinaj është i gatshëm t’i ndër marrë.

Këtu është çështja, unë nuk kam dëshirë të reduktoj kryeministrin e Kosovës edhe zotin Haradinaj në njëfarë trimërie dhe guximi animal, qysh duan disa të fortë të tregojnë, është i fortë, është i guximshëm. Por, kërkoj nga kryeministri që të marrë çështjet për vendime të mëdha politike në duar, ashtu siç e obligon Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e Kushtetuta e Republikës së Kosovës e obligon Qeverinë dhe kryeministrin që të marrë qëndrim dhe veprimet e tilla politike t’i ndjekë. Nëse nuk është i gatshëm dhe nuk është i aftë t’i ndër marrë ashtu siç deklaroi këto veprime politike, atëherë nuk ka tjetër vetëm të tërhiqet nga posti, dhe ne ta zgjedhim dikë tjetër, por kjo nuk mund të shkojë më tutje.

Unë e di se po bërtasin edhe mund ta merrni fjalën për replikë, natyrisht edhe ne ju dëgjojmë me kujdes, po këto janë deklarata të zotit Haradinaj dhe unë kërkoj nga kryeministri i Republikës së Kosovës ose të marrë përgjegjësinë për veprime politike dhe të fillojë me koordinimin e punës për dialogun me Serbinë, ose të heqë dorë nga posti që e ka dhe obligimet kushtetuese dhe t’u lëshojë rrugë të tjerëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muharrem Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë,

Ka më tepër se 7 orë që kemi filluar debatin për dialogun e mundshëm me Serbinë dhe për fatin e keq, mbas 7 orëve jemi më larg se sa kur kemi filluar. Ka pasur debate interesante, kërkesa interesante, duke filluar prej të zhdukurve, reciprocitetit ekonomik e politik, reparacioneve të luftës, Preshevën, Bujanocin e deri te referendumi. Edhe të gjitha këto qëndrojnë dhe janë të sakta, por për fatin e keq krijojnë një përshtypje sikur ne po shkojmë ose duhet të shkojmë në dialog me Serbinë për qejf, jo realisht qysh është situata. Sepse në dialog me Serbinë nuk shkojmë për qejf, por shkojmë sepse duket që s'kemi qare pa shkuar.

E dëgjova me vëmendje edhe debatin e zotit Kurteshi, i dëgjova më herët edhe debatet e kolegëve, edhe të zotit Abdixhiku. Kam përshtypjen që problemi nuk është siç provojnë ta paraqesin. Problemi është shumë më i thellë! Problemi është se Vetëvendosje nuk e mbështet PSD-në në tekstin e rezolutës, ata e kanë një rezolutë për vete. LDK-ja nuk e mbështet as Vetëvendosjen as PSD-në as Qeverinë. Ata i kanë disa ide të tjera, ata kërkojnë një referendum. Partia Demokratike e Kosovës pranon gjithçka, por nuk e pranon as idenë që në krye të delegacionit që do ta përfaqësojë Kosovën në bisedime me Serbinë të jetë dikush tjetër për pos Hashim Thaçit. Edhe kështu në këtë Kuvend ka disa grupacione që kanë filluar tashmë, jo të mendojnë për brezat që do të vijnë në këtë vend, jo të mendojnë për të ardhmen e këtij vendi por për zgjedhjet e ardhshme.

T'ia kujtoj edhe njëherë zotit Abdixhiku që presidenti i vendit është zgjedhur me më shumë se 80 vota, ndërkaq kryeministri me 62 vota dhe realisht është komplet e pandershme të thuhet se kryeministri përfaqëson 10 vota.

Po e shoh nga ana e ime e majtë, zoti Selimi po më përcjell në vazhdimësi. Nuk arrita që t'i jap një përgjigje më herët. Deklaroi se Hashim Thaçin po e mbrojnë jo PDK, por Aleanca dhe NISMA! Realisht, ne nuk e kemi parë problem, Rexhë, nëse shëf i delegacionit të Kosovës në bisedime është Hashim Thaçi ose dikush tjetër. Por, unë nuk e kam kuptuar asnjëherë çfarë ju keni personalisht kundër Hashim Thaçit?! Apo ndoshta dikush nga PDK-ja, mbase kolegu Xhelili mund të na japë ndonjë sqarim. Faleminderit!

KRYESUESI: Ti i përmende dhjetë emra. Ti a po e merr fjalën për të diskutuar apo po bën pyetje për deputetë? Tash të gjithë duan replikë, veç ia more, atij, Milaimit, zanatin! A deshi kush... Samiu ka replikë, edhe Rexha pastaj.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e pranoj të drejtën e replikës. Në të vërtetë, është edhe detyrë dhe obligim, e drejtë e deputetit, natyrisht që të kundërshtojë përmbajtjen.

Po, jo me emra domethënë vetëm të hedhë poshtë, sipas asaj mendësisë jakobine; mua nuk po më pëlqen, është çështja e grahu personave me emra. Jo bre, nuk është çështje personash. Askush personalisht, e as unë nuk kundër askujt personalisht, nuk kam asgjë.

Këtu kemi të bëjmë me çështje publike. Ne po deklarojmë edhe po i përsërisim ato që i kanë deklaruar udhëheqësit, e unë deklarova për kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Haradinaj. Edhe unë kërkoj nga zoti Haradinaj edhe nga çdokush që merr një obligim kushtetues e ligjor që t'i shkojë deri në fund obligimeve të veta. T'i respektojë ato edhe t'i zbatojë ato.

Ai që deklaron se nuk jam në gjendje, nuk jam i informuar, nuk mundem, nuk di, nuk duhet të rrijë në atë post. Kjo është shumë punë e thjeshtë! Prandaj, ne e kemi atë mundësi të deklarohe mi. Edhe të lihet, domethënë ne jemi duke biseduar për dialogun. Unë e trajtova çështjen e 'Zajednicës', e 'Zajednica' është a-ja, b-ja dhe zeti i dialogut. Domethënë është shteti serb në shtetin e Kosovës, përkundër të cilit, në çdo kohë me të gjitha mjetet edhe si opozitar edhe në kushte të tjera ka qenë zoti Haradinaj.

Edhe nëse nuk e ka ndërruar pozitën e vet, atëherë unë pres që ai ta marrë udhëheqjen këtu edhe ta kundërshtojë 'Zajednicën' serbe, por jo të deklarojë se nuk mund ta ndryshojë ekipin menaxhues që e ka shkruar statutin kundërkushtetues.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nitaj ka kundër-replikë.

MUHARREM NITAJ: Sa për sqarim. Nuk është e vërtetë që kryeministri Ramush Haradinaj ka deklaruar ose i është përgjigjur zotit Hoti: 'S'po kam çfarë të bëj se më kanë ardhur disa të fortë'. E ka deklarua edhe publikisht, dhe unë besoj që edhe zoti Kurteshi e ka dëgjuar. Kryeministri Haradinaj ka deklaruar se 'Zajednicën' e kam gjetur dhe ma keni gatuar ju, duke menduar këtu në Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Kështu që unë i apeloj edhe kolegut Kurteshi që të jemi të saktë në formulimet që themi, dhe të mos shkaktojmë një lloj hutie duke keqinterpretuar deklaratat e të tjerëve.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selimi ka replikë.

REXHEP SELIMI: Faleminderit!

Kërkoj atëherë...Sami, veç pak! Në fakt, bëri një pyetje zoti Nitaj, që mua më duhet të mendoj shumë që t'ia kthej një përgjigje gjeniale, në përputhje me pyetjen e tij. Por nuk kam ndonjë arsye personale në kundërshtimin tonë me Thaçin, dhe kjo pyetje po më duket banale. Unë ta kisha dhënë përgjigjen nëse ju më ishit përgjigjur: A keni pra ju ndonjë arsye personale në mbështetje të Thaçit në këtë dialog? Pra, kur bëhet pyetje, a keni diçka kundër tij personalisht? Unë them jo, kurrëgjë personalisht nuk kam, sepse po të kisha pasur personalisht, ndoshta do ta kisha zgjidhur personalisht.

Unë nuk kam problem me Thaçin! Kosova ka problem me Thaçin! E tash, pjesë e këtij problemi jeni bërë edhe ju. Edhe një gjë ta keni parasysh; është fakt që sot gjatë gjithë kësaj seance, madje as vetë deputetët e PDK-së nuk e kanë mbrojtur Thaçin sa ju dhe NISMA. Dhe këtë pyetje po ua kthej juve tani. Ku e gjetët inspirimin dhe motivin, që ju jeni kundërshtarët e djeshëm që ju kanë nxjerrë jashtë për t'ua zgjedhur deputetë në mandatin e kaluar?! Tani jeni bërë, thjesht, patericë e tij. I keni shkuar prapa, e kuptoj, por mos na ftoni edhe neve t'i shkojmë prapa atij. Pra, mos na ftoni edhe neve ta bëjmë gabimin që e keni bërë ju.

KRYESUESI: Zoti Nitaj ka kundër-replikë!

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar.

Po pres që të qetësohet salla pak. Zoti Selimi, koleg Selimi nuk e kemi asnjë arsye të vetme t'i shkojmë Hashim Thaçit prapa. Kryeministri i vendit deklaroi këtu, tha vendoseni, merreni në dorë, Parlamenti i Kosovës dhe me votë përcaktojeni kë dhe kur!

Realisht ne jemi pak më praktikë sesa ju. Nëse ju do të mund ta caktoni, për shembull, një njeri që do t'i drejtojë bisedimet me Serbinë me 2/3 e votave në Parlamentin e Kosovës, ia pafshi hajrin. Kam përshtypjen se nuk mund ta bëni as ju, po duket se s'po mund ta bëjë as shumica parlamentare. Prandaj deklarova më parë, grupet politike në këtë Kuvend nuk po i japin as pesë para për fatin e këtij vendi.

KRYESUESI: Faleminderit! Ismet Beqiri ka replikë me Nitajn. Në emër të grupit parlamentar. Edhe Zafiri në emër të NISMA-s.

ISMET BEQIRI: Faleminderit! Zoti nënkryetar. A ka mundësi t'i them vetëm dy-tri fjalë, sepse qëndrimi i Lidhjes Demokratike dhe i grupit është i qartë për dialogun dhe eventualisht për atë çfarë është propozuar këtu. Është qëndrim i njohur publik. Sot, këtu mund të ketë përsëritje të shqetësimeve të natyrave dhe këndeve të ndryshme. Përndryshe, qëndrimin e LDK-së është shumë e qartë që nuk mund ta ndryshojë askush, dhe këtë po ju tregoj që tash dhe besoj që e keni kuptuar gjatë gjithë dialogut ose debatit që është bërë.

Ajo që desha të them është që; së pari nuk është mirë të manipulohet Asociacioni, nuk e ka krijuar LDK-ja dhe kjo është një e pavërtetë. Dhe mbi të gjitha është fat që është pranuar edhe nga të tjerët që atje është një pikë e veçantë ku thuhet: 'Po qe se ka edhe gabime në marrëveshje, është Gjykata Kushtetuese e cila do ta bëjë përmirësimin'.

Është fat dhe është shumë për vendin që ekziston ky formulim, përndryshe edhe do të kishte pasur mundësi ndoshta të ketë edhe ndonjë gabim. Ndërkaq, sa i përket qeverisjes, sa i përket dialogut, unë nuk di pse do duhej të shqetësoheni dhe t'i kërkonit votat e LDK-së! Po thoni i kemi votat edhe për qeverisje edhe për dialog, le të vazhdojnë janë institucione që i kanë, aq sa i kanë

vota dhe për ne nuk është problem le të vazhdojnë. Por, mos të llogarisin në Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Në mos asgjë, edhe nëse ndonjëherë kemi bërë për qëllim të mirë ndonjë gabim, po ju siguroj që nuk do t'i përsërisim më. Kjo është me rëndësi.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nitaj a e deshe fjalën?

MUHARREM NITAJ: I nderuar koleg Beqiri. Unë kam përcjellë moralin politik në Kuvendin e Kosovës, duke mos qenë pjesë e Kuvendit të Kosovës. Ju kam dëgjuar juve publikisht të deklaroni se kurrë nuk do të shkoni në koalicion me Hashim Thaçin dhe vetë më pastaj keni shkuar. Ndërkaq, për Asociacion jua kujtoj se Asociacionin në Gjykatën Kushtetuese e ka dërguar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës së bashku me Vetëvendosjen, në të kundërtën kjo çështje do të ishte e kryer sot.

Prandaj, po them edhe një herë që të jemi të saktë dhe të mos abuzojmë me deklaratat publike.

KRYESUESI: Faleminderit! Ismet edhe për ty vlen sikur për Samiun! E ke kryer. E ke kryer. Zafir Berisha e ka fjalën për replikë, edhe ia me Rexhën. Rexha nuk është këtu.

ZAFIR BERISHA: Mua po më vjen keq, po, unë sa po e kuptoj është keqkuptuar qëndrimi zyrtar i Nismës, paraqitur edhe nga deputetët dhe nga kryetari i Nismës. Unë nuk po besoj që Rexha është aq i pamundur sa të mos i kuptojë, por fatkeqësisht ai po paraqitet sikur nuk po i kupton! Edhe Rexha e di mirë që ne nuk bëhemi patericë e askujt. Por, qëndrimi këmbëngulës i Rexhës për të mos pasur unitet, befasisht po koincidon me përfaqësuesin ose zëdhënësin e Hashim Thaçit në Kuvend që foli më herët, ministrin e Drejtësisë. Pra, ai ishte shumë i interesuar që të mos arrihet një konsensus mes forcave politike që po koincidon me qëndrimin e Rexhës.

Prandaj, të nderuar kolegë, unë kam shpresuar që ky debat do të na shërbejë për unifikim të qëndrimeve karshi një furtune që e ka shteti i Kosovës. Përndryshe, përfundimi i debatit siç po shihet, domethënë më shumë do të jetë debat koti edhe fjalë boshe vetëm për t'u bërë lajm në portale, po jo ai që është synim po edhe përgjegjësi jona. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Jo, jo unë fjalën ta jap, por për replikë jo! Se ti nuk ke diskutuar. Rexha nuk është! Në rregull, përfundoi edhe kjo puna e replikave. Fjalën e ka sipas rendit Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, nënkryetar, e respektove si parti më e madhja në Kuvend mundësinë të ma japësh fjalën. Faleminderit!

Me të vërtetë është interesante që, e tha një koleg këtu që nuk ka qenë në Kuvend, por ne i kemi përcjellë edhe ata që nuk kanë qenë në Kuvend çfarë kanë thënë!

Dhe, është mirë kur flasim për moral politik. Është e pabesueshme domethënë se çfarë metamorfoze kanë tash të njëjtit njerëz, ndërkaq mundohen me na mbajt neve ders, thuhet.

Kështu, sa i përket qëndrimit, ne e kemi thënë edhe më herët dhe unë nuk dua të kthehem. Veç një gjë po ju siguroj, nga ajo që LDK-ja ka synim, sigurisht që jo vetëm individi, por edhe subjekti në rrugëtim mund të ketë lëshime. Po e përsëris edhe një herë, nuk do t'jua japim më mundësinë dhe kënaqësinë që ne të bëjmë gabim ose të bëjmë lëshime, pavarësisht që edhe atëherë kur i kemi zgjedhur këta që sot, shumë prej tyre janë të zëshëm ose kanë qenë më mirë të thuhet të zëshëm kundër bartësve të institucioneve, edhe këtu e dëgjova më herët edhe një gjë, nuk e ka zgjedhur LDK-ja në këtë mandat kryetarin e Kuvendit, por nuk isha këtu ta them.

Këtë mandat dihet kush e ka zgjedhur kryetarin e Kuvendit, sepse i bën bashkë me presidentin. Thashë edhe një herë, nëse kemi gabuar, kemi bërë lëshim me qëllimin më të mirë, po ju siguroj që më nuk bëjmë lëshime të tilla, sepse po e shohim që janë në dëm të vendit. Dialogun asnjëherë nuk e kemi kontestuar si subjekt politik, fundi i fundit, programi dhe filozofia politike e LDK-së bazohet në dialogim, në zgjidhje të problemeve me marrëveshje, por kjo nuk nënkupton që ky dialogim duhet të bëhet nga kushdo qoftë, kurdo qoftë dhe për çkado qoftë.

Këtu tash dallojmë nga disa që, po mendoj, unë nuk e di cili është ose cila është arsyeja e këtij turravrapit. Për t'i bërë dëm Kosovës, mundemi kur të duam! Dhe nuk e di pse kjo nguti për këtë dialog, pse kjo zjarrmi që gjithsesi të shkojmë. Më shumë i ngutet Serbisë, mos u bëni merak, këtu jemi, do të dialogojmë edhe pas zgjedhjeve që do t'i fitojmë kurdo që të mbahen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ilmi Reçica.

ILMI REÇICA: I nderuar zoti nënkryetar i Kuvendit

Kolegë të nderuar deputetë,

Qytetarë të nderuar,

Mendoj që jo vetëm në këtë seancë gjatë këtij debati parlamentar për bisedimet, po edhe më herët me diskutimet tona, me fjalët tona, me qëndrimet tona, nganjëherë edhe me shpifjet tona nuk jemi duke i bërë mirë as Qeverisë së Kosovës, as ekipit që do ta udhëheqë dialogun, po nuk jemi duke i bërë mirë as Kosovës!

Unë po mendoj dhe jam shumë sigurt që jemi duke e dobësuar pozitën negociatore të Kosovës. Ndoshta dikush edhe e ka qëllim, gjë që nuk kisha dashur ta besoj, ndoshta dikush e ka nga brengosja, ndoshta dikujt në frikë i zmadhohen sytë, sheh pak më shumë sesa që duhet parë, po

realisht ne duhet të dëshmojmë që ky Parlament së paku duhet të jetë unik në qëndrimet e veta. Nuk mund të bisedojmë për finalizimin e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë pa e pasur parasysh historinë.

Dhe historia thotë kështu; të gjithë e dimë, Serbia (përjashtim dy luftërave botërore) 87 vjet e ka mbajtur Kosovën të okupuar.

87 vjet ka vrarë, ka prerë, ka grirë, ka bërë gjithçka çfarë ka mundur mbi qytetarët tanë. Dhe mendoj do të duhej të gjithë të mburremi që kemi ardhur në një situatë që të dialogojmë me një shtet duke qenë shtet. Dhe në kuadër të kësaj me qëndrimet tona, me propozimet tona, me idetë tona, duhet ta forcojmë edhe vetën edhe këtë Kuvend, po edhe delegacionin që do t'i udhëheqë bisedimet. Gjatë atyre 87 vjetëve okupim nga më të vrazhdit e më të egrit, ka pasur një Lëvizje kombëtare për çlirim të Kosovës. Ka pasur një Lëvizje paqësore për çlirim dhe pavarësi të Kosovës. Ka pasur një Ushtri Çlirimtare të Kosovës që ka arritur që së bashku me të gjitha kategoritë e mëhershme ta bëjë të lirë këtë vend dhe pastaj të gjithë qytetarët e këtij vendi ta shpallin pavarësinë e këtij vendi. Dhe në kuadër të kësaj, besoj që të gjithë kemi aksione, edhe ata që kanë qenë në vijën e parë të frontit, edhe ata që kanë mbështetur, po edhe ata të cilët në forma të ndryshme e kanë ndihmuar këtë proces.

Dhe nuk duhet as t'i lejojmë, po as t'ia ngarkojmë një individit ose një grupacioni ose një partie krejt këtë proces. Mendoj që duhet të jemi shumë të përgjegjshëm dhe shumë të ndërgjegjshëm. I gjithë diskutimi çfarë bëhet këtu. Bëhet për ta atakuar një njeri! Është i shantazhuar, e ka këtë e ka atë. Pozicioni dhe pozita e presidentit të shtetit është pozitë kushtetuese. Gara bëhet gjersa të përfundojë ajo çfarë është garë, pas garës nuk mund të ketë garë. Vetëm te ne ka ashtu. Gara do të duhej të zhvillohej më herët, kur është koha për garë, kur dihet fituesi, ka përfunduar gara.

Kemi kaluar nëpër një proces legal. Është dëshmuar që shpallja e pavarësisë së Kosovës ka legjitimitet dhe legalitet ndërkombëtar. Dhe aty e ka parë Serbia që e ka humbur betejën. Dhe pikërisht pas asaj ka rrjedhë një rezolutë e Këshillit të Sigurimit që ka kërkuar nga Kosova dhe nga Serbia t'i normalizojnë raportet dhe marrëdhëniet. Dhe në kuadër të kësaj është caktuar si lehtësues Bashkimi Evropian. Për shkak se të gjitha vendet e Ballkanit, përfshirë edhe Kosovën dhe Serbinë, janë të interesuara, punojnë angazhohen që të jenë pjesë integruese e Bashkimit Evropian.

Këto janë rregulla, janë të përcaktuara qartë, dhe në kuadër të kësaj ata e kanë shumë të qartë se si duhet udhëhequr procesi. Ne çfarë po bëjmë?! Ne në vend se ta forcojmë pozitën e këtij Kuvendi, në vend që t'ia japim rëndësinë këtij Kuvendi, dhe mos harroni legjislaturën e kaluar, unë kam qenë kryetar i Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme së bashku me KDI. Nëpërmjet debateve të ndryshme, tryezave të ndryshme, në Mitrovicë dhe brendësi të Kosovës

dhe kudo qoftë, kemi arritur ta sensibilizojmë opinionin, qytetarët, institucionet dhe këtë Kuvend që të marrë përgjegjësi. Të jetë strumbullari i dialogut me Serbinë.

Kuvendi duhet të jetë ai që duhet ta përcaktojë, ta krijojë, ta ndërtojë dhe ta përcjellë zbatueshmërinë e një platforme, që do të jetë obligative për të gjithë. Për të gjitha institucionet, cilat do qofshin ato. Dhe në kuadër të kësaj mendoj që ne mund të merremi vesh shumë lehtë. Tri-katër çështje, ta ruajmë sovranitetin dhe integritetin e Kosovës. Të marrim qëndrim të qartë që nuk ka shkëmbim as ndarje të Kosovës. Që nuk ka organizim të ndryshëm jashtë asaj që është përcaktuar me Kushtetë, organizim të brendshëm të Republikës së Kosovës. Dhe në kuadër të kësaj, ne duhet të kërkojmë që delegacioni që do të shkojë në bisedime në Bruksel t'i raportojë këtij Kuvendi. Dhe domosdo, sigurt se secila marrëveshje ndërkombëtare është obligative sikurse votimi i presidentit që të bëhet me 2/3 e votave.

Dhe, nuk është kjo çështje e koalicioni pavarësisht numrave, por është çështje e krejt këtij Parlamenti që përfaqëson qytetarët e këtij vendi.

Ka shumëçka që ne mund të flasim dhe të diskutojmë. Është fatmirësi që e kemi një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese dhe nuk mundet asnjë institucion, asnjë bartës i një institucioni të kalojë përmbi atë aktgjykim, ta shkelë atë aktgjykim.

Se ne kemi situata të ndryshme, çfarë kanë ndodhur me presidentët që e kanë shkelur Kushtetutën! Kanë shkuar në shtëpi. Dhe kjo duhet të ndodhë me secilin bartës të institucioneve, dhe kjo është një lehtësim. Po, duhet ta kemi parasysh që në pjesët e tjera të marrëveshjeve të nënshkruara, Gjykata Kushtetuese nuk i ka atakuar ato vendime. Të mos i fokusojmë disa aktgjykime dhe aktvendime, të themi këto janë në rregull, ndërsa këto të tjerat nuk bëjnë.

Gjykata Kushtetuese të gjitha ato vendime që i ka marrë, duhet të jenë të zbatueshme këtu. Dhe për fund. Unë flas që, edhe thërras, që vërtet ne ta marrim seriozisht këtë çështje. Të mos diskutojmë kush do t'i prijë këtij procesi. Ne ta ndërtojmë një platformë ta bëjmë një ekip që do ta krijojë ajo platformë dhe do t'i tregojë saktësisht se çfarë duhet të veprojë delegacioni i Kosovës atje. Mos të nxjerrim vija se ndoshta dikush është edhe daltonist e s'i vëren a janë të kuqe apo janë të ndryshme. Se ka shumë këtu që kemi daltonistë politikë, i nderuar zoti nënkryetar!

Dhe pikërisht për këtë po them që ne duhet të jemi të qartë, çka është obligim dhe detyrim i këtij Parlamenti dhe i të gjithë neve?! Dhe po flitet për shantazhe për gjithçka tjetër.

Ju kisha bërë ftesë! Denoncues janë ata që e kanë parë dhe kanë dëgjuar diçka që ka ndodhur. Por, disa shpifësve denoncues, ju kisha bërë ftesë që të heqin dorë nga shpifjet, se ato shpifje

pastaj i bëjnë denoncime. Atë që e kanë parë dhe e kanë dëgjuar me vesh të tyre, ta dëshmojnë kurdo qoftë, po jo duke shpifur, pastaj atë shpifje ta bëjnë denoncim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Arbërie Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë!

I gjithë ky debat, jo vetëm sot, por gjatë gjithë këtyre ditëve e vërteton atë që Lëvizja Vetëvendosje ka kohë që e ka thënë. Kjo qeveri nuk ka as të drejtën e as legjitimitetin të flasë për këtë çështje, dhe më e mira e vendit do të ishte dorëheqja e kësaj Qeverie, e bashkë me të edhe e presidentit, të cilit kryeministri me lehtësi po i jep të drejtën të vazhdojë bisedimet ndonëse ai ishte personi kryesor që gjatë procesit të deritanishëm të bisedimeve e defaktorizoi Kosovën, duke e bërë sovranitetin dhe integritetin e saj të negociueshëm. Sot kryeministri Haradinaj ndër të tjera tha se po e citoj: ‘Na e ka zënë rrugën mosbesimi i njëri-tjetrit’. Është e natyrshme kur dihet se besimi do të duhej fituar në bazë të raporteve të mirëndërturam, në bazë të raporteve të cilat nuk janë bazuar në tradhti të mëparshme, andaj nuk duhet harruar se prej kur Qeveria Thaçi hyri në negociata me dialogun, ka shumë tema të cilat kanë qenë të rëndësishme për vendin dhe nuk janë trajtuar asnjëherë. U përmend edhe nga kolegët e tjerë më herët se çështja e të pagjeturve nuk është shtruar asnjëherë si çështje për t’u zgjidhur. Në vend të trysnisë dhe sanksioneve ndërkombëtare për Serbinë që t’i kthejë të pagjeturit, Hashim Thaçi deklaroi se Kosovën e presin kompromise të vështira. Kush ia dha të drejtën dhe legjitimitetin këtij njeriu që të shkelë mbi dhimbjen dhe jetërat e atyre që u vranë, u dhunuan dhe u zhdukën?

Dështimi i institucioneve tona që të adresojë në mënyrën e duhur çështjen e të pagjeturve, është jo vetëm dështim që, edhe 19 vjet pas luftës kanë karshi 1652 familjeve, që çdo ditë përballen me ankthin dhe dhimbjen për më të dashurit e tyre, por edhe dështim ndaj detyrës, ndaj përgjegjësisë, ndaj vendit, të kaluarës dhe të ardhmes. Kur tërë Kosova u përfshi nga flakët, u vra dhe u masakrua, një prej qyteteve që pësoi më së shumti në aspektin humanitar, ashtu edhe në atë material, ishte qyteti im i lindjes, Gjakova, ku e mbijetova luftën me gjithë familjen time. Sipas të dhënave të Fondit për të Drejtën Humanitare, Gjakova është qyteti që ka pasur më së shumti humbje në njerëz, 1022 civilë shqiptarë dhe 361 ushtarë të UÇK-së janë vrarë gjatë luftës së fundit në qytetin e Gjakovës. Janë familje të tëra në Gjakovë dhe gjithandej në Kosovë që akoma nuk dinë për fatin e më të dashurve të tyre dhe Hashim Thaçi del e flet për kompromise të dhimbshme, në vend se të kërkohet në radhë të parë drejtësi për të gjitha viktimat civile të luftës, për secilin qytetar të Republikës së Kosovës.

Kush nuk e njeh sot në Kosovë nënën Ferdonije, këtë grua që humbi gjithë familjen e saj? Kush nuk e njeh e di dhimbjen e betejat e nënave, grave gjakovare për humbjen e familjarëve të tyre dhe dhimbjen dhe mosinformimin, ndonëse ato kanë sot një kërkesë të vetme: të dinë se ku janë

më të dashurit e tyre. Qytetarë të Gjakovës dhe gjithandej në Kosovë u vranë dhe e u ekzekutuan, u dogjën të gjallë në shtëpitë e tyre. Nuk kaloi natë gjatë luftës së fundit që të mos shihen shtëpi nën tym e flakë në komunën e Gjakovës. 21 martirë gra e fëmijë u ekzekutuan vetëm në familjen Vesa në natën e 2 prillit të vitit 1999. Në këtë natë u prenë mes jeta e Ritës, që akoma nuk i kishte mbudhur dy vjet, jeta e Dalinës që atë natë do të mbushte dy vjet, u vra Marigona, Sihana, Arlindi, Delvina, të gjithë fëmijë që akoma s'kishin mbushur moshën 10-vjeçare.

Dren Cakaj, i mbijetuar i vetëm në këtë masakër, 10-vjeçar në atë kohë, kujton se kur u largua nga shtëpia të cilës paramilitarët serbë i kishin vënë flakën, pasi ekzekutuan të gjithë të pranishmit, motra e tij më e vogël ishte akoma gjallë dhe kërkonte ndihmë, por Dreni nuk mund ta ndihmonte dot. Ai ishte një fëmijë 10-vjeçar edhe vetë i plagosur dhe po e shihte me sy tmerrin në shtëpinë e tij. Familja Querkezi, Vesa, Sharai, Danaj janë vetëm disa nga shumë familjet në Kosovë, që përjetuan tmerrin më të rënda të luftës së viteve 1998-'99. Në Mejë Gjakovës u ekzekutuan të gjithë meshkujt nga 15 deri në 60 vjeç, 377 meshkuj shqiptarë. Nuk mund t'i përmend të gjitha rastet e krimeve në Gjakovë, sepse janë shumë. Familjet që panë tmerrin me sy, familje të cilave, paramilitarët serbë u hynë në shtëpi, duke i ekzekutuar para syve të familjarëve të tyre dhe sikur në Gjakovë masakra të civilëve kanë ndodhur gjithandej në Kosovë, qytetarë civilë, vajza, djem, gra e burra akoma të pagjetur. Jo vetëm që kjo temë nuk ishte në tryezën e bisedimeve, apo ashtu siç do të duhej të ishte parakushti kryesor për çdo marrëveshje dypalëshe me Serbinë, Thaçi sot vetëdelegohet për të vazhduar dialogun. Merr kompetenca për të vazhduar dialogun dhe na flet për normalizim, ndërsa Haradinaj deklaroi se s'ka kohë të merret me këtë proces. Serbisë duhet t'i përsëritet çdo ditë e çdo herë e vërteta se ata kanë kryer krime, kanë vrarë civilë, foshnja e pleq, se kanë bërë gjenocid.

Kjo duhet të jetë para çdo bisede për çështje të tjera. Ata do të duhej të mbanin përgjegjësi për veprimet e tyre, duhet të dënojnë krimet dhe duhet të dënojnë kriminelët. Krimi do të duhej të ndëshkohej e vetëm pastaj të vazhdonin bisedimet. Përveç kësaj çështje që shkel të drejtat bazike të njeriut, nuk duhet të harrojmë se secila marrëveshje që trumbetohej se është arritur, nuk është respektuar. Unë do të përmend vetëm dy marrëveshje që kanë të bëjnë me çështjen e arsimit e që janë shumë të rëndësishme, çështja e kurrikulave serbe dhe atë të njohjes së diplomave. Akoma edhe sot fëmijët serbë në shkollat e Kosovës, e që nuk janë pak, por rreth 140 shkolla, mësojnë se Kosova është krahinë autonome e Serbisë dhe se shqiptarët janë terroristë e armiq të Serbisë. Kurrikula me të cilën mësojnë fëmijët serbë në Kosovë hartohet në Serbi. Tekstet mësimore, sidomos ato të historisë e gjeografisë vijnë nga Serbia dhe kanë një gjuhë që nxitin urrejtje ndëretnike dhe janë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës.

Në shtator të vitit 2009 Qeveria e Kosovës kishte themeluar një komision për rishikimin e kurrikulave të Kosovës dhe tekstin e përdorimit të kurrikulave serbe dhe teksteve shkollore serbe për përdorim në territorin e Kosovës, për t'u siguruar se ato janë në përputhje me Kushtetutën tonë dhe me Kornizën e Kurrikulumit të Kosovës. Edhe ky komision kishte gjetur se librat e

shkencave shoqërore, historisë dhe gjeografisë në gjuhën serbe kanë gjuhë të urrejtjes dhe se flitet se Kosova është pjesë e Serbisë, por pse për këtë nuk është ndërmarrë asgjë, sipas ministrit të atëhershëm të arsimit, zoti Arsim Bajrami, kjo ishte çështje politike. Akoma edhe sot gjendja mbetet e njëjtë. Republika e Serbisë nuk pranon të dërgojë planprogramet për miratim në Ministrinë e Arsimit të Republikës së Kosovës dhe institucionet arsimore serbe janë jashtë kontrollit të Ministrisë së Arsimit. Si mund të dialogohet tutje me qeverinë e një vendi, me presidentin e një shteti që mbjell urrejtje të fëmijët dhe të rinjtë e Republikës së Kosovës.

Po ashtu në dialogun teknik janë arritur edhe dy marrëveshje sa i përket njohjes së diplomave, njëra e nënshkruar në vitin 2014 dhe tjetra në vitin 2016. Por, ende nuk ka njohje të diplomave universitare të Republikës së Kosovës në Serbi dhe janë qindra të diplomuar në universitete të Kosovës që presin njohje të diplomave të tyre nga Serbia, duke vështirësuar kështu jetesën e tyre, duke pamundësuar punësimin e tyre dhe detyrimin e shumë të rinjve për t'u larguar nga kjo zonë. Prandaj, ne duhet të insistojmë në zbatimin e kërkesave legjitime ndaj Serbisë dhe Kosova nuk duhet të ketë një president pa integritet që është thjeshtë një informator i Vuçiqit dhe Medvedevit të Rusisë dhe vetëm pas plotësimit të këtyre kërkesave ne mund të punojmë në platformën për zhvillimin e dialogut, por pa harruar se platforma duhet t'i përjashtojë të gjithë individët që kanë dëshmuar se interesat personale i kanë mbi ato të vendit. Uniteti nuk mund të arrihet me njerëz joparimorë dhe është e qartë se jo të gjithë janë persona parimorë. Prandaj Lëvizja Vetëvendosje s'mundet dhe nuk do të jetë pjesë e një ekipi unifikues që ka në mesin e vet individë që nuk mbajnë parime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Kryesues, fjalën e kam kërkuar më herët, por nuk ka dert. Sido që të jetë, po i ndan dikujt po, dikujt jo, pa të drejtë dhe pajtohem plotësisht me zotin Kurteshi pse nuk ia dhe fjalën dhe shpresoj në të ardhmen.

Sidoqoftë, ne e mbajmë mend në kujtesë G 7-tën kur thoshte s'ka ndarje dhe s'ka bashkim. Para se të vihet te pavarësia e Kosovës dhe unë mendoj edhe i kisha ftuar edhe sot që brenda kësaj rezolute që kushti i parë le të jetë që territori i Kosovës mos të guxojë të jetë në tavolinë, tema e diskutimit rreth ndarjes. Tjetrën që e kemi shumë me rëndësi dhe që të gjithë e dimë është 'Zajednica' ose Asociacioni, dikush po thotë kemi përgjegjësi apo s'kemi përgjegjësi, pa ia bërë askujt me gisht, ne të gjithë e dimë se kush ka qenë në qeveri, si ka ardhur deri te ajo marrëveshje, çka ka thënë Gjykata Kushtetuese dhe këtu ishte dashur të jetë pjesë e kësaj rezolute po ashtu që të ishte decidivisht që ky Asociacion të jetë në harmoni me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, ose edhe me ligjet e Kosovës.

Sa i përket se kush e kryeson dialogun, ne prej mëngjesit jemi duke kërkuar këtu që të kemi një dakordim të përbashkët dhe ta japim kontributin tonë si deputetë se çfarë formati do të jetë

dialogu, kush do ta përfaqësojë, grupet parlamentare janë këtu dhe askush nuk po i ndalë që të kenë përfaqësues. E thamë se kjo të konsiderohet si hapje e dialogut të brendshëm për përfaqësimin e Kosovës në Bruksel, dhe po shihet shqetësimi i të gjithë neve që jemi prezent këtu dhe të gjithë qytetarëve është se cili do të jetë epilogu i asaj marrëveshjes finale që dikush po thotë ka vija të kuqe, dikush s'ka vija të kuqe, por ne të gjithë e dimë se çka mendon Serbia për ne e po ju them se edhe ne të gjithë mendojmë për të njëjtë, se po të mundemi deri në Nish shkojmë. Edhe për disa kolegë të mi patriotë, folkloristë që po flasin vetë, po ta kishim çliruar vetë dhe me ia qit çizmen në kufi me kohë, nuk e kishim pasur këtë temë në tavolinë, por është dashur t'ia lëmë të fuqishmëve për të na ndihmuar ta heqim atë qafirin Milosheviqin prej këtu.

Si rezultat i kësaj kemi pasur një rezolutë në Kosovë, kemi pasur bisedime në Vjenë, kemi pasur Pakon e Ahtisarit, si rezultat i asaj kemi pasur pavarësinë e mbikëqyrur, kemi pasur misione ndërkombëtare dhe si dhe si rezultat i asaj sot deri diku jemi vend me të drejtë besoj shumë shpejt deri diku edhe në liberalizim. Jemi vend që nuk kemi ushtri, që duhet të kemi shumë shpejt ushtrinë. Nuk e di kush e tha më herët se ka pasur bisedime në Bruksel rreth kësaj teme. Ne kemi qenë mandatin e kaluar në opozitë dhe me shumë ministra të ish-qeverisë kemi diskutuar se çka nuk duhet të bëhet në Bruksel dhe i kisha lutur sidomos disa miq të mi që të mos i japin vetes të drejtë që të fyejnë kolegët e vet, sidomos disa që e kemi provuar njëri-tjetrin mirë dhe njihemi mirë, sepse kush më shumë e kush më pak secili ia kemi dhënë një grimë hak këtij vendi. Nuk besoj se ka vullnet qytetar, as në institucione, as në pozitë, as në opozitë, që ne të dalim humbës në Bruksel, por nëse shkojmë pikë e pesë atëherë iu krijojmë favor institucioneve serbe mbi Kosovën. Për këtë arsye i kuptoj miqtë e mi të cilët po na kritikojnë sot pse jemi rreshtuar pas Thaçit.

Ne jemi sot, le të shkojnë ata nesër, para neve kanë qenë, nuk ua harxhojmë, aty ua lëmë, s'ka problem hiç. Kanë përvoja të mira edhe të hidhura mes vete, por mos t'ia akuzojnë kolegët e vet se në fund të ditës, në politikë jemi, marrëveshja ka qenë publike, të gjithë e kemi ditur, koalicion parazgjedhor e mos të fyejmë shumë se për besë nganjëherë edhe po e humb kuptimin. Ndërsa rreth disa poezive emocionale që i dëgjova, unë nuk di, por ju e dini se ende Gjermania dënon qytetarë të vet për krime të shkaktuara kundër hebrenjve, akoma paguan borxhe për Izraelin për ato krime të Luftës së Dytë. Nëse dikush mundohet të na shesë patriotizëm se si i kemi harruar dhe se si po i harrojmë, gabim e kanë dhe e dinë shumë mirë se gjaku nuk falet. Edhe politika, shkon sot njëri, vjen tjetri, por krimet që janë shkaktuar, do të përgjigjen herët a vonë kushdo që i ka shkaktuar. Faleminderit shumë.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Driton Selmanaj e ka fjalën.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit shumë!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar njerëz të mirë të këtij vendi!

Në fakt, ka 18 vjet që unë e shoh se energjitë më të mëdha i shpenzojmë në dialog të brendshëm me njëri-tjetrin, sesa në konsolidim të kapaciteteve tona në raport me të tjerët. Ngjashëm na ka ndodhur edhe me Malin e Zi për çështjen e demarkacionit. Humbëm shumë vjet dhe në fund erdhëm aty ku duhej të ishim në fillim dhe sot pak a shumë po ngjan njësoj dhe ne po merremi me njëri-tjetrin, akoma nuk po shohim asnjë mundësi të mirë për t'i dhënë një epilog të mirë në raport me fqinjin tonë verior. Pse po vjen kjo? Unë mendoj se janë tri arsye. E para, ata që i kanë kompetencat po ikin prej kompetencave të tyre. Kryeministri në mëngjes kishte marrë disa letra dhe të gjitha letrat që provonte t'i lexojë, në fakt ishin në kundërshtim me atë që thoshte ai. Në fakt, nuk ka pasur proces teknik të bisedimeve tona me Republikën e Serbisë, i gjithë procesi ka qenë politik, që nga fillimi e deri në fund. Zoti Haradinaj duke provuar që të ikte vetë nëpër vrima, thoshte ju po ikni, a në fakt ai vetë është duke provuar të ikën nga temat e mëdha. Është një paradoks, ai që ka kompetencat, ai ikën nga kompetencat e veta, ai që nuk i ka kompetencat, ai merr, yrysh t'i marrë këto kompetenca, pra presidenti.

Tash normalisht që kjo neve na shkakton një situatë ku e kontestojmë legjitimitetin kushtetues. Na vjen keq, por veç dy ditë nëse e keni kryer Fakultetin Juridik, nëse keni juristë te miqtë e juaj apo në shtëpinë tuaj, nuk ka presidenti i vendit legjitimitet për të udhëhequr negociatat, harrojeni këtë!

I vetmi autoritet që i jep legjitimitet institucioneve të tjera është Kuvendi i Kosovës, nuk ka tjetër. Çdo qasje tjetër është naivitete, për të mos thënë se mund të shkojë deri në turpësi. Tjetra, ne po flasim për besimin dhe kjo është themelore. Ne nuk kemi besim te këta njerëz. Pse nuk kemi besim? Unë kurrë s'kisha menduar se kryeministri Haradinaj do të vijë koha të thotë se unë Radojqiçin e kam mik, kurrë s'kam mundur ta besoj se në zyrën e tij një person që ka dhjetë precedente penale dhe ai ulet në krye të vendit dhe ai thotë se ai ishte nënkryetar i Listës serbe. Po ishte kryetari aty, pse nuk ulej kryetari aty në krye të vendit?

Nga ana tjetër e kemi një president që në vitin 1999, bashkë me kryetarin e Kuvendit shkon në Mitrovicë dhe u thotë njerëzve kështu: mos u mërzhiteni, se do t'ju kthejmë shpejt në banesat dhe shtëpitë tuaja. Por, çfarë ndodhi? Jo që nuk u kthyen, por u detyruan t'i shesin shtëpitë, Serbia i ka blerë shtëpitë e tyre. Ata nuk kanë mundur as të vizitojnë asnjëherë shtëpitë e tyre dhe në fund çka, e krijuam mundësinë të ndërtohet edhe një Luginë e Diellit atje me 300 shtëpi të kolonëve serbë, ku vijnë aty dhe e kolonizojnë thuajse atë pjesë dhe kjo ka ndodhur në prani të këtij procesi i cili ka qenë i fuqishëm në situata të ndryshme në Kosovë.

Tashti unë them se vetëm ata të cilët e kanë lansuar idenë e ndarjes së Kosovës, ata e kanë arritur qëllimin, sepse qëllimi i tyre ka qenë që të bëhet në diskursin publik kjo temë, çkado që arrihet më pak se ndarja ta shpallin si fitore të tyre. Në fakt, kjo ka për të qenë rreziku më i madh për Kosovën.

Pse nuk po i besojmë Kryeministrit e Presidentit? Unë mendoj se kjo është një doktrinë e njohur prej rusëve, prej sllavëve. Çfarë kanë bërë ata me Çeçeninë, për shembull? Njerëzit të cilët kanë qenë në luftë, i kanë vënë në pushtet, i kanë joshur me para, i kanë korruptuar, i kanë demoluar dhe çfarë, ka humbur besimi se mund të vdesë dikush për vendin e vet. Këtë situatë e keni sjellë në Kosovë, ku askush nuk iu beson dhe secili njeri në Kosovë, aq shumë u lodh dhe është demoluar saqë çfarëdo zgjidhje që ofron për Mitrovicën thotë veç hiqma qafe se jemi lodhur prej kësaj teme. Kjo ka qenë teoria e dikujt e konsoliduar mirë, sepse ka arritur të ndërtojë një sistem kleptokratik ku keni shkatërruar gjithçka, ia keni marrë besimin dhe shpresën dhe ata tani thonë bëni çka të doni se jemi lodhur nga kjo punë.

Kjo ka qenë ide që 18 vjet. Unë po jua kujtoj këtë, në vitin 1992, Dobrica Qosiq ka qenë kryetar i Akademisë së Shkencave të Serbisë. Në Këshillin e Sigurimit ka prezantuar dokumentin për ndarjen e Kosovës, por jo kështu, ka thënë 60 për qind t'i marrë Kosova, 40 për qind ata. Në vitin 2002 filloi të aktualizohet sërish nga një kryeministër i Serbisë, por për këtë punë u vra dhe tash vjen presidenti i vendit tonë me takime sekrete diku e diku dhe kemi informatë po shkon bashkë me zotin Vuçiq të llobojë te miqtë tanë sa është i mirë shkëmbimi i territoreve dhe ne tash po themi këtu kush ka luftuar dhe çka ka bërë? Por, ne jemi në një situatë më komplekse dhe më delikate që nga çlirimi jonë apo që nga ekzistenca jonë si shtet. Nuk mundemi ne tash, unë jam pjesë e atyre njerëzve që mendojnë se duhet të bëhet një revizion çka kemi bërë deri sot me këto marrëveshje politike dhe unë po ju them se prej 23 marrëveshjeve politike, qoftë edhe teknike që i kemi arritur me Serbinë, vetëm katër prej tyre janë zbatuar në plotëni. Këto janë të dhëna të cilat i bëjnë organizatat e pavarura monitoruese, të tjerat janë ose të pazbatueshme ose janë në proces, ose janë zhdukur diku.

Tashti po them rreziku më i madh është që ne klasa politike jemi kthyer te projektet e Serbisë. Këto janë projekte të importuara e që na del presidenti i vendit e na thotë po, shihni, duhet t'i bëjmë disa kompromise të dhimbshme, mund të jenë të rënda, ejani edhe ju atje t'ia qesim kulmin kësaj pune. Por nuk shkon kështu.

Unë po dua t'ju kujtoj diçka, disa zëdhënës të UÇK-së e mbaj mend shkruanin si kanë për ta çliruar Çamërinë, si kanë për ta çliruar madje edhe territorin e Malit të Zi e Maqedonisë dhe tash të njëjtit po na thonë se shkëmbimi i territoreve është zgjidhje. Por, a e harruat Çamërinë tani? Po, a po bëni humor me këtë vend ju a? Kur po i dëgjoj prej njerëzve të tillë që po thonë ide brilante, po kjo nuk është zgjidhje, por është trishtim vetëm ta dëgjosh, nuk është zgjidhje ndarja e Kosovës, as shkëmbimi i territoreve. Ne duhet të kujdesemi maksimalisht që shqiptarët e Maqedonisë, të Malit të Zi, të Preshevës, arbëreshët e Italisë, shqiptarët në Çamëri të gëzojnë të drejtat politike dhe civile. Ne duhet ta konsolidojmë shtetësinë tonë. Idetë e tilla, po na dalin sikur bashkëregjisorë të këtyre tematikave paska pasur brenda vetë neve.

Tash krejt në fund si i bie kjo punë? T'ia besosh të drejtën Hashim Thaçit, të drejtën për bisedime, është sikurse t'ia besosh hajnit kuletën. Por, mosni se kështu nuk shkon. Prandaj, unë duke i parë edhe deklaratat të cilat i thoshte do ta padisë Serbinë për gjenocid, nuk e bëri kurrë, do ta padisë Dick Marty-n për gënjeshtria, nuk e bëri kurrë. Duke i parë edhe shumicën e marrëveshjeve të arritura me Serbinë, të cilat shumica prej tyre po dalin të dëmshme, unë them se ky njeri nuk ka besim, ky person mund të jetë aksidentalisht apo me vetëdëshirë në agjenda të tjetërkujt, jo në interesa të shtetit të Kosovës.

Zgjidhja e vetme e kësaj situatë është kjo: meqenëse kjo Qeveri po ikën nga përgjegjësitë e veta, nuk ka as legjitimitet se nuk ka numra, të shkojmë në zgjedhje dhe kushdo që i fiton zgjedhjet, edhe LDK-ja nëse i fiton zgjedhjet, edhe nëse LDK-ja nuk i fiton zgjedhjet, le të marrë përgjegjësinë për t'i dalë në ballë të gjitha sfidave të cilat i ka ky vend, përfshirë të gjitha temat e edhe dialogun ku mund të jetë në ekip si aksesor edhe presidenti, pse jo, por jo si kryenegociator, sepse e kaluara e tij ka dëshmuar se ky vend më shumë ka pasur dëm sesa dobi dhe unë duke e parë sot sjelljen e presidentit tonë, duke lexuar dokumente për të cilat ose nuk i ka lexuar hiç, ose e kanë keqinformuar këshilltarët e tij, përpos presidentit që kanë filluar ta shohin si rrezik për vendin, kanë filluar ta shohin edhe mediokritetin e kësaj Qeverie si rrezik për vendin. Prandaj sa më herët që ta kuptoni edhe ju t'i jepni drejtim kësaj pune, do të ishte më e mira për vendin. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Selmanaj, sa për sqarim tëndin, asnjë komunikatë e UÇK-së në emër të Shtabit të Përgjithshëm, nuk ka kërkuar as çlirimin e Çamërisë, as çlirimin e Malit të Zi, as Maqedonisë. Ka pasur intervista, por komunikatë në emër të Shtabit që ka qenë i vetmi dokument legal për atë punë nuk ka pasur. Kështu që nuk është mirë të flasësh për çështje që nuk i di. I ke të botuara të gjitha komunikatat, kështu që... E kreu unë tash. Anë, zoti Selmani dëshiron kundër-replikë.

DRITON SELMANAJ: Shiko zoti Haliti. Nëse dëshironi t'i sjelli edhe video-incizimet, sepse aq me zell i zgjeronim edhe...

KRYESUESI: Secila komunikatë ka numrin e vet...

DRITON SELMANAJ: Veç një sekondë, mos ma merr kohën time...

KRYESUESI: Vetëm të sqaroj unë ty, incizimet janë diçka tjetër!

DRITON SELMANAJ: Jo, jo vetëm një sekondë!

Jakup Krasniqi e lexonte një komunikatë, dy persona i rrinin anash me armë në duar, komunikata ishte; 'që ne Ushtria Çlirimtare e Kosovës do të luftojmë deri në çlirimin e të gjitha trojeve

shqiptare deri sa t'i bashkojmë ato, përfshirë; trojet në Çamëri, trojet në Mal të Zi ta sjell edhe videokasetën'!

Madje, madje u lëshuan pas dy ditësh edhe pasaporta! Leje këtë temë se nuk del mirë. Lëre këtë temë!

KRYESUESI: Replikë, Rexha po dëshiron. Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Jo komunikatat, po betimi i ushtarit të UÇK-së e thotë ashtu.

Prandaj, nuk kam nevojë t'jua kujtoj juve, por ua kujtoj këtyre në mes dhe disa të tjerëve betim, jo komunikatat. E mendoj që betimi është përmbi komunikatë.

KRYESUESI: Zoti Haxhiu e ka fjalën për replikë.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Zoti Driton, shumëkush që deri sot të ka përcjellë në "CLICK", ka pasur ndonjëherë mundësi t'i shohë disa analiza, ndonjërit ndonjëherë nuk na i kanë pëlqyer, por ke bërë analiza.

Sot si deputet i shndërruar në kukuvajkë! Kukuvačkë, qyqe, duke vajtura çfarë ka ndodhur. Driton, nga ju pritet për ta dhënë ndonjë ide për të ardhmen. Bash asgjë nuk the për dialogun, për unifikimin. Mendjen si me shkuar te zgjedhjet me ardhur te pushteti.

Po të tregoj se ti nuk ke asnjë njohuri për Mitrovicën! Bash lidhje nuk ke se çfarë ka ndodhur në Mitrovicë. Veç po ta rikujtoj prej 2000-tës deri më 2008-tën kush ka qenë atje kryetar komune, dhe po ta rikujtoj që shpërngulja më e madhe e shqiptarëve ka ndodhur në atë periudhë kohore. Rikthimi i shqiptarëve në Veri ndodh pasi Hashim Thaçi vjen në pushtet. Në viti 2008 fillon rikthimi i shqiptarëve nga Jugu në Veri. Mos hy në gjëra që nuk i njeh, sa për të thënë diçka! Po, ka nevojë ky vend të diskutojë për konsensus, për unifikim të gjejmë vërtetë një zgjidhje, por jo duke u kthyer te komunikatat e UÇK-së e nga ajo që ndoshta dikur e ke pasur lakmi e nuk e ke arritur, edhe tani hajde të bëj diçka, një dialog koti.

Po presim që me dhënë kontributin, vërtetë çdonjëri këtu, me dhënë një zgjidhje e zgjidhja është më se e nevojshme se qytetarët nuk presin nga ne që ne të përplasemi, prej atyre gjërave të cilat nuk japin kurrfarë zgjidhje për vendin përveçse replika koti edhe asnjë zgjidhje. Po, ka mundësi ky Kuvend të dëshmojë seriozitetin e tij, ta gjejë rrugëzgjidhjen, unë ua dhashë një ju vura në sprovë, bash asnjë prej subjekteve nuk u prononcua sepse nuk jeni të interesuar me pas zgjidhje.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Paj tash unë nuk e di pse po i jep replikë këtyre. Unë nuk përmenda emra asnjë, po gjithsesi tash...Tashti a po e sheh që vetëm fjalët e para m'i kanë dëgjuar të fundit nuk kanë interes nuk kanë interes t'i dëgjojnë ose nuk kanë potencial, kapacitet.

Unë e dhashë zgjidhjen! Zgjidhja për të fuqizuar legjitimitetin qytetar janë zgjedhjet. Një kryeministër që ik prej përgjegjësive, një kryeministër që nuk e ka shumicën për ta votuar një ligj të vetëm në Kuvend, është mirë me thanë; hajde të shkojmë në zgjedhje cilado qeveri që vjen e ofron për t'u dalë në ballë proceseve, jo vetëm këtij, por të gjithë të tjerëve. Nëse nuk dini t'i kapni, po me vjen keq. Boll i qartë jam e flas goxha gegërishten madje, por nëse nuk mund t'i absorboni këto që i them, keni problem.

Nuk dua të kthehem edhe njëherë te tematikat e tjera, sepse kam përshtypjen që ju vjen edhe juve, kështu që më mirë po ndalem këtu.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani fjalën e ka Xhelal Sveçla.

XHELAL SEVÇLA: Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Përgjatë gjithë procesit të negociatave me Serbinë, Kuvendi i Kosovës ose është anashkaluar ose është keqpërdorur. Pushteti ekzekutiv i Kosovës, qeveritë e të gjitha kohërave, duke qenë jo transparente dhe jo parimore e kanë keqpërdorur Kuvendin edhe i kanë injoruar vendimet e tij kur nuk i kanë konvnuar ato. Qeveritë kanë vepruar me arbitraritet duke i shkelur rezolutat e Kuvendit siç është ajo e 28 korrikut 2011, 18 tetorit 2012, 6 qershorit 2013 dhe 29 dhjetorit 2016.

Tash së voni janë dy çështje problematike që duhet theksuar: e para, insistimi i Hashim Thaçit për vazhdim të negociatave, gjithsesi nën udhëheqjen e tij dhe e dyta, raporti mbi arritjet dhe sfidat në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit nga Qeveria e Kosovës.

Së pari raporti i Qeverisë konfirmon atë çfarë ne Lëvizja Vetëvendosje kemi thënë gjatë tërë kohës. Këto negociata janë dështim absolut i Kosovës në raport me Serbinë! Jo vetëm se marrëveshjet kanë qenë jashtëzakonisht të dëmshme, por me zbatimin e njëanshme nga Kosova i është mundësuar Serbisë moszbatim apo zbatim selektiv i marrëveshjeve. Pra, edhe nëse ka pasur një...të mirë për Kosovën në këto marrëveshje, Serbia i ka zhbërë.

Pyetja më e shpeshtë midis qytetarëve sot është; pse kjo nguti?! Pse kjo urgjencë për të rifilluar negociatat? Në njërën anë i thurni lavde vetës me suksese të marrëveshjeve, gjë që po del sot që nuk është e vërtetë as me koordinatat tuaja, këtë po e thotë edhe raporti i vet Qeverisë, kurse në anën tjetër, kemi Qeverinë e skandaleve më e dobëta deri më tani dhe presidentin më të delegitimuar se kurrë.

Qysh në shikim të parë vërehet një aleancë imediate. Ky dialog i duhet Serbisë për të përshpejtuar integrimet në Evropë, ky dialog po i duhet edhe Qeverisë Haradinaj e shantazhuar nga Hashim Thaçi që t'i zgjasë ditët e saj. E ky dialog po i duhet edhe vet Hashim Thaçit që ta shtyjë arrestimin e tij nga Gjykata Speciale! Këto qëllime prodhojnë një rrjedhje logjike të ngjarjeve. E si bëhet kjo shtyrje më e mirë sesa me negociata që nuk përfundojnë kurrë? E si nuk përfundojnë kurrë negociatat me Serbinë? Duke e instaluar Zajednicën si autonomi territoriale e të lidhur drejtpërdrejt me Serbinë e duke garantuar vazhdimin e përjetshëm të telasheve.

Të nderura deputetë, e ku më shumë më shumë sesa në Mitrovicë dhe Veri të Kosovës vërehet mësymja e shtetit serb? Atje shteti serb është këmbëkryq, qoftë legalisht dhe ilegalisht. Që nga paslufta e deri tani, nëpërmjet hapa të vazhdueshëm kriminal, Serbia arriti që të bëjë fakt të kryer spastrimin etnik, prezencën e saj aty, duke e kufizuar prezencën e institucioneve të Kosovës në Veri. Krimi më i madh, ndaj jo vetëm kësaj pjese të Kosovës u bë me ndarjen e Mitrovicës në të cilën drejtpërdrejt kanë marr pjesë Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli. Ata ndalën kthimin e qytetarëve dhe të punësuarve në atë pjesë të Mitrovicës menjëherë pas përfundimit të luftës. Kushdo e ka parë videon kur këto të dy personazhe i zmbropsin qytetarët me premtimin se Mitrovica do të bashkohet brenda javësh. Por ja jemi 19 vite pas e jo që nuk u bashkua Mitrovica, por edhe juridikisht po doni ta vulosim këtë ndarje. E për më keq, po bëhen gati që atë pjesë ta fusin në pazarin e autonomisë territoriale që përmban Zajednica. Nga formula me padrejtësitë të mëdha e Pakos së Ahtisarit, ku Mitrovica bëhet një qytet me dy komuna, tash po përpiqeni ta ktheni në një qytet në dy shtete.

Shqiptarët në Veri kanë mbetur në mëshirën e askujt, pasi që Komuna Veriore e Mitrovicës nuk interesohet për ta, Komunës në Jug nuk i kanë lënë kompetenca ndërsa Qeveria i injoron totalisht. Nga 2013-ta Qeveria pothuajse nuk ka investuar asnjë cent për shqiptarët atje. Për derisa spastrimi etnik i shqiptarëve vazhdon në heshtje, Serbia investon miliona euro në projekte të reja konolizimi nëpërmjet ndërtimit të shtëpive e banesave kolektive. Investimeve në infrastrukturë dhe subvencionimin e jetës së serbëve atje, si dhe duke ua mundësuar mospagimin e shpenzimeve të rrymës, ujit, taksave e tatimeve të tjera.

Tash edhe ndërton komplekse të tëra, siç është ndërtimi i 300 shtëpive në Luginën e Diellit përkaj Kroit të Vitakut, i cili edhe ashtu është i ndarë në dy komuna; në Komunën Veriore të Mitrovicës dhe atë të Zveçanit. Kjo është karota e Serbisë kur shkopi për ata individë brenda pakicës serbe në Kosovë, të cilët inkuadrohen në shoqërinë e Kosovës janë detyrimi për të ndërprerë marrëdhëniet me institucionet e Kosovës, janë kërcënimet, rrahjet deri edhe të vrasjet. Ndërsa, 50 shtëpi atje, pra te Kroi i Vitakut, akoma qëndrojnë të djegura dhe nuk lejohen të rindërtohen as nuk ndahet mjete për ta. Shkelja e të drejtave mbi baza etnike nuk duket ndryshe, e jo vetëm. Ne asnjëherë nuk duhet të harrojmë apo të falim apo të pranojmë konsekuencat e masakrës së shkurtit të viti 2000, ku nga pjesëtarët e strukturave paralele të Serbisë, u vranë dhjetë shqiptarë dhe u dëbuan me dhunë 11 364 të tjerë.

Nga negociatat e deritanishme, janë legalizuar Rojat e Urës dhe e ashtuquajtura Mbrojtja Civile, shumica e të cilëve janë pjesë e Policisë së Kosovës, por i shërbejnë vetëm strukturave paralele. Për më tepër në raportin e Qeverisë thuhet se për komandantin e rajonit të Mitrovicës, Serbia ka ofruar dy emra. Tash merreni me mend çfarë skandali është në këtë mes. Serbia e cila na lufton i cakton komandantët e policisë së shtetit tonë. Qeveria e tanishme, sikurse ato të mëhershmet, në vend se të iniciojë dialog të sinqertë e të hapur me serbët lokal, ajo zhvillon takime kontroverse me eksponentët që njihen si personazhe të botës së krimit në ato anë. Siç është rasti i takimit të Haradinajt me mafiozin Milan Radojçiq.

Për derisa gjatë tërë këtyre viteve zyrtarët e ndryshëm e kishin gojën plot për lirinë e lëvizjes ura kryesore në lumin Ibër që prej mbarimit të luftës është jofunksionale. E bllokuar herë me tela gjemborë, herë me zhavorr e herë me Park të Paqes. E tash në ta ashtuquajturin proces të rivitalizimit me të cilin proces janë shkelur dy marrëveshje për hapjen e saj, atë të fund-qershorit 2016 e herën tjetër të 20 janarit 2017. Edhe sot hapja e urës tentohet të përdoret për kompromisin e radhës, qoftë për vijën e re administrative ndërmjet dy komunave, apo edhe për themelimin e Zajednicës.

Komuna Veriore e Mitrovicës akoma nuk e ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me atë Jugore, për arsye se dëshiron të ndryshojë vijën administrative me ç'rast ndarja bëhet me rrjedhën e lumit Ibër, ndarje natyrale gjeografike mes dy vendeve me çka fshatrat Vinarc, Gushavc, Suhadoll, Vidimiriq dhe Lagjja e Doktorëve do t'i takonin Komunës Veriore të Mitrovicës.

Përgjatë gjithë këtyre viteve ka pasur me dhjetëra incidente dhe sulme terroriste që kanë përfunduar edhe me vrasje, e autorët asnjëherë, në asnjë rast të vetëm nuk u zbuluan e mos të flasim për ndëshkim.

Jo vetëm se u sulmuan familjet shqiptare në shtëpitë e tyre por edhe ato pak institucione të shtetit të Kosovës që u shërbejnë popullatës atje, u thyen e u dogjën në mungesë të mbrojtjes së shtetit. Jo vetëm pikat doganore e gjykata, por edhe Shtëpia e Shëndetit në Kodrën e Minatorëve tri herë ka pësuar nga zjarr-vënia. Ajo vazhdon të funksionojë ekskluzivisht me mbështetjen e Komunës Jugore të Mitrovicës pasi që nuk mbështet as nga Qeveria e Kosovës, as nga Komuna Veriore e Mitrovicës, e as nga ashtuquajtura Zyra Administrative, e udhëhequr nga Adriana Hoxhiq.

Për më tepër edhe në rastet e privatizimit në pjesën Veriore aty ku fitues ka qenë ndonjë shqiptar AKP-ja ka anuluar këto blerje me qëllim të moslejimit që shqiptarët të bëhen pronarë të pronave të privatizuara. Paramendoni paradoksin, shqiptarët lejohen të blejnë prona në Kurshumli, por nuk lejohen të bëhen pronar të pronave në Veri të Mitrovicës. Dialogu i deritanishëm as nuk e bashkoi Mitrovicën as nuk siguroi kthimin e shqiptarëve atje e as nuk integroi pakicën serbe në Kosovë.

Përgjatë tërë këtyre viteve përderisa kjo pesë u la anash nga pjesa tjetër e Kosovës, ajo më së shumti u tradhtua nga zyrtarët institucionalë të Kosovës që për ironi të fatit edhe vinin nga jo zonë, dhe e njihnin me themel problematikën aty. Në një moment apo tjetër kryeministri, ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Punëve të Jashtme, ministri i Financave, kryetrari i Gjykatës Kushtetuese, kryetari i Këshillit Gjyqësor, kryeprokurori, guvernatori i Bankës Qendrore, kryetari i Kuvendit dhe shumë e shumë deputetë kanë të Mitrovicës me rrethinë. Pra, gati e gjithë konjuktura drejtuese e shtetit tonë, ndaj nuk mund të thuhet se nuk kanë legjitimuar po këta gjendjen e tmerrshme në Mitrovicë. As nuk mund të shfajësohen nga përgjegjësia e tyre institucionale e kombëtare.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit nënkryetar i Kuvendit,

Në tryezat e thirrura nga partitë politike, e që filluan partitë më të mëdha opozitare, unë mendoj që tema të cilën e ka zgjedhur sot PSD-ja, është një temë që e kanë kërkuar pothuajse të gjitha subjektet politike, por mbi të gjitha e ka kërkuar në vazhdimësi shoqëria civile dhe qytetarët në përgjithësi.

Kuvendi është vendi ku duhet të diskutohen temat qofshin të nivelit çfarë jemi diku diskutuar sot, por edhe çdo temë që prek interesin e qytetarëve. Mbi këtë bazë, unë konsideroj që ikja e përgjegjësive është jo vetëm fshehje, por më shumë sesa kaq.

Në këtë debat ishte dashur që në fillim, jo të presim mbi tetë orë përsëritje e stërpërsëritje vetvetes të shumicës që morën fjalën më herët, por ishte dashur të ndalemi pikërisht në rekomandimet e propozuara nga PSD-ja. Se cilat janë ato rekomandime, e të japim ide e propozime të gjithë ne, në mënyrë që të nxjerrim një rezolutë që do t'i ndihmonte procesit. Hashim Thaçin nuk ua sollëm ne, Hashim Thaçin e solli LDK-ja! Ky është fakt. Hashim Thaçin si president i vendit, ne atëherë e kundërshtuam me të madhe, por Hashim Thaçi është president i vendit dhe unë nuk e di pse kaq të etur për t'ia përmendur emrin shumë herë LDK-ja që e solli vet.

Tani, a mund të themi që nuk është president?! Jo. Se e kanë vendosur vetë more, me vota të vetat, me shumë dëshirë e shumë vullnet, edhe me benificione shumë të mëdha e me pozita që i kanë marrë edhe ata që nuk janë këtu, po edhe ata që janë këtu besa duke i rehatuar edhe familjarët e tyre. Tutje. A e zgjodhi Kosova dialogun me dëshirë? Unë mendoj që jo. Por, a duhet të dialogojmë? Unë besoj që askush dhe asnjë subjekt politik nuk e ka guximin të thotë jo. Dhe mbi të gjitha shumë herë edhe Vetëvendosja ka thënë po. Po, pra. Me dialogu, po. Dhe si me dialogu? Ishte dashur Kuvendi, këtu sot për orë të tëra të vendos pra se si do të dukej platforma

në mënyrë që të mos na vinë situata çfarë na kanë ardhur, që ne shumë herë i kemi kundërshtuar marrëveshjet të cilat asnjëherë të vetme nuk janë diskutuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës ku janë deputetët të zgjedhurit e popullit. Nuk janë diskutuar, por i kemi diskutuar pas nënshkrimit dhe pikërisht sot po flasim që të mos na vijnë situata të tilla. Po flasim për diçka që Kuvendi duhet të vendos se si do të shkojnë këto bisedime dhe kush do duhej të jetë në ekipin negociator.

Unë mendoj që, asnjëherë të vetme Aleanca nuk e ka thënë që Hashim Thaçi duhet me çdo kusht të jetë njeriu që i udhëheqë këto bisedime. Për mua personalisht si deputete e Parlamentit të Kosovës është shumë e rëndësishme ekipi që është negociues, kush është në atë ekip. Dhe shumë herë e kam thënë, e them edhe sot, po të isha në opozitë kisha me thënë prapë të njëjtën gjë! Në debate të tilla, në bisedime të tilla, në instanca të tilla, përgjegjësinë më të madhe do duhet ta kishte pikërisht opozita. Sepse opozita është ajo që monitoron Qeverinë për të mos bërë gabime.

Dhe duke i ikur përgjegjësisë nuk do të thotë që kemi sjellë alternativë, por ikja e përgjegjësisë, edhe njëherë thash, është fshehje dhe mospasje e ideve dhe kur nuk ke ide normal se flet e flet me orë të tëra dhe me fraza shumë boshe dhe në fakt në substancë nuk ka kurrgjë. Unë shumë herë nuk pajtohem me Blerim Kuqin edhe pse e kam koleg këtu afër. Mirëpo, nganjëherë i ka disa, sinqerisht e bën një përmbyllje që ndoshta me pak humor, por ndonjëherë janë disa mesazhe që dikush duhet vërtetë ta ketë një memorie ose të sheh në ndërrijen e dikujt tjetër. Flitet për ikje të kryeministrit apo për bisedat e tij me këdo qofshin, ama askush askujt nuk mundet me i mbush mendjen, atij që ka veç pak mendje të ndritur që i ka ikur përgjegjësisë ndonjëherë. Por, thirrja që Kuvendi të merr përgjegjësi nuk është ikje e përgjegjësisë.

Ne shumë herë jemi ankuar në secilën Qeveri edhe në këtë Qeveri për moszbatimin e rekomandimeve që dalin prej Kuvendit, dhe normal se roli i Kuvendit është ky, ta monitorojë Qeverinë dhe mos ta lejojë të bëjë gabime. A ka qeveri pa gabime? Jo. A do të ishte shumë komode Qeveria po të ishte një zë i heshtur i Kuvendit? Po!

Atëherë ngritja e zërit në Kuvend është dhënia e ideve, platformë e saktë me ide të sakta dhe njëkohësisht një përgjegjësi shumë e madhe, dhe asnjë marrëveshje e vetme mos të nënshkruhet para së të vjen e të diskutohet në Kuvend. Dhe unë asnjëherë në jetën time nuk e kam thënë dhe nuk e përmend emrin që dikujt shumë herë i intereson ta thotë në gjuhën e armikut, unë them; Bashkësia e Komunave me shumicë serbe.

Bashkësia e Komunave me shumicë serbe të nderuar deputetë, ka ardhur një vendim i Gjykatës Kushtetuese që dikujt, dikush është i prirë që herë t'i beson e herë të mos i beson, varësisht sa s ai bie tamam një sako, por në fakt ajo Bashkësi pra e ka një vendim nga Gjykata Kushtetuese që askush nuk mundet me kontestu, dhe as nuk e ka guximin ta kundërshtojë. Dhe ai rezultat, ai vendim i Gjykatës ka ardhur si rezultat i shtyrjes së qytetarëve, pra 204 000 qytetarëve, po t'ju

kishte ofrua ndoshta ishin bërë edhe më shumë, jam shumë e sigurt, që kanë shtyrë ish-presidenten për t'ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Dhe pikërisht është ai vendin dhe mbi bazën e atij vendimi, pra ne e kemi një vendim në duar, por mos të flasim për diçka që shumë herë me vetëdije të plotë apo pavetëdije por në ndërdijen e tyre siç e ka nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri që shumë herë e ka përmendur shkëmbimin e territoreve. Ama shumë herë!

Është i pari dhe shumë e ka përsëritur dhe stërpërsëritur dhe po përsëritet edhe këtu. Është pikërisht një njeri që është nënkryetar i subjektit, pra të LDK-së që e ka përmendur këtë. Dhe unë besoj jam shumë e sigurt që askush nga ne nuk thirret, nuk duhet të thirret në diçka që është dhimbje për të gjithë, e aq më pak në qoftë flasim këtu për familjet të cilat i kanë plagët e veta që kurrë nuk iu shërohen. Me fol për nënën Ferdone Qerkezi këtu në Kuvend, sinqerisht për mua është e dhembshme. Nuk duhet kurrë të pretendohet të përfitohet qoftë edhe një votë e vetme, kurrë nuk kisha dashur ta përfitojë me i përmend emrin. Por, unë mendoj që ajo është një mesazh shumë i fortë për të gjithë ne, që në një takim me presidentin Fatmir Sejdiu, gjatë atij takimi i nënkryetare e Komunës së Gjakovës, presidenti Fatmir Sejdiu e pyeti: Si po ndihesh? Tha, “ka edhe ma zi”! “Çka ka ma zi”, i tha?! “Ma zi kishte me qenë po të me humbte mendja dhe mos të mbaja në mend se çfarë m’i ka ndodhur familjes sime. Por uroj që ta kem mendjen dhe çdoherë të tregoj se çka m’i ka ndodhur familjes sime dhe nga kush!”

Prandaj, unë uroj që secili prej nesh ta kemi mendjen e ndritur me atë kapacitet që kemi sepse nuk pretendoj të jem e përkryer, por unë besoj që nuk është askush nga ne i përkryer. Mund të jetë në ndonjë fushë, por me përgjegjësi shumë të madhe e them që secili duhet ta marr përgjegjësinë e vet, në mënyrë që të mos të lejojmë as Hashim Thaçin por askënd tjetër të bëjnë gabime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja, Doruntinë Maloku-Kastrati.

S’mund të replikojnë deputetët të cilët janë pjesë e të njëjtit grup parlamentar. Unë si praktikë nuk e kam të njohur.

DORUNTINË MALOKU-KASTRATI: Të nderuar deputetë,

Meqë sot u përmend shumë shpesh në këtë seancë inati dhe inatçinjtë, kam vendosur që ta lexoj një kolumne të babait tim Enver Malokut, e shkruar më 10 korrik 1998 e cila e mban titullin; “Inatçinjtë duhet të sundohen”.

‘Një prej virtyteve të domosdoshme për njerëzit që duan të hyjnë në politikë e të udhëheqin institucione, pra edhe partitë, është aftësia e gatishmëria e tyre për komunikim serioz me bashkëpunëtorët, përkrahësit, simpatizantët, rivalët dhe kundërshtarët, madje edhe me armiqtë e vet. Kjo cilësi është shumë e dëshirueshme për politikanët tanë! Disa prej tyre manifestojnë

publikisht, madje edhe nga disa herë në ditë inatin ndaj njëri-tjetrit. Ku ka inate ka edhe pasione të tjera, pra edhe pasione të adhurimit e të mbështetjes së rezervë për miqtë e vet.

Ndërprerja e komunikimeve apo komunikimit akuzues me ata që trajtohen si kundërshtarë dhe komunikimi intensiv pëlqyes e pajtues me ata që trajtohen si miq dhe aleatë, dëshmojnë se disa politikanë tanë e kuptojnë komunikimin thjesht si çështje private. Disa udhëheqës e drejtues të institucioneve më të rëndësishme të Kosovës nuk kanë komunikuar mes vete me vite të tëra, e për këtë paradoks që ndodh vetëm këtu ka qenë i informuar edhe opinioni.

Reagimet e formës lutëse të tij për pajtimin e politikanëve tanë nuk kanë dhënë asnjë rezultat, siç nuk po japin rezultat as lutjet e ditëve të fundit që u dërgohen bajraktarëve të partive tona. As më parë e as tash, nuk janë shpjeguar shkaqet e ndërprerjes së komunikimit, pra as të ndërpres së bashkëpunimit e të funksionimit të institucioneve që s'mund të funksionojnë të shkëputura. E aq më pak në kundërshti dhe në armiqësi me vete.

Si shkëputje të kontakteve dhe bashkëpunimit edhe rivendosja e tyre bëhet befasisht, pra pa e ditur shkasit e njëres e tjetres! Mirëpo, pasojat janë të rënda. Një prej pasojave është legalizimi i këtij vesi dhe deformimi i opinionit që pajtohet dhe që për habi vuan për shkak të inateve që kanë politikanët tanë. Nga përvoja dihet se një prej shkaqeve të shpeshta të ndërprerjes së komunikimeve është mosdurimi i kritikës që mund t'u bëhet politikanëve tanë ose grupit të tyre politik. Mjafton një tërheqje vërejtjeje, një kritikë ose një pakënaqësi e shprehur ndaj tyre që ndërpriten komunikimet, madje edhe për çështje me interes publik dhe shtetëror.

Përjashtimi i qëndrimit kritik, ose thënë më saktë njerëzor në komunikime i hap rrugën servilizmit të pakufishëm. Rrallë sot mund të shihen udhëheqës të institucioneve ose të partive të rrethuar me personalitete dhe individualitete të formuara! Të kthehemi te politikanët e njerëzit inatçinj.

E kam dëgjuar një tregim domethënës këto ditë për këta tipa njerëzish. Një llapjan nuk caktoi për zot shtëpie djalin e madh, por të voglin pasi i madhi ishte inatçi. T'i mban inat me gruan tënde dhe s'flet shpesh me nga një javë; si mund të udhëheqësh e të mbash shtëpi pa folur me anëtarët e familjes së shtëpisë?, i kishte thënë ai të birit. Me një fjalë, tipat inatçi nuk bënë të lejohen të sundojnë. Ata duhet të sundohen natyrisht me ligje, por ligje s'kemi dhe as nuk kemi organ ligjvënës.

Të nderuar deputetë, unë e lexova këtë kolumne të Enver Malokut të publikuar më 10 korrik, saktësisht njëzet vite më parë, 10 korrik 1998, për t'ju treguar se inatçiu i sotëm Hshim Thaçi është po ai i njëjti sikur ata të njëzet vjetëve më parë.

Inatçiu i sotëm e di mirë se është pengesa e vetme për arritjen e një konsensusi të gjerë për një temë kaq të rëndësishme për Kosovën. Është po i njëjti inatçi i Rambujesë, është i njëjti inatçi i shpalljes së Pavarësisë dhe tash i finales me Serbinë. Prandaj, tipat si Thaçi nuk bën të lejohen nga ky Kuvend që të udhëheq një proces, i cili më shumë se gjithçka tjetër ka nevojë për konsensus të gjerë, i cili s' do të arrihet asnjëherë për shkak të presidentit inatçi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Blerim, dy minuta!

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Edhe pse fjalën e kam kërkuar me një ambient krejt tjetër, po, po filloj prapë. Edhe, unë e kam një lutje në raport me kryeministrin e Republikës së Kosovës. Që të ketë mëshirë kryeministri të mos sjellë këso raporte të punës më asnjëherë! Sa herë po sjell raporte të punës, edhe me këto vendime kaq të mëdha e kaq shumë, edhe me këto ligje që i ka drejtuar drejt Kuvendit, diqysh edhe ana e majtë edhe ana e djathtë po sëmuren, edhe po frikësohem se po pësojnë ndonjë infarkt para pushimit, se tash jemi para pushimit shpresoj edhe sot dhe nesër jemi në pushim. Bile në pushim, kryeministër leje rehat, puno. Këtu jemi bashkë me kolegë, ti je nda me ta, ke shkuar në Shqipëri, por unë jam me ta bashkë me ta, puno pak më pak dhe pastaj këta janë rehat.

Kurse më herët desha t'iu them disa kolegëve: mirëmëngjesi, a u zgjuat, a fjetët a? Futuni bre pak në temë se krejt dolët prej temës. Unë kam një propozim shumë konkret dhe doli edhe prej disa propozimeve të juaja. Unë e ftoj kryeministrin, pasi që është kërkuar nga kryeministri që të ftojë të gjithë liderët që janë në Parlament, të ulet me ta, ta bëjë një platformë për bisedime, ta caktojë me ta formatin e bisedimeve, pastaj të na e sillni këtu në Kuvend, pastaj të shohim ne a e votojmë apo jo.

Ata që nuk duan të marrin pjesë në atë tubim, në atë debat që e kërkon kryeministri do të duhej të shohin ku i kanë çadrat, sepse këtu u fol shumë rreth kësaj çështje, ndërsa unë jam i sigurt se disa prej tyre i kanë çadrat ndoshta edhe jashtë Kosovës. Pra ftoj liderët e partive, uluni bëni platformën e përbashkët.

KRYESUESI: Deputeti Ali Lajçi s'është në sallë. Fjalën e ka deputeti Arbër Rexhaj.

ARBËR REXHAJ: Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës!

Nëse në historinë e Kosovës para shpalljes së pavarësisë dhe pas shpalljes së saj, nëse ndokush do të hyjë në librin e koncesioneve të dëmshme për vendin e vet, ai është Hashim Thaçi që u përmend shumë sot, në pozicione të ndryshme të qeverisë, të bëra së bashku me PDK-në në koalicion me partitë tjera të cilat hynin e dilnin nga formacionet e dialogut. Mendësia e Hashimit, PDK-së dhe partive të tjera që merrnin pjesë në dialog ishte mendësi e nënshtrimit.

Dukej sikur atje kishin shkuar të kapur nga ndërkombëtarët, nga kërpeshi i korrupsionit dhe së fundmi nga Gjykata Speciale, të cilën e kishin krijuar vetë.

Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është karakterizuar me nënshtrim total para temave për çështje të brendshme, ndonëse në fillim gënjenin se po bisedonin për çështje teknike. Aty asnjëherë nuk u kërkua zgjidhje për çështjen e të pagjeturve, kompensim për dëmet e luftës, kthimin e artefakteve, reciprocitetin për të drejtat e shqiptarëve në Serbi, ndonëse në Kosovë u tolerua ndarja e Mitrovicës de fakto, komunat etnike që çuan në kompromisin e radhës Zajednicën, për çka edhe po na çon çdo ditë Thaçi duke u thirrur në të dhimbshmen, në pafuqinë e cila nuk duhet të tolerohet. Si Thaçi e Haradinaj nuk kanë më kredencialet optimale, njëri duke bërë kompromise në kurriz të qytetarëve, tjetri duke mos pasur fuqi as në numra për të shtyrë përpara asnjë çështje, veçse një argat i Thaçit në Bruksel dhe zëdhënës i Kadrisë në Kosovë. Prandaj këta duhet të shkojnë menjëherë në shtëpi. Ia nisën me Pakon e Ahtisarit, të cilën e pranuan në emër të pavarësisë, pako që krijonte komuna etnike serbe dhe vazhduan deri në Zajednicën serbe, e cila bosnjëzon Kosovën.

Tash së fundi deklarohen se nuk kanë vija të kuqe, flasin për shkëmbim të territoreve dhe e hapin këtë temë. Në fakt këta janë dezertuesit e shtetit, të demokracisë dhe të institucioneve të Republikës së Kosovës. Nëse në tavolinë të bisedimeve do të jetë shkëmbimi territorial, kjo do të thotë thirrje për luftë. Ne nuk kemi tokë për të dhënë: kemi dhënë mjaft, nuk mund të japim më. Por edhe ky nëse është një bluf i Thaçit që ka të bëjë se duhet ta bëjë Zajednicën më të pranueshme, duhet ta dijë se më parë do të shkojë ai me krejt çka ka përreth sesa e lejojmë ne të na fusë Serbinë prapa në Kosovë. Në dokumentin për të arriturat e vitit 2015, në marrëveshjen e Brukselit thuhet se të arriturat në dialogun e Brukselit kanë ndikuar drejtpërdrejt në realizimin e objektivave strategjike duke përfshirë këtu sovranitetin shtetëror brenda dhe jashtë vendit. Në këtë dokument thuhet se forcimi i mëturjemë i sovranitetit të shtetit është ndër arritjet kryesore të angazhimeve tona në dialogun e Brukselit, kemi arritur të finalizojmë zbatimin e një numër marrëveshjeve ndër të cilat veçojmë marrëveshjet në drejtësi dhe shuarjen e strukturave ilegale të mbrojtjes civile, krahas të tjerave të cilat janë në proces.

Ndërsa, në raportin e vitit 2018, kjo demaskohet, sepse në vend të shuarjes së strukturës ilegale të mbrojtjes civile, kemi integrimin e tyre në institucionet e Kosovës, 483 persona kanë kontrata me institucionet e Kosovës. Personat e integruar nuk janë të përgjegjshëm dhe nuk i raportojnë institucioneve të Kosovës. Kështu pra thuhet në raport.

Edhe pse në dëm tonin, megjithatë u parapa të ketë integrim të 39 sosh të policisë paralele MUP-it, në zyrat civile në komunat veriore të Kosovës. Sigurisht se kjo është e tmerrshme. Serbia e pengoi e Kosovën në nismat rajonale në tryezat ndërkombëtare dhe në të gjitha iniciativat. Serbia e pengon Kosovën rreth përfaqësimit të saj me simbole të veta, Serbia e pengon Kosovën në kryesimin e nismave dhe organizatave ndërkombëtare. Te forcimi i sundimit të ligjit, mirëqenies,

integritit dhe sigurisë së qytetarëve në dokumentin e vitit 2015, më konkretisht të marrëveshjes si ajo IBM dhe protokollit teknik, liria e lëvizjes, tregtia e lirë, vulat doganore, shkëmbimi sistematik i të dhënave elektronike, grumbullimin e taksave doganore në pikëkalimet Jarinë dhe Bërnjak, kanë pasur efekte të drejtpërdrejta në planin ekonomik dhe fiskal sepse kanë ulur dukshëm veprimtarinë e jashtëligjshme, kanë forcuar sundimin e ligjit dhe kontrollin efektiv kufitar, janë shtuar dukshëm të hyrat në buxhetin e Kosovës nga rritja e të hyrave nga taksat. Një pjesë e taksave është derdhur në fondin për zhvillimin e komunave veriore.

Ndërsa, në dokumentin e vitit 2018, theksohet se: Serbia shkel marrëveshjen duke përdorë vulat doganore, vulat doganore serbe me emërtime serbe të qyteteve të Kosovës. Grafiku i autoriteteve serbe ende përfshin Prishtinën si zonë, ose zyrë doganore të tyre, kurse sa i përket shkëmbimit sistematik elektronik të të dhënave doganore, pala serbe ka shtyrë deri në vitin 2015, ndërsa pala kosovare e zbaton këtë marrëveshje nga viti 2013. Ndarja e Kosovës legjitimohet pra edhe me heshtjen e ndërtimit të murit në Mitrovicë, tolerimit të strukturave paralele atje që rrezikojnë shtetin atje, po ashtu e papranueshme është rikolonizimi që sot nuk u përmend fare që po ndodhë atje, i cili me krijimin e Zajednicës do të vazhdojë edhe në komunat me shumicë serbe.

Prandaj, Thaçi duhet të shkarkohet si president i vendit, zëvendësi i tij kryeministri Haradinaj që nuk i ka as numrat minimalë në Kuvend duhet të shkojë në shtëpi. Vetëm kështu mund ta ndalim Zajednicën, dialogun me koncesionet e Thaçit në dëm të qytetarëve të vendit dhe pafuqisë së Haradinajt dhe t'i hapë udhë fuqisë e cila në të ardhmen do të krijojë alternativë kombëtare edhe përballë Serbisë, edhe përballë sfidave që na presin. Edhe në këto dy minutat e fundit dua të përmend një fakt këtu që u përmend, jo për arsye të replikës, por një deputete tha këtu se u përmend për arsye partitizimi, pra zonja e nderuar Ferdane Çerkezi, unë në fakt mendoj se çdo deputet i Kuvendit të Kosovës këtu, është mirë që personat e tillë t'i përmendë sa herë që mundet në tema e diskurse të ndryshme, sepse në një farë forme ato janë fytyra jonë dhe akuzoi për përfitime vote deputeten tonë Arbërie Nagavci.

Në fakt, mendoj dhe inkurajoj çdo deputet të këtij Kuvendi, emra të tillë të përmenden sa më shpesh sepse mbi kurrizin e tyre edhe me dashtë nuk përfitohet, veçse duke mos i përmend ne edhe i harrojmë ata. Unë e di se ndoshta secili deputet nuk e ka në mendim që personat e tillë t'i harrojë. Po ashtu dua të përmend se këtu është thirrur shumë në Kushtetutë dhe unë po e shtoj edhe një aspekt tjetër, në kushtetueshmëri të disa deputetëve. Mirëpo nuk mund të bëhemi vagon i këtyre negociatave të cilat drejtpërdrejt e kanë shkelur Kushtetutën e Kosovës, pra kemi një president i cili ka krijuar Zajednicën në mospërputhje të Kushtetutës, ka depërtuar qytetarë turq duke mos respektuar as ligjin e as Kushtetutën, ka dhënë territor Malit të Zi duke mos respektuar Kushtetutën dhe shumë çështje të tjera.

Prandaj, hiqeni Hashimin e mëpastaj pranojini kërkesat e Lëvizjes Vetëvendosje të cilat shumë prej deputetëve të pozitës edhe jashtë na thanë se janë të mira, por barrikadimi rreth një personi,

rreth një presidenti i cili megjithatë ka treguar se nuk është unifikues, por është përçarës, mënyra e zgjedhjes së presidentit me protesta me gaz të tregon kemi të bëjmë me një njeri i cili po e përçan Kuvendin. Meqenëse është kështu kërkoj edhe nga deputetët e PDK-së që të lëshojnë pe këtu, të pranojnë pikat të Lëvizjes Vetëvendosje e më pastaj mund të diskutojmë.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Pavarësisht thirrjeve dhe kërkesave të vazhdueshme qoftë të deputetëve, qoftë të shoqërisë civile që të ndërtohet konsensus politik rreth dialogut duke ndërprerë insistimin që të diskutohet pas perdeve apo mënyrave të tjera konspirative, të arrihet akordim të cilat u proklamuan si të dëmshme dhe që janë esenciale për të ardhmen e Kosovës. Kjo qasje duhet të ndërpritet, sepse në mënyrë të mostransparencës dhe tendencës së bajraktarizmit dërgohen mesazhe negative nga të cilat iu mundësohet atyre që nuk janë dashamirë të Kosovës, që të kemi krijim apo fuqizim të subjektivitetit shtetëror të Republikës së Kosovës.

Deri tash nga kjo qasje, në vend se të kemi konsolidim të brendshëm shtetëror dhe njohje e anëtarësim të Kosovës në mekanizma ndërkombëtarë, ne po pengohemi çdo ditë dhe çdo moment nga Serbia, ndërsa qasja jonë ndaj dialogut është e njëjtë. Në praktikat e rezolutave tregohet se jo çdo herc qëllimi është përputhur me nevojën dhe rrethanat. Shikoni edhe kronologjinë e tekstit të rezolutave nga 2013-ta e tutje. Prandaj të nderuar kolegë deputetë, më lejoni që të rikonfirmoj qëndrimin e LDK-së dhe timin për debatin e sotëm si dhe pozicionin tonë për procesin e dialogut.

LDK mbetet e përkushtuar për një proces, dialog serioz, konsensual dhe brenda kornizës kushtetuese. Marrëveshja përfundimtare me Serbinë duhet të nënkuptojë normalizim të plotë në mes të dy shteteve që arrihet vetëm me njohje reciproke. Marrëveshja duhet t'i mundësojë Kosovës anëtarësim të menjëhershëm në OKB si dhe të hapë rrugë në anëtarësimin në BE dhe NATO. Marrëveshja me Serbinë duhet të arrihet duke mos e cenuar integritetin territorial të Republikës së Kosovës, duke ruajtur karakterin unitar të shtetit të Kosovës dhe duke respektuar frymën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Si shenjë e vullnetit të mirë, shteti i Serbisë duhet të ofrojë të gjitha të dhënat për të pagjeturit, të shprehë vullnet për kërkimfalje dhe për kompensim të dëmeve të luftës. Nisja e një procesi të ri të dialogut me Serbinë pa përgatitje paraprake është e rrezikshme dhe e papërgjegjshme.

Dialogu po tentohet të udhëhiqet nga institucione jolegjitime dhe jashtë mandatit kushtetues të tyre. Ekipet që i tejkalojnë institucionet shtetërore cenojnë përfaqësimin kushtetues në këtë proces dhe përbëjnë kthim prapa. Askush nuk mund të vendosë fatin e Kosovës në tavolinën e

dialogut. Dialogu duhet të udhëhiqet nga institucione shtetërore që kanë kompetenca kushtetuese dhe legjitimitet politik. Ne si LDK jemi të gatshëm të bëhemi pjesë aktive e dialogut por vetëm pas legjitimitet qytetar nëpërmjet votës së lirë. Ne mbesim të përkushtuar për një proces dialog konsensual serioz dhe brenda kornizave kushtetuese. Ne nuk votojmë asnjë rezolutë që mandaton persona që kanë legjitimitet dhe kompetenca për një proces të tillë.

Dhe, për fund, ata që akuzojnë LDK-në për zgjedhjen e presidentit Hashim Thaçi, dallimi mes tyre dhe e kaluara e tyre me Hashim Thaçin është si një fije floku. Faleminderit!

KRYSUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ali Lajçi.

ALI LAJÇI: Të nderur qytetarë të Republikës!

Tema e dialogut dhe ky kapitull mjaft me rëndësi për vendin ka një historik të vetin i cili është i bazuar në një konceptim dhe në një projekt i cili mund të themi se ka qenë deri tash edhe i konstatuar praktikisht, por edhe në mënyrën e menaxhimit të tij si një proces i cili ka qenë i dështuar dhe trend gjithnjë shkallë-shkallë negativ. Ne flasim se kur ishte Vjena apo kur ishte edhe nevoja për kërkesën që Kosova të shkojë dhe të kërkojë pavarësinë e drejtpërdrejt, nuk ka ndodhur. Nuk ka ndodhur respektimi i rezolutave të cilat ky Kuvend i ka marrë dhe të cilat pastaj i ka siguruar nëpërmjet tyre që dialogu të mos prek çështjen e integritetit territorial, nuk duhet të prekë pastaj as ndërtimin e brendshëm juridik të saj, nuk bëhet fjalë pra jashtë juridiksionit të Kushtetueses në tavolina.

Por çka ndodhur? Vjena pas pamundësisë për të rezistuar se pavarësia duhet të njihet drejtpërdrejt, u bë një kompromis dhe u pranua prej subjekteve politike dhe krijuan një grup të unitetit i cili në vijim pastaj bëri shkarje dhe pranoi edhe koncepte të tjera që depërtuan në rregullimin e brendshëm juridik siç ishte Asociacioni i Komunave me shumicë serbe, ose Zajednica që i themi tani e që qe bërë një trysni goxha e madhe dhe e rreptë në institucionet e Republikës që pastaj u pranua kjo. Me pranimin e Asociacionit të Komunave serbe mos mendoni se dikush e ka aprovuar në 2013 e dikush në 2015. Ka qenë i njëjti model dhe mos harroni se ky Asociacion në çfarëdo rasti, qoftë i 2013-ës, qoftë i 2015-ës, është një asociacion antikushtetues, sepse vendos një etni mbi etnitë e tjera, vendos pra komunitetin pakicë serbe mbi komunitetin shumicë dhe në këtë rast krijon devalvim të sistemit lokal deri në atë qendror.

Prandaj, dikush thotë se Asociacioni i Komunave duhet të bëhet a i 2013-ës apo 2015-ës, që të dyja mos harroni, kushdo që ka marrë hise këtu, nuk dua të hyjë në historikun e saj. Unë kam pasur presione nga të gjitha partitë politike dhe institucionet e Republikës që ta formojë komunën e Gorozhdecit si njëra prej këtyre gjashtë si pilotkomuna atëkohë e që unë kam rezistuar dhe pas gjithë kësaj edhe faktori ndërkombëtar dhe nuk ka ndodhur. Luta e ka bartur si ministër i asaj kohe me vete këtë numër pra gjashtë që ta bëjë në Partesh dhe e ka bërë. Por dua të them se kur merren edhe përgjegjësitë për një projekt, apo një ecuri sigurisht se ata njerëz pastaj nuk kanë

çare dhe duhet ta bëjnë. Duket se këtë proces e kanë marrë parti të cilat nuk ka nevojë për t'i deshifruar e dimë procesin e vendosjes së dialogut dhe nuk kanë pasur çare pa e bërë tash edhe këtë të dytën demarkimi, i cili u bë gabimisht dhe pastaj ishte e domosdoshme që të shtyhet tre vjet dhe të tërhiqej dhe të shtyhej e tërhiqej derisa bëhej një votë apo dy dhe pastaj ta aprovojë dhe ta lidhë edhe një nyjë me këtë demarkim të gabuar që ai të mos ketë zbatueshmëri në terren. Tash jemi këtë çka do të thotë ky Asociacion në baza etnike? Kjo do të thotë se ne kështu apo ashtu, kur kërkojmë reciprocitetin, sigurisht duhet të shikojmë çka është reciprociteti, në cilin kontekst kërkohet?

Reciprociteti në atributin kombëtar është shumë i drejtë, në atributin e pakicave kombëtare siç janë serbët e shqiptarët është i padrejtë, sepse shqiptarët e Luginës së Preshevës apo Kosovën Lindore janë autoktonë dhe ata kanë qenë dhe duhet të jenë në Kosovë, kurse pjesa e integruar që duhet të bëhet në Mitrovicë, doemos që nuk ka ndodhur, çdo tentim për ndarje është prekje në opsionin e pavarësisë, është prekje në kontributet e gjertanishme. E njëjta gjë është edhe krijimi i Asociacionit, por Asociacioni është mënyra më e sofistikuar e cila çon te ndarja. Kur them Asociacion në baza etnike, sepse ne e kemi një asociacion ju lutem ku mund të regjistrohen të gjitha komunat që duan të jenë brenda Republikës së Kosovës, prandaj komunat në veri të Mitrovicës nuk është qëllimi i një Asociacioni për t'i garantuar ata, por mos harroni se dardha e ka bishtin pas, prandaj nuk është i pranueshëm. I pranueshëm është vetëm integrimi i tyre dhe asnjëherë nuk mund të shtrohen pazare në të dy rrisqet tona, siç është edhe Mitrovica e edhe Presheva, të dyja janë tonat, dhe cilëndo ta humbasësh, e humb ti dhe ka fituar Serbia. Këto çështje janë të ditura.

Çka është legjitimiteti? Ju lutem, ku është një siguri te ne? A i kemi këto institucione që ne me votën tonë të jemi dikushi, të kemi një sovranitet çka votojmë e çka jo? Ju shpesh thoni se jemi të detyruar të bëjmë këtë dhe atë dhe e kemi pranuar një kompromis të dhembshëm ndër të tjera. Askush nuk ka të drejtë të aprovojë apo votojë ndonjë projekt, ndonjë çështje që është kundër vullnetit të tij, sepse atëherë nuk e ushtron sovranitetin e votës. Prandaj, mos votoni ju lutem projekte të cilat janë të dhimbshme, sepse është shumë e çuditshme se pse e humbni sovranitetin e votës suaj kur votoni kundër vetvetes, aq më tepër kur ju konstatoni se është i dhembshëm dhe nuk duhet të votohet. Në këtë praktikë ne kemi çaluar shumë dhe kemi ardhur në një pozicion ku faktikisht tentimi për të pasur një konsensus që është shumë e nevojshme, cili është konsensusi tash pas krejt këtij trendi negativ, a është ky një konsensus për të marrë përgjegjësi për projekte të liga dhe në dëm të vendit apo një konsensus faktikisht që e krijojmë bashkë dhe e bëjmë në interes të vendit?

Sigurisht nuk shtrohet këtu se ne këtu po heqim dorë nga Asociacioni me shumicë serbe, por tërhiqet vërejtja, urdhëroni të bashkohemi ta bëjmë ne këtë, sepse e kemi marrë obligim. Jo zotëri, nuk duam të bashkohemi në projekte të cilat i kanë krijuar vetë vendit telashe, dhe madje prekin edhe sovranitetin e tij. Në këtë rast ne duhet t'i trajtojmë edhe të tjerat tema. Ky dialog

nuk është vështir ta definojmë interesin e saj, të Kosovës në këtë rast. Cili është interesi i saj dhe çka mund të bëjmë në këto?

A mund të qetësohemi pak dhe të dëgjohe mi apo si është puna? Ti ulu pak pasi kryetari nuk po do! Ulu pak atje, zotëri!

Shikoni, ne po e shtrojmë çështjen kështu. Ne jemi dakord që ky trend i dialogut të ndalet, ky trend të ndalet dhe të fillojë atëherë kur Republika e Malit të Zi e njëj statusin e Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran, nëse e kemi statusin dhe kemi bërë dialog teknik dhe në qoftë se nuk e kemi statusin, kemi bërë dialog teknik dhe nëse nuk e kemi statusin, kemi bërë dialog në ajër, sikurse deri tash. Cilin problem e kemi zgjidhur deri tash me dialog? Jo, ne e kemi marrë një fusnotë që askush sot nuk përgjigjet se është antikushtetuese dhe shtrohet tani problemi a do të jetë një rezolutë e aprovuar në Kuvend, e cila do të ishte obligative sigurisht se jo se praktikat e tilla kanë treguar se rezolutat nuk i merr parasysh kjo strukturë shtetërore, prandaj pritni le të na njëj Serbia.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Lajçi! Regjia, ju lutem edhe një minutë shtesë për Lajçin.

ALI LAJÇI: Shikoni! Jemi shumë qartë në një situatë ku jemi. Ne kishim pasur dëshirë të mos bisedohej sot për këto, sepse janë disa vjet të humbura. Sot pjesën prej urës e veriun e Mitrovicës ka hyrë Rusia në interesa, kurse Listën Serbe e kemi bartur direkt si proces edhe kushtetues në Kuvendin e Republikës, kurse në Aeroport e kemi futur Turqinë dhe në KEK. Unë nuk i përjashtoj lidhjet ekonomike dhe interesat koncesionare, por në këtë rast janë interesa shumë strategjike të cilat po i kushtojnë vendit dhe tash një konsensus i cili menjëherë pas njohjes së pavarësisë.

KRYESUESI: Faleminderit zoti Lajçi. Uluni, mjaft! Fjalën e ka Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Vetëm desha ta pyes LDK-në edhe një herë a e kanë votuar Hahim Thaçin për president?

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Shemsi Syla.

SHEMSI SYLA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë, të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Më 11 gusht të vitit 2007, ekipit të unitetit të Kosovës i kryesuar nga presidentit Sejdiu para treshes së emisarëve specialë të Grupit të Kontaktit i ishte preyentuar një draft-dokument prej tetë pikash. Në pikën e shtatë thuhej, po citoj: ekipi negociator i Kosovës ka mbështetur raportin dhe propozimin gjithëpërfshirës të presidentit Ahtisari si rezultat i bisedimeve intensive të Vjenës që përfunduan me një kompromis i bindur se në këtë mënyrë arrihet të respektohet

vullneti i shumicës së Kosovës dhe njëkohësisht afrohet garanci legale dhe politike për mbrojtjen e komuniteteve të tjera në Kosovë, veçanërisht të komunitetit serb.

Këto garanci sigurohen edhe nëpërmjet pranisë civile dhe ushtarake ndërkombëtare e cila është pjesë përbërëse e Pakos Ahtisari. Ndonëse konsideron se Pakoja e Ahtisarit një balancim tejet delikat, është një kompromis i dhimbshëm, ekipi i unitetit mbetet fuqimisht pranë qëndrimit se kjo pako është e panegociueshme. Kjo për arsye se çdo prekje e këtij balanci delikat, këtë pako do ta bënte krejtësisht jofunksionale.

Të nderuar deputetë,

E vura theksin në këtë pikë, sepse edhe pas shpalljes së Pavarësisë të gjithë liderët institucionalë e kanë pasur moto e refren të qëndrime të tyre politike, faktin se Pakoja e Ahtisarit është një balancë delikate dhe kompromis i dhembshëm dhe se pakoja është e pa negociueshme, sepse çdo ndërhyrje e bën krejtësisht jofunksional shtetin e Kosovës. E pas dhjetë vjetësh të Pavarësisë së Kosovës presidenti Thaçi po paralajmëron edhe një proces të dhembshëm politik. Ai po flet me të njëjtën gjuhë dhe po përdor të njëjtat argumente edhe tash, kur po deklaron se bisedimet me Serbinë do të jenë të vështira dhe gjithashtu edhe marrëveshja finale do të jetë e dhembshme. Dallimi i vetëm është se atëherë është ditur publikisht se çfarë përmban pakoja e Ahtisarit, ndërsa sot Thaçi me diskutimin e tij politik po paralajmëron një marrëveshje të dhembshme, përmbajtjen e së cilës nuk e di sot askush.

Deklarimi i Thaçit se, mos të mashtrohet kush se Serbia do ta njohë pavarësinë e Kosovës “veç hajt”, lë të nënkuptohet se Kosova do të duhet të humbasë diçka e kjo humbje do të jetë e dhembshme. Kompromiset e dhembshme në bisedimet e Vjenës i dimë, ku nëpërmjet decentralizimit u formuan komuna me shumicë serbe, ku fshatra që ishin paralarje të Gjilanit iu bashkuan komunës së Novobërdës, e Lutfi Haziri deklaronte se ia bëme Serbisë “tetë me dy”.

Trashëgimia kulturore e Mesjetës iu dha Serbisë edhe atë bashkë me eks-territore të kishave dhe të gërmadhave të tyre. Pakicave iu dha e drejta e votës në çdo ndryshim të Kushtetutës, u pranua himni i Kosovës pa tekst dhe flamuri u ndërrua, që nuk ka asnjë shenjë identifikimi të shqiptarëve të Kosovës. Tash, pas dhjetë vitesh shteti i pavarur po hyn në një proces të dytë kompromisesh e marrëveshjesh të dhembshme dhe minimumi i dhembjes do të jetë autonomia veriore dhe asociacioni për komunat tjera me shumicë serbe. Çdo kompromis përtej kësaj nuk është më dhembje, por katastrofë dhe shembje e Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Në rrafshin politik Kosova i ka bërë kompromiset mbi të cilat u hartua Pakoja e Ahtisarit dhe u shpall pavarësia. Kompromiset politike ky Kuvend duhet t'i shpallë të mbyllura. Po ashtu, Kosova ka fituar edhe legjitimitetin juridik nëpërmjet Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. GJND-ja me qendër në Hagë, që përfaqëson gjykatën e nivelit më të lartë të Kombeve të

Bashkuara publikoi pasditen e datës 22 korrik të vitit 2010 opinionin këshillëdhënës lidhur me ligjshmërinë e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Gjatë fjalës së tij kryetari i gjykatës, Jasashi Ovada, tha: “Shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt të vitit 2008 nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare, me dhjetë vota pro dhe katër kundër gjykata është e mendimit, se Deklarata e Pavarësisë së Kosovës nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare dhe se sipas gjykatës, nga të gjitha të dhënat Pavarësia e Kosovës nuk ka shkelur, as Rezolutën 1244, si dhe kornizën kushtetuese të UNMIK-ut. Por për çudi, këtë argument kaq të fortë juridik liderët e Kosovës kurrë nuk e kanë përmendur, sikur dikush t’ua ketë ndaluar duke ju thënë “Harrojeni, tash filloni bisedimet teknike me Serbinë”. Madje, edhe vetë presidenti i Serbisë, Vuçiq, për nevojat e tij të brendshme po i akuzon kundërshtarët e tij politikë, se ata nëpërmjet kësaj gjykate e legjitimuan Pavarësinë e Kosovës, kurse liderët tanë u kujtuan tash ta përmendin tetë vjetorin e vendimit të kësaj gjykate apo jo.

Pra, çfarë i mungon Kosovës politikisht e juridikisht që të jetë shtet sovran? Asgjë nëpërmjet refuzimit të Serbisë. Dhe tash, pasi që Serbia po reziston karshi faktorit ndërkombëtar dhe po kërkon hise e territor brenda Kosovës, hajde tash ju që shquheni për kompromise të dhembshme, edhe një herë rishikoni se çfarë mund t’i merret Kosovës për ta pajtuar Serbinë! E për ta pajtuar Serbinë presidenti i Kosovës, me shumë gjasa, gjatë takimi të fundit në Bruksel ka pranuar rihapjen dhe rinegocimin e statusit politik të Kosovës, por këtë akt të rëndë, ashtu siç di ai, e kamufloi së bashku me pesë liderët tjerë politikë me lajmin e madh se “u mor pëlqimi për liberalizimin e vizave”.

Të nderuar deputetë, gjatë bisedimeve në Vjenë ishin tri parime themelore të grupit të kontaktit, me të cilat ishte pajtuar edhe Rusia, sipas të cilave: 1. nuk ka kthim në gjendjen e para vitit 1999; 2. nuk ka ndarje të Kosovës dhe 3. nuk ka bashkim të Kosovës me ndonjë shtet apo union tjetër. Këto tri parime kanë nënkuptuar edhe kornizat brenda të cilave është shpallur pavarësia e Kosovës. E nëse anashkalohet parimi i dytë, se nuk ka ndarje të Kosovës, atëherë nuk vlen as parimi i tretë, që thotë se nuk ka bashkim të Kosovës me ndonjë shtet tjetër dhe duhet t’i drejtohem me referendum sovranit popull për të pyetur në do ndarje të Kosovës apo bashkim të Kosovës me ndonjë shtet tjetër.

Gjatë një vizite në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në një intervistë dhënë Radio Evropës së Lirë lidhur me marrëveshjen finale me Serbinë, Hashim Thaçi, ka pas deklaruar, se ka ardhur koha që nëpërmjet referendumit për këtë çështje të vendosë sovranin, ndërsa tani nuk guxon ta përmendë fare referendumit.

Të nderuar deputetë, në fund kam një apel për kryeministrin e Kosovës, i cili për të disatën herë ka deklaruar se sipas tij ndarja e Kosovës apo këmbimi i territoreve do të thotë luftë.

Zoti kryeministër, për të mos ndodhur kjo që thoni ju jepni përkrahje këtij Kuvendi për ta hartuar e aprovuar një platformë të qartë politike, që pa aprovimin e tij të mos hap askush bisedimet me Serbinë. E kush rihapë e rinegocion statusin e Kosovës pa pëlqimin e këtij Kuvendi duhet ta dijë se shkel Kushtetutën dhe cenon sovranitetin, integritetin e subjektivitetin e shtetit edhe ashtu të munguar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Ky debat po shihet që në shumicën e rasteve ka devijuar nga tema që është thirrur. Është debati për dialogun, prandaj duhet të bazohemi në këtë temë dhe po ashtu, të mos lejojmë që vërtet të bëhet histori këtu, të përmenden procese të ndryshme në të cilat kanë qenë protagonistë edhe ata që po flasin. Dhe njëkohësisht, do t'u kisha thënë që të keni parasysh se cili ishte qëndrimi i kryeministrit Haradinaj. Ai tha: "Urdhëroni në Kuvend, merrni vendim, nxirreni një platformë e cila obligon ekipin negociues në bisedime". Dhe, të gjithë u pajtuan që janë për dialogun, për një dialog të strukturuar mirë dhe që sjell rezultate për Republikën e Kosovës.

Partia Social Demokrate i ka ofruar pikat, të tjerët po ofrojnë pika tjera, prandaj ju lutem, iniciuesi duhet t'i ofrojë pikat të harmonizohen me grupet parlamentare pavarësisht pozicioneve, pozitë-opozitë, ta shohin interesin e Kosovës siç po thirren në interes të Kosovës e nuk po veprojnë sipas fjalëve të tyre dhe të mos paragjykojnë asgjë. Përkundrazi, edhe ekipi edhe platforma, edhe bisedimet, të shkojnë në kahen çfarë i konvenon Kosovës. Lërimi përrallat tjera, po merrni me temën drejtpërdrejtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, nënkryetar!

Meqë si temë ndoshta është konsumuar mjaft dhe kemi folur edhe herë tjera në të, nuk po hyj fare në të, përpos që po e pyes kolegen meqë e shtroi një pyetje për Grupin e LDK-së, se a e kanë votuar zotin Thaçi. Unë vendi ku jam ulur është tepihu i djegur prej lotsjellësit që e ka qitur vetë kolegja për një kauzë, të cilën e ka harruar posa janë ulur në karrige.

Kisha me e pyet atë, a e ka votuar demarkacionin për të cilin e ka tymosur edhe këtë institucion të lartë të vendit edhe ka dhunuar popullin me logjika të tilla, që ata i kanë përdorur si kauzë për të ardhur në pushtet.

KRYESUESI: Hajde Teutë, diçka ke, s' di as vetë çka ke, po hajt.

TEUTA HAXHIU: Shumë faleminderit prej koleges sime!

Edhe një herë, pyetjen a e kanë votuar Hashim Thaçin dhe a kanë bërë president, njëra pyetje, po edhe për disa të tjerë, që ia kanë bërë edhe kuorumin. Kurse, asnjë moment, për asnjë moment nuk pendohem për atë që e kam bërë. Kemi arritur ta nxjerrim dhe besoj shumë në atë që kemi mundur të nxjerrim edhe duke i shti të tjerët që kanë nënshkruar të nënshkruajnë edhe diçka dhe e kemi lënë një hapësirë, sado që e dhembshmja dhe plaga ka ardhur pikërisht nga Qeveria e udhëhequr nga zoti Mustafa.

Pra, edhe një herë, a e keni zgjedhur Hashim Thaçin president? Përgjigjen e dua prej LDK-së dhe a e kanë bërë këta presidentë apo jo? Kurse, për atë që e kemi bërë asnjë moment nuk ia heq veprimin që e kam bërë.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë ka zonja Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Me e pyet zonjën Haxhiu ku ka mbërritur Komisioni për shënjim të vijës kufitare, a i ka filluar korrigjimet dhe tjetra, dua të pyes çka ka bërë me 250 nënshkrimet të qytetarëve, në emër të të cilëve kanë bërë zhurmë edhe më herët. Çka u bë me nënshkrimet, ku i kanë lënë që i kanë shty dhunshëm brenda dhe pse s'merren sot me ato nënshkrime të qytetarëve?

KRYESUESI: Fjalën e ka Drita Millaku.

DRITA MILLAKU: Të nderuar qytetarë,

Kundër marrëveshjeve të dëmshme kemi kundërshtuar shumë. Janë bërë shumë protesta, pothuajse në të gjitha komunat e Kosovës dhe ajo më e madhja nga paslufta u bë në Prishtinë, ku kanë marrë pjesë mbi 100 000 qytetarë. Gjithashtu, në kundërshtim të këtyre marrëveshjeve ka pasur edhe vendime të komunave, ku u miratuan edhe deklarata të drejtpërdrejta kundër marrëveshjeve për zajednicën dhe ato që e shoqërojnë atë.

Për t'i kundërshtuar marrëveshjet janë mbledhur mbi 205 000 nënshkrime, siç thanë edhe parafolësit e mi të qytetarëve të Kosovës dhe në atë kohë pjesë e këtyre kundërshtimeve kanë qenë edhe Ramush Haradinaj dhe Fatmir Limaj, për të cilët për çudi tani kanë ndryshuar qëndrim dhe sot bëhen pjesë e Hashim Thaçit për takimet e reja të dialogut të vjetër në Bruksel.

Në atë kohë zoti Haradinaj pat deklaruar se marrëveshjet kanë rrezikuar gjithnjë atë që kanë arritur, madje edhe Pavarësinë e Kosovës. Këto marrëveshje do të sjellin Kosovën para luftës, ka thënë ai. Ndërsa, zoti Limaj pati thënë, filluan me mashtrimin e madh, filluan duke i quajtur "bisedime teknike" e tashmë po përfundojnë ato duke e rrënuar shtetin nga brenda. Pyetjet tani i kam drejtpërdrejtë për zotin Haradinaj dhe Limaj, edhe pse nuk janë, mirëpo shpresoj që do të na përgjigjen.

Pse pra po e rrezikoni Kosovën dhe pse jeni bërë pjesë e këtij mashtrimi, meqenëse asgjë nuk ka ndryshuar, as formatin e dialogut e as personazhet që po merren me të. Kurrë më parë nuk ka pasur kundërshtim më të madh, se marrëveshjet për Zajednicën dhe ato për energjinë, telekomunikacionin dhe Suhadollin, nga brenda Kosovës, nga mërgata jonë, nga shqiptarët e Republikës së Shqipërisë dhe të tjerët në rajon. Përveç Qeverisë së atëhershme dhe kësaj të tanishmes askush nuk e pranon këtë kornizë të dialogut, që po e bën Thaçi me Vuçiqin.

Se dialogu ka dështuar kjo po duket haptazi. Unë dua të ndalem pak te platforma e Qeverisë së vitit 2011, ku ndër të tjera ky dialog filloi gjoja “dialog teknik”, duke përfunduar shumë shpejt në dialog krejtësisht politik për çështje të brendshme të Kosovës. Platforma e Thaçit kryeministër ka dështuar nga fillimi në fund dhe asnjë nga temat e saj nuk ka pasur zgjidhje, përkundrazi disa prej tyre kanë pësuar përkeqësim. Kanë kaluar shtatë vjet të plota, nuk ka rrugë tjetër për ne si përfaqësues të popullit dhe organizma të tjerë shoqërorë, përveçse të ndalemi e të bëjmë analizën e mirëfilltë. Krejt çka është dialoguar duhet të jetë pjesë e një shqyrtimi të hollësishëm dhe prej krejt kësaj duhet të nxjerrim zyrtarët përgjegjës të dëmeve që kemi pësuar.

Qeverisja e Kosovës me gjithë faktin se pretendonte të kishte hyrë në këtë dialog të ndërmjetësuar nga BE-ja si palë e barabartë kundrejt Serbisë, ajo asnjëherë nuk u trajtua si e tillë, as nga BE-ja, as nga Serbia, por as përfaqësuesit tanë nuk e trajtuan veten si të tillë. Marrëveshjet paraprake të nënshkruara të cilat fare nuk janë zbatuar tregojnë shumë mirë mosgatishmërinë për bashkëpunim të ndërsjellë reciprok të Serbisë karshi Kosovës. Njëra nga këto marrëveshje ka qenë ajo që ka të bëjë me kthimin e dokumentacionit kadastral të marrë në kohën e luftës, që asnjëherë nuk është zbatuar, pasi që e vetmja gjë që është arritur të kthehet ka qenë një listë dokumentacioni që i përket qytetit të Suharekës, kur dihet mjaft mirë se në territorin serb ndodhen mbi 12 milionë dokumente kadastrale dhe civile, që u takojnë regjistrave kadastrale në territorin kosovar.

Pra, në platformën e vitit 2011 ka qenë edhe kjo pikë, por nuk është bërë asgjë në këtë drejtim. Temë tjetër mjaft e rëndësishme e cila nuk është prekur kurrë në dialog, është fondi pensional, invalidor dhe familjar, i grabitur nga shteti i atëhershëm serb i vitit 1999. Pra, janë mbi 20 vjet që djersa e 80 mijë kontributdhënësve tanë mbahet pa të drejtë nga Serbia. Mbi 30 mijë qytetarë kontributdhënës tanimë kanë vdekur dhe kjo temë ka qenë platformë e vitit 2011, por për shtat vjet rresht dialog nuk është bërë asgjë.

Kosova në aspektin kulturor gjatë kohës së luftës është dëmtuar mjaftë ndjeshëm pasi që thanë edhe shumë kolegë parafolës, pasi që një numër i madh i monumenteve kulturore të shkatërruara ka qenë mjaftë i madh. Një dëm tjetër edhe më i rëndë i është shkaktuar me vjedhjen e 12 mijë eksponentëve dhe artefakteve duke i zhvendosur në muzetë e qyteteve serbe pa të drejtë, pasi që ato i takojnë historisë dhe kulturës sonë, fatkeqësisht edhe për këtë pikë nuk është bërë asgjë. Artefaktet qëndrojnë në Serbi për shtat vjet dialog.

Çështje e një rëndësie tjetër të veçantë ka qenë edhe në platformën e qeverisjes për dialog të vitit 2011, ishte edhe ajo për pronat të cilat i kanë takuar Kosovës nga ish-federata e Jugosllavisë, të cilat po ashtu pa të drejtë janë marrë dhe posedohen nga Serbia. Edhe kjo ka qenë në platformë, por s'që është hapur si temë në dialog.

Në platformën e vitit 2011 përmendet edhe demarkimi me Serbinë. Në këtë formacion të pushtetit që e kemi nuk kemi tjetër çka të mendojmë, përpos katastrofës, nga e cila rrezikohemi dhe problemet janë vetëm janë shfaqur sërish duke filluar me Karaçevën e në vazhdim do të ketë më së paku mbi 50 vende tjera problematike si Karaçeva.

Me platformën e vitit 2011 shkruhej se temë e dialogut do të jenë edhe dëmet e luftës dhe kjo temë nuk u hap asnjëherë në dialog. Serbia i ka borxh Kosovës për dëmet e luftës, të cilat llogariten afër 20 miliardë euro. Kohëve të fundit, çdo herë e më shumë po përmendet nga udhëheqësit tanë në dialog e sidomos nga Hashim Thaçi, se po afrohet koha për vendime të rënda e të dhembshme. A thua, në çka po aludohet? A mos po synohet t'u bëhet me dije qytetarëve se shpëtimi i lëkurës së Thaçit mbart me vete një kosto mjaftë të lartë, cila duhet të paguhet me dhembje apo shkëmbim territori, ose edhe me krijimin e komunave autonome brenda Kosovës, e cila do të ishte mjaftë e dëmshme për stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e institucioneve të vendit. Mjaft me marrëveshje të fshehta e të dëmshme!

Mjaft me tradhti prapa shpine!

Nuk ju duron më askush!

Asnjë nuk ka kohë të ju mbajë në kurriz!

Hashim Thaçi, Ramush Haradinaj dhe asistentë tjerë të pazareve, duhet të shkoni!

Shtatë vjet padrejtësi të reja iu shkaktuan Kosovës. Edhe dhjetë vjet tjera Thaçi po do të na mbajë peng derisa t'i mbarojë Gjykata Speciale të gjitha rastet. Aq shumë mashtrime keni bërë, aq shumë gabime, aq shumë dëme, sa për besë e keni katandisur aq shumë për të keqen më të madhe që i keni bërë Kosovës prej pasluftës.

KRYESUESI: Faleminderit! Bilalli ka kërkuar replikë.

BILALL SHERIFI: Faleminderit! Po, sa herë të përmendet partia deri më tani është dhënë replikë, prandaj edhe unë e kërkoj.

Për zonjën Millaku, si duket... po e përmend Nismën, Glauk, qe po ta përmend emrin, që të ta jap pretekstin që të kërkoj ti replikë. Unë mendoj që mos kërkon armiq, as kundërshtarë, aty ku

nuk keni, por meqë e bëtë një pyetje, tash po ju përgjigjem me një pyetje. A i besoni ato që i thatë apo veç i lexuat sa për ta vënë re, ato që ua ka dhënë komiteti për t'i lexuar e të kërkoni edhe ku s'ka hiç kundërshtarë, ku s'ka hiç armiq. Limaj i di përgjegjësitë e veta, është kryetar i një partie politike që nuk u jep juve llogari, u jep zgjedhësve të vet, u jep organeve të veta dhe e keni pasur rastin sot ta dëgjoni, ka qenë jashtëzakonisht konstruktiv. Ka zgjatur dorën e bashkëpunimit në përmbajtje dhe në format. Nëse keni ndonjë ide, që deri më tash nuk dëgjova asnjë ide, për të kontribuar se si të ecet përpara, atëherë që paku, së paku, mos u merrni me shpifje, sepse për asnjë moment, as Nisma, as zoti Limaj, nuk ka hequr dorë nga të gjitha ato për çka ka qëndruar gjatë kohës sa ka qenë në opozitë apo gjatë kohës sa kemi qenë në pozitë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër replikë zonja Millaku.

DRITA MILLAKU: A i besoja asaj që thash? Po, i besoj dhe them me përgjegjësi të plotë, Hashim Thaçi duhet të largohet, sepse ka bërë koncesione shumë të dhembshme, ndërsa Ramush Haradinaj i është bërë argat atij. Kjo është arsyeja për të cilën ata duhet të largohen.

KRYESUESI: Faleminderit! Hajde edhe ti, pasi që edhe ty ta përmendën kryetarin.

TIME KADRIJAJ: Ne nuk e kemi autorizuar atë zonjën e nderuar, as të flasë në emër të kryeministrit, sepse as s'e kemi zëdhënëse të Qeverisë, se s'e pranojmë as me atje poshtë roje e Qeverisë të jetë. Po çka të flasim ne me këta, kur s'e pranojnë as shtetin e Kosovës, as simbolet e Kosovës dhe gjithçka çka... as himnin e Kosovës. Edhe në evenimente, të cilat janë shumë të rëndësishme, ata nuk ngritën në këmbë duke thënë se janë patriotë. Patriotë nuk është me fjalime të zjarrta, sikurse po i mbajnë këta. Po, patriot është të shkosh aty ku është vendi, të bisedosh dhe t'i shprehësh shqetësimet dhe të mos na dhunojnë këtu në Parlamentin e Kosovës me deklaratat e tyre.

KRYESUESI: Faleminderit! Arbër Rexhaj, kundër-replikë!

ARBËR REXHAJ: Në fakt, krejt diskutimi që u shtrua këtu ishte për dialogun dhe Lëvizja Vetëvendosje përherë mundohet t'u ikën këtyre individualizmave, se s'kemi ardhur këtu për ta mbrojtur veten, po flasim për çështjen.

Në fakt, meqenëse u përmendën fjalimet e zjarrta po dua ta them një gjë. Është shumë e vërtetë, që Lëvizja Vetëvendosje mban fjalimet më të mira në Kuvend. Nëse e patë ju, i patë të gjithë deputetët tanë që ishin të angazhuar me tema të caktuara dhe tejet të përgatitur dhe sigurisht që koleges deputete i duket e çuditshme kjo, sepse nuk ka praktika në partitë tjera siç kemi ne. Dhe prandaj, kërkesat tona për dialogun, thashë edhe në fjalimin tim, duhet t'i përfshijnë dy gjëra:

pikat e Lëvizjes Vetëvendosje dhe heqjen e Hashim Thaçit si bartës i dialogut. Nëse e bëhen këto, sigurisht që ne edhe mund të diskutojmë. Mirëpo, siç po e shoh nuk ka vullnet këtu.

KRYESUESI: S'ke replikë, nuk ta përmendi emrin o burrë! Ky bëri kundër-replikë! A po, po ta ka përmendur kryetarin e Kosovës! Kundër-replikë ka Timja njëherë, e pastaj shohim e bëjmë.

TIME KADRIJAJ: Po fakt se subjektet e tjera politike nuk kanë emisarë politik të cilët i përcjellin seancat e Kuvendit të Kosovës dhe pikë për pikë i shkruajnë. Mua po më çudisin disa deputetë që sa herë po flasin mezi po e lexojnë atë referat që ua ka shkruar dikush. Se është normale kur nuk e shkruan vet nuk e ndjen vetë si është, ti do ta lexosh pikë e presje, sepse nuk e di se çfarë ke shkruar vetëm e lexon sikur ta marrësh një roman ta lexosh. Dhe është mirë këta të merren me subjektin e vet politik mos të merren me kryeministrin sepse nuk e kanë begraundin, nuk e kanë begraundin e kryeministrit tani me fol kush që po flet këtu.

KRYESUSI: Leje pashë Zotin. Leje, apo e lëmë, se tani të gjithë duan të çohen. Hajde Nezir edhe ti, një replikë apo kundër-replikë, çfarë ke?

NEZIR ÇOÇAJ: Nënkyetar, faleminderit shumë për mundësinë që ma dhe se po dua të flas, se kryetari ish-kryetari i partisë sime e ka shpallur pavarësinë dhe ka kontribuar për këtë shtet. E është këtu një parti që nuk e njeh këtë shtet. Unë e kuptoj që këta kërkojnë që Hashimi të tërhiqet nga dialogu, sepse ka qenë njeri, ju e dini cilësimet çfarë i kanë bërë edhe nga aspekti ndërkombëtar, aktoret që sot vendosin për politikën botërore.

Prandaj, këtyre u pengon Hashim Thaçi dhe merren vetëm me emër të Hashim Thaçit. Ne e kemi diskutuar sot edhe duhet të diskutojmë. Ejani, ejani ta formojmë një delegacion të përgatitur profesionalisht, çdo pikë dhe çdo temë jemi të interesuar ta diskutojmë atje, po bashkëngjitet hyni në ekip. Është lehtë me shikuar televizorin po është mirë me hy në ekip edhe me marr përgjegjësi bashkë.

Këtë e ka kërkuar edhe Hashim Thaçi edhe lideri aktual i Partisë Demokratike të Kosovës, këtë e kemi kërkuar edhe sot edhe ne si deputetë në Kuvendin e Kosovës. Prandaj, mos t'ju bëjë goja shumë, por nuk ka njeri tjetër pos Hashim Thaçit të bëjë bisedime dhe dialog, përkatësisht të punojë për shtetin e Kosovës. Unë e kuptoj që nuk doni ta njihni këtë shtet, nuk doni t'i njihni të gjitha ato që i atribuohen shtetit, por nuk është..

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Kujtim Shala. Kujt po do t'ia vazhdosh... Boll, boll! Nuk ka më!

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti nënkryetar,
Të nderuar kolegë,

Do të përpiqem të jem i shkurtër meqë jemi në fundin e një debati tepër të gjatë, por unë besoj që ka qenë një debat tepër i reduktuar në rastet të caktuara për shkak të motivimit të personal. Në disa raste për shkak të keqkuptimeve, në raste të tjera për shkak të pozicionimeve politike.

Unë besoj që kjo, si çështje së pari dhe në rrafshin themelor është kushtetuese, prandaj lidhet edhe me përfaqësimin e Kosovës. Nuk mendoj që kjo duhet të kthehet në një debat të ri për çështjen e vjetër se kush e zgjodhi presidentin, kush e votoi ose jo. Ne duhet të flasim për natyrën e institucionit dhe për natyrën e përfaqësimit. Por, kjo nuk do të thotë që ne nuk duhet të vlerësojmë punën e personave në funksionet publike, qoftë edhe kur kanë në periudha të ndryshme funksione të ndryshme publike.

Tani si qëndron çështja me përfaqësuesin që ne dëshirojmë ta quajmë drejtues të ekipit cilido qoftë ai. Një ekipi më të gjerë, apo përfaqësues të shumicës. Unë besoj që problemi dhe pengesa themelore është kushtetuese. Sepse funksioni i presidentit si reflektim i unitetit, nënkupton një përfaqësim simbolik. Ekspertët e fushës së interpretimeve kushtetuese e quajnë përfaqësimin simbolik dhe formal. Çfarë do të thotë kjo?! Që të jetë më e thjeshtë për të gjithë dhe sidomos për ata që na ndjekin.

Presidenti i vendit mund të përfaqësojë institucionet, në institucione dhe në raporte bilaterale në ato raste kur Kosova ka ndërtuar raporte. Ndërkaq, ne kemi përpara një proces të cilin e quajmë: 'Dialog për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë', që do thotë me një shtet me të cilin nuk kemi raporte normale, i cili nuk na njeh, jo vetëm që nuk na njeh por edhe na pengon. Tani në rrafshin kushtetues, përfaqësues, i dhe mandat ose jo është Qeveria, por kur kemi çështje specifike si kjo normalisht që duhet të mandatohen. Prandaj, në vitin 2011, Qeveria e Kosovës është mandatuar që të drejtojë këtë proces.

Ky nuk është proces i ri. Tani ne po flasim për një fazë finale. Nuk duhet të jemi kaq të sigurt. Unë besoj që si fazë finale është e mundshme, por unë nuk besoj që ne po flasim për njohjen reciproke të dy vendeve. Dhe jo si qëndrim, po si mendim personal e kam se kjo çështje do të marr edhe një kohë relativisht të gjatë. Prandaj, nuk kemi pse të nxitojmë! Ky proces, edhe po të dëshirojmë ne, sikurse dëshirojnë përfaqësuesit ndërkombëtar dhe institucionet ndërkombëtare qofshin ata miq ose jo, nuk mund të përmbyllet për kaq kohë sa po projektohet. Dhe po ashtu mendoj që nëse mbyllet për një kohë të shkurtër, dhe mbyllet me njohje reciproke ai nuk do të jetë në asnjë rast rezultat i favorshëm për Kosovën. Sidomos kur keni parasysh raportet në së paku tri dekadat e fundit që kemi ne, dikur si një krahinë e tani si shtet me Serbinë.

Tani, po pse po bisedojmë?! Çfarë duhet të normalizojmë? Cilat është çështja? Po të mos ishte problemi faktit i Veriut të Kosovës ne nuk do të bisedonim me Serbinë. Unë nuk besoj që Serbia po e përdor si argument ose si kartë themelore në këtë rast Asociacionin sepse i duket tepër pak. E pse? Sepse ndikimi i saj, sot, aktualisht, ne duhet ta themi është shumë më i madh sesa që do të

mund të ndikonte nëpërmjet një mekanizmi të tillë. Por kjo nuk duhet të shtrohet si çështje terriroresh. Nëse e shtrojmë kështu ne pranojmë të bisedojmë për rezistencën e shtetit tonë. Që do të thotë për ekzistencën e atdheut tonë, se s'kemi atdhe tjetër!

Të gjitha debatet për rivendosje drejtësie, për rivendosje terriroresh, për kompensim terriroresh nuk kanë bazë të vërtetë sepse nuk ka pasur lëvizje të mëdha terriroresh. Asnjëherë Leposaviqi s'ka qenë pjesë e Serbisë. Kanë qenë katër-pesë katunde të cilat përbëjnë disa mija hektarë që i janë bashkuar Kosovës. Duhet të keni parasysh këtë fakt.

Tani, pse ekzistojmë ne si shtet në perspektivën e ligjit ndërkombëtar? Sepse Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka dhënë në vendim, një opinion që na e njeh këtë të drejtë. Besoj ju kujtohet që, dikush e tha në fillim kur bisedonim për çështjen e Pavarësisë së Kosovës, që Kosova është një rast sui generis dhe të gjithë pa e ditur që po punojnë kundër interesit të Kosovës thoshin që “Kosova është një rast sui generis”.

Opinion i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë thotë që: “Kosova vërtet nuk është një rast sui generis”. Pse? Sepse është si të gjitha të tjerat! E pse? Sepse është në përputhe me ligjin ndërkombëtar, me të drejtën ndërkombëtare. Kjo na jep të drejtë neve që të sillemi si shtet edhe në këtë rast. Unë do t'i kthehem shumë shkurt çështjes së Asociacionit. Baza e saj politike e kthyer në një bazë kushtetuese; është aneksi 3 i pakos së Ahtisarit, paragrafi 9.1, i cili normalisht nuk e projektonte kështu si i bë me marrëveshjen e vitit 2015. Këtë duhet ta themi. Ua njeh të drejtën komunave por organizime të asaj natyre. Jo plotësisht kështu.

Ajo marrëveshje i jepte një ekskluzivitet politik dhe është normale për proceset e dialogimit politik, tek ato rezultate çojnë. Por, baza kushtetuese dhe unë besoj që ne duhet të jemi të kujdesshëm dhe të mos e kualifikojmë përtej saj. Baza kushtetuese e saj është marrëveshja e viti 2013, sepse është ratifikuar dhe opinion i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës thotë që: “Asociacioni të themelohet sipas Marrëveshjes së vitit 2013”.

Kjo, unë besoj që atë e bënë një mekanizëm të parrezikshëm. Nëse debati kthehet rreth saj, ose që ta them pak më qartë, nëse kamuflohet ajo që duhet t'i jepet një etnie nën emrin e saj, atëherë ne jemi para një problemi të ri, që s'është Asociacioni, që s'është problemi i vjetër. Që të jemi korrekt, Gjykata Kushtetuese nuk ka vlerësuar kushtetutshmëri sepse nuk ka pasur përpara një akt juridik, por një marrëveshje pa fuqi juridike sepse nuk ka qenë e ratifikuar. Dhe mekanizmi i kontrollimit të saj është pikërisht marrëveshja. Një paragraf i veçantë, i cili e implikon drejtpërdrejt Gjykatën Kushtetuese dhe kur implikon Gjykatën Kushtetuese implikon pushtetin interpretues politik dhe juridik suprem të Kosovës. Përtej tij nuk ka dhe ne nuk guxojmë të bisedojmë përtej saj.

Të gjitha këto që po them unë, besoj që janë shenja që lënë të kuptohet që ne mund të vazhdojmë të dialogojmë me Serbinë pa e cenuar frymën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe normalisht pa rënë asnjëherë ndesh me ligjin ndërkombëtar. Debatet tona të brendshme as nuk duhet dhe as nuk mund të kthehen në argumente kundër kësaj që po them unë. Tani ne na duhet legjitimitet sepse nëse shohim me kujdes në rrafshin kushtetues kjo është çështje e zgjidhur, por legjitimiteti është politik, ajo që të jep Kushtetuta është juridike në radhë të parë, pastaj bëhet politike sepse prodhon rezultat, produkt.

Këtë legjitimitet ne mund ta marrim vetëm me votë. Lidhja Demokratike e Kosovës partia së cilës i përkas unë, është gati që të drejtojë këtë proces, por ne kërkojmë që kjo e drejtë të na jepet drejtpërdrejt nga qytetarët e Kosovës. Dhe sot dëshiroj të theksoj, Vjosa ka përmendur një element të rëndësishëm, që është edhe ide e LDK-së, që nëse cenohet legjitimiteti ose nuk na duket i mjaftueshëm, është shumë normale që ne të provojmë që këtë çështje ta zgjidhim me referendum.

KRYESUESI: Vazhdojani edhe një minutë Kujtimit.

KUJTIM SHALA: Faleminderit shumë.

Ata që në na zgjedhin ne e kanë legjitimitetin në çdo rast. Unë besoj që kjo është rruga dhe unë besoj që ky është shansi që ne të merremi vesh, që të legjitimohemi dhe pastaj të ecim që njerëzit të cilët dalin në krye me votë popullore të jenë edhe në krye të procesit dhe të tjerët t'i bashkohen. Nuk mund të drejtohen këto procese, tani e dini është edhe kusht ndërkombëtar dhe kërkesë e tyre që ata që drejtojnë procesin duhet të kenë së paku mbështetjen e 2/3-tave të përfaqësuesve të qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Glauk a replikë apo do të diskutosh? Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Tash pikërisht desha të kyçem këtu ku e la Kujtimi sepse e hapi një temë shumë interesante dhe pati një diskutim substancial. Kjo është e lidhur me produktin më të rëndësishëm që e ka sjellë dialogu me Serbinë e që është krijimi i Asociacionit të Komunave me shumicë serbe.

Unë mendoj që janë katër probleme të mëdha me këtë krijimin e Asociacionit të Komunave Serbe. Unë çka e refuzoj kategorikisht dhe mendoj që nuk ka qenë në rregull me krijimin e Asociacionit të Komunave serbe ka qenë për t'ia dhënë statusin e marrëveshjes ndërkombëtare. Kjo është marrëveshje ndërkombëtare faktikisht.

Faktikisht me vetë faktin se e ke nënshkruar me Serbinë për të krijuar një asociacion komunal në Kosovë, kjo për mua është e papranueshme, është problem i madh, është problem në vetvete, sepse nëse thua se Asociacioni i Komunave serbe ka bazë në dokumente të Kosovës, pra kur i

referohesh Planit të Ahtisarit, nuk mund të thuash ta bëjë Asociacionin e Komunave serbe duke shkuar ta bësh me Serbinë Asociacionin e Komunave serbe. Kjo është gabim i pafalshëm, gabim politik trashanik, me pasoja shumë të mesha për shtetin e Kosovës. Për shembull, në Plan të Ahtisarit shkruan edhe kështu, do të krijohet Këshilli për Komunitete. A të shkojmë tash ta krijojmë Këshillin për Komunitete duke diskutuar me Vuçiqin? Është gabim! Çka është në Plan të Ahtisarit, ti nuk e ke detyrë për ta krijuar në marrëveshje bilaterale me Serbinë. Atëherë pse kur themi se duhet të krijohet Asociacioni i Komunave me shumicë serbe, e kur e marrim referencë Planin e Ahtisarit po u dashka të shkohet të krijohet më marrëveshje me Serbinë? Është gabim!

Pra problemi më i madh dhe gabimi më i madh i institucioneve të Kosovës dhe liderëve që na kanë përfaqësuar kur kanë shkuar të bisedojnë me Vuçiqin këtë punë, është ta vënë në tavolinë dhe për t'ia dhënë formën Asociacionit të Kosovës në marrëveshje me Serbinë. Ky është problemi i parë!

Problemi i dytë është pse Asociacioni të quhet marrëveshje e parë. D.m.th. ia kanë dhënë një emër, ia kanë bërë një kualifikim. Kështu ia kanë bërë edhe një kualifikim, duke thënë se kjo është vetëm marrëveshja e parë. Tash kjo i hap disa probleme të reja. Cila qenka marrëveshja e dytë? Cila qenka marrëveshja e tretë? Tani, atë që prej Kosovës është konsideruar si çmimi më i lartë i mundshëm që Serbia të krijojë një autonomi këtu, ti e ke quajtur marrëveshje e parë. A po e shihni gabimin e dytë të institucioneve tona dhe atyre që kanë dashur të na përfaqësojnë?

Problemi i tretë me Asociacionin është kur po themi se gjithçka është në rregull. Gjykata Kushtetuese na ka treguar si duhet ta bëjmë. Më falni, por në shkelje nuk ka restaurim të gjendjes së mëparshme. Kur e ke shkelur Kushtetutën, nuk mund të thuash se nuk u bë asgjë, Gjykata po na tregon si ta bëjmë një asociacion tjetër. Unë mendoj se në logjikën e të drejtës, në logjikën e Kushtetutës, në logjikën e të drejtës penale, nuk ka restaurim të gjendjes së mëparshme, e ke shkelur Kushtetutën dhe nuk mund të thuash se është shkelur në 23 vende dhe tash është shlyer ajo e tash do të dimë si të bëhet ajo. Kur shkelet Kushtetuta në vendet serioze zonja e zotërinj nuk është kjo hajgare që shlyhet kjo me një muhabet goje, të thuhet tash u krye kjo e po kthehemi në gjendjen e mëparshme. Veprat penale, bile kjo nuk është çfarëdo vepre penale, kjo është shkelje e Kushtetutës, unë mendoj se në kategorizimet politike të shkeljeve, mua më duket shkelja më e rëndë. Nuk mund të amnistohesh prej nënshkrimit të shkeljes së Kushtetutës.

Unë mendoj se gabimi i katërt me Zajednicën, kjo është arsyeja pse nuk e pranojmë, jo të themi një version i çfarëdoshëm është i parrezikshëm, por unë mendoj se është i rrezikshëm sepse e ka karakterin etnik, Zajednica e ka karakterin etnik. Thotë aty, emri i saj është Bashkësia e Komunave me shumicë serbe. Mua nuk më duket në rregull kjo. Në shtetin e Kosovës të ketë zgjidhje etnike ku thuhet serbe, unë mendoj se është dëmtuese për shtetin e Kosovës, unë mendoj se nuk duhet të pranohet. Në momentin kur ke zgjidhje etnike, kur thuhet se komandanti i rajonit

të policisë duhet të jetë serb, dhe Serbia paska të drejtë sipas atij raporti të na dërgojë emrat e dy serbëve që patjetër serbë duhet të jenë, kjo është diskriminuese, kjo është kundër vlerave evropiane, ne aty duam të shkojmë, po them i në Evropë, po e përmendim Këshillin e Evropës, sipas të gjitha rezolutave dhe dokumenteve më të rëndësishme të BE-së, prej Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nuk lejohet të jenë diskriminuese këto zgjidhje. Ky është problemi i katërt shumë i madh i Zajednicës.

Tash edhe lidhur me disa pasaktësi të tjera. Këtu unë i përmbloodha disa, e dëgjova debatin e paradites me vëmendje, prej orës dhjetë isha këtu dhe kam dëgjuar secilin që ka folur këtu. Unë i grumbullova disa kështu që mua më duket naivitete që duhet t'i refuzojmë dhe dekonstruojmë. E para, po flisni shumë për Hashim Thaçin, po e përmendi shumë Hashim Thaçin. Kjo nuk është e pjekur politikisht të flitet kështu, po e përmendni shumë Hashim Thaçin. Ai e ka marrë e ka qit mbi vete dialogun, ai po shkon po bisedon e Serbinë, ai po i he vijat e kuqe. Ai ka për të vendosur për shtetin tonë, ai po thotë unë kam për të vendosur për shtetin e Kosovës, kam për të bërë një kompromis të dhimbshëm për Kosovën. Ai do të vendosë për fëmijët tanë në çfarë Kosove do të jetojnë. Po kjo është naive të thuhet mos u merrni me Hashim Thaçin. Hashim Thaçi po merret me Kosovën, Hashim Thaçi fëmijës tim do t'ia caktojë ku ka për të jetuar, çfarë jete do teje, çfarë shkollimi do të bëjë e ju po thoni mos u merrni me Hashim Thaçin. Pra, është gabim elementar të thuhet kështu.

E dyta, pse ju nuk po e mbështetni Hashim Thaçin, sepse kështu i jepni atij fuqi, ishte konkludimi i dytë i debatit. Hashim Thaçi në karrierën e vet ka treguar se është ekspert për të prodhuar kundërshtarin politik. Ai nuk është ekspert për të bërë miq, ai është ekspert për të bërë kundërshtarë politikë. Nëse e shihni se si ka vepruar me Lëvizjen Vetëvendosje prej vitit 2005 me burgje me arrestime, e deri te rrëzimi prapa shpinës i koalicionit me LDK-në vitin e kaluar, këto tregojnë për një person që metodën elementare të veprimit politik e ka intrigën, jo bashkëpunimin, kurse tash ju po ankoheni se pse nuk po i besoni. Por, si t'i besojmë? Ky njeri është ekspert i mosbesimit, për të prodhuar mosbesim. Nuk i kemi fajet ne, por i ka fajet ai me veprimet e veta politike, ka shkuar duke u bërë e më shpirtngushtë politikisht, fuqia ka shkuar duke i rënë dhe me këtë ju duhet të pajtoheni. Pse? Sepse metoda dhe qëllimi i tij bazik është që të jetë i përjetshëm në politikë. Por, nuk mundesh kështu, nuk mund të jesh i përjetshëm në politikë, kryeministër në pushtet, prej presidentit kryeministër, prej kryeministrit në president. Me këso veprime dhe të mundohesh të jesh mirë me të gjithë, i dashur prej populli, prej opozitës, kjo nuk është e pamundur për Hashim Thaçin. Prandaj, kritikata tona edhe pse flasim për të janë plotësisht të arsyeshme, ai njeri nuk e ka krijuar vendin që të jetë i pranueshëm, po do të na ofrojë një dialog, por nuk mund të na sjellë sepse këtu duhet të votojë me 80 vota.

KRYESUESI: Faleminderit Glauk! Zoti Kujtim Shala ka replikë.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Dëshiroj të bëjë dy tri saktësime, disa gjëra më duhet t'i përsëris siç i thashë që të kuptohen drejtë. Unë e para e pranova dhe e përsëris që marrëveshja e viti 2015 ka ekskluzivitet politik, por ajo nuk është marrëveshje ndërkombëtare. Marrëveshje ndërkombëtare është ajo e vitit 2013, e ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës dhe kështu kthehet në detyrim kushtetues dhe ju e dini se nëse shkon përtej kësaj është detyrimi. D.m.th. ky është fakti, kurse shkelje të akteve të ndërmjetme nuk mund të ketë.

Aktet juridike janë veprime dhe ato konsiderohen shkelje, edhe formulimet e Gjykatës Kushtetuese janë të një natyre tjetër. Por, shumë më e rëndësishme është elementi që unë po e përsëris edhe një herë, vetë marrëveshja e vitit 2015 kërkon që vetë të interpretohet nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Kjo është çështja themelore, sepse duket i fortë formulimi im se ai mekanizëm i parë kështu nuk është i rrezikshëm. Çfarë kam parasysh këtu, saktësisht që ai të jetë një mekanizëm monoetnik. Monoetnik e thotë marrëveshja e parë e vitit 2013, por jo interpretimi i Gjykatës Kushtetuese dhe kjo e kthen në shtratin dhe në frymën e Kushtetutës së Kosovës. Këto janë ato që pak a shumë thash unë, ndërsa Pakoja e Ahtisarit, ju nëse doni mos e ju referoni asnjëherë, ajo nuk është kthyer në një marrëveshje ndërkombëtare, por është akti themelor nga i cili ka dalë Kushtetuta e Kosovës, kushtetuta e cila ne e kishim për aq sa zgjati pavarësia e mbikëqyrur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca, kundër-replikë!

GLAUK KONJUFCA: Jo saktësisht ashtu si po e thotë Shala edhe unë e mendova. E mendova për Marrëveshjen e vitit 2013, që është miratuar këtu me 80 vota, pra ajo është gabim. Të krijosh Asociacion të Komunave serbe me 80 vota në marrëveshje me një shtet tjetër, pra ia ke dhënë një diçka që ka mbështetje në dokumentet e tua të brendshme siç po e thua vetë, përmendet diku se kanë të drejtë një asociacion edhe në Plan të Ahtisarit, ti ke shkuar dhe e ke qit në tavolinë me Vuçiqin dhe ia ke dhënë formën, së paku formën, sepse kur ta miratosh një marrëveshje me 80 vota, ajo po i bie se ia ke dhënë formën e marrëveshjes ndërkombëtare. Unë këtë e cilësoj një gabim trashanik të gjithë atyre që e kanë ngritur atëherë dorën që atëherë me ia dhënë karakterin e marrëveshjes ndërkombëtare. E dyta, prapë unë konsideroj se kjo ka karakter etnik.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Saranda Bogujevci.

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit, kryesues!

Vetëm desha të flas për disa çështje që kanë të bëjnë me çështje të luftës.

KRYESUESI: Nëse ke folur, ke folur të enjten. Tani nuk ka diskutues të tjerë! Jo, dy herë për të njëjtën çështje jo. Unë nuk e dita se ka diskutuar. Bekim Haxhiu ka replikë ndaj Shalës.

BEKIM HAXHIU: Po dua të replikoj me dy diskutuesit e fundit sepse po i referohen marrëveshjes së vitit 2013, asgjë më shumë e as më pak nuk ka në atë marrëveshje se në Pakon e Ahtisarit. Pakoja e Ahtisarit është votuar në këtë Kuvend me dy të tretat dhe çdo ripërsëritje nuk është diçka e re po është ajo përsëritje e asaj që ka ndodhur. Nuk po dua të mbrojë askënd përveç asaj që e tha zoti Shala se nëse shkojmë në zgjedhje i jepet një legjitimitet dikujt tjetër për të udhëhequr dialogun. Ky Kuvend ka legjitimitetin e plotë për të bërë ekipin negociues, ekipin e unitetit, sepse është dalë nga zgjedhjet më të mira të dala pasluftës në vitin 2017 dhe kush e mohon legjitimitetin e këtij Kuvendi do të thotë se është gabim, vetëm ka një ambicie për të ardhur në pushtet, për të shfrytëzuar dialogun si mundësi për të ardhur te pushteti. Por, edhe pas atyre zgjedhjeve kemi për të ardhur te momenti kur duhen dy të tretat të vendosin prapë për dialogun dhe prapë me konsensus nëse nuk e arrijmë sot. Prandaj, më mirë ta arrijmë sot sesa të prodhojmë situata të paqena. Faleminderit!

KREYESUES: Faleminderit! Prapë Kujtim? Kundër-replikë, Kujtimi!

KUJTIM SHALA: Faleminderit!

Jo! Vetëm sa për sqarim, unë mendoj që 2/3-at si procedurë është e njëjta gjë, por Pakoja e Ahtisarit dhe marrëveshja e vitit 2013 janë gjëra plotësisht të ndryshme, domethënë nuk mund të shpjegohen, s'mund të reduktohen në shpjegim të procedurës.

Ndërkaq, sa i takon legjitimitetit, unë e pata fjalën jo për legjitimitet juridik kushtetues, po për legjitimitet politik. Nëse keni legjitimitet manifestojeni dhe ju duhet ta manifestoni me votë. Kërkohen dy të tretat, na jepni 2/3-at dhe zgjidhet kjo çështje.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë nuk desha të diskutoj, por mendoj që keni diskutuar mjaftë. Besoj që askush në Kosovë nuk e ka të drejtën të falë asnjë metër katror tokë. Dihet vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare dhe në përputhje me atë duhet të zhvillohen edhe bisedimet.

Tani fjalën e ka propozuesi i çështjes, respektivisht zoti Visar Ymeri, që të thotë fjalën përfundimtare dhe kërkon normalisht nga ju deputetë, mbështetjen.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Nuk qenka askush nga Kabineti qeveritar!

Qytetarë të Republikës,

Ky debat ka filluar të enjten, mirëpo për shkaqe objektive natyrisht që u desh të vazhdojë sot, sepse nuk arritëm ta përfundojmë atë ditë. Pati shumë diskutime natyrisht prej deputetëve. Konsideroj që një pjesë e deputetëve diskutimet i patën të dobishme do të thosha, mirëpo në ditën e gabuar. Pra, diskutonin për diçka që nuk ishte temë, sepse siç e parashtrova edhe atë ditë kur e hapëm këtë pikë të debatit edhe me rezolutën që e propozuam, ky nuk ka qenë i menduar të

jetë debat për dialogun si të tillë, po ka qenë i menduar të jetë debat për vendimmarrjen në procesin e dialogut, në të cilin Kuvendi do ta shprehte nëpërmjet rezolutës vendosmërinë e vet për ndarjen e qartë të roleve dhe ekskluzivitetin vendimmarrës që do të duhej t'i takonte Kuvendit, siç e kemi propozuar edhe ne, pastaj vijnë diskutimet për platformën, për përfaqësimin, e kështu me radhë, gjë që u dëgjuan edhe sot nga disa prej deputetëve.

Dhe tash, meqenëse u fol sot për çështje të ndryshme, atëherë më duhet disa prej tyre edhe t'i shtroj në këtë fjalë të fundit timen.

Para se të hyj në to, natyrisht që unë jam i gatshëm të takohem dhe mendoj se është e domosdoshme që të takohemi me përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare, në mënyrë që ta diskutojmë tekstin e rezolutës dhe plotësimin eventual të saj para se ta hedhim në votim në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pra, konsideroj që grupet parlamentare, kushdo që ka propozime për ta plotësuar atë rezolutë që kemi propozuar ne, ose atë tekst që kemi propozuar ne, do të duhej që këtë ta bënim në një takim, ose më shumë takime nëse ka nevojë, në mënyrë që t'i japim shans një harmonizimi dhe pajtueshmërie me tekstin e tekstin e rezolutës në përgjithësi.

Këtu u thanë disa gjëra, pati edhe akuza, që besa edhe personale, karshi meje, por nuk po merrem me to. Dua që t'i trajtoj disa prej çështjeve që u dëgjuan këtu. Një herë na u tha që 2/3-at janë problematike, sepse edhe po të votohej një vendim nga 2/3-at e Kuvendit ai prapë nuk do të thotë që është vendim i mirë, që është e vërtetë. Pra, ka shumë vendime që janë votuar me 2/3-at e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës e që kanë qenë vendime jashtëzakonisht të dëmshme për Republikën e Kosovës, përfshirë marrëveshjen e vitit 2013, që është ratifikuar këtu në Kuvend dhe e cila, siç e përmendi edhe zoti Konjufca, i shkakton probleme jashtëzakonisht të mëdha Republikës së Kosovës, ose marrëveshja për demarkacionin, që po ashtu është votuar me 2/3-at, e kështu me radhë, të mos hyj në secilën marrëveshje.

Dhe pastaj, u tha nga i njëjti grup politik që duhet të diskutojmë këtu edhe si Kuvend ta ndalim Hashim Thaçin dhe si Kuvend t'i shtojmë kërkesa Serbisë. Po pra! Këtë po e themi edhe ne. Si kuvend duhet ta marrim përgjegjësinë përmbi dialogun dhe si Kuvend vendimet i marrim me votë, dhe si Kuvend, për të qenë të sigurt që vendimet do të jenë në të mirë të Republikës së Kosovës, ose për ta synuar një vendimmarrje të tillë, duhet ta kemi votën e theksuar, pra votën e kualifikuar 2/3-at, këtë po e themi edhe ne. Nëse ku Kuvend vendos nëpërmjet rezolutës që nuk ka person të mandatuar aktualisht që përfaqëson Republikën e Kosovës në negociatën me Serbinë, atëherë ne nuk kemi negociatën me Serbinë, përderisa të vendos Kuvendi që kjo është platforma e negociatave dhe ky është personi.

Po çfarë ndodhë në ndërkohë? Në ndërkohë, derisa ne po themi që Kuvendi duhet ta ndalë Hashim Thaçin po i vazhdon negociatat. Prandaj, ky Kuvend duhet t'i thotë Hashim Thaçit "Ti

nuk je i thirrur për një çështje të tillë”. Aktualisht, Kuvendi nuk e ka një fjalë të tillë të votuar dhe Kuvendi do të duhej ta votonte këtë rezolutë, e cila thotë që deri më tash nuk ka të mandatuar e në momentin kur e mandaton me 2/3-at e Kuvendit ai person, ose ata persona do të jenë përfaqësuesit e Republikës së Kosovës në procesin e dialogut. Mirëpo, kjo nuk mund të vijë para se të diskutojmë njëherë për platformën dhe në të t’i vendosim edhe kërkesat karshi Serbisë me të gjitha ato që u përmendën këtu pajtohem, edhe kohën kur duhet të fillojnë negociatat dhe pajtohem se nuk duhet të ngutemi dhe s’kemi pse të ngutemi, edhe cilat janë synimet e Republikës së Kosovës nga ky proces negociator.

Pra, Kuvendi do të vendosë kur të fillojë procesi negociator, për çka flitet në këto negociata, a duhet të shkojmë e të dialogojmë me Serbinë dhe në fund, kush të na përfaqësojë atje dhe si e mbikëqyrim në këtë përfaqësim dhe këtë proces. Këto i kemi të gjitha në rezolutën që e kemi propozuar ne. Tash, ka mundësi që dikush e keqkupton qëllimshëm, sepse do ta përdorë për të sulmuar dikë, ka mundësi që dikush e keqkupton paqëllimshëm, sepse nuk e ka lexuar me vëmendje. Por, sidoqoftë, e ndjeva të nevojshme dhe të rëndësishme që edhe një herë ta shpjegoj tekstin e rezolutës dhe atë që ajo mendon të arrijë në këtë Kuvend të Republikës së Kosovës.

Dhe tash, natyrisht u fol këtu për produktin mbase më problematik që ka ndodhur, ose i cili rrjedh prej se ka filluar ky proces negociator, në vitin 2011, ose 2012, dhe ai është Bashkësia e Komunave me shumicë serbe. Duhet ta kemi të qartë një gjë. Ajo që është dakorduar në vitin 2013 dhe ajo që është përmbushur në vitin 2015, ose është substancializuar dhe detajuar në vitin 2015, është Bashkësi e Komunave me shumicë serbe, nuk është asociacion dhe ka dallim në mes të bashkësisë dhe asociacionit, këtë duhet ta bëjmë të qartë. Dhe e dyta, aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese që i referohet marrëveshjes, të cilën zoti Shala po e quan politike, për Bashkësinë e Komunave me shumicë serbe. Ai aty e problematizon në shumë rrafshe Bashkësinë e Komunave me shumicë serbe, po e problematizon veçanërisht në dy aspekte: karakterin etnik të saj dhe kompetencat ekzekutive të saj. Tash këtu është një gjë interesante. Te kompetencat ekzekutive, veçanërisht te zotimi që e bën pushteti qendror i republikës së Kosovës që t’i bartë kompetenca shtesë organeve të Bashkësisë së Komunave me shumicë serbe, kurdo që ajo shihet e nevojshme. Kjo nga Gjykata Kushtetuese shihet si niveli i tretë i pushtetit, që e përmbys rendin kushtetues të Republikës së Kosovës, aktualisht të organizuar në dy nivele të pushtetit, pra qendror dhe lokal, dhe i cili është i papranueshëm, sepse e ndryshon Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kjo pikë është e kopjuar nga marrëveshja e vitit 2013, në mos gabofsha atje është pika 5, ose 6, e Marrëveshjes së vitit 2013, që nënkupton se edhe marrëveshja e vitit 2013 paska qenë në shpërputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, që do të thotë se ky Kuvend që e ka ratifikuar atë marrëveshje si ndërkombëtare, ka qenë i lajthitur sepse nuk është informuar që ajo marrëveshje është në shpërputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës e që nënkupton se Kuvendi i Republikës së Kosovës, hajde ta themi kështu but, pavetëdijshëm e ka shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Dhe tash, çfarë bëjmë ne? Këto po i konstatojmë si

probleme, por a nuk do të duhej t'i marrim masat që këtë radhë, ky Kuvend i Republikës së Kosovës të mos bëjë shkelje të pavetëdijshme të Kushtetutës së Republikës dhe të mos bëjë as shkelje të vetëdijshme të Kushtetutës së Republikës. Dhe po, në platformën që do ta miratojmë këtu do të dakordohemi dhe mund të dakordohemi, që cilido rezultat i këtij procesi negociator do të shkojë në votë popullore në referendum.

Siç e dëgjova të thoshte përfaqësuesi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e në mos gabofsha, edhe përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje. Ato janë për platformën dhe aty dakordohemi në këtë platformë të cilën e votojmë me 2/3-at, me votë të kualifikuar, për tërë procesin dhe mënyrën se si institucionet e Republikës së Kosovës do të sillen karshi këtij procesi. Por ama, është jashtëzakonisht e rëndësishme që këtu prapë fjalën përfundimtare dhe fillestare ta ketë Kuvendi i Republikës së Kosovës e veçanërisht është e rëndësishme se sigurisht ajo që është paraparë në rezolutën që e kemi propozuar ne, që Kuvendi të jetë i përfshirë në mbikëqyrje të procesit në vazhdimësi. Jo pra të votojë në rezolutë në fillim dhe pastaj të ratifikojë një marrëveshje në fund, sepse kështu po krijohet kjo e pavetëdijshmja shkelje e Kushtetutës. Ndërkohë që me angazhimin e përditshëm në mbikëqyrje, nuk po them në negociata, por në mbikëqyrje të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe me të drejtën e heqjes së mandatit për të mandatuarin, ose të mandatuarit për procesin e dialogut, Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka në dorë procesin e dialogut, si dhe sigurohet që në këtë proces të mos ketë kurrfarë devijimi, as nga kushtetutshmëria e vendit, as nga interesat e Republikës dhe më me rëndësi, nga platforma të cilën e ka miratuar vet për ta mbrojtur interesin e kësaj Republike. Nëse nuk e bëjmë këtë, cila është alternativa?

Alternativa është që Hashim Thaçi vazhdon procesin e dialogut, ne mblidhemi këtu dhe kundërshtojmë se si ai nuk bën ta udhëheq këtë dialog dhe në fund, na vjen një marrëveshje që kërkon të bëhet marrëveshje ndërkombëtare dhe pastaj ne e dimë se çfarë ndodh me deputetët individualisht dhe trys...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: I ke pasur pesë minuta, i shfrytëzove dhjetë. Edhe një minutë po ta jap, njëmbëdhjetë bëji.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Po e përmbyll. Pra, edhe një herë, konsideroj që është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe e domosdoshme që t'i përgjigjemi një pyetjeje të thjeshtë, e ajo është: A jemi ne si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dakord që t'ia veshim këtij institucioni, më të lartit organ legjislativ dhe platformës e forumit më të lartë demokratik të Republikës së Kosovës, përgjegjësinë ekskluzive karshi procesit të dialogut me Serbinë?

Për ne Partinë Socialdemokrate të Kosovës kjo është domosdoshmëri për t'ia mbrojtur interesin Republikës dhe secili grup parlamentar, kujtoj unë, do të duhej të mendonte në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kujtim, dëshiron edhe ti replikë, a? Mirë, mirë, të drejtë s'ka po... jo, jo, merre, merre, se edhe ai e ka shfrytëzuar më shumë, se... fol, fol,... Jo, jo, s'ka lidhje që ia ka përmendur emrin, por pas referuesit s'ka të drejtë.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, por tanimë duket që është e nevojshme ta përsëris për herën e tretë.

Gjykata Kushtetuese thotë që asociacioni s'mund të jetë monoetnik, një. Dhe dy, që s'mund të ketë kompetenca ekzekutive. Ndërkaq, sa i takon marrëveshjes së vitit 2013 mund të ketë kapërcime të kornizës që përcakton Kushtetuta jonë, mund të ketë dhe shkelje të Kushtetutës, por ua rikujtoj që Gjykata Kushtetuese nuk ka pranuar ta trajtojë atë duke konsideruar që s'është një materie për të.

Kurse, sa i takon rezolutës dhe asaj që propozon në esencë sponsori, mendoj se Kuvendi ka të drejtë kushtetuese të mbikëqyrë gjithçka që lidhet me politikën e jashtme dhe kjo do të thotë, që ka të drejtë të mbikëqyrë, kontrollojë në secilin rast Qeverinë dhe Kuvendi s'mund t'ia japë vetes me një rezolutë, të cilën e ka me bazë në Kushtetutë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ne i kemi në sallë 44 deputetë. Propozim-rezoluta nuk është harmonizuar në mes deputetëve. Kuorum për të votuar nuk kemi. Kemi edhe disa ligje për t'i miratuar, por nuk janë të ngutshme.

Meqenëse s'ka kuorum dhe nuk është Qeveria këtu, unë dua ta mbyll seancën këtu dhe dua të ju them që me këtë rast e mbyll edhe Sesionin pranveror.

Mirupafshim në fillimin e Sesionit vjeshtor sipas rregullave që kemi. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*